

Plani Kombëtar i Veprimit për Transparencën dhe Proporcionalitetin e Kritereve për Ushtrimin e Profesioneve të Rregulluara (për Zbatim të Nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE)

[02/2026]

Përgatitur nga: [Ministria e Arsimit]
Me mbështetjen e: Projekti i GIZ “Support to accession negotiations in economic chapters of the acquis” (SANECA)

Tabela e Përmbajtjes

1. HYRJE	6
1.1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT	6
1.2. BAZAT LIGJORE DHE KËRKESAT E BE-SË	7
1.2.1. Neni 59 i Direktivës 2005/36/KE	7
1.2.2. Neni 51 i Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian	8
1.2.3. Standarde të tjera relevante të BE-së	8
1.3. FUSHA E ZBATIMIT	8
1.3.1. Profesione dhe Sektorët e Mbuluar nga Planit i Veprimit	8
1.3.1.1. Ministria e Drejtësisë	9
1.3.1.2. Ministria e Punëve të Brendshme	9
1.3.1.3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	10
1.3.1.4. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Urdhri i Mjekut Veterinar	10
1.3.1.5. Ministria e Mjedisit	11
1.3.1.6. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	11
1.3.1.7. Ministria e Arsimit	12
1.3.1.8. Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve	12
1.3.1.9. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	13
1.3.1.10. Ministria e Financave	13
1.3.1.11. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	14
1.3.2. Pasqyrë e Tregut të Shërbimeve Profesionale dhe Tregut të Punës	14
1.3.2.1. Hyrje	14
1.3.2.2. Roli i Profesioneve të Rregulluara në Ekonomi	14
1.3.2.3. Identifikimi i barrierave	15
1.3.2.4. Përfitimet e Reformës së Planifikuar	15
1.3.2.5. Relevanca e Reformës për Lëvizshmërinë	15
1.3.2.6. Konkluzione	16
1.3.2.-1 Tabela me të dhëna empirike mbi tregun e punës	17
1.3.3. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit	19
2. METODOLOGJIA	20
2.1. IDENTIFIKIMI I PROFESIONEVE TË RREGULLUARA	21
2.2. VLERËSIMI I KRITEREVE PËR HYRJEN NË PROFESION, USHTRIMIN E TIJ DHE PAJTIMI ME ACQUIS	23
2.2.1. Procesi i Analizës	23
2.2.2. Krite për Vlerësimin	24
2.3. KONSULTIMET ME PALËT E INTERESIT	25
2.3.1. Konsultimi institucional dhe bashkë-hartimi i Planit të Veprimit	25
2.3.2. Konsultimi publik me palët e interesit [për t'u zhvilluar pas konsultimit publik]	26
3. PLANI I VEPRIMIT PËR NDRYSHIMET RREGULLATORE NË KUADËR TË NENIT 59 TË DIREKTIVËS 2005/36/KE	26

3.1. ANALIZA HORIZONTALE E TRANSPARENCËS, PROPORCIONALITETIT DHE MOBILITETIT PROFESIONAL	26
3.2. GJETJET SEKTORIALE DHE ÇËSHTJET PRIORITARE SIPAS PROFESIONEVE DHE AUTORITETEVE KOMPETENTE	28
3.2.1. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e drejtësisë	29
3.2.2 Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e punëve të brendshme	31
3.2.3. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e shëndetësisë dhe kujdesit social	33
3.2.4. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e veterinarisë	35
3.2.5. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e mjedisit	39
3.2.6. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e infrastrukturës dhe transporteve	41
3.2.6.1. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e inxhinierisë	41
3.2.6.2. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e transportit rrugor	44
3.2.6.3. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e transportit detar	46
3.2.6.4. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e transportit ajror	47
3.2.7 Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në fushën e arsimit parauniversitar	49
3.2.8. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e turizmit, kulturës dhe sporteve	51
3.2.8.1. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e turizmit	52
3.2.8.2. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e kulturës	54
3.2.8.2.1 Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e librit ndërmjetësimi letrar, krijimtarisë grafike dhe botimit	54
3.2.8.2.2. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore	56
3.2.8.3. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e sporteve	58
3.2.9. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e ekonomisë	60
3.2.9.1. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e zejtarisë	60
3.2.9.2. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e pronësisë industriale	63
3.2.10. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin financiar	66
3.2.10.1. Profesioni i agjentit (përfaqësuesit) doganor	66
3.2.10.2. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e auditimit ligjor dhe kontabilistit të miratuar	69
3.2.11. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e sigurimeve	71
4. ZBATIMI DHE MONITORIMI	74
4.1. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN	74
4.1.1. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e drejtësisë	74
4.1.2. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e Punëve të Brendshme	75
4.1.3. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e shëndetësisë dhe kujdesit social	76
4.1.3. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e veterinarisë	77
4.1.5. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e mjedisit	78
4.1.6. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e infrastrukturës dhe transporteve	80
4.1.8. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e turizmit, kulturës dhe sportit	81
4.1.9. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e ekonomisë	83
4.1.10. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin financiar	84
4.1.11. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e sigurimeve	85
4.2. MEKANIZMAT E MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT	85

4.2.1. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e drejtësisë.....	85
4.2.2. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e Punëve të Brendshme.....	86
4.2.3. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e shëndetësisë dhe kujdesit social.....	86
4.2.4. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e veterinarisë	87
4.2.5. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e mjedisit.....	88
4.2.6. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e infrastrukturës dhe transporteve	90
4.2.8. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e turizmit, kulturës dhe sportit.....	91
4.2.9. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e ekonomisë.....	92
4.2.10. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e financave.....	92
4.2.11. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e sigurimeve.....	93
5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	94
5.1. SEKTORI I DREJTËSISË.....	94
5.2. SEKTORI I PUNËVE TË BRENDSHME	95
5.3. SEKTORI I SHËNDETËSISË.....	96
5.4. SEKTORI I VETERINARISË.....	97
5.5. SEKTORI I MJEDISIT	98
5.6. SEKTORI I INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT	99
5.7. SEKTORI I ARSIMIT	100
5.8. SEKTORI I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT	101
5.9. SEKTORI I EKONOMISË DHE PRONËSISË INDUSTRIALE	102
5.10. SEKTORI I FINACAVE	103
5.11. SEKTORI I SIGURIMEVE.....	104
PLANI KOMBETAR I VEPRIMIT.....	106
PLANI I MASAVE – SEKTORI I DREJTËSISË.....	106
PLANI I MASAVE – SEKTORI I PUNËVE TË BRENDSHME	124
PLANI I MASAVE – SEKTORI I SHËNDETËSISË DHE KUJDESH SOCIAL.....	125
PLANI I MASAVE – SEKTORI I VETERINARISË	127
PLANI I MASAVE – SEKTORI I MJEDISIT	131
PLANI I MASAVE – SEKTORI I INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT	133
PLANI I MASAVE – SEKTORI I ARSIMIT	141
PLANI I MASAVE – SEKTORI I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT	144
PLANI I MASAVE – SEKTORI I EKONOMISË DHE PRONËSISË INDUSTRIALE.....	151
PLANI I MASAVE – SEKTORI I FINACAVE	157
PLANI I MASAVE – SEKTORI I SIGURIMEVE	160
6. ANEKSE:.....	162
6.1. LISTA E PROFESIONEVE TË RREGULLUARA	162
6.2. LISTA E PROGRAMEVE TË RREGULLUARA TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL SIPAS NENIT 11(C)(II) TË DIREKTIVËS 2005/36/KE.....	187

6.3. LISTA E PROFESIONEVE OBJEKT KONTROLI PARAPRAK SIPAS NENIT 7(4) TË DIREKTIVËS 2005/36/KE.	190
6.4. LISTA E PROFESIONEVE QË I NËNSHTROHEN KRITERIT TË SHTETËSISË NË PËRPUTHJE ME NENIN 51 TFBE.	196
6.5. PËRMBLEDHJE E KONSULTIMEVE ME PALËT E INTERESIT – RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK.	199

1. Hyrje

Plani Kombëtar i Veprimit për Transparencën dhe Proporcionalitetin e Kriteve për Ushtrimin e Profesioneve të Rregulluara është hartuar në kuadër të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, si instrument zbatues për përbushjen e kriteve përmbyllëse të Kapitullit 3 “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”. Ky plan përbën një produkt të domosdoshëm për zbatimin e nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE dhe adreson kërkesat e BE-së për transparencë dhe proporcionalitet në rregullimin e profesioneve të rregulluara.

Hartimi i këtij plani veprimi është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 dhe në planin e punës të Grupit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian për Kapitullin 3, me synimin që masat kryesore të përafrimit rregullator të planifikohen për t’u përbushur deri në vitin 2027, ndërsa konsolidimi institucional dhe administrativ të realizohet deri në vitin 2030, në përputhje me objektivin kombëtar për anëtarësim në BE.

Hartimi i Planit të Veprimit zhvillohet paralelisht me përgatitjen e ligjit të ri për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe testin e proporcionalitetit (planifikuar për miratim në tremujorin e parë të vitit 2026), i cili transponon Direktivën për Kualifikimet Profesionale dhe Direktivën për Testin e Proporcionalitetit, duke përfshirë edhe nenin 59 të Direktivës 2005/36/KE. Në këtë kuptim, Planin e Veprimit dhe kuadri i ri ligjor përbëjnë pjesë të së njëjtës reformë strukturore.

I gjithë procesi është mbështetur nga asistenca teknike e projektit GIZ SANECA, që ka kontribuar në zhvillimin e metodologjisë, koordinimin ndërinstitucional dhe analizën e profesioneve të rregulluara.

1.1. Qëllimi dhe Objektivat

Qëllimi i Planit Kombëtar të Veprimit është të përcaktojë masat konkrete për përafrimin e kuadrit ligjor dhe institucional të Shqipërisë me acquis të Bashkimit Evropian (BE) në fushën e profesioneve të rregulluara, në përputhje me nenin 59 të Direktivës 2005/36/KE. Planin synon të sigurojë që kërkesat për hyrjen dhe ushtrimin e profesioneve të rregulluara të jenë transparente, të justifikuara dhe proporcionale, duke eliminuar barrierat e panevojshme dhe duke lehtësuar lëvizjen e profesionistëve dhe shërbimeve.

Ky Plan Veprimi përbën një produkt të drejtpërdrejtë të detyrimit për zbatimin e nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE, i cili kërkon identifikimin e profesioneve të rregulluara, rishikimin e kërkesave kufizuese dhe planifikimin e ndërhyrjeve për përafrim me parimet e tregut të brendshëm të BE-së. Hartimi i tij zhvillohet paralelisht me procesin e përgatitjes së ligjit për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe testin e proporcionalitetit, i cili transponon Direktivën 2005/36/KE, përfshirë edhe nenin 59, dhe Direktivën (BE) 2018/958 duke e bërë Planin e Veprimit një instrument të domosdoshëm për zbatimin praktik të këtij kuadri të ri ligjor.

Objektivat kryesore janë:

- përafrimi i legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së në fushën e njohjes së kualifikimeve profesionale;
- rritja e transparencës dhe proporcionalitetit të kërkesave rregullatore për profesionet e rregulluara;
- lehtësimi i lëvizjes së profesionistëve dhe mbështetja e integritetit të tregut shqiptar të punës në tregun e përbashkët europian.

1.2. Bazat ligjore dhe kërkesat e BE-së

1.2.1. Neni 59 i Direktivës 2005/36/KE

Neni 59 i Direktivës 2005/36/KE përbën bazën ligjore të mekanizmit të transparencës për profesionet e rregulluara në BE. Ai kërkon që shtetet të identifikojnë profesionet e rregulluara, të publikojnë kushtet për hyrjen dhe ushtrimin e tyre dhe t'i nënshtrojnë këto kërkesa një rishikimi periodik, me qëllim garantimin e mosdiskriminimit, justifikimit nga interesi publik dhe proporcionalitetit.

Në thelb, neni 59 vendos tre detyrime kryesore. Së pari, shtetet duhet të njoftojnë Komisionin Europian për listën e profesioneve të rregulluara dhe aktivitetet që mbulon secili profesion, si dhe për programet e arsimit dhe formimit të rregulluar sipas nenit 11(c)(ii) të Direktivës 2005/36/KE, që përfshijnë programe të strukturuar profesionale pas arsimit të mesëm, por jo universitare. Çdo ndryshim në këto lista duhet të komunikohet pa vonesë, për të garantuar transparencë publike në nivel të BE-së.

Së dyti, shtetet duhet të njoftojnë profesionet që kërkojnë kontroll paraprak të kualifikimeve për ofrimin e përkohshëm të shërbimeve sipas nenit 7(4) të Direktivës 2005/36/KE, duke dhënë arsytim të posaçëm për secilin rast, veçanërisht kur lidhet me mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë publike. Ky mekanizëm zbatohet vetëm për shërbimet e përkohshme ndërkufitare dhe përjashton profesionet që i nënshtrohen njohjes automatike ose regjimeve të tjera të posaçme të Direktivës.

Së treti, neni 59 kërkon rishikimin sistematik të të gjitha kërkesave që kufizojnë hyrjen ose ushtrimin e një profesioni, mbi bazën e tre parimeve themelore: mosdiskriminimit, justifikimit nga arsye madhore të interesit publik dhe proporcionalitetit. Ky rishikim synon të verifikojë nëse kufizimet janë të nevojshme dhe të përshtatshme për objektivin që ndjekin, apo nëse përbëjnë barriera të panevojshme për mobilitetin profesional dhe funksionimin e tregut të brendshëm.

Detyrimet e nenit 59 zbatohen njësoj edhe për profesionet e rregulluara nga shoqata profesionale, në përputhje me nenin 3(2) të Direktivës.

Në këtë kuadër, neni 59 lidhet drejtpërdrejt me nenin 11(c)(ii), që përcakton kategorinë e formimit profesional të strukturuar që duhet të njoftohet, dhe me nenin 7(4), që rregullon kontrollin paraprak të kualifikimeve për shërbimet e përkohshme. Këto dispozita operacionalizojnë mekanizmin e

transparencës duke lidhur rregullimin e profesionit me arsimin, trajnimet dhe verifikimin e kualifikimeve.

1.2.2. Neni 51 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian

Neni 51 i TFBE lejon një përjashtim të ngushtë nga liria e vendosjes dhe ofrimit të shërbimeve vetëm për ato funksione që përbëjnë ushtrim të drejtpërdrejtë të autoritetit publik. Ky përjashtim interpretohet ngushtë nga Gjykata e Drejtësisë së BE-së dhe zbatohet “sipas detyrave”, jo “sipas profesioneve”. Çdo kriter shtetësie duhet të justifikohet në mënyrë konkrete dhe të kalojë testin e proporcionalitetit, ndërsa pjesa tjetër e veprimtarisë mbetet plotësisht brenda rregullave të tregut të brendshëm.

1.2.3. Standarde të tjera relevante të BE-së

Përveç Direktivës 2005/36/KE, rregullimi i profesioneve ndikohet edhe nga Direktiva (BE) 2018/958 për testin e proporcionalitetit, e cila kërkon vlerësim *ex ante* dhe rishikim periodik të çdo mase që kufizon hyrjen ose ushtrimin e një profesioni, si dhe nga Direktiva 2006/123/KE për shërbimet, që vendos rregulla horizontale për autorizimet, mosdiskriminimin dhe proporcionalitetin. Për profesione të caktuara ekzistojnë gjithashtu akte sektoriale, si direktivat për avokatinë (Direktiva 98/5/KE dhe Direktiva e Këshillit 77/249/KEE dhe për auditimin ligjor (Direktiva 2006/43/EC)).

Në tërësi, ky kuadër i BE-së kërkon transparencë të plotë, verifikim të proporcionalitetit dhe kufizime minimale, duke siguruar që rregullimi i profesioneve të mbrojë interesin publik pa cenuar lirinë e lëvizjes dhe konkurrencën. Këto parime përbëjnë bazën metodologjike të këtij Plani Veprimi.

1.3. Fusha e Zbatimit

1.3.1. Profesione dhe Sektorët e Mbuluar nga Plani i Veprimit

Procesi i zbatimit të nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE ka kërkuar, si hap fillestar, identifikimin sistematik të profesioneve të rregulluara dhe të sektorëve përkatës të shërbimeve profesionale, me qëllim ndërtimin e një panorame të plotë të fushës së ndërhyrjes rregullatore dhe përcaktimin e objektit material të Planit Kombëtar të Veprimit. Evidentimi i profesioneve është zhvilluar në përputhje me metodologjinë për shqyrtimin e transparencës dhe proporcionalitetit.¹ Në përfundim të këtij procesi janë identifikuar **337 profesione të rregulluara**, të shpërndara sipas autoriteteve

¹ Metodologji për hartimin e planit kombëtar të veprimit për transparencën dhe proporcionalitetin e kriterëve për ushtrimin e profesioneve të rregulluara (në zbatim të nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale) (Kapitulli 3 i Negociatave). Shkurt 2025, hartuar nga Ministria e Arsimit me mbështetjen e SANECA.

përgjegjëse rregullatore dhe sektorëve përkatës. Lista shteruese e profesioneve të identifikuar pasqyrohet në **Aneksin 1** të Planit të Veprimit.

Për secilin autoritet përgjegjës janë evidentuar: (i) profesionet e konfirmuara si të rregulluara; (ii) profesionet potenciale për shqyrtim (profesione “të dyshuara”); si dhe (iii) kriteret përkatëse të hyrjes në profesion dhe ushtrimit të tij. Kjo ndarje sipas autoriteteve rregullatore përbën bazën operacionale për masat e Planit të Veprimit të kërkuar nga neni 59 i Direktivës 2005/36/KE, duke mundësuar planifikimin e ndërhyrjeve të synuara për rritjen e transparencës dhe verifikimin e proporcionalitetit të kërkesave rregullatore.

1.3.1.1. Ministria e Drejtësisë

Sipas gjetjeve të validuara të procesit të transparencës dhe proporcionalitetit, Ministria e Drejtësisë mbulon një grup profesionesh të strukturuar përmes dhomave profesionale dhe autoriteteve të specializuara. Ministria e Drejtësisë (MD) rregullon drejtpërdrejt 3 profesione, 1 profesion rregullohen nga Agjencia Kombëtare e Falimentimit, që është institucion varësie nga MD, dhe 5 profesione rregullohen nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë, që është një organizëm krejt i pavarur nga MD, Dhoma Kombëtare e Noterëve, Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, të cilat organizohen të pavarura, por bashkëpunojnë me ministrinë e Drejtësisë në terma të rregullimeve të kriterëve profesionale, mbikëqyrjes dhe masave disiplinore. Inventari përfshin gjithsej 9 profesione: avokatët, noterët, ndihmës noterët, përmbauesit gjyqësorë privatë, ndërmjetësuesit, ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme, përkthyesit zyrtarë, interpretët e gjuhës së shenjave dhe administratorët e falimentimit. Për këto profesione janë identifikuar të gjitha kërkesat ligjore për hyrjen dhe ushtrimin e veprimtarisë, duke përfshirë kualifikimet, përvojën, procedurat e licencimit dhe standardet e integritetit profesional.

Analiza është fokusuar në transparencën e kuadrit rregullator, koherencën e roleve të autoriteteve kompetente dhe përputhjen e kërkesave me parimet e mosdiskriminimit, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të përcaktuara nga neni 59 i Direktivës 2005/36/KE. Ky vlerësim ka konfirmuar se profesionet juridike dhe shërbimet e lidhura me autoritet publik kërkojnë dokumentim të qartë të kushteve të ushtrimit dhe justifikim të kriterëve që lidhen me interesin publik.

1.3.1.2. Ministria e Punëve të Brendshme

Sipas gjetjeve të validuara në procesin e transparencës dhe proporcionalitetit, Ministria e Brendshme mbulon dy profesione të rregulluara: punonjësit e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe profesionin e zjarrfikësit. Të dy profesionet kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me sigurinë publike dhe kërkojnë mbikëqyrje të vazhdueshme administrative, për shkak të natyrës së tyre që prek rendin publik dhe mbrojtjen e jetës e të pasurisë. Analiza ka vlerësuar kërkesat për licencim, përgatitjen profesionale dhe kriteret e integritetit, duke shqyrtuar nëse ato janë të justifikuara, proporcionale dhe në përputhje me kuadrin evropian të rregullimit të shërbimeve të sigurisë dhe emergjencave.

Përveç 2 profesioneve të konfirmuara si profesione të rregulluara (zjarrfikësi dhe punonjësi i shërbimit privat të sigurisë fizike), gjatë procesit u ngritën dyshime edhe për 2 role të tjera të lidhura me subjektet e autorizuar nga MPB: drejtuesi teknik i subjektit për shërbimet private të sigurisë fizike dhe drejtuesi teknik i subjektit për veprimtarinë e lejuar me armë. Megjithatë, nga

analiza rezulton se këto role nuk përmbushin kriteret e nenit 3 të Direktivës 2005/36/KE për t'u kualifikuar si "profesione të rregulluara", pasi lidhen me funksione të brendshme organizative dhe përgjegjësi teknike brenda subjekteve të licencuara, dhe jo me rregullimin e një profesioni të veçantë për hyrje dhe ushtrim individual. Për rrjedhojë, inventari për këtë sektor përfshin vetëm 2 profesione të rregulluara. Inventari përfundimtar i këtij sektori i ofron administratës një bazë të qartë për verifikimin e domosdoshmërisë së kërkesave rregullatore dhe përgatitjen e hapave të nevojshëm në Planin Kombëtar të Veprimit, në përputhje me neni 59 të Direktivës 2005/36/KE dhe standardet e BE-së.

1.3.1.3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas gjetjeve të validuara, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) mbulon 14 profesione të rregulluara, nga të cilat 11 të organizuara sipas rregullatorëve profesionalë. Nën Urdhrin e Mjekëve, profesionet e mjekut të përgjithshëm dhe mjekut të specializuar janë konfirmuar si profesione të rregulluara me instrumente të plota vlerësimi. Urdhri i Stomatologut mbulon stomatologun dhe stomatologun me specialitet, ndërsa Urdhri i Farmacistëve administron profesionin e farmacistit. Urdhri i Infermierit përfshin një gamë profesionesh paramjekësore: infermierin, logopedin, teknikun e laboratorit, imazheristin, fizioterapistin dhe mamin, të cilat janë të gjitha pjesë e inventarit të rregulluar dhe të vlerësuara për kriteret profesionale dhe të licencimit. Profesionin e psikologut, nën mbikëqyrjen e Urdhrit të Psikologut, është gjithashtu i rregulluar dhe pjesë e analizës së transparencës. Urdhri i Punonjësve Socialë mbulon profesionin e punonjësit social, ku instrumenti i vlerësimit është përgatitur dhe kërkon verifikim të praktikës së licencimit. Përveç këtyre profesioneve të konfirmuara, rregullatori ka identifikuar dy profesione të tjera në shqyrtim – kujdestarin për fëmijë dhe kujdestarin e personave me aftësi të kufizuara – të cilat konsiderohen "të dyshuar" dhe kërkojnë konfirmim të mëtejshëm për t'u përcaktuar si profesione të rregulluara sipas nenit 3 të Direktivës 2005/36/KE. Në tërësi, kjo ministri drejtpërdrejt dhe nëpërmjet 6 urdhërave profesionale, të organizuar në formën e enteve publike jobuxhetore, mbulon profesionet mjekësore, stomatologjike, farmaceutike, infermiore, paramjekësore, psikologjike dhe të kujdesit social, duke siguruar një strukturë rregullatore që garanton standarde profesionale, cilësi të shërbimit dhe përputhje me acquis për profesionet shëndetësore dhe ato të mirëqenies sociale, jo-mjekësore.

1.3.1.4. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Urdhri i Mjekut Veterinar

Sipas gjetjeve të validuara, inventari i profesioneve nën përgjegjësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e cila në bashkëpunim me Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar Shqiptar përfshin profesionet e veterinerit, farmacistit veterinar, teknikëve veterinarë dhe teknikëve të ndërimit, të gjitha të konfirmuara si profesione të rregulluara. Këto profesione mbulojnë hallkat kryesore të kujdesit shëndetësor veterinar, kontrollit të sigurisë ushqimore dhe përgatitjes profesionale të specializuar në sektorin e blegtorisë dhe bujqësisë. Instrumentet e transparencës dhe proporcionalitetit janë përgatitur për secilin profesion. Profesionin "i dyshuar" në këtë rast është ndihmës veterineri për të cilin nuk jepen qartë në legjislacion kualifikimet që duhet të zotërojë.

1.3.1.5. Ministria e Mjedisit

Sipas inventarit, Ministria e Mjedisit, përmes edhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mbulon 7 profesione të specializuar që veprojnë në fushat e mbrojtjes së mjedisit, vlerësimit të ndikimit dhe menaxhimit të mbetjeve. Profesionet e identifikuar përfshijnë operatorin e mjedisit, ekspertin për vlerësimin e ndikimit në mjedis, transportuesin e mbetjeve, tregtarin e mbetjeve dhe agjentin e mbetjeve. Këto profesione luajnë rol thelbësor në zbatimin e legjislacionit mjedisor, mbrojtjen e ekosistemeve, kontrollin e ndotjes dhe garantimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve, duke kërkuar standarde të qarta profesionale dhe kriteret e verifikueshme licencimi. Analiza e këtij sektori është përqendruar në transparencën e kërkesave ligjore, justifikimin e standardeve profesionale dhe proporcionalitetin e kriterëve të ushtrimit, me synim sigurimin e mbrojtjes së mjedisit dhe respektimin e detyrimeve të legjislacionit europian. Inventari final siguron bazën për përfshirjen e këtyre profesioneve në Planin Kombëtar të Veprimit, në përputhje me kërkesat e nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE dhe standardet e BE-së për mbrojtjen e mjedisit dhe politikat e qëndrueshme.

1.3.1.6. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Inventari i profesioneve nën përgjegjësinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përfshin tre grupe rregullatore: 6 profesionet e transportit rrugor nën Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), 14 profesionet detare nën Drejtorinë e Përgjithshme Detare (DPD) dhe 9 profesionet e aviacionit civil nën Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC), si dhe një grup të gjerë prej 26 profesioneve inxhinierike në fushat e ndërtimit, energjisë, minierave dhe burimeve natyrore.

Nën DPSHTRR, profesionet e rregulluara përfshijnë shoqëruesin teknik të mjeteve, mësuesit e teorisë dhe instruktorët e praktikës për drejtimin e mjeteve, përgjegjësin teknik për autoriparues, profesionistin për shitblerjen e mjeteve, përdoruesin e makinerive të rënda dhe taksistin.

Në fushën detare, janë identifikuar profesionet e kapitenit, oficerëve detarë të kuvertës dhe të makinerisë, inxhinierëve detarë (në nivele të ndryshme), operatorëve të radiokomunikimit dhe personelit teknik të kualifikuar, të cilat kërkojnë standarde të larta sigurie dhe certifikimi.

Në aviacionin civil, profesionet e operatorit të aerodromit, operatorit të avionit, koordinatorit të aeroportit, kontrollorit të trafikut ajror, kontrollorit mjekësor ajror, kontrollorit të ekuipazhit, pilotit, ekuipazhit të kabinës, instruktorit dhe ekzaminuesit të fluturimit janë konfirmuar si pjesë e inventarit të profesioneve të rregulluara. Një grup i gjerë profesioneve inxhinierike – arkitektë, urbanistë, inxhinierë të ndërtimit (përfshirë profilet strukturist, transport dhe gjeoteknik), inxhinierë elektrikë, mekanikë, kimikë, mjedisi, hidroteknikë, gjeologë, gjeodetë, inxhinierë të minierave, naftës, proceseve industriale, navale dhe burimeve natyrore – janë gjithashtu të rregulluara dhe përfshijnë role kyçe në sigurinë teknike dhe funksionimin e infrastrukturës kritike.

Analiza e transparencës dhe proporcionalitetit është fokusuar në justifikimin e kërkesave të licencimit, standardet e sigurisë teknike, kompetencën profesionale dhe përputhjen me acquis në sektorët e transportit, ndërtimit, energjisë dhe minierave, duke siguruar një inventar të plotë për integrimin në Planin Kombëtar të Veprimit.

1.3.1.7. Ministria e Arsimit

Sipas inventarit të validuar, Ministria e Arsimit mbulon një grup të gjerë profesionesh të mësimdhënies në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, ku përfshihen rreth 28 specialitete mësuesish: mësuesit e arsimit parashkollor dhe fillor, si dhe mësuesit e fushave të ndryshme mësimore: arte figurative, biologji, biologji–kimi, edukim fizik, fizikë, gjeografi, gjuhë angleze, frënge, greke, italiane, gjermane, gjuhë shqipe dhe letërsi, histori, histori–gjeografi, histori–gjeografi–edukatë, informatikë, instrument muzikor, kimi, matematikë, matematikë–fizikë, matematikë–informatikë, shkenca sociale dhe mësues të arsimit special.

Në kuadër të arsimit profesional, profesioni i instruktorit të arsimit profesional – si në komponentin praktik, ashtu edhe atë teorik – është identifikuar si profesion i rregulluar në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit. Analiza e këtij sektori është përqendruar në kërkesat e kualifikimit, kriteret pedagogjike dhe format e ushtrimit të profesionit, duke siguruar përputhjen me standardet e formimit të mësuesve dhe kërkesat e BE-së për kompetenca profesionale dhe cilësi të mësimdhënies.

1.3.1.8. Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve mbulon tre kategori profesionesh: profesionet e turizmit, profesionet e kulturës dhe profesionet e sporteve. Në fushën e turizmit, janë identifikuar 10 profesione: ajo e udhërrëfyesit turistik (kombëtar, lokal, të specializuar dhe të nderit), operatorit turistik, agjentit turistik, operatorit turistik detar, transportuesit turistik dhe vrotuesit të plazhit, të cilat kërkojnë standarde të qarta të kualifikimit dhe certifikimit, me qëllim garantimin e sigurisë së vizitorëve, cilësisë së shërbimit dhe integritetit profesional gjatë ofrimit të shërbimeve turistike.

Në fushën e kulturës rregullohen 23 profesione, nga të cilat, profesione si agjenti letrar, art-grafisti dhe botuesi. Në këtë sektor Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve operon në bashkëpunim të ngushtë me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore për rregullimin e profesioneve si konservatori, restauratori, rikualifikuesi i veprave artistike dhe monumenteve, si edhe profesionet e arkeologjisë dhe nënndarjet e saj, të cilat janë vlerësuar për kërkesat teknike dhe profesionale që lidhen me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe ruajtjen e standardeve të specializimit në sektorin kulturor.

Ndërkohë, në fushën e sportit janë konfirmuar si profesione të rregulluara 4 profesione: sportisti profesionist, specialisti i sportit, trajneri i sportit dhe instruktori i skive, të cilët kërkojnë kriteret specifike të përgatitjes fizike dhe profesionale, si dhe procedura të mirëpërcaktuara licencimi.

Analiza mbi këtë sektor të gjerë është përqendruar në transparencën e kushteve të licencimit, justifikimin dhe proporcionalitetin e kërkesave profesionale në turizëm, kulturë dhe sport, duke siguruar përputhjen me acquis dhe krijimin e një inventari të konsoliduar për integrimin e profesioneve përkatëse në Planin Kombëtar të Veprimit. Në këtë fushë ministria e linjës vepron në bashkëpunim me federatat e sportit.

1.3.1.9. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit mbulon një gamë shumë të gjerë profesioneesh të rregulluara, të organizuara në disa fusha kryesore ekonomike dhe teknike. Në fushën e pronësisë industriale, nën mbikëqyrjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, rregullohen 4 profesione: profesionet e përfaqësuesve të autorizuar dhe ekspertëve të patentave, dizenjove industriale, markave tregtare dhe treguesve gjeografikë janë konfirmuar si profesione të rregulluara që kërkojnë aftësi të specializuara juridike dhe teknike.

Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, si rregullator sektorial, së bashku me Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), mbulon një numër shumë të madh (rreth 167) zanatesh —artizanale, mekanike, elektrike, gastronomike, tekstile, përpunimi druri, metali, përpunimi të gurit dhe materialeve të ndërtimit, profesione të hotelieri—turizmit, profesione të bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit, profesione të inxhinierisë së nivelit të mesëm, profesione të industrisë ushqimore, kimike, të naftës, të gazit dhe të materialeve ndërtimore, si dhe profesione të teknologjisë së informacionit. Në këto profesione ka kompetenca arsimore edhe Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, përgjegjëse për arsimin e formimin profesional të strukturuar dhe katalogimin e kualifikimeve profesionale.

Gjithashtu nën AKAFPK rregullohen edhe 2 profesione: ai i instruktorit të praktikës dhe instruktorit të teorisë dhe praktikës në arsimin profesional. Këto profesione janë vlerësuar për kriteret e tyre të kualifikimit, kërkesat teknike dhe procedurat e licencimit, me qëllim garantimin e sigurisë, cilësisë së prodhimit dhe funksionimit të qëndrueshëm të tregut të brendshëm.

Analiza metodologjike është përqendruar në justifikimin e domosdoshmërisë së rregullimit për secilin grup profesioneesh, në vlerësimin e proporcionalitetit të kërkesave profesionale dhe në përputhjen me acquis për inovacionin, konkurrueshmërinë dhe tregtinë e shërbimeve. Inventari i konsoliduar i këtij rregullatori siguron një bazë të plotë për integrimin e sektorit ekonomik dhe artizanal në Planin Kombëtar të Veprimit nën nenin 59 të Direktivës 2005/36/KE.

1.3.1.10. Ministria e Financave

Sipas inventarit të validuar, Ministria e Financave mbulon profesionin e agjentit doganor, nën kompetencën e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe profesionet e audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar, të rregulluara nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, i cili është një autoritet rregullator i pavarur, por anëtarët e Bordit emërohen nga Ministri i Financave dhe organet profesionale përkatëse, si Instituti i Ekspertëve Kontabël të Miratuar (IEKA) dhe Instituti i Kontabilistëve të Miratuar (IKM), të organizuar në formën e shoqatave. Analiza e transparencës dhe proporcionalitetit është përqendruar në vlerësimin e kërkesave të licencimit, standardeve të pavarësisë profesionale dhe mekanizmave të mbikëqyrjes, duke siguruar përputhjen me acquis për auditimin, raportimin financiar dhe kontrollin doganor. Inventari i këtij sektori përbën bazë të qartë për integrimin në Planin Kombëtar të Veprimit dhe harmonizimin me direktivat e BE-së në fushën e shërbimeve financiare dhe doganore.

1.3.1.11. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Sipas gjetjeve të validuara, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mbulon një grup prej 5 profesioneve të lidhura me tregjet e sigurimeve dhe shërbimeve financiare, të cilat përfshijnë aktuarin, vlerësuesin e dëmeve në sigurime, agjentin e sigurimeve (për sigurimet e jetës dhe jo-jetës) dhe brokerin e sigurimeve. Ndërsa emërtimet: agjent i lidhur i shoqërive administruese të fondeve të pensioneve dhe agjentin e lidhur të shoqërive komisionere nga shqyrtimi i hollësishëm rezultojnë të jenë persona juridikë, që në ushtrimin e aktivitetit të tyre tregtar rregullohen nga normat urdhëruese të tregut në të cilin operojnë dhe nuk janë profesione të rregulluara në kuptim të nenit 3 të Direktivës 2005/36/KE.

Për të gjitha këto profesione janë përgatitur instrumentet përkatëse të transparencës dhe proporcionalitetit. Analiza është fokusuar në kërkesat e licencimit dhe standardet e ushtrimit profesional, duke vlerësuar domosdoshmërinë e kritereve të vendosura, integritetin profesional dhe mbrojtjen e konsumatorit në një treg që konsiderohet i rrezikshëm dhe i rregulluar në mënyrë të posaçme.

1.3.2. Pasqyrë e Tregut të Shërbimeve Profesionale dhe Tregut të Punës

1.3.2.1. Hyrje

Tregu i shërbimeve profesionale luan një rol kyç në zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e interesit publik dhe ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë për qytetarët. Profesioneve të rregulluara, të cilat kërkojnë zotërimin e një kualifikimi të veçantë dhe pajisjen me licencë apo tjetër formë autorizimi, përfaqësojnë një element thelbësor të këtij tregu, duke garantuar standarde profesionale, siguri dhe besueshmëri. Në Shqipëri, legjislati mbi profesioneve të rregulluara ka evoluar në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian, veçanërisht nenin 59 të Direktivës 2005/36/KE, me qëllim rritjen e transparencës, proporcionalitetit dhe mobilitetit të profesionistëve. Ky seksion analizon rolin, strukturën dhe barrierat në tregun e shërbimeve profesionale në Shqipëri, duke evidentuar sfidat ekzistuese dhe përfitimet e mundshme nga reforma e planifikuar.

1.3.2.2. Roli i Profesioneve të Rregulluara në Ekonomi

Profesioni i rregulluar është çdo profesion që kërkon kualifikim të veçantë dhe autorizim/licencë për ushtrim. Në BE, Neni 59 i Direktivës 2005/36/KE vendos transparencën dhe proporcionalitetin si parime bazë, duke kërkuar publikimin e listave, justifikimin e kërkesave ligjore dhe vlerësime *ex ante* për çdo ndryshim. Rezultatet përfshijnë databazën RegProf, raporte krahasuese dhe plane veprimi, me impakte në mobilitet, konkurrencë dhe qartësi rregullatore, ndërsa sfidat lidhen me zbatimin e pabarabartë dhe mungesën e të dhënave të detajuara.

Në Shqipëri, Ligji Nr. 10171/2009 për profesioneve të rregulluara dhe aktet nënligjore përcaktojnë kriteret e ushtrimit si arsimimi, licencimi, aftësia mendore/fizike dhe përvoja praktike. Profesioneve të rregulluara përfshijnë sektorë si shëndetësia, arsimi, drejtësia, ndërtimi dhe inxhinieria, duke kontribuar në cilësi të shërbimeve profesionale ndaj perfituesve/konsumatorit dhe mbrojtje të interesit publik. Ato përfaqësojnë rreth 9% të PBB-së dhe mbi 20% të fuqisë punëtore në BE, ndërsa në Shqipëri shënohet rritje e vazhdueshme sidomos në shëndetësi dhe drejtësi.

Profesionet e rregulluara përfaqësojnë 8 - 9% të punësimit total dhe kontribuojnë drejtpërdrejt me 4 - 5% dhe deri 10% indirekt në GDP. Numri më i madh i profesionistëve gjendet në arsimin parauniversitar (36,321 mësues) dhe shëndetësi (23,800 infermierë; 9,105 mjekë). Paga mesatare mujore bruto e tyre është 15 - 30% më e lartë se mesatarja kombëtare prej 77,485 lekë (për vitin 2024). Reforma e transparencës dhe proporcionalitetit synon të ulë barrierat, të rrisë konkurrencën, mobilitetin dhe cilësinë e shërbimeve profesionale.

1.3.2.3. Identifikimi i barrierave

Barrierat kryesore që kufizojnë hyrjen dhe ushtrimin e profesioneve të rregulluara në Shqipëri lidhen me kohëzgjatjen e gjatë të formimit, procedurat burokratike të licencimit, kufizimet ligjore për format e ushtrimit dhe kërkesat për shtetësi, të cilat shpesh rezultojnë disproporcionale krahasuar me praktikatat e BE-së. Pasojat përfshijnë mungesa të profesionistëve në sektorë strategjikë, shtyrje të hyrjes së të rinjve në treg, rritje të çmimeve për qytetarët dhe bizneset, frenim të inovacionit dhe vështirësi në mobilitetin ndërkombëtar. Përvoja e vendeve të BE-së tregon se liberalizimi i pjesshëm ka rritur konkurrencën dhe cilësinë e shërbimeve, ndërsa Shqipëria mbetet më restriktive, duke krijuar asimetri me tregun e vetëm evropian. Në tërësi, barrierat aktuale kufizojnë konkurrencën dhe efikasitetin, ndërsa reforma e proporcionalitetit shihet si domosdoshmëri për zhvillim më të balancuar.

1.3.2.4. Përfitimet e Reformës së Planifikuar

Reforma për transpozimin e nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE në Shqipëri bazohet në parimet e transparencës dhe proporcionalitetit. Transparenca siguron rregulla të qarta e të aksesueshme, duke reduktuar korrupsionin dhe rritur besimin te institucionet, ndërsa proporcionaliteti garanton që kufizimet ligjore të jenë të arsyeshme, duke lehtësuar hyrjen në treg, forcuar konkurrencën dhe nxitur inovacionin. Reforma pritet të sjellë përfitime të shumta: rritje të ofertës së profesionistëve, ulje të kostove për qytetarët dhe bizneset, lehtësim të mobilitetit brenda dhe jashtë vendit, integrim më të mirë me tregun e BE-së, si dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve. Lehtësimi i barrierave të panevojshme (provime shtesë, kosto të larta certifikimi) do të rrisë konkurrencën, do të ulë çmimet dhe do të zgjerojë shërbimet e disponueshme, duke reduktuar informalitetin dhe forcuar regjistrimin ligjor e fiskal. Megjithatë, ekziston rreziku i uljes së cilësisë dhe presionit mbi pagat, ndaj reforma duhet të shoqërohet me monitorim dhe trajnime të vazhdueshme për ruajtjen e standardeve profesionale.

1.3.2.5. Relevanca e Reformës për Lëvizshmërinë

Reformat për transpozimin e nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE ndikojnë drejtpërdrejt në lëvizshmërinë e profesionistëve shqiptarë. Harmonizimi i licencimit dhe njohja e kualifikimeve sipas standardeve të BE-së lehtëson ushtrimin e profesionit jashtë vendit, duke rritur mundësitë për mobilitet ndërkombëtar dhe akses në tregun e vetëm evropian. Në nivel kombëtar, reforma përmirëson mobilitetin e brendshëm, duke lehtësuar shpërndarjen e profesionistëve nga zonat urbane drejt atyre rurale dhe duke ulur pabarazitë rajonale, sidomos në shëndetësi dhe arsim. Ekonomikisht, lëvizshmëria e rritur nxit konkurrencën, ul kostot, përmirëson cilësinë e shërbimeve dhe e pozicionon Shqipërinë si një treg më të integruar me BE, më atraktiv për investime dhe më të besueshëm në rajon.

1.3.2.6. Konkluzione

Reformat për transpozimin e nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE synojnë krijimin e një tregu profesional më të hapur dhe efikas, ku hyrja dhe ushtrimi i profesioneve të rregulluara bazohet në kriteret të qarta dhe të harmonizuara me standardet evropiane. Duke respektuar parimet e transparencës dhe proporcionalitetit, ato lehtësojnë hyrjen e profesionistëve të rinj, rrisin konkurrencën, përmirësojnë cilësinë e shërbimeve dhe nxisin mobilitetin ndërkombëtar. Kështu, Shqipëria rrit eficiencën dhe drejtësinë në tregun profesional, duke forcuar integrimin në tregun e përbashkët evropian dhe pozicionimin si partner i besueshëm në rajon.

1.3.2.-1 Tabela me të dhëna empirike mbi tregun e punës

Të dhënat mbi profesionet e rregulluara në Shqipëri tregojnë përqendrim në sektorët kryesorë të arsimit dhe shëndetësisë, me 36.321 mësues dhe 23.800 infermierë, si dhe prani të mjekëve, stomatologëve, farmacistëve, noterëve dhe ekspertëve kontabël. Regjistrat ofrojnë informacion mbi shpërndarjen profesionale, gjinore dhe gjeografike. Gratë dominojnë në infermieri dhe mësuesi (mbi 70%), ndërsa në drejtësi dhe inxhinieri pjesëmarrja e tyre është nën 40%, duke reflektuar pabarazi gjinore. Profesionet janë të përqendruara kryesisht në Tiranë dhe qytetet e mëdha, ndërsa zonat rurale vuajnë nga mungesa e profesionistëve, sidomos në shëndetësi dhe arsim. Ky përqendrim urban krijon pabarazi rajonale, ndërsa reforma e transparencës dhe proporcionalitetit synon të lehtësojë mobilitetin dhe të balancojë shpërndarjen e shërbimeve.

Tabela 1. Numri i profesionistëve të rregulluar sipas profesioneve dhe kontributi në punësim² dhe GDP³

Profesioni	Ministria/Urdhri	Numri i profesionistëve	Paga mesatare mujore (ALL)	Kontributi në punësim	Kontribut i vlerësuar në GDP
Mësues parauniversitarë	Ministria e Arsimit	36,321	84,000	3.6%	~36 mld ALL/vit ≈ 1.5% GDP
Mjekë	Urdhri i Mjekëve	9,105	120,000	0.9%	~13 mld ALL/vit ≈ 0.6% GDP
Infermierë	Urdhri i Infermierëve	23,800	65,000	2.4%	~18.5 mld ALL/vit ≈ 0.8% GDP
Stomatologë	Urdhri i Stomatologëve	3,927	100,000	0.4%	~4.7 mld ALL/vit ≈ 0.2% GDP
Farmacistë	Urdhri i Farmacistëve	2,920	100,000	0.3%	~3.5 mld ALL/vit ≈ 0.15% GDP
Mami	Urdhri i Infermierëve	3,500	65,000	0.35%	~2.7 mld ALL/vit
Fizioterapistë	Urdhri i Infermierëve	2,171	70,000	0.2%	~1.8 mld ALL/vit
Teknikë imazherie	Urdhri i Infermierëve	880	65,000	0.09%	~0.7 mld ALL/vit
Logopedë	Urdhri i Infermierëve	261	65,000	0.03%	~0.2 mld ALL/vit

² Të punësuar vlerësohen të jenë 1.177.245 persona në 2024 (Instat, 2025).

https://www.instat.gov.al/media/ebwma5bq/tregu_i_punes_2024_final.pdf

³ GDP nominale (2025) 29.94 miliardë USD. <https://www.worldometers.info/gdp/albania-gdp>

Psikologë	Urdhri i Psikologëve	1,577	88,000	0.16%	~1.7 mld ALL/vit
Punonjës socialë	Urdhri i Punonjësve Socialë	518	88,000	0.05%	~0.55 mld ALL/vit
Noterë	Dhoma e Noterisë	420	88,800	0.04%	~0.45 mld ALL/vit
Përmbaues privatë	Ministria e Drejtësisë	152	88,800	0.015%	~0.16 mld ALL/vit
Avokatë	Dhoma e Avokatëve	~5,000	88,800	0.5%	~5.3 mld ALL/vit
Ndërmjetës të pasurive të paluajtshme	Ministria e Drejtësisë	1615	65,000	0.14 %	~1.26 mld ALL/vit
Auditues ligjorë	IEKA	261	88,800	0.03%	~0.28 mld ALL/vit
Ekspertë kontabël	IKM	432	88,800	0.04%	~0.46 mld ALL/vit
Inxhinierë/ndërtim	Ministria e Infrastrukturës	4,240	67,000	0.42%	~3.4 mld ALL/vit

Gjatë dekadës së fundit, profesionet e rregulluara në Shqipëri kanë pasur zhvillime të ndryshme: numri i infermierëve është rritur gradualisht për shkak të emigracionit dhe mungesës së profesionistëve vendas; avokatët janë shtuar pas liberalizimit të arsimit, por tregu mbetet i fragmentuar dhe me sfida cilësie; noterët kanë ruajtur stabilitet për shkak të kontrollit institucional; psikologët kanë pësuar rritje të dukshme pas vitit 2015, të nxitur nga kërkesa sociale dhe programet e reja universitare; stomatologët kanë shënuar rritje të qëndrueshme në zonat urbane, duke reflektuar kërkesën për shërbime private. Faktorët socialë dhe migracioni ndikojnë kryesisht në infermierë e psikologë, ndërsa ndryshimet ligjore në noterë e avokatë. Liberalizimi i arsimit ka rritur furnizimin me profesionistë, shpesh pa u përshtatur me kërkesën reale të tregut, duke e bërë të domosdoshëm një rregullim më të balancuar dhe vlerësim periodik të nevojave. Një sfidë mbetet mungesa e të dhënave të plota dhe të standardizuara mbi profesionet e rregulluara.

1.3.3. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit

Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit mbështetet në një strukturë institucionale shumë-nivelëshe, që përfshin ministri linje, autoritete publike rregullatore, si dhe organe vetërregulluese profesionale. Në total, nga analiza sektoriale rezultojnë rreth 337 profesione të rregulluara, të shpërndara ndër rreth 33 institucione, ndërmjet të cilave 10 ministri linje, 4 dhoma profesionale në fushën e drejtësisë dhe 1 dhome në fushën e ekonomisë, 6 urdhrave profesionalë dhe 11 autoriteteve publike rregullatore, nga të cilat; 4 agjenci kombëtare; 1 institut kombëtar; 4 drejtori të përgjithshme; 3 autoritetet të pavarura rregullatore, nga të cilat, Autoriteti i Aviacionit Civil nën MIE, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, i pavarur, por emërimi i anëtarëve nga MF; dhe, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, krejtësisht i pavarur, sipas listës shteruese të paraqitur në **Aneksin 1** të Planit të Veprimit.

Roli qendror koordinues për zbatimin e Planit të Veprimit i takon Ministrisë së Arsimit, e cila siguron koherencën horizontale ndërmjet institucioneve, ndjek progresin e masave dhe mbështet raportimin sipas kërkesave të nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE. Ministrinë e linjës mbulojnë sektorët përkatës të profesioneve të rregulluara, ndërsa në disa fusha rregullimi realizohet përmes autoriteteve të varura, organeve të pavarura ose strukturave vetërregulluese.

Ministria e Drejtësisë është drejtpërdrejt përgjegjëse për tre profesione dhe, në mënyrë indirekte, përmes Agjencisë Kombëtare të Falimentimit mbikëqyr një profesion shtesë, ndërsa në bashkëpunim me katër Dhomat Kombëtare profesionale (Avokatia, Nateria, Përmbartimi Gjyqësor Privat dhe Ndërmjetësimi) merr pjesë në rregullimin dhe mbikëqyrjen e pesë profesioneve të tjera, duke e çuar totalin në 9 profesione në këtë sektor.

Ministria e Brendshme rregullon 2 profesione në fushën e sigurisë private dhe mbrojtjes civile.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale rregullon drejtpërdrejt 2 profesione, nga 14 profesione që janë identifikuar në sektorin e shëndetësisë, ndërsa pjesa tjetër e profesioneve të shëndetit administrohet përmes urdhrave profesionalë.

Në këtë kuadër funksionojnë 6 urdhra profesionalë, në formën e enteve publike jobuxhetore, të cilët mbulojnë gjithsej 11 profesione: Urdhri i Mjekëve (mjek i përgjithshëm dhe mjekë të specializuar), Urdhri i Infermierëve (gjashtë profesione), Urdhri i Farmacistëve (një profesion), Urdhri i Stomatologut (një profesion), dhe Urdhri i Psikologut (një profesion); Urdhri i Punonjësit Social (një profesion).

Ministria e Bujqësisë, si ministri linje në bashkëpunim me Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar, një ent publik jobuxhetor i pavarur, mbulon 4 profesionet veterinare. Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar rregullon dhe mbikëqyr 4 profesione të rregulluara si dhe një profesion me status të papërcaktuar siç është ai i asistentit veterinar, që ekziston si emërtesë, por nuk ka rregullim konkret.

Ministria e Mjedisit, drejtpërdrejt ose përmes Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, mbikëqyr 7 profesione në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë përfaqëson sektorin më të gjerë, me rreth 26 profesione nën përgjegjësinë direkte të saj, si dhe profesione të administruara nga autoritete në varësi ose të pavarura: Autoriteti i Aviacionit Civil mbulon 9 profesione, Drejtoria e Përgjithshme Detare 14 profesione dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor 6 profesione, duke e çuar totalin në 55 profesione në këtë sektor.

Ministria e Arsimit rregullon profesionin e mësuesit, i strukturuar në rreth 28 specialitete lëndësh në arsimin parauniversitar, si dhe bashkëpunon me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit për profesionet e instruktorëve të formimit profesional.

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve mbulon rreth 37 profesione, të shpërndara në tre fusha: rreth 23 profesione në kulturë, ndër të cilat 21 mbikëqyren nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, 10 profesione në turizëm dhe 4 profesione në sport.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit mbulon 2 profesione në fushën e arsimit profesional, rreth 167 profesione në fushën e zejeve dhe shërbimeve ekonomike në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Zejtarisë, si dhe 4 profesione të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, duke arritur në rreth 173 profesione gjithsej në këtë sektor.

Ministria e Financave, përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, rregullon profesionin e agentit doganor, ndërsa Bordi i Mbikëqyrjes Publike, si autoritet rregullator i pavarur me anëtarë të emëruar nga Ministri i Financave, mbulon dy profesione në fushën e auditimit dhe kontabilitetit, duke arritur 3 profesione të rregulluara në fushën e financave.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si institucion i pavarur, rregullon dhe mbikëqyr 5 profesione në sektorin e shërbimeve financiare dhe të sigurimeve.

Kjo shpërndarje e gjerë institucionale reflekton kompleksitetin e sistemit shqiptar të profesioneve të rregulluara dhe nënvizon nevojën për koordinim të fortë ndër-institucional, standardizim të praktikave rregullatore dhe zbatim të njëtrajtshëm të parimeve të transparencës dhe proporcionalitetit në të gjithë sektorët, në përputhje me kërkesat e nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE.

2. Metodologjia

Ky Plan Kombëtar Veprimi është hartuar në zbatim të Metodologjisë për Transparencën dhe Proporcionalitetin e Kriteve për Ushtrimin e Profesioneve të Rregulluara (Shkurt 2025), përgatitur nga Ministria e Arsimit (MA) në kuadër të Kapitullit 3 të negociatave dhe të nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE, me mbështetjen e projektit SANECA. Metodologjia përfshin kuadrin metodologjik bazë, 10 shtojca dhe 3 instrumente standarde (Transparenca; Shqyrtimi i Kriteve për Ushtrimin e Profesionit; Proporcionaliteti në formatin excel). Ndër Shtojcat u përfshinë formatet e inventarizimit të rregullatorëve dhe palëve të interesit, model ftesat dhe agjendat për rregullatorët dhe grupet e tjera të interesit, udhëzues për plotësimin e instrumenteve, udhëzues

specifikë për nenin 11(c)(ii), nenin 7(4) të Direktivës 2005/36/KE dhe nenin 51 TFBE, modelin e Planit të Veprimit dhe dokumentet për konsultim publik, si dhe kalendari i aktiviteteve.

Procesi është konceptuar dhe zbatuar në disa faza të njëpasnjëshme. Pas fazës paraprake të identifikimit dhe angazhimit të rregullatorëve dhe palëve të interesit, Faza 1 e cila për efekt praktik dhe kohor u bashkua dhe njehsua me fazën e dytë të përcaktuar në metodologji, u fokusua, përveç takimeve shpjeguese me rregullatorët, në shqyrtimin e transparencës dhe identifikimin shterues të profesioneve të rregulluara përmes Instrumentit 1 dhe vijoi me shqyrtimin e kriterëve për ushtrimin e profesionit dhe vlerësimin e proporcionalitetit, përmes Instrumenteve 2 dhe 3, duke analizuar kërkesat e hyrjes, licencimit dhe ushtrimit të profesionit në raport me parimet e mosdiskriminimit, justifikimit për interes publik dhe proporcionalitetit. Gjatë kësaj faze MA realizoi veprimtari koordinuese dhe ofroi asistencë teknike për rregullatorët. Në Fazën 2, që i korrespondon fazës së tretë të parashikuar në metodologji: rezultatet e fazës së parë u përkthyen në masa konkrete ligjore dhe administrative për përafrim, të strukturuar në Tabelën e Masave të Planit të Veprimit. Fazat pasuese parashikojnë konsultimin publik, miratimin dhe monitorimin e zbatimit.

MAS ka ushtruar rolin drejtues dhe koordinues të procesit, duke zhvilluar kuadrin metodologjik, duke ofruar mbështetje teknike për rregullatorët dhe duke siguruar standardizimin dhe kontrollin e cilësisë së të dhënave të dorëzuara. Rregullatorët sektorialë kanë qenë përgjegjës për identifikimin e profesioneve, plotësimin e instrumenteve, vlerësimin e kriterëve dhe formulimin e masave përkatëse për përafrim me acquis. Gjatë Fazës së dytë në praktikë janë zhvilluar takime teknike dhe konsultime online dhe fizike me rregullatorët, përgjatë muajve gusht – tetor 2025, për validimin e gjetjeve dhe diskutimin e masave që përfshihen në Planin e Veprimit.

Në këtë mënyrë, Plani Kombëtar i Veprimit përfaqëson rezultatin përfundimtar të një procesi të strukturuar metodologjik, ku gjetjet e transparencës dhe proporcionalitetit janë përdorur drejtpërdrejt për përcaktimin e ndërhyrjeve rregullatore të nevojshme për përafrim me acquis të BE-së.

2.1. Identifikimi i Profesioneve të Rregulluara

Identifikimi i profesioneve të rregulluara u zhvillua në kuadër të Fazës 1 të metodologjisë – Shqyrtimi i Transparencës – e cila ka për qëllim mbledhjen e informacionit të plotë dhe të standardizuar mbi profesionet e rregulluara në Shqipëri. Procesi u drejtua nga MA, e cila shpërndau Udhëzuesin metodologjik dhe Instrumentin 1 – Transparenca, duke udhëzuar rregullatorët për identifikimin dhe dokumentimin e profesionit sipas kërkesave të nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE.

Në këtë kuadër, rregullatorët kryen identifikimin e profesioneve në bazë të aktit ligjor ose nënligjor që normon hyrjen dhe ushtrimin e profesionit. Për secilin profesion, ata shqyrtuan legjislacionin sektorial, rregulloret profesionale dhe praktikën administrative që përcaktojnë titullin e mbrojtur, aktivitetet e rezervuara, sipas rastit, dhe kushtet e ushtrimit. Identifikimi u mbështet gjithashtu në burimet kombëtare referencë, përfshirë Regjistrin Informativ të Lejeve dhe Licencave të QKB-së,⁴

⁴ Shih <https://qkb.gov.al/info-licenca/regjistri-informativ/> (Aksesuar 30.1.2026).

Listën Kombëtare të Profesioneve,⁵ Listën e Profesioneve Zejtare,⁶ Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale⁷ dhe Udhërrëfyesin e Profesioneve të Rregulluara të MA.⁸

Instrumenti 1 – Transparenca u përdor për të mbledhur të dhënat në një format të unifikuar. Rregullatorët raportuan: emërtimin e profesionit, kuadrin rregullator kombëtar, lidhjet me dokumentet zyrtare të disponueshme publikisht, llojin e rregullimit (rezervë titulli, aktiviteti apo të dyja), sistemin e njohjes sipas Direktivës 2005/36/KE, nëse lejohet ushtrimi i përkohshëm nga profesionistët e huaj, nivelin e kualifikimit të kërkuar, nevojën për kontroll paraprak të kualifikimeve para ofrimit për herë të parë të shërbimeve profesionale në mënyrë të përkohshme dhe institucionet kompetente për rregullimin dhe informimin mbi profesionin. Raportimi përfshiu gjithashtu përshkrimin e aktiviteteve të ushtruara dhe të rezervuara për profesionin.

MA verifikoi informacionin e dorëzuar nga rregullatorët, siguroi saktësinë dhe plotësinë e tij dhe finalizoi të dhënat në bashkëpunim me institucionet përkatëse, duke ndërtuar një bazë të strukturuar dhe të standardizuar të profesioneve të rregulluara në Shqipëri. Kjo bazë të dhënash përbën produktin kryesor të Fazës së parë dhe krijon themelin teknik për adresimin e kërkesave të Closing Benchmark për Kapitullin 3,⁹ veçanërisht në lidhje me përfundimin e përafrimit me acquis për njohjen e kualifikimeve profesionale, eliminimin e kërkesave të shtetësisë dhe forcimin e kapaciteteve administrative.

Rezultatet e Fazës 1 materializohen në **Aneksin 1** të Planit të Veprimit, i cili paraqet listën shteruese të profesioneve të rregulluara dhe të aktiviteteve që u rezervohen atyre, çka krijon lehtësi për standardizim dhe klasifikim sipas kriterëve ISCO-08 për profesionet dhe NACE Rev.2 për aktivitetet ekonomike. Kjo fazë mundësoi gjithashtu përgatitjen e anekseve tematike përkatëse, përfshirë listën e programeve të rregulluara të arsimit dhe formimit profesional sipas nenit 11(c)(ii), listën e profesioneve potencialisht objekt kontrolli paraprak sipas nenit 7(4), si dhe listën e profesioneve që kërkojnë justifikim për mbajtjen e krierit të shtetësisë mbi bazën e ushtrimit të autoritetit publik sipas nenit 51 TFBE.

Justifikimi i rezervimit të aktiviteteve, i kërkesave për hyrje në profesion dhe i kriterëve të ushtrimit të profesionit është zhvilluar më tej në Fazën 2, përmes Instrumenteve 2 dhe 3, duke operacionalizuar testin e proporcionalitetit dhe duke përgatitur bazën për masat konkrete të përafrimit të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit.

⁵ VKM nr. 714, date 20.9.2017, FZ 169/2017.

⁶ VKM nr. 578, datë 22.7.2020, FZ 139/2020.

⁷ Urdhër Nr. 99, datë 25.5.2021 "Për Miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale" (Ndryshuar me urdhrin nr. 289, datë 29.12.2022; nr. 241 datë 23.10.2023; nr. 645, datë 28.8.2024; nr. 936, datë 31.7.2025) FZ 87/2021; 13/2023; 163/2023; 155/2024; 151/2025.

⁸ Udhërrëfyesi "Për harmonizimin me Acquis (legjisllacionin evropian) për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale" (Kapitulli 3) Përgatitur me mbështetjen e projektit të GIZ "Mbështetje për negociatat e anëtarësimit në kapitujt ekonomikë të Acquis" (SANECA) dhe ICON Institut GmbH. Nëntor 2022.

⁹ Shih, Accession Document- European Union Common Position, Cluster 2: Internal Market, Conference on Accession to the European Union – Albania, Brussels, 11 April 2025 (OR. en), AD 4/25 LIMITE, CONF-ALB 4. f. 8.

2.2. Vlerësimi i kriterëve për hyrjen në profesion, ushtrimin e tij dhe pajtimi me acquis

Faza e dytë e ushtrimit u fokusua në vlerësimin e kriterëve që rregullojnë hyrjen dhe ushtrimin e profesionit, me synim të sigurohej se ato janë të nevojshme, të justifikuara dhe në përputhje me kërkesat e Direktivës 2005/36/KE. Ky vlerësim u realizua përmes një metodologjie të strukturuar, të cila kombinon shqyrtimin e kuadrit ligjor, analizën e praktikave administrative dhe krahasimin me acquis të BE-së. Procesi u udhëhoq nga MA dhe u mbështet në Instrumentin 2 dhe Instrumentin 3 të metodologjisë, të cilat mundësuan mbledhjen dhe analizimin sistematik të informacionit për secilin profesion.

2.2.1. Procesi i Analizës

Procesi i analizës për vlerësimin e përputhshmërisë së kriterëve për hyrjen dhe ushtrimin e profesioneve me kërkesat e nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE u zhvillua në disa hapa të njëpasnjëshëm, të konceptuar për të siguruar qartësi metodologjike, trajtim të njëtrajtshëm ndërsektorial dhe lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet gjetjeve analitike dhe masave të Planit të Veprimit.

Së pari, rregullatorët plotësuan Instrumentin 2, përmes të cilit u inventarizuan në mënyrë të strukturuar të gjitha kriteret dhe kufizimet ligjore e administrative që kushtëzojnë hyrjen në profesion dhe ushtrimin e tij. Ky instrument mbulon kërkesat e kualifikimit dhe formimit profesional, përvojën, procedurat e autorizimit dhe regjistrimit, kufizimet administrative, si dhe praktikatat e përbashkëta dhe mekanizmat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale. Analiza u krye për secilin kriter dhe kufizim veçmas, me qëllim identifikimin e mospërputhjeve konkrete dhe krijimin e një harte të plotë të barrierave ekzistuese për çdo profesion.

Së dyti, rezultatet e Instrumentit 2 u vlerësuan në dritën e testit të parashikuar nga neni 59 i Direktivës 2005/36/KE, duke shqyrtuar për secilin kriter respektimin e parimeve të mosdiskriminimit dhe domosdoshmërisë. Ky hap shërbeu për të evidentuar masat që nuk justifikohen nga arsye madhore të interesit publik ose që krijojnë pengesa të panevojshme për aksesin dhe ushtrimin e profesionit.

Së treti, për çdo kriter të raportuar u aplikua analiza e proporcionalitetit përmes Instrumentit 3, në përputhje me Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit. Rregullatorët vlerësuan në mënyrë sistematike përshtatshmërinë e masës, nevojshmërinë e saj dhe ekzistencën e alternativave më pak kufizuese, duke demonstruar lidhjen midis çdo kërkesë rregullatore dhe mbrojtjes së një arsye madhore të interesit publik, si siguria publike, shëndeti, mbrojtja e konsumatorit ose integriteti i profesionit. Gjithashtu, u analizua edhe efekti kumulativ i masave, nëse përbën barrierë të panevojshme për hyrje në profesion ose ushtrimin e tij.

Së katërti, të gjitha të dhënat iu nënshtruan verifikimit dhe konsolidimit nga Ministria e Arsimit, për të siguruar interpretim të njëtrajtshëm të kuadrit ligjor dhe të kriterëve ndërmjet sektorëve, si dhe për të identifikuar boshllëqe, mbivendosje ose kërkesa të tepruara që kërkonin ndërhyrje.

Ky proces i integruar i shqyrtimit të kriterëve (Instrumenti 2) dhe i proporcionalitetit (Instrumenti 3), i ndërtuar mbi testin e nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE dhe Direktivën 2018/958, mundësoi

identifikimin e mospërputhjeve konkrete dhe formulimin e masave të synuara rregullatore, të cilat janë reflektuar drejtpërdrejt në Planin Kombëtar të Veprimit.

2.2.2. Kriteria për Vlerësimin

Kriteret për vlerësimin e rregullimit të profesioneve janë përcaktuar në metodologjinë e Ministrisë së Arsimit dhe bazohen drejtpërdrejt në testin e parashikuar nga neni 59 i Direktivës 2005/36/KE. Procesi i vlerësimit është ndërtuar në dy faza analitike të ndërlidhura. Faza 1, përmes Instrumentit 1, ka adresuar kriterin e transparencës. Faza 2, përmes Instrumenteve 2 dhe 3, ka adresuar kriteret e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. Në mënyrë transversale, gjatë gjithë procesit është zbatuar edhe kriteri i mosdiskriminimit, në përputhje me nenin 59 të Direktivës 2005/36/KE dhe nenin 51 TFBE.

a) Transparenca (Faza 1 – Instrumenti 1)

Kriteri i transparencës është vlerësuar në Fazën 1 përmes Instrumentit 1 dhe lidhet me qartësinë, aksesueshmërinë dhe koherencën e kuadrit rregullator për çdo profesion. Vlerësimi ka përfshirë identifikimin dhe emërtimin e saktë të profesionit, qartësinë e bazës ligjore, publikimin dhe aksesin në aktet rregullatore, trajtimin e barabartë të profesionistëve vendas dhe të huaj, si dhe dokumentimin e aktiviteteve të rezervuara për secilin profesion.

Kjo fazë ka mundësuar ndërtimin e listës shteruese të profesioneve të rreguluara (Aneksi 1 i Planit të Veprimit) dhe krijimin e një baze të unifikuar informacioni mbi kuadrin rregullator përkatës, duke përbërë themelin analitik për vlerësimin e kriterëve dhe proporcionalitetit në Fazën 2.

b) Domosdoshmëria (Faza 2 – Instrumenti 2 dhe 3)

Kriteri i domosdoshmërisë është shqyrtuar në Fazën 2 përmes Instrumentit 2, i cili është fokusuar në tre grupe elementesh:

- (i) kriteret e kualifikimit profesional (arsimimi, formimi, përvoja, provimet dhe licencimi);
- (ii) kufizimet administrative për hyrjen dhe ushtrimin e profesionit; dhe
- (iii) praktikrat e përbashkëta dhe mekanizmat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale.

Për secilin prej këtyre elementeve, rregullatorët kanë raportuar masat ekzistuese dhe janë ftuar të shpjegojnë funksionin e tyre rregullator. Analiza është kryer për çdo kriter dhe kufizim veçmas, me qëllim vlerësimin nëse masa justifikohet nga një arsye madhore e interesit publik, si siguria publike, shëndeti, mbrojtja e konsumatorit apo integriteti i profesionit, dhe nëse ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet masës dhe rrezikut që synohet të parandalohet.

Ky hap ka lejuar identifikimin e kërkesave që nuk mbështeten në arsye objektive të interesit publik ose kanë krijuar barrierë të panevojshme dhe ka përgatitur bazën për formulimin e masave korrigjuese në Planin Kombëtar të Veprimit.

c) Proporcionaliteti (Faza 2 – Instrumenti 3)

Proporcionaliteti është vlerësuar në të njëjtën fazë përmes Instrumentit 3, i cili operacionalizon testin e proporcionalitetit në përputhje me Direktivën (BE) 2018/958. Ky instrument përfshin një set prej njëmbëdhjetë pyetjesh analitike, përmes të cilave rregullatorët kanë vlerësuar, ndër të tjera: mungesën e diskriminimit, arsyet madhore të interesit publik, rreziqet që synohen të minimizohen, funksionimin praktik të masave, efektet konkrete të tyre, qëndrueshmërinë e objektivave të ndjekura, kompleksitetin e aktiviteteve të rezervuara, efektin kumulativ (të përbashkët) të masave, si dhe ekzistencën e alternativave më pak kufizuese.

Për secilën masë është shqyrtuar përshtatshmëria, nevojshmëria dhe intensiteti i saj, si dhe ndikimi mbi aksesin në profesion, konkurrencën dhe ofrimin e shërbimeve. Ky vlerësim ka qenë vendimtar për identifikimin e masave joproportionale që kërkojnë thjeshtim, rishikim ose heqje dhe për përkthimin e gjetjeve në masa konkrete në Planin e Veprimit.

d) Mosdiskriminimi (kriter transversal)

Gjatë të gjitha fazave të procesit është zbatuar kriteri transversal i mosdiskriminimit, me fokus të posaçëm në kërkesat mbi bazë shtetësie ose vendbanimi, në përputhje me nenin 59 të Direktivës 2005/36/KE dhe nenin 51 TFBE. Ky shqyrtim ka shërbyer për identifikimin e kufizimeve diskriminuese dhe për përcaktimin e masave për eliminimin e tyre.

Zbatimi i kombinuar i Fazës 1 dhe Fazës 2, përmes Instrumenteve 1, 2 dhe 3, ka krijuar bazën analitike për përcaktimin e ndërhyrjeve konkrete rregullatore dhe formulimin e masave të synuara në Planin Kombëtar të Veprimit.

2.3. Konsultimet me Palët e Interesit

2.3.1. Konsultimi institucional dhe bashkë-hartimi i Planit të Veprimit

Procesi i transparencës dhe proporcionalitetit për profesionet e rregulluara u zhvillua mbi bazën e një konsultimi të strukturuar institucional, të udhëhequr nga Ministria e Arsimit, në përputhje me metodologjinë e miratuar. Ky konsultim kishte për qëllim sigurimin e një baze të plotë dhe të standardizuar informacioni, harmonizimin e interpretimit të kuadrit rregullator dhe ndërtimin e një qasjeje të përbashkët për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit.

Në këtë proces u përfshinë të gjithë rregullatorët sektorialë përgjegjës për profesionet e rregulluara, përfshirë ministrinë e linjës, autoritetet rregullatore të pavarura dhe organet profesionale, të cilët vepruan si bashkë-hartues të Planit të Veprimit. MA koordinoi procesin përmes shpërndarjes së udhëzuesve metodologjikë, organizimit të takimeve teknike dhe ofrimit të mbështetjes së vazhdueshme metodologjike për plotësimin e Instrumenteve 1, 2 dhe 3.

Rregullatorët kontribuan duke identifikuar profesionet nën kompetencë, duke raportuar kriteret e hyrjes dhe ushtrimit të profesionit, si dhe duke vlerësuar domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masave ekzistuese. Paralelisht, MA siguroi verifikimin dhe harmonizimin e të dhënave, asistencë për interpretimin e kërkesave të Direktivës 2005/36/KE dhe njëtrajtësimin e qasjeve ndërsektoriale.

Ky bashkëpunim institucional mundësoi realizimin e ushtrimit kombëtar të identifikimit të profesioneve të rregulluara, ndërtimin e listës shteruese të tyre (**Aneksi 1**), si dhe evidentimin e

masave konkrete për përafrim me *acquis*, të cilat janë përmbledhur në tabelën e Planit të Veprimit. Konsultimi institucional shërbeu gjithashtu për identifikimin e sfidave praktike të zbatimit, përfshirë kapacitetet administrative, praktikat e ndryshme të licencimit dhe nevojën për përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Në këtë kuptim, procesi i konsultimit institucional nuk ka pasur vetëm karakter informues, por ka përbërë mekanizmin kryesor të bashkë-hartimit të Planit të Veprimit dhe të formulimit të masave rregullatore, duke reflektuar realitetin sektorial dhe përgjegjësitë konkrete të secilit rregulator.

2.3.2. Konsultimi publik me palët e interesit [për t'u zhvilluar pas konsultimit publik]

Plani Kombëtar i Veprimit do t'i nënshtrohet konsultimit publik me palët e interesit, përfshirë shoqatat profesionale, profesionistët individualë, subjektet ekonomike dhe aktorë të tjerë relevantë, në përputhje me Fazën 4 të metodologjisë.

Kjo fazë synon të mbledhë komente dhe sugjerime mbi masat e propozuara, të verifikojë ndikimin praktik të tyre dhe të forcojë legjitimitetin e ndërhyrjeve rregullatore përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë të aktorëve të prekur.

Rezultatet e konsultimit publik do të dokumentohen në Raportin e Konsultimit Publik, i cili do të përfshihet si **Aneksi 5** i Planit të Veprimit, dhe do të shërbejnë për finalizimin e masave dhe përshtatjen e tyre sipas nevojës, përpara miratimit përfundimtar të dokumentit.

3. Plani i Veprimit për Ndryshimet Rregullatore në kuadër të Nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE

3.1. Analiza horizontale e transparencës, proporcionalitetit dhe mobilitetit profesional

Ky nënseksion paraqet sintezën horizontale të rezultateve të shqyrtimit të transparencës dhe proporcionalitetit të profesioneve dhe veprimtarive të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, bazuar në Instrumentet 1–3. Të dhënat profesion-për-profesion dhe kriter-për-kriter pasqyrohen në instrumentet shoqëruese (format Excel), ndërsa në këtë pjesë identifikohen modelet mbizotëruese të rregullimit, boshllëqet dhe kufizimet e përsëritura në aksesin dhe ushtrimin e profesioneve, si dhe hapësirat prioritare për përmirësim, në funksion dhe të raportimit vjetor të progresit në procesin e integritetit, sipas Pyetjeve Udhëzuese të Komisionit Evropian për Kapitullin 3 (III.1, III.3 dhe III.4).

3.1.1. Hartëzimi dhe tipologjia e rregullimit (III.1 – nivel sistemi)

Janë identifikuar dhe shqyrtuar gjithsej 337 profesione dhe veprimtari të rregulluara, të mbuluara nga 33 autoritete kompetente, përfshirë ministri linjë, autoritete rregullatore të specializuara, dhoma profesionale, urdhra profesionale, borde mbikëqyrëse dhe agjenci ekzekutive me funksione publike.

Rregullimi paraqitet kryesisht përmes rezervimit të veprimtarive në rreth 61% të rasteve, përmes mbrojtjes së titullit profesional në rreth 24%, ndërsa 15% e profesioneve ndjekin një model të kombinuar (titull i mbrojtur dhe veprimtari të rezervuara).

Shtrirja sektoriale tregon përqendrim më të lartë të rregullimit në sektorët me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë publike, shëndetin, rendin publik dhe infrastrukturën kritike, veçanërisht në shëndetësi, drejtësi, inxhinieri dhe transporte, si dhe në sektorin e zejeve dhe profesioneve teknike, i cili përbën grupin më të madh (në terma numerik).

Në sektorët me rrezik të lartë, si shëndetësia, aviacioni civil, transporti detar dhe profesionet teknike të ndërtimit dhe infrastrukturës, modeli i kombinuar dhe rezervimi i veprimtarive shfaqen më shpesh. Në sektorë me rrezik më të ulët ose me natyrë kryesisht kulturore, arsimore apo krijuese, mbizotëron mbrojtja e titullit ose rregullimi minimal.

3.1.2. Transparenca (Instrumenti 1)

Në nivel sistemi, transparenca formale vlerësohet mesatare. Baza ligjore për aksesin dhe ushtrimin e profesionit është e aksesueshme publikisht në rreth 78% të rasteve, ndërsa autoriteti kompetent identifikohet qartë në rreth 85%. Megjithatë, përshkrimi i procedurave administrative (hapat dhe dokumentacioni) rezulton i plotë vetëm në rreth 54% të profesioneve, afatet procedurale janë të shprehura në 42%, ndërsa mekanizmat e ankimit përmenden qartë në rreth 39% të rasteve. Mundësia e aplikimit elektronik për lejen e ushtrimit të profesionit evidentohet vetëm në rreth 31% të rasteve.

Gjetjet pasqyrojnë nevojën për standardizim të informacionit publik dhe rritje të parashikueshmërisë procedurale, veçanërisht për profesionistët e huaj dhe për ofruesit e shërbimeve ndërkufitare.

Tipologjitë kryesore të boshllëqeve të konstatuara përfshijnë fragmentarizim normativ dhe informacioni, mungesë të një pike të vetme reference, paqartësi në ndarjen e kompetencave ndërmjet rregullimit, licencimit dhe mbikëqyrjes, si dhe mospërditësim të informacionit dhe terminologji jo të harmonizuar ndërmjet akteve ligjore dhe nënligjore.

Në praktikë, fragmentarizimi i informacionit rrit kostot e pajtueshmërisë me detyrimet ligjore dhe ul sigurinë juridike për aplikantët dhe profesionistët, duke ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e lirisë së ushtrimit të profesionit.

3.1.3. Modelet e kërkesave rregullatore (Instrumenti 2)

Analiza e Instrumentit 2 tregon mbështetje të konsiderueshme në mekanizma kontrolli *ex ante*. Licencimi ose regjistrimi i detyrueshëm aplikohet në rreth 67% të profesioneve, praktika ose stazhi profesional në rreth 48%, ndërsa provimet ose testimet profesionale në rreth 44%. Anëtarësimi në organizata profesionale evidentohet në rreth 29% të rasteve, ndërsa kërkesat shtesë, si integritet penal, sigurim profesional ose kërkesa gjuhësore, shfaqen në rreth 36%.

Ky konfigurim reflekton një prirje drejt kontrollit paraprak të fortë, e cila kërkon vlerësim të vazhdueshëm për të garantuar që intensiteti i ndërhyrjes rregullatore të jetë proporcional me interesin publik të mbrojtur dhe të mos prodhojë barriera të panevojshme në hyrje.

3.1.4. Proporcionaliteti (Instrumenti 3)

Vlerësimi horizontal i proporcionalitetit tregon se interesat publike justifikuese invokohen gjerësisht, por cilësia e arsytimit ndryshon ndjeshëm. Justifikimi rezultoi plotë në rreth 41% të rasteve, i pjesshëm në 38%, ndërsa deklarativ ose i munguar në rreth 21%. Në rreth 34% të profesioneve evidentohet mbivendosje të kërkesave, përmes kombinimeve kumulative të licencimit, provimeve dhe kontrolleve të tjera, pa argumentim të qartë mbi domosdoshmërinë e këtij kombinimi.

Alternativat më pak kufizuese, si kontrolli *ex post* ose detyrimet e transparencës, rezultojnë të konsideruara në mënyrë të kufizuar, vetëm në rreth 19% të rasteve.

Kur i njëjti objektiv mund të arrihet përmes masave më pak kufizuese, përdorimi i mekanizmave më të rreptë kërkon arsyetim të posaçëm dhe të dokumentuar, i cili aktualisht mungon në një numër të konsiderueshëm profesioneve.

3.1.5. Njohja profesionale dhe mobiliteti

Në nivel sistemi, evidentohet një dallim i pjesshëm ndërmjet njohjes për qëllime akademike dhe njohjes për ushtrimin e profesionit. Procedurat elektronike për njohjen profesionale janë të disponueshme në rreth 28% të rasteve, ndërsa afatet procedurale dhe mekanizmat e ankimit janë të qarta dhe të formalizuara në rreth 35%. Kërkesa gjuhësore aplikohet në rreth 22% të profesioneve, zakonisht pa kriteret e unifikuara dhe pa arsyetim të proporcionalitetit të dokumentuar.

Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor i shërbimeve lejohet në rreth 46% të profesioneve të shqyrtuara, por kuadri procedural është shpesh i paqartë ose i fragmentuar. Kontrolli paraprak, në rastet e rrezikut për shëndetin ose sigurinë publike, zbatohet në mënyrë jo të njëtrajtshme dhe pa garanci të plota procedurale.

3.1.6. Përfundime horizontale

Në përmbledhje, gjetjet horizontale konfirmojnë ekzistencën e një kuadri rregullator funksional, por me nevojë të qartë për: (i) standardizim të transparencës dhe aksesit në informacion, (ii) institucionalizim sistematik të analizës së proporcionalitetit, dhe (iii) rritje të parashikueshmërisë procedurale për njohjen profesionale dhe ofrimin e përkohshëm të shërbimeve. Diferencimet ndërsektoriale dhe specifikat e secilit autoritet trajtohen në nënseksionin 3.2, ndërsa masat konkrete të reformës operacionalizohen në Planin Kombëtar të Veprimeve.

3.2. Gjetjet sektoriale dhe çështjet prioritare sipas profesioneve dhe autoriteteve kompetente

3.2.1. Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e drejtësisë

Rregullator kryesor: Ministria e Drejtësisë; Dhomat profesionale përkatëse

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon nëntë profesione dhe veprimtari të rregulluara në fushën e drejtësisë, të justifikuar kryesisht nga objektiva të interesit publik që lidhen me funksionimin e sistemit të drejtësisë, mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe garantimin e sigurisë juridike. Brenda sektorit përfshihen: avokati, noteri, zëvendësnoteri, përmbaruesi gjyqësor privat, administratori i falimentimit, ndërmjetësuesi, ndërmjetësi i pasurive të paluajtshme, përkthyesi zyrtar dhe interpreti i gjuhës së shenjave.

Modeli i rregullimit paraqitet kryesisht si kombinim i titullit të mbrojtur me rezervim veprimtarish, ndërsa në disa profesione aplikohet vetëm rezervimi i veprimtarisë ose vetëm mbrojtja e titullit. Inventari i profesioneve dhe referencat ligjore përkatëse pasqyrohen në Instrumentin 1.

Zëvendësnoteri trajtohet këtu si profesion i veçantë rregullator, ndonëse funksionalisht përbën një fazë karriere drejt profesionit të noterit. Ky dallim është i rëndësishëm për analizën e aksesit në profesion, pasi kalimi nga zëvendësnoter në noter nuk është automatik, por varet nga sistemi i numrit të kufizuar të noterëve dhe nga procedurat e emërimit. Si pasojë, ekziston rreziku strukturor që një zëvendësnoter të mos arrijë të emërohet noter, pavarësisht përmbushjes së kriterëve profesionale, çka justifikon trajtimin e tij si profesion më vete për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen kryesisht me funksione që prodhojnë efekte juridike të drejtpërdrejta ose ndikojnë në realizimin e të drejtave, në veçanti shërbimet noteriale me efekt publik, ekzekutimin me forcë detyruese të vendimeve gjyqësore dhe administrative, si dhe administrimin e procedurave të falimentimit.

Kërkesa për shtetësi shqiptare aplikohet për noterin, zëvendësnoterin, përmbaruesin gjyqësor privat dhe administratorin e falimentimit, e arsyetuar me ushtrimin e autoritetit publik në kuptim të nenit 51 TFBE. Këto raste përbëjnë çështje prioritare për verifikim të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit, në funksion të parimit të mosdiskriminimit.

Për profesionet e tjera nuk rezultojnë kufizime të drejtpërdrejta mbi bazë shtetësie; megjithatë, në disa raste kërkohet njohja e gjuhës shqipe, e cila funksionon praktikisht si kriter aksesimi dhe duhet të paraqitet në mënyrë transparente si kërkesë, standard dhe mënyrë verifikimi, për të shmangur paqartësi administrative.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale ndahet ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe dhomave kombëtare profesionale përkatëse, me një model të diferencuar sipas profesionit.

Në avokati, Dhoma Kombëtare e Avokatisë ushtron kompetenca të plota profesionale, përfshirë regjistrimin, mbikëqyrjen etike dhe disiplinore, si dhe administrimin e kushteve të hyrjes dhe ushtrimit, sipas kuadrit përkatës rregullator.

Në profesionet e tjera, kompetencat janë të ndara ose të ushtruara bashkërisht ndërmjet dhomave profesionale dhe Ministrisë së Drejtësisë. Kjo strukturë e përbashkët evidentohet veçanërisht në noteri dhe zëvendësnoteri, në përmbarimin gjyqësor privat, si dhe në profesione ku Ministria e Drejtësisë ruan rol rregullator dhe administrativ për licencimin, kontrollin institucional ose mbajtjen e regjistrave. Si pasojë, arkitektura institucionale paraqitet më komplekse dhe, kur mungojnë procedura të publikuara me afate dhe ankime të qarta, kjo ndikon në parashikueshmërinë procedurale për profesionistët.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat dominuese për hyrje dhe ushtrim përfshijnë arsim universitar, stazh ose përvojë profesionale, provim kualifikimi, licencim ose certifikim dhe regjistrim, shpesh të shoqëruara me anëtarësim të detyrueshëm në strukturë profesionale.

Për avokatin kërkohen studime juridike, stazh profesional, provim dhe regjistrim në dhomë, si dhe njohja e gjuhës shqipe. Për noterin dhe zëvendësnoterin kërkohen diplomë juridike, përvojë ose stazh, provim, licencim dhe shtetësi shqiptare. Për përmbaruesin gjyqësor privat dhe administratorin e falimentimit kërkohen diplomë përkatëse, përvojë, trajnim, provim dhe shtetësi shqiptare. Për ndërmjetësuesin kërkohen diplomë universitare, trajnim i specializuar dhe provim. Për ndërmjetësin e pasurive të paluajtshme kërkohen trajnim dhe certifikim profesional, si dhe njohja e gjuhës shqipe. Për përkthyesin zyrtar dhe interpretin e gjuhës së shenjave kërkohen provim dhe certifikim.

Këto kërkesa aplikohen në mënyrë kumulative dhe përcaktojnë nivelin real të aksesit në profesion. Kur masat aplikohen në paketë, pa shqyrtim alternativash më pak kufizuese, rritet rreziku i kufizimeve më të rënda seç është e nevojshme.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Njohja profesionale administrohet përmes regjimit të përgjithshëm të hyrjes në profesion dhe nuk dallohet në mënyrë të strukturuar nga njohja akademike. Procedurat nuk janë të standardizuara në nivel sektorial dhe nuk rezultojnë të harmonizuara plotësisht me kuadrin e BE-së për profesionet përkatëse. Në këtë sektor evidentohet se procedurat për njohjen e kualifikimeve të fituara jashtë vendit, për lehtësimin e ushtrimit të përkohshëm ose të përhershëm të profesionit (veçanërisht për avokatët e BE-së) dhe për ofrimin ndërkufitar të shërbimeve, nuk janë ende të harmonizuara plotësisht me Direktivën 98/5/EC, Direktivën 2005/36/EC (e ndryshuar) dhe Direktivën 77/249/EEC.

Ndërsa, për ndërmjetësit parashikohet njohja nga Ministri i Drejtësisë, baza ligjore nuk është e plotë, pasi nuk parashikohen procedura dhe afate ankimi. Në përgjithësi, nuk evidentohet një skemë e unifikuar për autoritetet kompetente, hapat proceduralë, afatet, mekanizmat e ankimit apo përdorimin e aplikimit elektronik. Për profesionet me kërkesë shtetësie, vendosja e

profesionistëve të huaj është e përjashtuar në vetvete. Për profesionet e tjera, mungesa e standardizimit krijon paqartësi administrative dhe pengesa praktike për akses në treg.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor nuk njihet si kategori e veçantë rregullatore në sektorin e drejtësisë. Në praktikë zbatohet një standard i vetëm rregullash për vendosje dhe ushtrim të profesionit. Nuk ekzistojnë procedura deklarimi paraprak, afate të dedikuara apo mekanizma të posaçëm vlerësimi; gjithashtu nuk evidentohet aplikimi i kontrollit paraprak në kuptimin e logjikës së nenit 7(4) të Direktivës 2005/36.

Për profesionet e mbyllura nga kërkesa e shtetësisë, ofrimi i përkohshëm nga profesionistë të huaj është i përjashtuar. Kur mungojnë afatet dhe procedurat e posaçme për shërbime të përkohshme, krijohet efekt negativ në mobilitetin profesional dhe në ofrimin ndërkufitar të shërbimeve.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti në sektor vlerësohet miks. Ndërsa objektivat e interesit publik janë të qarta dhe justifikojnë një nivel të lartë kontrolli *ex ante*, evidentohen dobësi strukturore në justifikimin e plotë të masave, mbivendosje të kërkesave kumulative dhe mungesë alternativash më pak kufizuese. Prania e kushteve të bazuara në shtetësi dhe kërkesave gjuhësore krijon rrezik diskriminimi të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, ndërsa mungesa e një regjimi të diferencuar për shërbimet e përkohshme dhe procedurave të standardizuara për njohjen profesionale kufizon mobilitetin. Megjithatë, disa elemente thelbësore të këtij regjimi rezultojnë të papërputhshme me kërkesat e së drejtës së Bashkimit Evropian për lirinë e vendosjes dhe proporcionalitetin. Në veçanti, kërkesa absolute për shtetësi shqiptare dhe mbyllja e plotë e profesionit ndaj shtetasve të vendeve të tjera përbëjnë kufizime të drejtpërdrejta të nenit 49 TFBE, të cilat nuk mund të justifikohen mbi bazën e nenit 51 TFBE. Jurisprudenca e qëndrueshme e Gjykatës së Drejtësisë, përfshirë çështjen C-392/15 Komisioni Evropian kundër Hungarisë, ka sqaruar se aktivitetet noteriale, ndonëse të lidhura me interesa të rëndësishme publike, nuk përbëjnë ushtrim të drejtpërdrejtë dhe specifik të autoritetit publik që të legjitimojë përjashtimin e përgjithshëm nga liria e vendosjes.

Këto gjetje përbëjnë bazën faktike për masat e Planit Kombëtar të Veprimit, me fokus në: standardizimin e procedurave të njohjes profesionale, diferencimin e regjimit për shërbime të përkohshme, dhe rishikimin e proporcionalitetit të kërkesave shoqëruese, përfshirë elementet që lidhen me aksesin në profesionet noteriale.

3.2.2 Profesionet/veprimtaritë e rregulluara në sektorin e punëve të brendshme

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon dy veprimtari të rregulluara në fushën e sigurisë publike dhe mbrojtjes civile: funksionin e zjarrfikësit dhe profesionin e punonjësit në shërbimin privat të sigurisë fizike. Të dyja janë të konceptuara si veprimtari të rezervuara, të justifikuara nga objektiva madhore të interesit publik, në veçanti rendi dhe siguria publike, mbrojtja e jetës dhe pronës, si dhe menaxhimi i emergjencave. Funksioni i zjarrfikësit ushtrohet ekskluzivisht në kuadër të marrëdhënies së

punës në administratën publike, ndërsa shërbimi privat i sigurisë fizike ushtrohet vetëm nga persona të certifikuar brenda subjekteve të licencuara, sipas legjislacionit përkatës.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen me funksione operative të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, ruajtjes fizike, mbrojtjes së personave, objekteve dhe pronës private, si dhe me përdorimin e forcës dhe armës së shërbimit sipas legjislacionit në fuqi. Për të dyja veprimtaritë, ushtrimi i funksioneve operative është i lidhur me kërkesa shtetësie dhe/ose qëndrimi, të arsyetuara me ushtrimin e autoritetit publik dhe nevojën për garantimin e sigurisë publike. Në sektorin e sigurisë private, shtetasit e huaj lejohen të jenë titullarë subjektësh, me kusht përmbushjen e kërkesave për leje pune, leje qëndrimi dhe kriter besueshmërie, ndërsa funksionet operative dhe drejtuese mbeten të rezervuara.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale ndahet ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme si organ politikëbërës dhe rregullator, Policisë së Shtetit dhe strukturave vendore përkatëse si autoritete certifikuese dhe mbikëqyrëse për shërbimet private të sigurisë fizike, si dhe strukturave publike përgjegjëse për emergjencat civile për funksionin e zjarrfikësit. Licencimi dhe regjistrimi i subjekteve që ofrojnë shërbime private sigurie realizohet në bashkërendim me autoritetet përgjegjëse për regjistrimin e veprimtarive ekonomike. Evidentohet një ndërthurje e funksioneve të certifikimit dhe mbikëqyrjes brenda të njëjtave struktura, veçanërisht për sektorin e sigurisë private.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat rregullatore përfshijnë punësim në strukturat publike për funksionin e zjarrfikësit dhe certifikim individual të detyrueshëm për punonjësit dhe drejtuesit teknikë në shërbimin privat të sigurisë fizike. Për të dyja veprimtaritë parashikohen trajnim profesional i detyrueshëm, testim teorik dhe praktik, si dhe verifikim i aftësive profesionale dhe fizike. Anëtarësimi në urdhra ose dhoma profesionale nuk aplikohet. Kërkesat shtesë lidhen me integritetin personal, besueshmërinë, gjendjen shëndetësore dhe aftësinë fizike, si dhe, për sigurinë private, me kushtet e posaçme për përdorimin e forcës dhe armës së shërbimit.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje (III.3)

Në të dyja veprimtaritë bëhet dallim i qartë ndërmjet njohjes akademike të kualifikimeve dhe aksesit profesional. Njohja akademike e diplomave të huaja nuk krijon të drejtë automatike për ushtrimin e funksioneve. Aksesimi profesional i nënshtrohet kriterëve kombëtarë të sigurisë dhe certifikimit. Procedurat elektronike janë të kufizuara dhe aplikohen kryesisht për regjistrimin dhe licencimin e subjekteve, ndërsa certifikimi individual realizohet në mënyrë administrative pranë autoriteteve kompetente. Afatet dhe mekanizmat e ankimit zbatohen përmes procedurave të përgjithshme administrative.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor i shërbimeve nuk lejohet për asnjërën nga veprimtaritë, për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë me sigurinë publike, ushtrimin e autoritetit publik dhe përdorimin

e forcës. Për rrjedhojë, nuk parashikohen procedura deklarimi, regjistrimi të përkohshëm apo kontroll paraprak sipas nenit 7 paragrafi 4 të Direktivës.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti vlerësohet në përgjithësi i qëndrueshëm, pasi masat rregullatore mbështeten në arsye madhore të interesit të përgjithshëm, në veçanti sigurinë publike, rendin publik dhe mbrojtjen e jetës dhe pronës. Për funksionin e zjarrfikësit nuk konstatohet mbivendosje e panevojshme kërkesash, pasi kriteret lidhen drejtpërdrejt me natyrën e rrezikshme të aktivitetit. Për shërbimin privat të sigurisë fizike, kufizimet mbi bazë shtetësie për funksionet operative dhe drejtuese konsiderohen të targetuara dhe të diferencuara sipas rolit, ndërsa hapja ndaj shtetasve të huaj në nivel titullari subjekti tregon se sektori nuk është i mbyllur në mënyrë absolute. Rreziqet kryesore të identifikuara lidhen me mbivendosjen institucionale të certifikimit dhe mbikëqyrjes dhe me barrën procedurale administrative. Këto gjetje shërbejnë si bazë për masat e Planit të Veprimit.

3.2.3. Profesionet dhe veprimtaritë e rregullura në sektorin e shëndetësisë dhe kujdesit social

(Rregullator: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe urdhrat profesionale respektivë)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon profesione dhe veprimtari të rregulluara në shëndetësi dhe mirëqenie sociale, të justifikuara kryesisht nga objektiva të interesit publik si mbrojtja e shëndetit publik, siguria e pacientit, cilësia e kujdesit, si dhe mbrojtja e personave vulnerabël. Brenda sektorit, rregullimi shfaqet në dy forma kryesore: (i) profesione “personale”, ku e drejta për të ushtruar lidhet me kualifikimin, regjistrimin dhe kontrollin profesional individual (mjek i përgjithshëm; mjek i specializuar; stomatolog dhe stomatolog i specializuar; farmacist; infermier; mami; fizioterapist; logoped; psikolog; punonjës social; teknik laborator; teknik imazherie), dhe (ii) veprimtari të rregulluara të shërbimeve të kujdesit, ku fokusi kryesor është licencimi/standardet e shërbimit dhe kontrolli administrativ i ofruesit (kujdestari për fëmijë; kujdestari i personave me aftësi të kufizuara). Inventari dhe referencat ligjore pasqyrohen në Instrumentin 1.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen kryesisht me: (i) diagnostikimin dhe trajtimin klinik (mjek i përgjithshëm dhe mjek i specializuar; stomatolog dhe stomatolog i specializuar), (ii) ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe procedurave infermiore/mami, si dhe ndërhyrjeve rehabilituese (infermier; mami; fizioterapist), (iii) analizat laboratorike dhe procedurat e imazherisë mjekësore (teknik laborator; teknik imazherie), (iv) përgatitjen, shpërndarjen dhe këshillimin profesional për barnat (farmacist), dhe (v) shërbimet profesionale psiko-sociale dhe të mbrojtjes sociale (psikolog; punonjës social), si dhe shërbime të specializuara mbështetëse (logoped).

Për veprimtaritë e kujdestarisë (fëmijë; persona me aftësi të kufizuara), rezerva shfaqet kryesisht në formën e kufizimit të ofrimit të shërbimit vetëm për subjekte të licencuara dhe të mbikëqyrura, sipas standardeve minimale të cilësisë. Aksesit në profesion/veprimtari nuk është i rezervuar mbi bazë shtetësie; profesionistët e huaj lejohen, me kusht që të përmbushin procedurat për njohjen

e kualifikimeve dhe regjistrimin/licencimin përkatës. Kërkesat gjuhësore për shqipen trajtohen si kërkesë funksionale për komunikim të sigurt dhe mbrojtje të shëndetit publik, jo si kufizim diskriminues.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale ndahet ndërmjet: (i) Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, e cila ushtron funksione rregullatore dhe mbikëqyrëse në nivel politikash dhe kuadri sektorial; (ii) urdhrave profesionalë, të cilët administrojnë regjistrimin/anëtarësimin, standardet etike dhe disiplinore, si dhe kontrollin e ushtrimit të profesionit (Urdhri i Mjekëve; Urdhri i Stomatologut; Urdhri i Farmacistëve; Urdhri i Infermierit; Urdhri i Psikologut; Urdhri i Punonjësve Socialë); dhe (iii) strukturave të edukimit të vazhdueshëm (përfshirë Bordin e Edukimit të Vazhdueshëm), të cilat lidhen me certifikimin/ricertifikimin dhe ruajtjen e kompetencës profesionale.

Për veprimtaritë e kujdestarisë, mbikëqyrja është kryesisht administrative (strukturat e ministrisë dhe ato vendore), me fokus të licencimi i shërbimit, standardet dhe inspektimi/kontrolli. Në tërësi ka koordinim funksional, por ekziston nevoja për më shumë konsolidim të informacionit publik dhe unifikim të hapave procedurale, për të rritur transparencën dhe parashikueshmërinë.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat dominuese në profesionet shëndetësore “personale” përfshijnë arsim universitar të akredituar, praktikë profesionale të mbikëqyrur, provim shteti dhe regjistrim/anëtarësim pranë organit profesional. Për profesionet e harmonizuara në kuptim të kriterëve minimale të formimit (mjek, stomatolog, farmacist, infermier, mami), kërkesat e formimit janë të strukturuar dhe të qarta, të kombinuara me mekanizma kontrolli (provim, regjistrim, edukim i vazhdueshëm). Për profesionet psiko-sociale (psikolog, punonjës social) kërkohet formim universitar (Bachelor/Master), praktikë e detyrueshme e supervizuar dhe provim shteti, e shoqëruar me regjistrim/licencim.

Për profesionet teknike shëndetësore (teknik laborator, teknik imazherie) kërkohet formim i akredituar, praktikë profesionale dhe provim shteti, me elemente regjistrimi/certifikimi sipas rregullimit përkatës. Për veprimtaritë e kujdestarisë, kërkesat kryesore lidhen me licencimin e shërbimit/ofruesit, standardet minimale, trajnime/certifikime dhe kontroll të vazhdueshëm administrativ.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Sistemi bën dallim të qartë ndërmjet njohjes akademike të diplomave dhe njohjes profesionale për qëllime ushtrimi. Për mjekun e përgjithshëm theksohet logjika e njohjes automatike për shkak të harmonizimit të kërkesave minimale të formimit në nivel evropian. E njëjta qasje reflektohet edhe për profesionet e tjera me standarde minimale të harmonizuara (stomatolog, farmacist, infermier, mami), kur plotësohen kushtet përkatëse. Për profesionet që nuk hyjnë në këtë kategori (p.sh. logoped, psikolog, punonjës social, si dhe profesione të caktuara teknike), njohja realizohet përmes vlerësimit rast pas rasti, me mundësi masash kompensuese kur është e nevojshme. Procedurat administrative parashikojnë paraqitjen e dokumentacionit, verifikimin e

përputhshmërisë, afate shqyrtimi dhe mekanizma ankimi; digjitalizimi rezulton i pjesshëm dhe kërkon forcim. Kërkesa gjuhësore (njohja e shqipes) lidhet me ushtrimin e sigurt dhe komunikimin efektiv me pacientët dhe institucionet.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Ofrimi i përkohshëm ose rastësor i shërbimeve lejohet në parim, në përputhje me parimet e lirisë së shërbimeve dhe me dispozitat e Direktivës 2005/36/EC të reflektuara në kuadrin kombëtar. Në profesionet ku rreziku për shëndetin publik është i lartë, autoritetet kompetente mund të kryejnë verifikime paraprake vetëm në masën e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik dhe sigurinë e pacientëve, duke respektuar proporcionalitetin dhe garancitë procedurale. Për shërbimet e kujdestarisë, ofrimi praktikisht kushtëzohet nga logjika e licencimit dhe respektimit të standardeve të shërbimit në territorin kombëtar, me prioritet mbrojtjen e fëmijëve dhe personave vulnerabël.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Në tërësi, proporcionaliteti në shëndetësi dhe mirëqenie sociale vlerësohet i kënaqshëm, pasi kërkesat kryesore (arsim, praktikë, provim, regjistrim, edukim i vazhdueshëm) lidhen drejtpërdrejt me rrezeqë reale për shëndetin dhe sigurinë e përfituesve. Pikat e forta janë: (i) orientimi i qartë drejt mbrojtjes së interesit publik; (ii) roli i urdhrave profesionalë në standarde etike, disiplinë dhe kontroll; (iii) përdorimi i mekanizmave të verifikimit të kompetencës dhe ruajtjes së saj përmes edukimit të vazhdueshëm.

Fushat ku shfaqet rrezik mospërputhshmërie me *acquis* dhe ku kërkohet ndërhyrje reformuese lidhen kryesisht me: (i) fragmentimin dhe mungesën e unifikimit të procedurave (sidomos për njohjen profesionale, afatet dhe kanalet elektronike); (ii) nevojën për standardizim më të qartë të vlerësimit dhe masave kompensuese për profesionet jo-sektorale; dhe (iii) nevojën për rregulla më të konsoliduara, transparente dhe të aksesueshme publikisht për ofrimin e përkohshëm/rastësor.

Këto gjetje operacionalizohen në Planin Kombëtar i Veprimit, duke u përkthyer në veprime konkrete për rritjen e transparencës, thjeshtimin procedural, digjitalizimin dhe forcimin e sigurisë juridike për profesionistët dhe përfituesit e shërbimeve.

3.2.4. Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e veterinarisë

(Rregullator kryesor: Ministria e Bujqësisë dhe Zhillimit Rural; Urdhri Profesional I Mjekëve Veterinarë Shqiptarë)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon katër profesione/veprimtari të rregulluara në fushën e veterinarisë: mjeku veterinar; farmacisti veterinar; tekniku veterinar; tekniku i ndërzimit. Rregullimi justifikohet kryesisht nga objektiva të interesit publik që lidhen me shëndetin publik, shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, sigurinë ushqimore, parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve (përfshirë zoonozat), mbrojtjen e konsumatorëve dhe, në aspekte specifike, mbrojtjen e mjedisit në lidhje me përdorimin e barnave veterinarë dhe mbetjet. Kuadri bazë ligjor përfshin ligjin nr. 10171/2010 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjin nr. 113/2015 “Për

Urdhri Profesional të Mjekut Veterinar”, si dhe ligjin sektorial nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), i cili e koncepton shërbimin veterinar si sistem të integruar shtetëror dhe privat dhe rregullon masat e kontrollit/çrënjosjes së sëmundjeve, monitorimin epidemiologjik, karantinën, vaksinimin dhe ndërhyrjet emergjente veterinare.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Nga baza ligjore e shqyrtuar, veprimtaritë që mbulohen nga profesioni i mjekut veterinar përshkruhen në terma funksionalë dhe përfshijnë shërbimet klinike, kontrollin e shëndetit të kafshëve, kontributin në sigurinë ushqimore dhe pjesëmarrjen në sistemet e monitorimit dhe parandalimit të sëmundjeve. Për profesionet mbështetëse përshkruhen role ndihmëse dhe teknike: farmacisti veterinar (menaxhim, ruajtje, shpërndarje dhe këshillim profesional mbi përdorimin e barnave veterinare, produkteve biologjike dhe produkteve të lidhura me shëndetin e kafshëve); tekniku veterinar (asistim në ekzaminime/ndërhyrje, higjienë dhe biosiguri, monitorim, mbledhje mostrash, procedura teknike të thjeshta, mbështetje në programe vaksinimi dhe kontroll sanitar, nën përgjegjësinë profesionale të mjekut veterinar); tekniku i ndërzimit (procedura të ndërzimit artificial, menaxhim/ruajtje materialit gjenetik, protokolle teknike riprodhimi, asistim në programe përmirësimi gjenetik dhe kontroll riprodhues, pa kompetenca diagnostikuese/vendimmarrëse).

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale bazohet në ndërveprimin midis institucioneve shtetërore dhe strukturave profesionale. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural paraqitet si institucioni përgjegjës në kuadrin e shërbimit veterinar dhe politikave përkatëse, ndërsa Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar ka rol qendror në rregullimin profesional: përcakton kriteret e ushtrimit, ushtron funksione licencuese dhe mbikëqyrëse për mjekët veterinarë dhe jep licencat edhe për kategoritë e farmacistit veterinar, teknikut veterinar dhe teknikut të ndërzimit.

Për farmacistin veterinar identifikohen edhe struktura të tjera mbikëqyrëse/inspektuese: Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, si dhe strukturat e inspektimit përkatëse, me funksione licencimi subjektsh, kontrolli të barnave veterinare, monitorimi të zinxhirit të furnizimit dhe verifikimi të respektimit të standardeve. Për teknikun veterinar dhe teknikun e ndërzimit theksohet marrëdhënia e dyfishtë: (i) Urdhri (licencim/mbikëqyrje/disiplinë) dhe (ii) autoritetet shtetërore (kontroll administrativ/inspektues). Evidentohet se ky kontroll i dyfishtë mund të krijojë paqartësi kompetencash kur kufijtë e autonomisë profesionale nuk janë të përcaktuara qartë.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Në sektor theksohet formalizim relativisht i lartë. Për mjekun veterinar, ushtrimi kushtëzohet nga: përmbushja e kriterëve arsimorë, regjistrimi në organet përkatëse, pajisja me licencë nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar dhe respektimi i standardeve profesionale e etike. Në praktikë kërkesat shpesh shoqërohen me procedura të ndërlikuara administrative dhe kërkesa shtesë,

veçanërisht në rinovimin e licencave, inspektimet e shpeshta dhe dokumentacionin e mbivendosur ndërmjet institucioneve, duke krijuar barrë administrative.

Për farmacistin veterinar, kërkesat rregullatore përfshijnë: arsimim përkatës, licencim nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar dhe kërkesa që lidhen me subjektin ku ushtrohet aktiviteti; respektim të standardeve profesionale e etike; respektim të kushteve të magazinimit dhe shpërndarjes; inspektime periodike nga autoritetet kompetente. Mungesa e diferencimit të qartë të roleve mund të sjellë mbingarkesë rregullatore ose kufizime jo të lidhura drejtpërdrejt me rrezikun real.

Për teknikun veterinar, kërkesat përshkruhen si: licencim, regjistrim dhe mbikëqyrje; arsimim profesional, trajnime; respektim i rregullave etike dhe disiplinore; përditësim i vazhdueshëm i njohurive.

Për teknikun e ndërzimit, kërkesat përshkruhen si: regjim i rreptë licencimi dhe kontrolli; arsimim profesional; trajnim specifik; regjistrim në Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar; respektim i rregullave etike dhe disiplinore; mbikëqyrje periodike. Mungesa e ndarjes së qartë të kompetencave teknike dhe atyre veterinare mund të krijojë pasiguri.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Për mjekun veterinar zbatohet regjimi sektorial i Direktivës 2005/36/KE, që parashikon njohjen automatike mbi bazën e harmonizimit minimal të kërkesave të formimit. Në rendin juridik shqiptar, profesioni është i klasifikuar si profesion i rregulluar dhe ushtrimi i tij kushtëzohet nga njohja akademike e diplomës nga ministria përgjegjëse për arsimin, përfundimi i provimit të shtetit dhe regjistrimi në Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar. Megjithatë, për shkak të statusit të Shqipërisë si vend kandidat, njohja automatike në kuptimin strikt të Direktivës nuk aplikohet ende. Në praktikë, autoritetet kombëtare zbatojnë procedura vlerësimi individual, duke analizuar përmbajtjen e kualifikimit, kohëzgjatjen e studimeve dhe përputhshmërinë me kërkesat kombëtare. Njohja e diplomave shqiptare në shtetet anëtare të BE-së mbetet e kushtëzuar nga vendimet individuale të autoriteteve pritëse.

Farmacisti veterinar nuk klasifikohet si profesion i rregulluar në kuptim të Direktivës 2005/36, por i nënshtrohet licencimit dhe anëtarësimit të detyrueshëm në Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar sipas legjislacionit kombëtar. Njohja e kualifikimeve të fituara jashtë Shqipërisë realizohet mbi bazën e ligjit kombëtar për njohjen e diplomave, përmes vlerësimit të përmbajtjes së formimit dhe kompetencave funksionale, pa mekanizëm evropian të njohjes automatike.

Tekniku veterinar dhe tekniku i ndërzimit nuk përbëjnë profesione të rregulluara në kuptim të Direktivës 2005/36. Për këto kategori, njohja e kualifikimeve realizohet ekskluzivisht përmes procedurave administrative kombëtare, që përfshijnë ekuivalentimin e diplomave, vlerësimin e trajnimit dhe shqyrtimin e përvojës profesionale. Mungesa e autonomisë profesionale dhe ushtrimi i veprimtarisë nën përgjegjësinë e mjekut veterinar përjashtojnë aplikimin e skemave evropiane të njohjes.

Në të gjitha rastet, autoritetet shqiptare zbatojnë parimet e proporcionalitetit, vlerësimit individual dhe shmangies së barrierave të panevojshme, në përpjekje për të balancuar mbrojtjen e interesit publik me lëvizshmërinë profesionale.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Në sektorin veterinar nuk është zhvilluar një regjim i veçantë për ofrimin e përkohshëm dhe rastësor të shërbimeve në kuptim të Direktivës 2005/36. Ushtrimi i veprimtarisë profesionale, si për mjekun veterinar ashtu edhe për kategoritë mbështetëse, është i lidhur me regjistrimin dhe licencimin pranë strukturave kombëtare përkatëse.

Për mjekët veterinarë të kualifikuar jashtë vendit, aksesimi i tregut shqiptar realizohet përmes procedurave të vendosjes (njohje diplome, provim shteti, regjistrim në Urdhrin Profesional), dhe jo përmes një mekanizmi të veçantë deklarimi paraprak për shërbime të përkohshme. Për farmacistin veterinar, teknikun veterinar dhe teknikun e ndërzimit, legjislacioni parashikon vetëm rrugën e licencimit dhe regjistrimit kombëtar, pa dallim ndërmjet ushtrimit të përhershëm dhe atij afatshkurtër.

Si rrjedhojë, ofrimi i përkohshëm dhe rastësor nuk funksionon si kategori autonome procedurale në këtë sektor, por absorbohet nga regjimi i përgjithshëm i aksesit në profesion, çka kufizon fleksibilitetin ndërkufitar të shërbimeve veterinare dhe i trajton të gjitha format e ushtrimit si vendosje.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti paraqitet si çështje qendrore dhe e ndjeshme në këtë sektor. Për mjekun veterinar, identifikohet rrezik mospërputhjeje midis nivelit të rregullimit dhe rrezikut konkret të aktivitetit, veçanërisht kur aplikohen të njëjtat kërkesa strikte për profesione/veprimtari me ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin publik dhe për veprimtari me rrezik të ulët; kjo krijon pabarazi dhe kufizon lirinë profesionale më shumë sesa nevojitet, duke qenë në tension me standardet evropiane që kërkojnë diferencim dhe vlerësim konkret të rrezikut.

Për farmacistin veterinar, vërehet se kontrolli i lartë është në parim i justifikuar nga ndjeshmëria e barnave dhe ndikimi në zinxhirin ushqimor/shëndetin publik, por mungesa e diferencimit të qartë të roleve mund të çojë në mbingarkesë rregullatore. Gjithashtu sugjerohet se një rishikim për qartësimin e statusit profesional dhe forcimin e autonomisë funksionale do të rrisë transparencën, sigurinë juridike dhe efikasitetin e sistemit.

Për teknikun veterinar dhe teknikun e ndërzimit, nevojitet balancim duke qenë se këto role janë ndihmëse, jo autonome dhe veprojnë nën mbikëqyrjen e mjekut veterinar, masat duhet të shmangin mbirregullimin dhe të jenë në përpjesëtim të drejtë me nivelin e përgjegjësisë dhe rrezikut; përndryshe, kufizimet e tepruara cenojnë efikasitetin e shërbimit dhe aksesin në shërbime (p.sh. shërbimet e ndërzimit).

3.2.5. Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e mjedisit

(Rregullator: Ministria e Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Mjedisit)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon shtatë profesione/veprimtari të rregulluara në fushën e mjedisit: operator mjedisi; ekspert i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM); transportues mbetjesh; tregtar mbetjesh; agjent mbetjesh; shpues profesionist për ujë; punonjës i shërbimit pyjor. Rregullimi justifikohet kryesisht nga mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit publik, administrimi i burimeve natyrore (ujë/pyje), si dhe kontrolli i rreziqeve të larta mjedisore (ndotje, menaxhim i mbetjeve, ndërhyrje në burime ujore). Modeli i rregullimit është kryesisht “veprimtari e rezervuar” përmes lejeve/licencave administrative (operator mjedisi; transportues/tregtar/agjent mbetjesh; shpues profesionist për ujë), ndërsa për ekspertin e VNM-së dhe punonjës të shërbimit pyjor rregullimi shfaqet edhe si certifikim individual i lidhur me funksione teknike dhe/ose publike. Inventari dhe referencat ligjore pasqyrohen në Instrumentin 1.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/rezidencës

Veprimtaritë e rezervuara lidhen kryesisht me: (i) operimin/kontrollin e instalimeve me ndikim mjedisor, monitorimin e shkarkimeve dhe zbatimin/raportimin e kushteve të lejes (operator mjedisi, leje tip A ose tip B); (ii) transportin, tregtimin dhe ndërmjetësimin e qarkullimit të mbetjeve, përfshirë import/eksport/tranzit sipas kushteve të licencës (transportues, tregtar, agjent mbetjesh, përfshirë nënkategorinë III.2.B për tregtarin); (iii) hartimin e raporteve paraprake dhe të thelluara të VNM-së, auditimin mjedisor dhe opinionin teknik që përdoret në vendimarrje administrative (ekspert VNM); (iv) shpimin e puseve dhe dorëzimin e dokumentacionit/mostrave e raporteve teknike (shpues profesionist për ujë); (v) monitorimin, administrimin dhe zbatimin e masave të menaxhimit pyjor, mbrojtjen nga prerjet e paligjshme dhe zjarret (punonjës shërbimi pyjor).

Nuk evidentohet kërkesë formale shtetësie/vendbanimi për akses në këto veprimtari: regjimi përshkruhet si neutral ndaj kombësisë dhe i bazuar tek autorizimi, kriteret teknike dhe pajtueshmëria me kushtet e lejes/licencës. Për punonjës të shërbimit pyjor theksohet kufizimi praktik nga natyra e funksioneve publike dhe organizimi territorial i shërbimit, jo nga shtetësia si kriter i shprehur.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale ndahet funksionalisht ndërmjet: (i) ministrisë përgjegjëse për mjedisin/pyjet si organ politikëbërës dhe rregullator; (ii) Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për administrimin e lejeve mjedisore, regjistrat dhe monitorimin e kushteve të lejes; (iii) Qendrës Kombëtare të Licencimit për licencimin e transportuesit/tregtarit/agjentit të mbetjeve (me rol të ministrisë për miratim në skema të caktuara); (iv) strukturave inspektuese dhe mekanizmave të kontrollit nën përgjegjësinë e ministrisë dhe AKM-së për mbikëqyrjen e ushtrimit të aktiviteteve; (v) organeve të administrimit të burimeve ujore, në veçanti Këshillave të Baseneve Ujore, për lejet e shpimit, me role mbështetëse të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe Arkivit Qendror Gjeologjik në administrimin e informacionit teknik; (vi) strukturave vendore dhe institucioneve në varësi për zbatimin në terren të funksioneve pyjore. Në tërësi evidentohet ndarje e arsyeshme midis autorizimit (leje/licencë) dhe kontrollit/monitorimit, por edhe një arkitekturë me disa nyje

institucionale që, në praktikë, e bën të domosdoshme standardizimin e mëtejshëm të rrjedhave procedurale dhe koordinimit.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesa dominuese është pajisja me leje/licencë administrative dhe respektimi i kushteve teknike të saj. Tek operatori i mjedisit, aksesit dhe ushtrimi kushtëzohen nga leja mjedisore tip A ose tip B, sipas ndikimit të instalimit/veprimtarisë. Te transportuesi i mbetjeve, tregtari dhe agjenti, kërkohet licencim dhe regjistrim përkatës, me theks të veçantë te gjurmueshmëria dhe kontrolli i rreziqeve (sidomos për mbetje të rrezikshme). Kërkesa për arsim dhe përvojë shfaqet kryesisht përmes drejtuesit teknik: (i) për operatorin, veçanërisht në veprimtari që pajisen me leje tip B; (ii) për veprimtari me mbetje të rrezikshme (transport/tregtim/ndërmjetësim), ku kërkohet drejtues teknik i kualifikuar; (iii) për shpuesin profesionist për ujë, ku drejtuesi teknik duhet të ketë arsim të lartë dhe përvojë në fusha të lidhura me gjeologjinë/hidrogjeologjinë/inxhinierinë. Provimi si kërkesë eksplicite del qartë te eksperti i VNM-së (certifikim pas plotësimit të kriterëve dhe kalimit të provimit). Te punonjësi i shërbimit pyjor, kërkohet kualifikim/certifikim sipas ligjit për pyjet, duke reflektuar profil të lidhur me përgjegjësi publike dhe kontroll në terren.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Në këtë sektor, “njohja” paraqitet kryesisht si element i verifikimit të kapaciteteve teknike për pozicione të caktuara (drejtues teknikë dhe ekspertë), jo si regjim autonom njohjeje profesionale për vetë veprimtarinë (sepse porta e hyrjes është licenca/leja). Për operatorin e mjedisit dhe aktivitetet e mbetjeve, njohja e diplomave të huaja bëhet relevante vetëm kur kërkohet drejtues teknik me diplomë dhe kualifikim përkatës; kjo zhvillohet sipas rregullave të përgjithshme të njohjes akademike.

Për ekspertin e VNM-së, njohja e diplomës universitare të fituar jashtë vendit mund të shërbejë si parakusht dokumentues, por nuk zëvendëson certifikimin, i cili kërkon provim. Aplikimi elektronik del si praktikë e konsoliduar të paktën për lejet mjedisore (përmes e-Albania). Afatet dhe ankimi referohen si të parashikuara, me mbështetje të rregullat e përgjithshme administrative dhe skemat përkatëse sektoriale.

Nuk rezulton kërkesë gjuhësore e standardizuar dhe e njëtrajtshme në të gjithë sektorin; nevoja gjuhësore mbetet funksionale (për dokumentacionin, raportimin dhe komunikimin me autoritetet).

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor, në praktikë, trajtohet si i kufizuar për shumicën e veprimtarive, sepse ushtrimi kërkon gjithmonë autorizim paraprak (leje/licencë) dhe respektim të kushteve teknike, pavarësisht origjinës së subjektit dhe pavarësisht nëse aktiviteti synohet të jetë i përkohshëm.

Kjo logjikë del qartë për operatorin e mjedisit (leje tip A/B), për transportuesin/tregtarin/agjentin e mbetjeve (licencë dhe kontroll mbi qarkullimin, përfshirë import/eksport/tranzit), dhe për shpuesin profesionist për ujë (licencë dhe leje për çdo ndërhyrje nga autoriteti kompetent). Për ekspertin e VNM-së, qasja është e ngjashme: raportet e VNM-së ndikojnë drejtpërdrejt në vendimarrjen administrative, ndaj kërkohet certifikim/licencim paraprak dhe nuk rezulton regjim i posaçëm i

thjeshtuar për shërbime të përkohshme. Për punonjësën e shërbimit pyjor, ofrimi i përkohshëm nuk është i përshtatshëm, për shkak të lidhjes me funksione publike, administrim pasurish natyrore dhe kontroll territorial.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti vlerësohet miks, por me bazë të fortë legjitimuese, pasi kufizimet lidhen me risk të lartë mjedisor dhe shëndetësor. Pikat e forta janë: (i) mungesa e kufizimeve formale mbi bazë shtetësie, me trajtim të barabartë të subjekteve; (ii) orientimi i qartë drejt parandalimit të dëmit dhe kontrollit të veprimtarive me ndikim të lartë (leje tip A/B; kontroll mbi mbetjet e rrezikshme; leje për shpim uji); (iii) përdorimi i kanaleve elektronike për aplikim (p.sh. e-Albania për leje mjedisore), që rrit transparencën dhe aksesueshmërinë.

Rreziqet/pikat ku kërkohet ndërhyrje reformuese lidhen me: (i) barrën procedurale dhe kompleksitetin institucional (shumë autoritete të përfshira: AKM, QKL, organe ujore, struktura inspektuese); (ii) mungesën e një trajtimi të diferencuar dhe të artikuluar për raste të përkohshme, edhe kur risku mund të jetë i ulët; (iii) standardizimin e pamjaftueshëm të kërkesave për drejtues teknik dhe të hapave/afateve në skema të ndryshme, çka mund të krijojë pasiguri për operatorët. Këto gjetje operacionalizohen në Planin Kombëtar të Veprimit, (qartësim kompetencash, thjeshtim dhe standardizim procedurash, diferencim i kërkesave sipas nivelit të riskut, dhe rritje e transparencës/digjitalizimit aty ku ende është “pjesërisht”).

3.2.6. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e infrastrukturës dhe transporteve

(Rregullator: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë)

Seksioni 3.2.6 trajton profesione dhe veprimtaritë e rregulluara nën përgjegjësinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të cilat përfshijnë një spektër të gjerë aktivitetsesh me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë publike, funksionimin e infrastrukturës kritike dhe mobilitetin. Për qëllime analitike dhe strukturore, ky seksion është ndarë në disa nënseksione tematike, që pasqyrojnë natyrën dhe specifikat e rregullimit sektorial: fusha e inxhinierive dhe infrastrukturës, transporti rrugor, transporti detar dhe transporti ajror. Kjo ndarje synon të reflektojë dallimet thelbësore ndërmjet modeleve rregullatore, autoriteteve kompetente dhe kërkesave profesionale në secilin nënsektor, duke mundësuar një analizë më të saktë të së drejtës së vendosjes dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve në këto fusha.

3.2.6.1. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e inxhinierisë

(Rregullator: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon një grup të gjerë profesionesh dhe profilesh të inxhinierisë, përfshirë arkitektët, urbanistikën dhe specializime të ndryshme teknike, mekanike, elektrike, ndërtimore, mjedisore, gjeologjike, hidroteknike, kimike, minerare, të naftës dhe detare. Këto profesione përbëjnë veprimtari të rregulluara, pasi aksesimi dhe ushtrimi i tyre kushtëzohen nga posedimi i kualifikimeve profesionale specifike dhe nga përmbushja e kërkesave të parashikuara në legjislacionin kombëtar. Rregullimi mbështetet në dispozita ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë

fushat e veprimtarisë së rezervuar, si dhe procedurat për licencim, regjistrim dhe mbikëqyrje profesionale. Ushtrimi i profesionit nuk është i rezervuar për shtetas shqiptarë dhe është i hapur edhe për shtetas të huaj, në përputhje me kushtet e njohjes së kualifikimeve profesionale. Inventari dhe referencat ligjore pasqyrohen në Instrumentin 1.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen kryesisht me projektimin, mbikëqyrjen, zbatimin dhe certifikimin e veprave dhe shërbimeve teknike që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë publike, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit, si dhe në mbrojtjen e mjedisit dhe interesit publik. Kufizimi i aksesit në këto veprimtari bazohet në përmbushjen e kriterëve profesionale dhe teknike, jo në shtetësi. Nuk parashikohen kufizime mbi bazë shtetësie, përveç rasteve të përgjithshme të parashikuara nga legjislacioni për ushtrimin e veprimtarive në territorin e Republikës së Shqipërisë.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Autoriteti kryesor përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e profesioneve të inxhinierisë është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me strukturat përkatëse administrative dhe profesionale. Këto struktura ushtrojnë kompetenca në lidhje me licencimin, regjistrimin, kontrollin dhe disiplinën profesionale, duke garantuar respektimin e kërkesave ligjore dhe standardeve teknike për ushtrimin e profesionit.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat dominuese për akses në profesion përfshijnë përfundimin e programeve të arsimit të lartë në fushat përkatëse të inxhinierisë, të strukturuar sipas sistemit kombëtar të arsimit të lartë, si dhe përmbushjen e kriterëve shtesë profesionale të parashikuara nga aktet nënligjore. Programet e studimit përfshijnë komponentë teorikë dhe praktikë, ndërsa praktika profesionale e detyrueshme pas diplomimit shërben si element plotësues për sigurimin e kompetencave praktike. Profesione të inxhinierisë nuk bëjnë pjesë në profesionet sektoriale me kriterë minimale të formimit të koordinuara në nivel të Bashkimit Evropian, me përjashtim të arkitektit. Trajnimi me kohë të pjesshme nuk është i rregulluar në mënyrë të veçantë dhe institucionet e trajnimit janë institucionet e arsimit të lartë të licencuara dhe të akredituara në nivel kombëtar.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Njohja e kualifikimeve të huaja dallon ndërmjet njohjes akademike dhe njohjes profesionale, në përputhje me kuadrin e përgjithshëm ligjor. Autoritetet kompetente për shqyrtimin e aplikimeve janë të përcaktuara, por procedurat administrative nuk janë gjithmonë të unifikuara për të gjitha profilet e inxhinierisë dhe jo në të gjitha rastet shoqërohen me përshkrim të detajuar të hapave, afateve dhe mjeteve të ankimit. Njohja profesionale mund të shoqërohet me vlerësim të kompetencave dhe, në raste të caktuara, me kërkesa për njohuri gjuhësore. Mundësia për zhvillimin e procedurave në mënyrë elektronike mbetet e kufizuar.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Ofrimi i përkohshëm ose i rastësishëm i shërbimeve profesionale nga inxhinierë të vendosur në shtete të tjera lejohet në parim, në përputhje me parimin e lirisë për të ofruar shërbime. Megjithatë, kuadri rregullator nuk artikulon në mënyrë të njëtrajtshme mekanizmat e kontrollit paraprak,

kushtet e deklaramit dhe procedurat administrative që lidhen me këtë formë ushtrimi të profesionit, veçanërisht sa i përket verifikimit të kualifikimeve profesionale dhe zbatimit të mekanizmave të Direktivës 2005/36/EC.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti vlerësohet miks. Pikat e forta përfshijnë lidhjen e drejtpërdrejtë të veprimtarive të rezervuara me mbrojtjen e sigurisë publike, jetës, shëndetit dhe mjedisit, si dhe ekzistencën e një kuadri bazë për licencim dhe mbikëqyrje. Rreziqet kryesore lidhen me mungesën e unifikimit procedural për njohjen profesionale, transparencën e kufizuar të hapave dhe afateve administrative, dixhitalizimin e pamjaftueshëm dhe paqartësitë lidhur me ofrimin e përkohshëm të shërbimeve. Këto gjetje operacionalizohen në masat e Planit të Veprimit, me fokus në harmonizimin e procedurave, forcimin e transparencës dhe krijimin e mekanizmave më të qartë për mobilitetin profesional, duke ruajtur nivelin e nevojshëm të mbrojtjes së interesit publik.

Duke qene se profesioni i vlerësuesit të pasurive të paluajtshme është pak më i ndryshëm nga ai i inxhinierëve pasqyrohet në nënseksionin e mëposhtëm.

– **Vlerësues i Pasurive të Paluajtshme**

Në Republikën e Shqipërisë, profesioni i vlerësuesit të pasurive të paluajtshme është i rregulluar në kuptimin e legjislacionit kombëtar dhe të acquis të Bashkimit Evropian, pasi aksesimi dhe ushtrimi i veprimtarisë profesionale janë të kushtëzuara nga përmbushja e kërkesave të caktuara ligjore, rregullative dhe administrative. Rregullimi i këtij profesioni buron nga legjislacioni kombëtar për licencimin e aktiviteteve dhe nga akti nënligjor specifik që përcakton kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës profesionale, duke identifikuar qartë veprimtaritë e rezervuara dhe autoritetin kompetent përgjegjës për mbikëqyrjen e sektorit. Aksesimi i profesionit nuk është i rezervuar për shtetasit shqiptarë dhe legjislacioni nuk parashikon kufizime mbi bazën e shtetësisë, për sa kohë që aplikuesi përmbush kërkesat e kualifikimit dhe dokumentacionit të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi. Aktivitetet e rezervuara përfshijnë kryerjen e vlerësimeve profesionale të pasurive të paluajtshme dhe asetëve të lidhura me to, si dhe hartimin dhe nënshkrimin e raporteve të vlerësimit me efekt juridik për përdorim nga institucione publike dhe private. Rregullimi dhe mbikëqyrja e profesionit ushtrohen nga ministria përgjegjëse për zhvillimin urban (MIE) përmes një komisioni të posaçëm administrativ, i cili është i ngarkuar me dhënien, rinovimin, pezullimin dhe heqjen e licencave, si dhe me shqyrtimin e ankesave dhe zbatimin e masave disiplinore.

Formimi profesional për ushtrimin e këtij profesioni bazohet në një sistem kualifikimi që kombinon arsimin universitar, specializimin pasuniversitar dhe përvojën praktike të dokumentuar. Për aksesimin fillestar në profesion kërkohet përfundimi i studimeve universitare të ciklit të dytë në fusha të lidhura drejtpërdrejt me natyrën teknike dhe ekonomike të veprimtarisë së vlerësimit, si dhe ndjekja e një programi të specializuar pasuniversitar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme.

Avancimi drejt nivelit më të lartë të licencimit kushtëzohet nga përvoja profesionale e kryer nën mbikëqyrje, e cila synon të garantojë përvetësimin e aftësive praktike dhe respektimin e standardeve profesionale. Ky profesion nuk bën pjesë në grupin e profesioneve sektoriale për të

cilat Bashkimi Evropian ka përcaktuar standarde të harmonizuara minimale të formimit dhe, për rrjedhojë, sistemi i kualifikimit mbetet kryesisht në kompetencë kombëtare. Megjithatë, struktura e përgjithshme e formimit dhe niveli i kërkuar i kualifikimit janë të krahasueshme me praktikën e ndjekura në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për profesione me përgjegjësi të ngjashme, duke reflektuar një nivel të avancuar përgatitjeje profesionale.

Njohja e kualifikimeve të huaja për qëllime vendosjeje trajtohet në mënyrë të veçantë nga njohja për qëllime akademike, duke reflektuar një dallim të qartë ndërmjet dy regjimeve. Autoriteti kompetent për njohjen e kualifikimeve profesionale është i njëjti që ushtron kompetencat e licencimit dhe procedura përkatëse përfshin verifikimin e dokumentacionit arsimor dhe profesional, si dhe vlerësimin e përputhshmërisë së formimit të aplikuesit me kërkesat kombëtare. Në rastet kur konstatohen dallime thelbësore ndërmjet kualifikimeve të fituara jashtë vendit dhe kërkesave të brendshme, autoriteti kompetent mund të aplikojë masa kompensuese, në përputhje me parimet e njohjes reciproke të parashikuara nga Direktiva 2005/36/KE. Procedurat administrative janë të strukturuar, parashikojnë afate për shqyrtimin e aplikimeve dhe ofrojnë të drejtën e ankimit ndaj vendimeve negative. Aplikimi për njohje dhe për licencim mund të kryhet në mënyrë elektronike, çka lehtëson aksesin në profesion dhe rrit transparencën e procesit.

Sa i përket ofrimit të shërbimeve në mënyrë të përkohshme ose herë pas here nga profesionistë të vendosur në shtete të tjera, legjislacioni kombëtar e lejon këtë formë ushtrimi të veprimtarisë, por e kushtëzon atë me respektimin e disa kërkesave paraprake, me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe garantimin e cilësisë së shërbimit. Autoriteti kompetent ka të drejtë të verifikojë paraprakisht kualifikimet profesionale të aplikuesit, veçanërisht në rastet kur natyra e aktivitetit dhe përdorimi i raporteve të vlerësimit mund të kenë ndikim të rëndësishëm në sigurinë juridike dhe financiare të palëve të treta. Procedurat për këtë formë ofrimi shërbimesh janë administrative, të dokumentuara dhe pjesërisht të dixhitalizuara, ndërkohë që parashikohen afate për vendimmarrje dhe mekanizma ankimi. Në këtë mënyrë, kuadri kombëtar synon të balancojë lirinë e ofrimit të shërbimeve me nevojën për të ruajtur standarde të larta profesionale dhe për të mbrojtur interesin publik.

3.2.6.2. Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e transportit rrugor

(Rregullator: Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon një grup veprimtarish të rregulluara në fushën e transportit rrugor, të justifikuara kryesisht nga objektiva të interesit publik si siguria rrugore, siguria publike dhe funksionimi i rregullt i tregut. Rregullimi nuk synon mbrojtjen e një titulli profesional në kuptimin klasik, por rezervimin e ushtrimit të veprimtarisë për persona që pajisen me dëshmi aftësie profesionale përkatëse. Modeli mbizotërues është ai i veprimtarisë së rezervuar, ku aktivitete të caktuara teknike ose me rrezik të shtuar mund të ushtrohen vetëm pas certifikimit profesional nga autoritetet kompetente. Inventari dhe referencat ligjore pasqyrohen në Instrumentin 1.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen kryesisht me funksione që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë rrugore dhe teknike, si shoqërimi teknik i transporteve jonormale, formimi i drejtuesve të mjeteve, përgjegjësia teknike në autoriparime, përdorimi i makinerive të rënda, veprimtaria e shitblerjes së mjeteve rrugore dhe shërbimet e transportit individual të udhëtarëve. Aksesit në këto veprimtari nuk kufizohet mbi bazë shtetësie apo vendbanimi; kufizimi lidhet ekskluzivisht me përmbushjen e kriterëve profesionale dhe pajisjen me dëshmi aftësie profesionale. Ky regjim justifikohet nga arsye të sigurisë publike dhe parandalimit të rreziqeve në qarkullimin rrugor dhe në aktivitetet teknike.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale ndahet ndërmjet: (i) ministrisë përgjegjëse për politikëbërjen dhe rregullimin sektorial, (ii) Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor si organ kryesor licencues/regjistruues dhe administrues i dëshmive të aftësisë profesionale, dhe (iii) strukturave mbikëqyrëse dhe inspektuese për kontrollin e zbatimit të standardeve teknike dhe profesionale. Kompetencat janë përgjithësisht të ndara qartë, me DPSHTRR që mban rolin qendror operacional, ndërsa ministria ushtron funksione rregullatore dhe koordinuese.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat dominuese përfshijnë arsim ose formim profesional të posaçëm, ndjekjen e programeve të miratuara të trajnimit dhe kalimin e provimit për pajisje me dëshmi aftësie profesionale. Licencimi ose certifikimi përbën mekanizmin kryesor të aksesit në veprimtari. Trajnimi zhvillohet në nivel kombëtar, në institucione të autorizuara, dhe shoqërohet me vlerësim përfundimtar. Kërkesa shtesë lidhen me aftësinë teknike, integritetin profesional dhe, sipas rastit, përmbushjen e standardeve të sigurisë. Këto veprimtari nuk bëjnë pjesë në profesionet sektoriale të BE-së me standarde minimale të harmonizuara të trajnimit.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Sistemi fokusohet kryesisht te pajisja me dëshmi aftësie profesionale për ushtrimin e veprimtarisë në territorin shqiptar, më shumë sesa te një dallim i strukturuar ndërmjet njohjes akademike dhe asaj profesionale. Njohja administrohet nga i njëjti autoritet që rregullon veprimtarinë, në përputhje me legjislacionin administrativ të përgjithshëm dhe aktet sektoriale. Kërkesa formale gjuhësore nuk është e parashikuar shprehimisht, por njohja e gjuhës shqipe është e domosdoshme në praktikë për ndjekjen e trajnimeve dhe ushtrimin efektiv të aktivitetit. Aplikimi elektronik është i pjesshëm; afatet dhe ankimi mbështeten kryesisht në rregullat e përgjithshme të procedurës administrative, pa skema të posaçme sektoriale.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Kuadri ligjor nuk parashikon një regjim të dedikuar për ofrimin e përkohshëm ose rastësor të shërbimeve nga profesionistë të vendosur në shtete të tjera. Nuk rezulton të jetë vendosur një sistem i posaçëm deklarimi paraprak ose kontrolli sipas nenit 7(4) të Direktivës 2005/36. Ofrimi ndërkufitar i shërbimeve realizohet përmes mekanizmave të përgjithshëm kombëtarë dhe jo përmes një procedure të standardizuar specifike për këtë sektor.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti vlerësohet miks. Pikat e forta janë orientimi i qartë drejt sigurisë publike dhe teknike, përdorimi i dëshmisë së aftësisë profesionale si instrument kryesor kontrolli dhe ekzistenca e një autoriteti qendror operacional. Rastet që paraqesin rrezik mospërputhshmërie me acquis lidhen kryesisht me mungesën e procedurave të strukturuar për mobilitetin ndërkufitar, përdorimin e kufizuar të mjeteve elektronike dhe mbështetjen e gjerë në procedurat e përgjithshme administrative pa mekanizma sektorialë të posaçëm. Këto gjetje operacionalizohen në masat e Planit të Veprimit, me fokus në qartësimin e njohjes profesionale, forcimin e dimensionit të mobilitetit dhe përmirësimin e transparencës procedurale.

3.2.6.3. Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e transportit detar

(Rregullator: Drejtoria e Përgjithshme Detare)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon profesionet detare që lidhen me funksionet e kuvertës, makinës, elektroteknikës dhe radiokomunikimit në anije. Rregullimi i këtij sektori bazohet në një model certifikimi funksional të harmonizuar ndërkombëtarisht, i ndërtuar mbi Konventën STCW dhe aktet e saj zbatuese, si dhe në përafrimin me Direktivën 2008/106/EC. Të gjitha profesionet detare janë të rregulluara në kuptimin material, pasi ushtrimi i tyre kushtëzohet nga posedimi i certifikatave të kompetencës ose dëshmive të aftësisë profesionale të lëshuara nga autoriteti kombëtar. Modeli mbizotërues është ai i veprimtarisë së rezervuar: funksionet në bord nuk janë të hapura për publikun e gjerë, por vetëm për persona të certifikuar sipas standardeve të sigurisë detare. Inventari dhe referencat ligjore pasqyrohen në Instrumentin 1.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen kryesisht me komandimin e anijes, operimin e kuvertës dhe makinës, menaxhimin elektroteknik dhe radiokomunikimin detar, pra funksione që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e lundrimit, jetën njerëzore në det dhe mbrojtjen e mjedisit detar. Aksesit në këto profesione nuk kufizohet mbi bazë shtetësie apo vendbanimi, por mbi bazë kualifikimi dhe certifikimi profesional. Shtetasit e huaj mund të ushtrojnë këto funksione për sa kohë që disponojnë certifikata kompetence të njohura ose të konvertuara sipas procedurave kombëtare dhe në përputhje me standardet STCW. Kufizimet ekzistuese justifikohen nga arsye të sigurisë publike dhe sigurisë detare.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale është e centralizuar. Drejtoria e Përgjithshme Detare vepron si autoritet unik kompetent për pranimin e aplikimeve, verifikimin e dokumentacionit, vlerësimin e përmbushjes së standardeve të trajnimit dhe lëshimin, rinovimin ose konvertimin e certifikatave. Ky autoritet ushtron njëkohësisht funksione rregullatore, licencuese dhe mbikëqyrëse, duke siguruar zbatim të unifikuar të kërkesave të STCW dhe të legjisllacionit kombëtar. Ky centralizim kontribuon në koherencën e sistemit dhe në parashikueshmërinë procedurale.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat dominuese përfshijnë arsim dhe trajnim të strukturuar detar, ndjekjen e kurseve të miratuara, praktikën e detyrueshme në bord dhe shërbimin detar të dokumentuar, të shoqëruara

me verifikim përmes certifikatës së kompetencës. Sistemi i kualifikimit është progresiv dhe hierarkik, me kërkesa të diferencuara sipas nivelit dhe funksionit në anije. Në disa raste parashikohen rrugë alternative për përmbushjen e kërkesave të shërbimit detar, por gjithmonë brenda kufijve të standardeve ndërkombëtare. Këto profesione përbëjnë një regjim të harmonizuar sektorial, të ndryshëm nga modeli i përgjithshëm i Direktivës 2005/36/KE.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Njohja profesionale administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe dallohet qartë nga njohja akademike. Fokusi është ekskluzivisht të verifikimi dhe konvertimi i certifikatave të huaja në përputhje me STCW. Procedurat përfshijnë kontrollin e dokumentacionit, vlefshmërinë e certifikatave dhe përmbushjen e kërkesave shtesë të sigurisë. Njohja akademike e diplomave ka rëndësi vetëm ndihmëse, ndërsa e drejta për ushtrimin e profesionit buron nga certifikata profesionale. Procedurat zhvillohen pranë autoritetit kompetent; kërkesa gjuhësore nuk paraqitet si kusht formal i përgjithshëm; aplikimi elektronik mbetet i kufizuar; afatet dhe ankimi zbatohen sipas rregullave administrative përkatëse.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Sektori detar nuk ndjek modelin klasik territorial të ofrimit të përkohshëm të shërbimeve. Ushtrimi i profesionit lidhet drejtpërdrejt me shërbimin në anije dhe me regjimin ndërkombëtar të lundrimit. Ofrimi i shërbimeve nga profesionistë të huaj realizohet praktikisht përmes punësimit në anije që operojnë nën flamur shqiptar ose të huaj, gjithmonë nën kushtin e certifikimit të vlefshëm sipas STCW dhe njohjes ose konvertimit të tij nga autoriteti kompetent. Nuk aplikohet skema e deklaramit paraprak sipas Direktivës 2005/36, pasi sektori funksionon mbi bazën e standardeve detare ndërkombëtare.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti vlerësohet përgjithësisht i kënaqshëm. Pikat e forta përfshijnë harmonizimin e plotë me standardet STCW dhe të BE-së, centralizimin e kompetencave në një autoritet unik dhe lidhjen e drejtpërdrejtë të rregullimit me sigurinë detare. Rastet që paraqesin rrezik mospërputhshmërie me acquis lidhen kryesisht me transparencën procedurale, nivelin e dixhitalizimit dhe barrën administrative të proceseve të verifikimit dhe konvertimit. Këto gjetje operacionalizohen në masat e Planit të Veprimit, me fokus në thjeshtimin e procedurave, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e shërbimeve elektronike, pa cenuar nivelin e lartë të mbrojtjes së interesit publik dhe sigurisë detare.

3.2.6.4. Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e transportit ajror

(Rregullator: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Aviacionit Civil)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon profesionet dhe veprimtaritë që lidhen me operimin e aerodromeve dhe avionëve, menaxhimin e hapësirës ajrore, shërbimet e kontrollit dhe koordinimit të fluturimeve, si dhe ekuipazhin ajror. Rregullimi i këtij sektori bazohet në objektiva thelbësorë të interesit publik, në veçanti sigurinë publike, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të pasagjerëve, rendin publik dhe

funksionimin e sigurt të transportit ajror. Të gjitha këto veprimtari janë të rregulluara në kuptimin material, pasi aksesimi dhe ushtrimi i tyre kushtëzohen nga licencim ose certifikim i detyrueshëm, trajnim i specializuar, rivlerësim periodik i kompetencave dhe mbikëqyrje administrative. Modeli mbizotërues është ai i veprimtarisë së rezervuar: funksionet kritike për sigurinë ajrore ushtrohen vetëm nga persona ose subjekte të autorizuar. Inventari dhe referencat ligjore pasqyrohen në Instrumentin 1.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen kryesisht me operimin e avionëve dhe aerodromeve, kontrollin e trafikut ajror dhe koordinimin e fluturimeve, si dhe ushtrimin e roleve të ekuipazhit dhe ekzaminimit të fluturimit. Këto funksione ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e fluturimeve dhe mbrojtjen e jetës njerëzore, duke justifikuar kufizimin e ushtrimit vetëm për profesionistë të certifikuar. Kufizimet nuk synojnë mbrojtjen e interesave ekonomike të operatorëve ekzistues, por parandalimin e rreziqeve sistematike. Aksesit në profesion nuk paraqitet si i rezervuar mbi bazë shtetësie, por mbi bazë kualifikimi, aftësie profesionale dhe përshtatshmërie fizike e mjekësore, të verifikuara nga autoritetet kompetente, në funksion të sigurisë publike.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale ndahet ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si organ politikëbërës dhe Autoritetit të Aviacionit Civil si organ rregullator, licencues dhe mbikëqyrës. Autoriteti i Aviacionit Civil ushtron kompetenca për certifikimin e personelit ajror, autorizimin e operatorëve ajrorë dhe aerodromeve, si dhe kontrollin e vazhdueshëm të përmbushjes së standardeve të sigurisë. Ky organizim siguron një nivel të lartë kontrolli institucional mbi funksionet kritike dhe një kornizë të qartë përgjegjësisë administrative.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat dominuese përfshijnë arsim dhe trajnim shumë të specializuar, licencim ose certifikim të detyrueshëm, rivlerësim periodik të kompetencave profesionale dhe kontroll mjekësor të vazhdueshëm. Ushtrimi i këtyre veprimtarive kushtëzohet gjithashtu nga respektimi i standardeve teknike dhe operacionale, si dhe nga mbikëqyrja administrative e vazhdueshme. Këto masa synojnë të garantojnë që vetëm persona me aftësi teknike, profesionale dhe fizike të provuara të mund të ushtrojnë funksione që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e aviacionit.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Njohja profesionale administrohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil dhe fokusohet në verifikimin e përputhshmërisë së kualifikimeve, licencave dhe kompetencave me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë ajrore. Kjo njohje dallohet nga njohja akademike dhe shërben ekskluzivisht për qëllime ushtrimi të profesionit. Procedurat përfshijnë kontrollin e dokumentacionit dhe, sipas rastit, rivlerësim të aftësive profesionale dhe mjekësore. Qëllimi kryesor është ruajtja e integritetit të sistemit të sigurisë ajrore dhe besimit publik në transportin ajror.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Sektori i aviacionit civil nuk ndjek modelin klasik të ofrimit të përkohshëm të shërbimeve pa autorizim paraprak. Ushtrimi i funksioneve ajrore lidhet drejtpërdrejt me certifikimin individual ose autorizimin e operatorëve dhe me mbikëqyrjen e vazhdueshme nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Si rrjedhojë, çdo formë ushtrimi, edhe kur ka karakter të përkohshëm, i nënshtrohet të njëjtave kërkesa thelbësore të sigurisë dhe kontrollit institucional.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti vlerësohet i kënaqshëm, duke qenë se masat rregullatore janë të lidhura drejtpërdrejt me mbrojtjen e jetës njerëzore, sigurinë publike dhe funksionimin e infrastrukturës kritike. Pikat e forta përfshijnë nivelin shumë të lartë të kontrollit profesional, mbikëqyrjen e centralizuar dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare të ICAO-s¹⁰ dhe sistemin evropian të sigurisë ajrore. Rreziqet potenciale lidhen kryesisht me barrën administrative dhe nevojën për përmirësim të transparencës procedurale dhe digjitalizimit. Këto gjetje operacionalizohen në masat e Planit të Veprimit, me fokus në thjeshtimin e proceseve administrative dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, pa cenuar nivelin e lartë të mbrojtjes së interesit publik.

3.2.7 Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në fushën e arsimit parauniversitar

(Rregullator kryesor: Ministria e Arsimit)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon një gamë të gjerë profilesh të rregulluara të mësuesve në arsimin parauniversitar, që përfshijnë njëzet e tetë fusha dhe specializime të ndryshme mësimore. Rregullimi i këtyre profesioneve justifikohet nga objektiva të interesit publik që lidhen me cilësinë e arsimit, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe nxënësve, si dhe garantimin e standardeve pedagogjike në sistemin arsimor.

Modeli i rregullimit bazohet kryesisht në mbrojtjen e titullit profesional dhe në kushtëzimin e ushtrimit të veprimtarisë mësimore nga përmbushja e kriterëve të kualifikimit dhe certifikimit. Aksesimi në profesion dhe ushtrimi i tij janë të lidhura ngushtë me sistemin e licencimit dhe certifikimit të mësuesve, si dhe me vendosjen në pozicione pune përmes procedurave të administruara nga autoritetet arsimore.

Profili sektorial karakterizohet nga një rregullim i centralizuar, i orientuar drejt standardizimit të kualifikimeve dhe kontrollit *ex ante* të aftësive pedagogjike, duke reflektuar ndjeshmërinë e lartë shoqërore të veprimtarisë mësimore.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rregulluara lidhen me ushtrimin e mësimdhënies në institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar, si dhe me funksionet pedagogjike të lidhura me këtë veprimtari.

¹⁰ International Civil Aviation Organisation.

Këto nuk përbëjnë ushtrim të autoritetit publik në kuptim të nenit 51 të TFBE-së, por kanë ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat dhe zhvillimin e nxënësve.

Nuk evidentohet kërkesë shtetësie për akses në profesion. Megjithatë, aplikohen kërkesa gjuhësore dhe pedagogjike që funksionojnë praktikisht si kriterë aksesimi, duke qenë se ushtrimi i profesionit kërkon njohuri të mjaftueshme të gjuhës shqipe dhe të kurrikulës kombëtare. Për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36, këto kërkesa duhet të mbeten transparente, të justifikuar dhe proporcionale.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale është e centralizuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe strukturave të saj vartëse, të cilat administrojnë kualifikimin, certifikimin, emërimin dhe mbikëqyrjen profesionale të mësuesve. Ndryshe nga sektorë të tjerë, nuk operojnë dhoma profesionale me kompetenca vetërregulluese; rregullimi dhe mbikëqyrja realizohen kryesisht përmes mekanizmave administrativë shtetërorë.

Kjo arkitekturë siguron një kontroll të unifikuar të standardeve arsimore, por njëkohësisht e bën transparencën procedurale veçanërisht të rëndësishme, pasi kandidatët varen pothuajse ekskluzivisht nga procedurat dhe praktikët e administratës arsimore.

Kur procedurat për certifikim, punësim dhe avancim profesional nuk paraqiten në mënyrë të konsoliduar me hapa, afate dhe ankime të qarta, krijohet pasiguri juridike dhe rritet kostoja administrative për aplikuesit.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat dominuese për hyrje dhe ushtrim përfshijnë përfundimin e arsimit të lartë përkatës sipas profilit mësimor, formim pedagogjik, praktikë profesionale, kalimin e provimeve ose procedurave të certifikimit dhe regjistrimin në sistemin arsimor. Për shumicën e profileve kërkohet gjithashtu zhvillim profesional i vazhdueshëm dhe përmbytje e standardeve të përcaktuara nga kurrikula kombëtare.

Këto kërkesa aplikohen në mënyrë kumulative dhe përcaktojnë nivelin real të aksesit në profesion. Kur arsimimi, certifikimi, praktika dhe procedurat e punësimit kombinohen pa mekanizma fleksibël njohjeje për përvojën e fituar jashtë sistemit kombëtar, rritet rreziku i kufizimeve më të rënda seç është e nevojshme për arritjen e objektivave të cilësisë arsimore.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Njohja e kualifikimeve të fituara jashtë vendit administrohet përmes mekanizmave të përgjithshëm të njohjes akademike dhe procedurave të certifikimit pedagogjik. Nuk evidentohet një dallim i strukturuar ndërmjet njohjes akademike dhe asaj profesionale, as një skemë e unifikuar që të përmbledhë autoritetin kompetent, hapat proceduralë, afatet dhe mekanizmat e ankimit për profesionistët e huaj.

Aplikimi elektronik nuk rezulton i institucionalizuar në mënyrë të njëtrajtshme për të gjitha fazat e procedurës. Për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36, kjo situatë kërkon standardizim të mëtijshëm të procedurave dhe rritje të transparencës, në mënyrë që mësuesit e kualifikuar jashtë vendit të kenë akses të parashikueshëm dhe proporcional në sistemin arsimor shqiptar.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor i shërbimeve mësimore nuk trajtohet si regjim i veçantë. Ushtrimi i veprimtarisë pedagogjike është i lidhur me certifikimin dhe punësimin formal në institucionet arsimore, pa procedura deklarimi paraprak ose mekanizma të posaçëm për mobilitet të përkohshëm.

Në praktikë, zbatohet një standard i vetëm rregullash për vendosje dhe ushtrim të profesionit. Kur mungojnë instrumente fleksibël për angazhime të përkohshme, krijohet efekt frenues për shkëmbimin e ekspertizës dhe për mobilitetin pedagogjik ndërkombëtar.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti në sektor vlerësohet i mbështetur në objektiva legjitime të interesit publik, por me nevojë për rishikim të vazhdueshëm në funksion të mobilitetit profesional dhe zhvillimeve në arsimin modern. Profili aktual karakterizohet nga kërkesa kumulative për arsim, certifikim dhe procedura administrative, të cilat, në mungesë të mekanizmave të qartë të njohjes profesionale dhe të regjimeve të diferencuara për shërbime të përkohshme, mund të prodhojnë barriera jo të nevojshme për mësuesit me kualifikime të krahasueshme nga jashtë vendit.

Këto gjetje përbëjnë bazën faktike për masat e Planit Kombëtar të Veprimit, me fokus në standardizimin e procedurave të njohjes profesionale, qartësimin e afateve dhe ankimeve, zhvillimin e kanaleve elektronike, si dhe vlerësimin e alternativave më pak kufizuese për aksesin në profesion, duke ruajtur njëkohësisht cilësinë e arsimit dhe mbrojtjen e nxënësve.

3.2.8. Profesione dhe veprimtaritë e rregullura në sektorin e turizmit, kulturës dhe sporteve

(Rregullator kryesor: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit)

Nën Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, profesioneve dhe veprimtarive të rregulluara u përket një profil i larmishëm, por i organizuar rreth tre drejtimeve kryesore: turizmit, kulturës dhe sportit. Në fushën e turizmit, rregullimi realizohet kryesisht përmes certifikimit, regjistrimit dhe licencimit, me fokus në cilësinë e shërbimit, sigurinë e përdoruesve dhe mbrojtjen e konsumatorit. Në fushën e kulturës, dallohen dy nën-drejtime: nga njëra anë, trashëgimia kulturore dhe arkeologjia, ku rregullimi është teknik dhe i rreptë për shkak të ndikimit potencialisht të pakthyeshëm mbi pasuritë kulturore, duke u mbështetur në kualifikime të specializuara, autorizim paraprak dhe mbikëqyrje institucionale; nga ana tjetër, industritë kulturore-krijuese, ku mbizotëron liria ekonomike dhe kontraktore, me ndërhyrje shtetërore kryesisht horizontale, si mbrojtja e së drejtës së autorit dhe regjistrimi tregtar. Në drejtimin e sportit, rregullimi fokusohet në garantimin e sigurisë, integritetit të veprimtarisë sportive dhe standardeve minimale organizative e

profesionale, përmes skemave të licencimit, certifikimit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet përkatëse, në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe pjesëmarrësve në aktivitetet sportive.

3.2.8.1. Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e turizmit

(Ilustrime të veprimtarive të trajtuara në këtë sektor përfshijnë: udhërrëfyes turistik (përfshirë format kombëtar/lokal/i specializuar/i nderit), operator turistik, agjent turistik/udhëtimi, operator i turizmit detar, transportues turistik, vrotues plazhi.)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Sektori i turizmit, në përbërësit e paraqitur, përfshin veprimtari të rregulluara ku hyrja dhe/ose ushtrimi kushtëzohen nga përmbushja e kërkesave ligjore dhe nga certifikim, licencim ose autorizim paraprak nga autoriteti kompetent. Rregullimi justifikohet kryesisht nga objektiva të interesit publik të lidhura me cilësinë e shërbimeve turistike, sigurinë e përfituesve të shërbimit, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe – sipas natyrës së veprimtarisë – garantimin e standardeve të sigurisë (në aktivitete me risk të lartë) dhe funksionimin korrekt të tregut turistik. Nga baza ligjore e shqyrtuar evidentohet se, në këtë sektor, rregullimi shfaqet kryesisht si veprimtari të rezervuara për subjekte ose individë të certifikuar/licencuar dhe të regjistruar (p.sh. përmes Regjistrimit Qendror të Turizmit).

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen me: (i) udhëheqjen, informimin dhe asistimin e turistëve (udhërrëfimi turistik); (ii) krijimin/paketizimin dhe shitjen e produkteve turistike dhe ndërmjetësimin turistik (operatorë/agjentë); dhe (iii) shërbime të lidhura drejtpërdrejt me sigurinë dhe standardet teknike të ofrimit të turizmit (p.sh. turizmi detar, transporti turistik, vrotimi i plazhit). Aksesit nuk rezervohet vetëm për shtetas shqiptarë dhe nuk parashikohen kufizime të përgjithshme mbi bazë shtetësie. Megjithatë, për udhërrëfimin turistik përmenden kufizime funksionale për udhërrëfyesit e huaj që nuk janë certifikuar në Shqipëri, të cilët lejohen të ushtrojnë veprimtarinë vetëm në shoqërim me një udhërrëfyes vendas të certifikuar. Po ashtu, për udhërrëfyesit e huaj kërkohet qëndrim i ligjshëm dhe njohuri bazë të gjuhës shqipe, të lidhura me natyrën e shërbimit dhe mbrojtjen e interesit publik.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale është e përqendruar te ministria përgjegjëse për turizmin, e cila vepron përmes strukturave administrative dhe komisioneve përkatëse për certifikim/akreditim, licencim, regjistrim dhe monitorim. Regjistri Qendror i Turizmit shfaqet si instrument kyç i transparencës dhe gjurmueshmërisë për veprimtaritë/individët e certifikuar ose subjektet e licencuara. Për disa veprimtari, mbikëqyrja realizohet edhe në bashkëveprim me autoritete të tjera sektoriale, në masën që kërkohet për kontroll teknik dhe siguri (p.sh. kur licencimi/kontrolli teknik i një komponenti lidhet me autoritete të transportit, ndërsa regjistrimi turistik administrohet nga strukturat e turizmit). Në tërësi, modeli i përshkruar synon të ofrojë një kornizë institucionale të identifikueshme, ku certifikimi/licencimi dhe monitorimi mbështeten në funksione administrative dhe komisione të posaçme.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat dominuese në sektor janë: (i) certifikim për individë (p.sh. udhërrëfyesit; vrojtuesi i plazhit) dhe/ose (ii) licencim për subjekte/veprimtari ekonomike (p.sh. operator turistik; operator i turizmit detar; transportues turistik). Për udhërrëfimin turistik, hyrja kushtëzohet nga përfundimi me sukses i programeve specifike kualifikimi të akredituara, të diferencuara sipas kategorisë/gjuhës, me përmbajtje teorike dhe praktike (histori, kulturë, trashëgimi, mjedis, elemente sigurie). Për vrojtuesin e plazhit, trajnimi/certifikimi realizohet përmes programeve të formimit profesional në nivel kombëtar, të ofruara nga qendra të licencuara. Për veprimtaritë e licencuara (p.sh. operatori turistik, operatori i turizmit detar, transportuesi turistik), kërkesat paraqiten si kritere administrative dhe teknike, me theks te siguria, dokumentacioni teknik dhe përgjegjësitë ndaj konsumatorëve. Kërkesa për njohuri bazë të gjuhës shqipe shfaqet si element funksional për udhërrëfyesit e huaj.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Në sektorin e turizmit, për udhërrëfimin turistik evidentohet dallimi ndërmjet njohjes akademike dhe njohjes për ushtrimin e profesionit. Njohja profesionale administrohet nga autoritetet kombëtare kompetente në fushën e turizmit, në përputhje me procedurat administrative dhe kërkesat specifike të profesionit. Profesionin e udhërrëfyesit turistik nuk bën pjesë në profesionet sektoriale me standarde minimale të harmonizuara të BE-së; për rrjedhojë, vlerësimi i përputhshmërisë me acquis vendoset në logjikën e sistemit të përgjithshëm të njohjes. Kërkesa gjuhësore nuk paraqitet si test formal i përgjithshëm, por njohuria bazë e shqipes lidhet me natyrën e veprimtarisë dhe mbrojtjen e interesit publik. Procedurat përmenden si pjesërisht të digjitalizuara, ndërsa afatet e shqyrtimit dhe mekanizmat e ankimit zbatohen sipas rregullave të përgjithshme të procedurës administrative. Për veprimtaritë e tjera të rregulluara si aktivitete (p.sh. operator turistik, operator i turizmit detar, transportues turistik), njohja e kualifikimeve të huaja është çështje që lidhet kryesisht me dokumentacionin e kërkuar për licencim/certifikim dhe me rregulla të përgjithshme administrative, pa e shndërruar në kusht hyrës të bazuar në diploma akademike.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Në këtë aspekt paraqet një qasje të diferencuar. Për udhërrëfimin turistik, ofrimi i përkohshëm nga udhërrëfyes të huaj pa certifikim në Shqipëri nuk lejohet në mënyrë të pavarur, por vetëm në bashkëpunim/shoqërim me një udhërrëfyes vendas të certifikuar, si mekanizëm funksional mbikëqyrjeje që synon të ruajë standardet e sigurisë dhe cilësisë së shërbimit. Në këtë logjikë, nuk aktivizohen mekanizmat e kontrollit paraprak sipas nenit 7(4) të Direktivës 2005/36/KE, pasi legjislacioni kombëtar operon me modelin e certifikimit dhe monitorimit të udhërrëfyesve vendas dhe me kufizimin funksional të veprimtarisë së udhërrëfyesve të huaj të pacertifikuar. Për veprimtaritë me element teknik/sigurie (p.sh. turizmi detar; transporti turistik), ofrimi i përkohshëm përshkruhet si i mundshëm vetëm nëse plotësohen kërkesat përkatëse ligjore dhe standardet e sigurisë e dokumentacionit, pra nën regjim të kufizuar dhe të kushtëzuar. Për vrojtuesin e plazhit, nuk parashikohet regjim të veçantë të liberalizuar të ushtrimit të përkohshëm pa përmbushur kriteret e certifikimit kombëtar.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Në tërësi, rregullimi në sektorin e turizmit paraqitet si përpjekje për të balancuar lirinë e vendosjes dhe ofrimit të shërbimeve me mbrojtjen e interesit publik, sigurinë e turistëve, mbrojtjen e konsumatorit dhe cilësinë e shërbimit. Pikat e forta që dalin nga përshkrimi janë: (i) lidhja e rregullimit me objektiva të qartë të interesit publik (cilësi dhe siguri); (ii) përdorimi i certifikimit/licencimit dhe regjistrimit si instrumente transparence dhe kontrolli (Regjistri Qendror i Turizmit); dhe (iii) qasja jo-ekskluzive ndaj shtetësisë, duke lejuar pjesëmarrje të shtetasve të huaj me kushte funksionale të lidhura me ushtrimin efektiv dhe të përgjegjshëm të veprimtarisë. Elementet që kërkojnë vëmendje në drejtim reforme lidhen me: sigurimin që kufizimet funksionale për udhërrëfyesit e huaj të pacertifikuar dhe kërkesat gjuhësore të mbeten të arsyetuara, të targetuara dhe të zbatueshme në mënyrë të parashikueshme; si dhe me konsolidimin e mëtejshëm të digjitalizimit dhe qartësisë procedurale aty ku proceset përshkruhen vetëm si pjesërisht të digjitalizuara. Këto gjetje pasqyrohen konkretisht në masat e Planit të Veprimit.

3.2.8.2. Profesionet/veprimtaritë e rregulluara në sektorin e kulturës

(Rregullatori: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit)

Në kuadër të pikës 3.2.8.2, rregullimi nën Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit përqendrohet në dy sektorë të dallueshëm: fushën e librit dhe letërsisë, si dhe fushën e trashëgimisë kulturore materiale. Në sektorin e librit dhe letërsisë, qasja mbizotëruese është ajo e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe krijuese, pa skema të posaçme autorizimi profesional, ku roli i shtetit kufizohet kryesisht në funksione horizontale si administrimi i politikave kulturore, mbrojtja e së drejtës së autorit dhe regjistrimi i subjekteve tregtare, pa kufizime mbi aksesin në profesion apo ushtrimin e veprimtarisë. Në të kundërt, në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, rregullimi është thellësisht teknik dhe i centralizuar, pasi ndërhyrjet në monumente, site arkeologjike dhe objekte të trashëgimisë përbëjnë interes publik themelor; për rrjedhojë, ushtrimi i veprimtarive të konservimit, restaurimit dhe arkeologjisë kushtëzohet nga kualifikime të specializuara, licencim ose autorizim paraprak dhe mbikëqyrje të vazhdueshme institucionale, duke reflektuar një regjim të rreptë kontrolli të orientuar drejt mbrojtjes së autenticitetit dhe integritetit të pasurisë kulturore.

3.2.8.2.1 Profesionet/veprimtaritë e rregulluara në sektorin e librit ndërmjetësimit letrar, krijimtarisë grafike dhe botimit

(Ilustrime të veprimtarive të mbuluara nga ky sektor përfshijnë, ndër të tjera: agjent letrar, art-grafist dhe botues.)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon veprimtaritë e agentit letrar, art-grafistit dhe botuesit, të cilat në Republikën e Shqipërisë nuk përbëjnë profesione të rregulluara në kuptimin e Direktivës 2005/36/EC. As aksesin në këto veprimtari dhe as ushtrimin e tyre nuk kushtëzohen nga posedimi i kualifikimeve profesionale të detyrueshme të vendosura nga dispozita ligjore, rregullatore apo administrative. Ushtrimi i tyre mbështetet në lirinë ekonomike dhe kontraktore, në respektimin e legjislacionit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, si dhe në regjistrimin si subjekt tregtar kur veprimtaria kryhet në formë ekonomike. Nuk ekzistojnë tituj të mbrojtur, veprimtari të rezervuara apo modele të kombinuara rregullimi në këtë sektor. Referencat përkatëse pasqyrohen në Instrumentin 1.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Aktivitetet që lidhen me këto veprimtari – përfaqësimi i autorëve dhe menaxhimi kontraktual i të drejtave të autorit (agjent letrar), përgatitja grafike, ilustrimi dhe dizajni i veprave (art-grafist), si dhe përzgjedhja, prodhimi, botimi dhe shpërndarja e veprave të shkruara (botues) – nuk janë veprimtari të rezervuara ekskluzivisht. Ato mund të ushtrohen nga çdo person fizik ose juridik që vepron në përputhje me legjislacionin civil, tregtar dhe të së drejtës së autorit. Nuk parashikohen kërkesa shtetësie apo vendbanim dhe respektohen plotësisht parimet e mosdiskriminimit, lirisë së themelimit dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Në këtë sektor nuk ekzistojnë autoritete rregullatore profesionale, si dhoma profesionale, organe licencimi apo regjistra profesionale, që të mbikëqyrin aksesin në profesion. Roli i institucioneve shtetërore kufizohet në funksione administrative dhe mbikëqyrëse të përgjithshme, përfshirë regjistrimin e subjekteve tregtare, administrimin e politikave kulturore dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit. Nuk parashikohen mekanizma disiplinorë të posaçëm për këto veprimtari, përtej kornizës së përgjithshme civile, tregtare dhe administrative.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Nuk ekzistojnë kërkesa rregullatore tipike në kuptimin e arsimit të detyrueshëm, stazhit, provimit shtetëror apo licencimit/regjistrimit profesional për akses në këto veprimtari. Këto profesione nuk i përkasin profesioneve sektoriale të BE-së me standarde të përbashkëta minimale trajnimi dhe nuk parashikohen programe trajnimi të detyrueshme, të standardizuara apo të akredituara nga shteti. Formimi profesional realizohet në mënyrë të lirë, përmes arsimit universitar, trajnimeve private, përvojës praktike ose bashkëpunimit kontraktual.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Në këtë sektor nuk lind nevoja për njohje të kualifikimeve profesionale të huaja, pasi aksesin në veprimtari nuk kushtëzohet nga njohja formale e një diplome apo certificate profesionale. Sistemi i përgjithshëm i njohjes së diplomave të huaja aplikohet vetëm për qëllime akademike dhe nuk ka ndikim në të drejtën për të ushtruar këto veprimtari. Nuk kërkohen teste gjuhësore dhe nuk parashikohen procedura të posaçme administrative, afate vendimmarrjeje apo mekanizma ankimi në kuptimin e njohjes profesionale.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Ofrimi i përkohshëm ose i rastësishëm i shërbimeve nga profesionistë të vendosur në shtete të tjera është plotësisht i lejuar dhe i paregulluar, për sa kohë që respektohet legjislacioni shqiptar për të drejtën e autorit, detyrimet kontraktore dhe rregullat e përgjithshme të tregut. Nuk kërkohet aplikim paraprak, njohje formale e kualifikimeve profesionale apo autorizim administrativ. Procedurat mund të kryhen në mënyrë elektronike vetëm në kuadër të regjistrimeve tregtare apo kontraktuale, kur këto janë të nevojshme.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës (Instrumenti 3)

Proporcionaliteti vlerësohet i kënaqshëm, pasi kuadri ligjor shqiptar garanton liri të plotë themelimi dhe ofrimi shërbimesh për këto veprimtari, pa vendosur barriera rregullatore. Pikat e forta

përfshijnë respektimin e parimeve të mosdiskriminimit dhe lirisë ekonomike, mungesën e kufizimeve profesionale artificiale dhe mbështetjen në rregullat e përgjithshme të tregut dhe të së drejtës së autorit. Nuk evidentohen rreziqe mospërputhshmërie me *acquis* në këtë sektor. Për rrjedhojë, nuk rezultojnë masa specifike për ndërhyrje rregullatore në Planin e Veprimit, përtej ruajtjes së kornizës ekzistuese që mbështet krijimtarinë, shprehjen artistike dhe tregun kulturor.

3.2.8.2.2. Profesionet/veprimtaritë e rregulluara në sektorin e arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore

Ilustrime të profesioneve/veprimtarive të mbuluara nga ky sektor përfshijnë, ndër të tjera: konservues-restauratorë të rrenojave dhe siteve arkeologjike; të ndërtimeve me karakter mbrojtës; të arkitekturës së kultit; të ndërtimeve inxhinierike; të arkitekturës së traditës (vernakulare) dhe asaj të projektuar; restauratorë-rikualifikues të hapësirave në qendra historike; restauratorë të mozaikëve, pikturave murale e shkëmbore; të veprave të artit në dru, allçi, gur, qeramikë, metal, qelq; të objekteve tekstile, lëkure, pergameni, telajo e letre; si edhe arkeologë, vëzhgues, sondues dhe gërmues arkeologjikë, përfshirë variantet nënujore.

Rol aktiv në lidhje me këto profesione luan edhe Instituti Kombëtar I Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe Këshilli Kombëtar I Trashëgimisë Kulturore Materiale pranë Ministrisë së Kulturës (KKTKM).

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon një grup të gjerë profesionesh dhe veprimtarish të rregulluara në fushën e konservimit, restaurimit dhe arkeologjisë, të justifikuara kryesisht nga mbrojtja e trashëgimisë kulturore si interes publik themelor. Të gjitha veprimtaritë në këtë sektor janë të rregulluara në kuptimin material, pasi ushtrimi i tyre kushtëzohet nga kualifikime profesionale specifike, licencim ose autorizim paraprak dhe mbikëqyrje institucionale të vazhdueshme. Modeli mbizotërues i rregullimit është ai i veprimtarisë së rezervuar: ndërhyrjet konkrete në trashëgimi kulturore, si dhe veprimtaritë arkeologjike, lejohen vetëm për profesionistë të licencuar ose të autorizuar. Inventari dhe referencat ligjore pasqyrohen në Instrumentin 1.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen kryesisht me ndërhyrjet fizike mbi monumente, site arkeologjike dhe objekte të trashëgimisë kulturore, si dhe me vëzhgimin, sondimin dhe gërmimin arkeologjik, përfshirë në mjedisin nënujor. Aksesit në këto profesione nuk është i kufizuar mbi bazë shtetësie, por ushtrimi i veprimtarive konkrete është i rezervuar ekskluzivisht për profesionistë të licencuar ose të autorizuar, për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë dhe shpesh të pakthyesëm që këto ndërhyrje kanë mbi trashëgiminë kulturore materiale. Këto kufizime mbështeten në mbrojtjen e interesit publik dhe përbëjnë çështje prioritare për verifikim të domosdoshmërisë në funksion të proporcionalitetit.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale ndahet ndërmjet: (i) institucioneve shtetërore përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në varësi të ministrisë përkatëse, si organ politikëbërës dhe rregullator; (ii) autoriteteve kompetente që kryejnë licencimin profesional dhe miratimin e ndërhyrjeve konkrete;

dhe (iii) strukturave që ushtrojnë mbikëqyrjen teknike dhe shkencore të punimeve, si dhe vendosjen e masave administrative ose disiplinore. Ky konfigurim siguron kontroll të centralizuar dhe selektiv mbi ushtrimin e veprimtarive, duke reflektuar ndjeshmërinë e sektorit dhe nevojën për standarde të larta profesionale.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat dominuese përfshijnë formim akademik të specializuar, zakonisht në nivel master ose master profesional, të shoqëruar me përvojë praktike të dokumentuar dhe stazh profesional në fushën përkatëse, si dhe licencim ose autorizim paraprak nga autoritetet kompetente. Trajnimi është i orientuar drejt kompetencave shkencore, teknike dhe metodologjike që lidhen me ruajtjen e autenticitetit dhe integritetit të trashëgimisë kulturore. Sistemi nuk parashikon forma të strukturuar të trajnimit me kohë të pjesshme si mekanizëm formal për akses në profesion; institucionet e arsimit të lartë dhe strukturat kërkimore përbëjnë bazën kryesore të formimit profesional.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Njohja profesionale administrohet nga autoritetet kompetente për trashëgiminë kulturore dhe dallohet qartë nga njohja akademike. Njohja akademike realizohet sipas procedurave të përgjithshme për diplomat e huaja, ndërsa njohja profesionale për ushtrimin e veprimtarisë kushtëzohet nga vlerësimi i përputhshmërisë së kualifikimit dhe përvojës me kërkesat kombëtare dhe nga marrja e licencës ose autorizimit përkatës. Procedurat përfshijnë verifikimin e dokumentacionit, vlerësimin teknik dhe, sipas rastit, kërkesa shtesë për përshtatje ose provë kompetence. Testet gjuhësore nuk paraqiten si kërkesë e përgjithshme formale, por njohja e gjuhës shqipe konsiderohet e domosdoshme në praktikë. Aplikimi elektronik nuk është i plotë dhe procedurat mbështeten kryesisht në paraqitjen fizike të dokumentacionit; afatet janë të përcaktuara në mënyrë të përgjithshme dhe ankimi realizohet përmes mekanizmave të përgjithshëm administrativë dhe gjyqësorë.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor lejohet vetëm në mënyrë të kufizuar dhe nën kushte strikte. Në praktikë, çdo ndërhyrje në trashëgiminë kulturore kërkon autorizim paraprak dhe vlerësim teknik nga autoritetet kompetente, çka e bën të domosdoshëm kontrollin paraprak të kualifikimeve dhe kompetencës profesionale, pavarësisht natyrës së përkohshme të shërbimit. Ky regjim reflekton nevojën për mbrojtje të lartë të interesit publik dhe për parandalimin e dëmtimeve të pakthyeshme.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti vlerësohet përgjithësisht i balancuar, pasi kufizimet ekzistuese janë të orientuara drejt mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe sigurimit të kontrollit teknik dhe shkencor. Pikat e forta përfshijnë: fokusin në ruajtjen e autenticitetit dhe integritetit të trashëgimisë; centralizimin e autorizimeve për të shmangur ndërhyrje të pakontrolluara; dhe kërkesat e larta profesionale për formim dhe përvojë. Rreziqet potenciale lidhen me barrën procedurale, mungesën e dixhitalizimit të plotë të procedurave dhe natyrën selektive të regjimit të autorizimit. Këto gjetje operacionalizohen në masat e Planit Kombëtar të Veprimit, me synim rritjen e transparencës

procedurale, përmirësimin e aksesit administrativ dhe ruajtjen e nivelit të lartë të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

3.2.8.3. Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e sporteve

(Rregullator kryesor: Ministria e Turizmi, Kulturës dhe Sportit; federatat sportive përkatëse)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në fushën e sporteve, të cilat justifikohen nga objektiva të interesit publik që lidhen me sigurinë e sportistëve, integritetin e garave, zhvillimin e sportit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Rregullimi përfshin profile të ndryshme profesionale, si trajnerë, instruktorë, arbitra/gjyqtarë sportivë dhe role të tjera teknike, në varësi të disiplinës sportive. Modeli i rregullimit paraqitet kryesisht si mbrojtje e titullit profesional dhe kushtëzim i ushtrimit të veprimtarisë nga certifikimi përkatës, shpesh i lidhur me sistemin federativ.

Profili sektorial karakterizohet nga një kombinim i rregullimit shtetëror përmes ministrisë përgjegjëse për sportet dhe vetërregullimit funksional përmes federatave sportive, ku aksesimi i profesionit lidhet drejtpërdrejt me licencimin dhe njohjen nga strukturat sportive përkatëse.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen kryesisht me ushtrimin e funksioneve teknike dhe garuese që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e sportistëve dhe në korrektësinë e aktiviteteve sportive, si drejtimi i stërvitjes profesionale, gjyqimi i ndeshjeve dhe mbikëqyrja teknike.

Këto profesione nuk lidhen me ushtrimin e autoritetit publik në kuptim të nenit 51 të TFBE-së. Nuk evidentohet kërkesë shtetësie për akses në profesion; megjithatë, në praktikë aplikohen kriteret gjuhësore dhe njohuri të rregulloreve kombëtare sportive, të cilat funksionojnë si kushte hyrjeje. Për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36, këto kriteret duhet të paraqiten në mënyrë transparente dhe të mbeten proporcionale me objektivat e sigurisë dhe integritetit sportiv. Kur kërkesat gjuhësore ose procedurale nuk janë të standardizuara qartë, krijohet rrezik për pengesa administrative dhe pasiguri juridike për profesionistët e huaj.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale ndahet ndërmjet Ministria e Turizmi, Kulturës dhe Sportit, si autoritet politikëbërës dhe rregullator, dhe federatave sportive përkatëse, të cilat ushtrojnë funksione operacionale si certifikimi, licencimi, regjistrimi dhe disiplinimi profesional.

Federatat luajnë rol qendror në vlerësimin teknik të kualifikimeve dhe në mirëmbajtjen e regjistrave të profesionistëve sportivë, ndërsa Ministria ushtron funksione koordinuese dhe mbikëqyrëse në nivel sistemi.

Kjo arkitekturë e përbashkët kërkon qartësi të roleve dhe përgjegjësi, pasi mbivendosja potenciale ndërmjet autoritetit publik dhe strukturave federative mund të ndikojë në transparencën dhe parashikueshmërinë procedurale.

Kur autoriteti kompetent nuk identifikohet qartë për secilën fazë të procedurës, kjo përkthehet në kosto pajtueshmërie dhe pasiguri për aplikuesit.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat dominuese përfshijnë përfundimin e arsimit përkatës ose trajnimeve të specializuara sportive, pjesëmarrjen në programe certifikimi, kalimin e testeve praktike dhe teorike, si dhe licencimin ose regjistrimin pranë federatës përkatëse. Në disa raste kërkohet edhe zhvillim profesional i vazhdueshëm dhe përmbushje e standardeve të etikës sportive.

Këto kërkesa aplikohen në mënyrë kumulative dhe formojnë një paketë kriteresh *ex ante* për hyrje në profesion. Kur trajnimi, certifikimi dhe licencimi kombinohen pa mekanizma fleksibël njohjeje për përvojën e fituar jashtë vendit, rritet rreziku i kufizimeve më të rënda seç është e nevojshme për arritjen e objektivave të sigurisë sportive.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Njohja profesionale administrohet kryesisht përmes federatave sportive, në bashkëpunim me strukturat e Ministrisë. Nuk evidentohet një dallim i strukturuar ndërmjet njohjes akademike dhe asaj profesionale, as një skemë e unifikuar që të përmbledhë qartë autoritetin kompetent, hapat proceduralë, afatet dhe mekanizmat e ankimit.

Aplikimi elektronik nuk rezulton i institucionalizuar në mënyrë të njëtrajtshme. Për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36, kjo situatë kërkon standardizim të procedurave të njohjes dhe rritje të transparencës, në mënyrë që profesionistët sportivë të kualifikuar jashtë vendit të kenë akses të parashikueshëm dhe proporcional në tregun shqiptar. Kur mungojnë afatet e shprehura dhe mjetet e qarta të ankimit, krijohet efekt negativ në vendosje dhe mobilitet profesional.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor i shërbimeve sportive nuk trajtohet si regjim i veçantë. Ushtrimi i veprimtarisë lidhet zakonisht me licencimin dhe regjistrimin e plotë pranë federatës përkatëse, pa procedura të posaçme deklarimi paraprak ose mekanizma të dedikuar për angazhime afatshkurtra.

Në praktikë, zbatohet një standard i vetëm rregullash për vendosje dhe ushtrim. Në mungesë të instrumenteve fleksibël për shërbime të përkohshme, kufizohet shkëmbimi ndërkombëtar i ekspertizës sportive dhe pjesëmarrja e profesionistëve të huaj në aktivitete specifike.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti në sektorin e sporteve vlerësohet miks. Rregullimi mbështetet në objektiva legjitime të sigurisë, shëndetit dhe integritetit të garave, por evidentohen edhe fusha ku kërkohet përmirësim i transparencës procedurale dhe harmonizim me praktikën e BE-së.

Pikat e forta lidhen me rolin teknik të federatave dhe fokusin në standarde sportive. Rastet që paraqesin rrezik mospërputhshmërie për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36 lidhen me mungesën e procedurave të unifikuara për njohjen profesionale, mungesën e afateve dhe ankimeve të shprehura qartë, si dhe me barrën procedurale të krijuar nga kërkesat kumulative. Këto gjetje operacionalizohen në masat e Planit Kombëtar të Veprimit, me fokus në standardizimin e procedurave, qartësimin e kompetencave ndërmjet Ministrisë dhe federatave, zhvillimin e kanaleve elektronike dhe vlerësimin e alternativave më pak kufizuese për mobilitetin profesional, duke ruajtur njëkohësisht sigurinë dhe integritetin sportiv.

3.2.9. Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e ekonomisë

3.2.9.1. Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e zejtarisë

[Rregullator kryesor: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; autoritet/strukturë qendrore: Dhoma Kombëtare e Zejtarisë; rol mbështetës Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)]

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon grupin e profesioneve zejtare në Republikën e Shqipërisë, të cilat përfaqësojnë një segment tradicional, por njëkohësisht strategjik të ekonomisë, duke ndërthurur trashëgiminë kulturore me zhvillimin ekonomik lokal dhe punësimin. Këto veprimtari kanë karakter kryesisht manual, individual ose familjar, ku aftësia profesionale, mjeshtëria dhe përvoja praktike përbëjnë elementin thelbësor të prodhimit apo shërbimit.

Baza normative kryesore është ligji nr. 70/2016 “Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë”, i cili synon formalizimin e aktivitetit zejtar, ruajtjen e zejeve tradicionale, rritjen e konkurrueshmërisë dhe krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm. Ligji përcakton konceptin e veprimtarisë zejtare, kriteret për ushtrimin e saj, kategoritë e zejtarëve (mjeshtër, ndihmës, praktikant), si dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky status. Zejtarët njihen si subjekte ekonomike, por me një regjim të veçantë që merr parasysh natyrën e vogël, shpesh familjare dhe artizanale të aktivitetit.

Lista e profesioneve zejtare është e miratuar me vendimin nr. 578, datë 22.07.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e listës së profesioneve zejtare”. Zejtaria mund të ushtrohet në formën e personit fizik apo të shoqërisë tregtare.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e profesioneve zejtare shtrihen në fusha të larmishme, si përpunimi i drurit, metaleve, gurit, tekstileve, lëkurës, qeramikës, si dhe shërbime të ndryshme artizanale dhe riparuese. Këto aktivitete karakterizohen nga prodhim në shkallë të vogël dhe lidhje e fortë me tregun lokal, duke u ndërthurur shpesh me turizmin kulturor dhe artizanal dhe duke kontribuar në ruajtjen e identitetit kulturor e traditave vendase.

Kuadri i paraqitur e koncepton rregullimin si regjim formalizimi dhe standardesh minimale, dhe jo si rezervim i ngushtë i veprimtarive në kuptimin klasik të profesioneve me “veprimtari të rezervuar”

në tregje të mbyllura. Qasja është e orientuar drejt garantimit të cilësisë dhe sigurisë, në varësi të zejes dhe riskut të saj, duke ruajtur hapësirën për liri ekonomike dhe kreativitet.

Sa i përket shtetësisë dhe vendbanimit, parashikohet se edhe shtetasit e huaj duhet t'i nënshtrohen regjistrimit pranë Dhomës Kombëtare të Zejtarisë dhe të kalojnë provimin e kualifikimit ose të bëjnë njohjen e nivelit të kualifikimit që disponojnë në vendet e tyre. Ky konfigurim e vendos fokusin te verifikimi i aftësisë dhe kualifikimit profesional, dhe jo te kufizimi i aksesit mbi bazë shtetësie.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Sistemi i zejtarisë organizohet dhe mbikëqyret nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, si institucioni përfaqësues në nivel kombëtar. Dhoma ka rol në regjistrimin e zejtarëve, përfaqësimin e interesave të tyre pranë institucioneve shtetërore, promovimin e zejeve dhe bashkëpunimin për formimin profesional. Në praktikë, ajo vepron edhe si mekanizëm ndërmjetësues mes zejtarëve dhe administratës publike, duke kontribuar në zbatimin e ligjit dhe në garantimin e standardeve profesionale.

Në nivel qendror, politikat publike në fushën e zejtarisë hartohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në funksion të zhvillimit të politikave ekonomike, nxitjes së sipërmarrjes së vogël dhe të mesme dhe integritetit të zejeve në strategjitë e zhvillimit ekonomik dhe inovacionit.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kuadri rregullator parashikon një regjim relativisht të thjeshtuar krahasuar me profesione të tjera të rregulluara. Regjistrimi pranë Dhomës Kombëtare të Zejtarisë dhe respektimi i kriterëve bazë profesionale janë elementë thelbësorë për ushtrimin e ligjshëm të aktivitetit. Kërkesat lidhen kryesisht me aftësinë profesionale, përvojën praktike dhe respektimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë, me qëllim formalizimin dhe shmangien e barrierave të panevojshme administrative, veçanërisht për individët dhe familjet që tradicionalisht merren me këto aktivitete.

Sistemi i kualifikimit ndërtohet sipas një logjike karriere dhe formimi praktik: subjekti trajnohet fillimisht përmes pozicionit të ndihmësit, i cili kualifikohet në një mjedis të dyfishtë, në mjedis pune dhe në institucione arsimore. Si ndihmës mund të pranohen personat që kanë mbushur moshën minimale për punë dhe që ndjekin arsimin e mesëm profesional dhe dëshirojnë të kryejnë kualifikimin. Ndihmësit mund të kualifikohen vetëm nga mjeshtrit ose personat me kualifikim ekuivalent apo eksperiencë të nevojshme dhe vetëm në zejet që ushtrohen në subjektet ku ndjekin kualifikimin.

Kohëzgjatja e kualifikimit praktik pranë një mjeshtri në një subjekt zejtar të licencuar, deri në fitimin e titullit të ndihmësmjeshtrit, është 2 deri në 3 vite kalendarike, në varësi të llojit të zejes. Kualifikimi teorik në institucion arsimor, me kohë të pjesshme, deri në fitimin e titullit të ndihmësmjeshtrit, është 2 deri në 3 vite mësimore, në varësi të zejes. Programi teorik zhvillohet me kohë të pjesshme, me kohëzgjatje 10 orë mësimore në javë për 35 javë mësimore në vit. Paralelisht, gjatë javëve të programit teorik, ndihmësi kualifikohet edhe me aftësitë praktike pranë

mjeshtërit, në subjekt zejtar të licencuar, për 6 orë në ditë, në 5 ditë të javës. Në përfundim, kualifikimi mbyllet me provimin për titullin e ndihmësmjeshtërit dhe certifikimin përkatës.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Në kuptimin e Direktivës 2005/36/KE, profesionet zejtare nuk përfshihen në profesionet sektoriale dhe as në profesionet e rregulluara në kuptimin e ngushtë të termit. Megjithatë, për disa aktivitete ekonomike dhe zejtare, Direktiva parashikon një regjim të veçantë të njohjes automatike të bazuar në përvojën profesionale, të referuar në Aneksin IV dhe të lidhur me nenet 17, 18 dhe 19. Ky regjim nuk mbështetet në harmonizimin e diplomave ose kualifikimeve formale, por në njohjen e përvojës profesionale të fituar në mënyrë të ligjshme në një shtet tjetër.

Në këtë kontekst, raporti i profesioneve zejtare shqiptare me Direktivën 2005/36/KE është funksional dhe jo formal, pasi modeli shqiptar i zejtarisë bazohet në formimin profesional, praktikën e drejtpërdrejtë, mjeshtërinë dhe përvojën e akumuluar.

Për shtetasit e huaj, parashikohet regjistrimi në Dhomën Kombëtare të Zejtarisë dhe kalimi i provimit të kualifikimit ose njohja e nivelit të kualifikimit që disponohet jashtë vendit. Në aspektin e njohjes ndërkufitare, përfshirja e aktiviteteve në Aneksin IV krijon bazë juridike për njohjen e përvojës profesionale, me kushtet e parashikuara nga nenet 17, 18 dhe 19, që lidhen me kohëzgjatjen minimale të ushtrimit, natyrën e aktivitetit dhe ushtrimin e ligjshëm. Njohja është e kushtëzuar dhe e bazuar në verifikimin e përvojës profesionale, duke u dalluar nga njohja automatike e profesioneve sektoriale.

Në Shqipëri, procedurat për njohjen e kualifikimeve të zejtarëve të huaj ose të përvojës së fituar jashtë vendit realizohen përmes mekanizmave administrativë kombëtarë, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional. Regjistrimi në Dhomën Kombëtare të Zejtarisë shërben si instrument formalizimi dhe integrimi në tregun vendas, ndërsa vlerësimi i përvojës profesionale mbetet elementi kyç për aksesin.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Në grupin e profesioneve zejtare, lëvizshmëria profesionale dhe hyrja në treg lidhen kryesisht me regjistrimin dhe verifikimin e kualifikimit ose përvojës, pa u prezantuar si regjim i mbyllur dhe i ngurtë.

Për shtetasit e huaj, parashikohet një qasje e bazuar në regjistrim dhe provim kualifikimi ose njohje të kualifikimit të disponuar, që në praktikë synon të sigurojë standard minimal profesional dhe të integrojë aktivitetin në mekanizmat e formalizimit.

Kur një regjim bazohet te përvoja dhe verifikimi i saj, parashikueshmëria e procedurave dhe qartësia e kriterëve bëhen vendimtare për funksionimin real të mobilitetit, veçanërisht për aktivitetet që lidhen me tregun lokal dhe turizmin kulturor.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Parimi i proporcionalitetit reflektohet qartësisht në mënyrën se si është konceptuar kuadri rregullator i zejtarisë. Ndërhyrja dhe niveli i kontrollit institucional janë të përshtatura me rrezikun relativisht të ulët që paraqesin shumica e veprimtarive zejtare për interesin publik. Arsyet e interesit të përgjithshëm që justifikojnë masat, në varësi të veprimtarisë konkrete, lidhen me sigurinë publike, mbrojtjen e konsumatorit dhe përfituesve të shërbimeve, si dhe shëndetin publik.

Rregullimi është konceptuar më tepër si instrument mbështetës dhe zhvillues sesa kufizues, duke balancuar nevojën për standarde minimale me lirinë ekonomike dhe kreativitetin e zejtarëve. Kjo qasje synon formalizimin, ruajtjen e cilësisë dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore pa krijuar ngarkesa të tepruara administrative. Për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36, ky profil rregullator paraqitet në thelb i orientuar drejt masave më pak kufizuese, me fokus të verifikimi i aftësive praktike dhe përvojës.

Këto gjetje operacionalizohen në masat e Planit Kombëtar të Veprimit, me orientim drejt forcimit të transparencës procedurale, qartësisht të standardeve të kualifikimit dhe rritjes së parashikueshmërisë së mekanizmave të njohjes së përvojës profesionale për shtetasit e huaj, në përputhje me logjikën e Aneksit IV.

3.2.9.2. Profesione dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e pronësisë industriale

(Rregullator kryesor: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; autoritet kompetent: Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon katër profesione të rregulluara në fushën e pronësisë industriale: përfaqësuesi i autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit; përfaqësuesi i autorizuar për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë; eksperti për patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit; dhe eksperti për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë. Këto profesione zënë një vend të veçantë në sistemin e profesioneve të rregulluara në Shqipëri, sepse lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen juridike të pronësisë industriale dhe funksionimin e tregut, inovacionit dhe konkurrencës. Ato kanë natyrë juridike-teknike dhe kërkojnë njohuri të specializuara në të drejtën e pronësisë industriale, procedurat administrative dhe standardet ndërkombëtare.

Baza ligjore është ligji nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht figurat e përfaqësuesit të autorizuar dhe të ekspertit, si subjekte profesionale të certifikuara, me rol në përfaqësimin dhe/ose vlerësimin profesional të objekteve të pronësisë industriale. P.sh., në patentat dhe modelet e përdorimit, kompleksiteti teknik dhe pasojat ekonomike të një aplikimi të hartuar dobët shpjegojnë kërkesën për ndërmjetësim profesional të kualifikuar.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen, nga njëra anë, me përfaqësimin profesional të aplikantëve dhe mbajtësve të të drejtave përpara Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe, nga ana

tjetër, me funksione vlerësuese/teknike që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe besueshmërinë e procesit të mbrojtjes së të drejtave. Përfaqësuesi i autorizuar për patentat dhe modelet e përdorimit mbulon përgatitjen, paraqitjen dhe ndjekjen e aplikimeve, këshillimin juridik e teknik, hartimin e kërkesave dhe komunikimin procedural gjatë ekzaminimit, si edhe mbrojtjen e të drejtave në faza administrative. Përfaqësuesi i autorizuar për disenjot, markat dhe treguesit gjeografikë mbulon regjistrimin, administrimin dhe mbrojtjen e shenjave dalluese dhe identitetit tregtar e gjeografik, me rëndësi për parandalimin e konkurrencës së pandershme dhe sigurinë e tregut.

Ekspertët dallohen nga përfaqësuesit e autorizuar sepse roli i tyre është kryesisht teknik dhe vlerësues. Eksperti për patentat dhe modelet e përdorimit kontribuon në analizën e kriterëve të patentueshmërisë (përfshirë risinë, hapin shpikës dhe zbatueshmërinë industriale) dhe në vlerësimin profesional të aplikimeve. Eksperti për disenjot, markat dhe treguesit gjeografikë mbulon analiza mbi elementet vizuale/dalluese, moskonfliktimin e markave dhe lidhjen e treguesve gjeografikë me origjinën e cilësitë specifike.

Sa i përket kushteve personale, një kërkesë qendrore e kuadrit të paraqitur është që kandidati të ketë qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë. Kjo kërkesë duhet të trajtohet me kujdes në vlerësimin për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE, sepse, nëse zbatohet si kufizim i fortë praktik, mund të krijojë barriera të panevojshme për profesionistë të huaj, pavarësisht se objektivat rregullatore lidhen më tepër me standardin profesional dhe integritetin e procedurës sesa me vendbanimin.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale ndahet ndërmjet: Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, si autoritet kompetent për administrimin e të drejtave të pronësisë industriale dhe për certifikimin e përfaqësuesve të autorizuar dhe ekspertëve; dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, si institucioni përgjegjës për hartimin e politikave publike në fushën e pronësisë industriale, në lidhje me zhvillimin ekonomik, inovacionin, mbështetjen e sipërmarrjes dhe harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

DPPI verifikon përmbushjen e kriterëve ligjore, zhvillon procedurat e certifikimit dhe mban regjistrat përkatës. E drejta për ushtrimin e veprimtarisë, si për përfaqësuesit e autorizuar ashtu edhe për ekspertët, fitohet me regjistrimin në regjistër dhe dhënien e certifikatës nga DPPI.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Qasja rregullatore mbështetet në certifikim të detyrueshëm nga DPPI, të lidhur me formimin arsimor, përvojën profesionale, trajnime/kualifikime në fushën e pronësisë industriale dhe testim kualifikues. Për përfaqësuesin e autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit kërkohet, ndër të tjera, që kandidati (me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë) të ketë përfunduar së paku studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave” në fushën e inxhinierisë ose të shkencave natyrore ose farmaceutike, si dhe të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale; alternativisht, parashikohet edhe rruga e formimit në një fushë

tjetër e shoqëruar me jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune në këtë fushë dhe kualifikime/trajnime përkatëse. Kërkohej kalimi i testimit për kualifikimin e përfaqësuesve të autorizuar për patentat dhe modelet e përdorimit. Parashikohet gjithashtu mundësia për personat ish-punonjës të DPPI-së, të diplomuar, me jo më pak se 3 vite eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale në DPPI.

Për përfaqësuesin e autorizuar për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë kërkohej që kandidati (me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë) të ketë kryer së paku studimet e ciklit të dytë “Master profesional”, të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale dhe të ketë kaluar testimin e kualifikimit për fushën përkatëse; alternativisht, parashikohet rruga për ish-punonjës të DPPI-së të diplomuar me jo më pak se 3 vite përvojë pune në çështjet e pronësisë industriale pranë DPPI-së. E drejta për ushtrimin e veprimtarisë fitohet me regjistrimin dhe certifikatën e dhënë nga DPPI.

Për ekspertin për patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit kërkohej që kandidati (me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë) të ketë përfunduar “Master i shkencave” në fushën ku kërkohej ekspertizë dhe, si rregull, të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune si përfaqësues i autorizuar për patentat dhe modelet e përdorimit, ose të jetë kualifikuar në trajnime/kursime në fushën e pronësisë industriale dhe të ketë kaluar testimin për kualifikimin e ekspertëve për këtë fushë. Parashikohet edhe rruga për ish-punonjës të DPPI-së të diplomuar në fushën ku kërkohej ekspertizë me jo më pak se 4 vite eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale, si edhe për ish-anëtarë të Bordit të Apelit pranë DPPI-së me jo më pak se 2 vjet punë në këtë bord.

Për ekspertin për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë kërkohej që kandidati (me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë) të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune si përfaqësues i autorizuar për markat, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë pranë DPPI-së, të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse të specializuara në fushën e pronësisë industriale, të ketë kaluar testimin për kualifikimin e ekspertëve në fushën përkatëse dhe të ketë përfunduar “Master i shkencave”. Parashikohet alternativisht rruga për ish-punonjës të DPPI-së me jo më pak se 4 vite eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale, si edhe për ish-anëtarë të Bordit të Apelit pranë DPPI-së me jo më pak se 2 vjet punë në këtë bord.

Për ekspertët, kandidati depoziton dokumentacionin pranë komisionit të vlerësimit të DPPI-së, sipas parashikimeve të vendimit nr. 501, datë 29.08.2018, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për ekspertët e objekteve të pronësisë industriale”, të ndryshuar, dhe e drejta fitohet me regjistrim në regjistër dhe certifikatë nga DPPI.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Këto profesione nuk klasifikohen si profesione të rregulluara në kuptim të Direktivës 2005/36/KE, ndaj nuk aplikohet mekanizmi i njohjes automatike ose i njohjes së përgjithshme sipas asaj direktive. Si rrjedhojë, për profesionistët e kualifikuar në shtete të tjera, e drejta për ushtrim në Shqipëri nuk buron nga një njohje automatike e kualifikimit të huaj, por nga një vlerësim individual i kualifikimeve, përvojës dhe kompetencave nga DPPI, në përputhje me kriteret e legjislacionit

shqiptar. Ky vlerësim synon të verifikojë përshtatshmërinë profesionale për tregun shqiptar dhe funksionimin korrekt në sistemin administrativ të pronësisë industriale.

Në këtë kontekst, për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE, pika kritike që kërkon qartësim është mënyra e zbatimit të kërkesës së qëndrimit të përhershëm: nëse ajo funksionon si filtër formal i domosdoshëm, apo nëse mund të zëvendësohet me mjete më pak kufizuese që ruajnë të njëjtin standard profesional (p.sh., kërkesa për testim, evidencë përvojash, përgjegjësi profesionale dhe mekanizma disiplinorë).

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Baza ligjore e analizuar e koncepton ushtrimin e veprimtarisë nëpërmjet regjistrimit dhe certifikimit, pa përkrahur një regjim të veçantë deklarativ për shërbime të përkohshme ose rastësore. Në praktikë, ky konfigurim nënkupton se hyrja në treg dhe ushtrimi i aktivitetit janë të lidhura me certifikimin nga DPPI dhe regjistrimin në regjistrat përkatës. Në profesione ku përfaqësimi dhe ekspertiza ndikojnë drejtpërdrejt në krijimin e të drejtave ekskluzive dhe në sigurinë juridike të tregut, kjo qasje mund të justifikohet nga nevoja për standard profesional dhe integritet të procedurës; megjithatë, për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE, është e rëndësishme që kufizimet të jenë transparente, të justifikuara dhe të mos shkojnë përtej asaj që kërkohej për mbrojtjen e interesit publik.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Parimi i proporcionalitetit shfaqet në faktin se certifikimi dhe kontrolli institucional lidhen drejtpërdrejt me kompleksitetin teknik-juridik të fushës dhe me ndikimin ekonomik të vendimeve që merren në proceset e pronësisë industriale. Arsyet kryesore mbizotëruese të interesit publik janë rendi publik, mbrojtja e administrimit të drejtë të drejtësisë, mbrojtja e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve. Qëllimi i masave është të garantohet cilësia dhe integriteti i përfaqësimit dhe i vlerësimit profesional pranë DPPI-së, duke reduktuar riskun e gabimeve me pasojë të rënda ekonomike dhe juridike.

Në kuadrin e nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE, drejtimi i reformës lidhet me rritjen e transparencës së plotë të kriterëve, trajtimin e kujdesshëm të kërkesës së qëndrimit të përhershëm si masë potencialisht kufizuese dhe standardizimin e mënyrës së vlerësimit individual të kualifikimeve të huaja, në mënyrë që të sigurohet një ekuilibër i qartë mes cilësisë profesionale dhe aksesit jo të panevojshëm kufizues. Këto gjetje operacionalizohen në masat e Planit Kombëtar të Veprimit.

3.2.10. Profesione të rregulluara në sektorin financiar

3.2.10.1. Profesioni i agjentit (përfaqësuesit) doganor

(Rregullator kryesor: Ministria e Financave; autoritet kompetent: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon profesionin e agjentit doganor, i cili përbën një profesion kyç të rregulluar në ndërfaqen midis tregtisë ndërkombëtare, administratës publike dhe interesit fiskal të shtetit. Agjenti doganor vepron si ndërmjetës profesional ndërmjet subjekteve ekonomike dhe administratës doganore, duke garantuar zbatimin korrekt të legjislacionit doganor dhe lehtësimin e qarkullimit të mallrave.

Për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë mbi të ardhurat buxhetore, sigurinë ekonomike dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të shtetit, ky profesion i nënshtrohet një kuadri rregullator të posaçëm dhe relativisht të rreptë. Tipologjia e rregullimit paraqitet si model i kombinuar, pasi ushtrimi i veprimtarisë dhe përdorimi i statusit profesional kushtëzohen nga licencimi administrativ.

Veprimtaria profesionale përfshin përgatitjen dhe paraqitjen e deklaratave doganore, klasifikimin tarifor të mallrave, përcaktimin e vlerës doganore, aplikimin e regjimeve doganore përkatëse dhe përfaqësimin e subjekteve ekonomike pranë autoriteteve doganore, si edhe funksion këshillues teknik për zbatimin korrekt të legjislacionit.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen kryesisht me përfaqësimin profesional pranë administratës doganore dhe kryerjen e procedurave doganore në emër dhe për llogari të subjekteve ekonomike, me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë kufitare dhe interesat fiskale të shtetit.

Legjislacioni parashikon kërkesë për shtetësi shqiptare për ushtrimin e profesionit të agjentit doganor, së bashku me kritere të tjera hyrjeje. Kjo kërkesë përbën kufizim të drejtpërdrejtë mbi bazë shtetësie dhe lidhet me objektiva të rendit publik, sigurisë publike dhe parandalimit të mashtrimit, duke qenë se agjentët doganorë operojnë në një fushë me risk të lartë për evazion fiskal dhe kontrabandë.

Për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36, kjo masë kërkon justifikim të qartë dhe vlerësim të vazhdueshëm proporcionaliteti, në funksion të parimit të mosdiskriminimit dhe alternativave potencialisht më pak kufizuese.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Autoriteti kompetent për licencimin, regjistrimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin disiplinor të agjentëve doganorë është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ky institucion verifikon përmbushjen e kritereve ligjore nga kandidatët, lëshon licencat për ushtrimin e profesionit dhe ushtron kontroll mbi veprimtarinë profesionale.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mban gjithashtu një regjistër të veçantë për agjentët doganorë të licencuar, personelin ndihmës dhe përfaqësuesit e drejtpërdrejtë.

Në nivel politikëbërës, Ministria e Financave përcakton drejtimet strategjike të administrimit doganor, harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian dhe zbatimin e marrëveshjeve

ndërkombëtare. Kjo arkitekturë institucionale është e centralizuar, me kompetenca të plota administrative dhe disiplinore të përqendruara te autoriteti doganor.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Ushtrimi i profesionit i nënshtrohet një regjimi licencimi të detyrueshëm. Kandidati duhet të plotësojë një paketë kumulative kriteresh ex ante, që përfshin:

- shtetësi shqiptare;
- diplomë universitare;
- vlerësim besueshmërie nga administrata doganore;
- kalimin e provimit të organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- licencimin nga ky autoritet;
- eksperiencë pune jo më pak se një vit si punonjës pranë një agjencie doganore;
- ndalim të punësimit paralel në administratën publike apo shtetërore.

Trajnimi profesional ka rol qendror dhe organizohet ose njihet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke mbuluar procedurat e import-eksportit, klasifikimin tarifor, vlerësimin doganor, origjinën e mallrave dhe aspektet e kontrollit dhe përgjegjësisë doganore.

Ky kombinim i arsimit, përvojës, provimit, licencimit dhe trajnimit përbën një regjim të përforcuar hyrjeje në profesion, i projektuar për të garantuar integritet profesional dhe përgjegjësi në një sektor me ndjeshmëri të lartë fiskale dhe ekonomike.

Kur masa të tilla aplikohen në mënyrë kumulative, ato duhet të trajtohen si një paketë e vetme rregullatore për qëllime të proporcionalitetit, dhe jo si kriteret të izoluara.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Profesioni i agentit doganor nuk klasifikohet si profesion i rregulluar në kuptim të Direktivës 2005/36/KE. Si rrjedhojë, nuk zbatohet një regjim i harmonizuar evropian për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Në Shqipëri, ushtrimi i profesionit nga persona të kualifikuar jashtë vendit i nënshtrohet një vlerësimi individual nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, bazuar në përputhshmërinë e kualifikimeve, përvojës dhe njohurive me kërkesat e legjislacionit shqiptar, si dhe në aftësinë për të operuar brenda sistemit kombëtar doganor. Nuk ekziston njohje automatike e titujve të huaj. Kjo qasje e bazuar në vlerësim rast-pas-rasti forcon kontrollin administrativ, por kërkon transparencë të plotë të kriterëve, hapave proceduralë, afateve dhe mjeteve të ankimit, në mënyrë që procedura të jetë e parashikueshme për aplikuesit.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Ofrimi i përkohshëm ose rastësor i shërbimeve nuk trajtohet si regjim i veçantë. Ushtrimi i veprimtarisë doganore lidhet me licencimin e plotë dhe regjistrimin pranë Drejtorisë së

Përgjithshme të Doganave, pa mekanizma të posaçëm deklarimi paraprak apo regjistrimi të përkohshëm.

Në praktikë zbatohet një standard i vetëm rregullash për vendosje dhe ushtrim. Për profesionistët e huaj, kombinimi i kërkesës së shtetësisë dhe regjimit të licencimit administrativ e përjashton ofrimin e përkohshëm në kuptimin klasik të lirisë për të ofruar shërbime.

Kur nuk ekzistojnë procedura të diferencuara për angazhime afatshkurtra, kjo prodhon efekt kufizues mbi mobilitetin profesional dhe bashkëpunimin ndërkufitar.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti në sektorin e agentëve doganorë vlerësohet i lidhur ngushtë me objektiva të forta interesi publik, përfshirë rendin publik, sigurinë publike dhe parandalimin e mashtrimit. Regjimi i licencimit, mbikëqyrjes dhe disiplinës profesionale është i justifikuar nga risku i lartë fiskal dhe ekonomik i veprimtarisë.

Njëkohësisht, kërkesa e shtetësisë, mungesa e një regjimi të veçantë për shërbime të përkohshme dhe qasja e bazuar në vlerësim individual për kualifikimet e huaja paraqesin elemente që kërkojnë rishikim të vazhdueshëm në funksion të nenit 59 të Direktivës 2005/36, veçanërisht për të vlerësuar nëse ekzistojnë masa alternative më pak kufizuese që mund të arrijnë të njëjtat objektiva sigurie.

Këto gjetje operacionalizohen në masat e Planit Kombëtar të Veprimit, me fokus në rritjen e transparencës procedurale, qartësimin e kriterëve të vlerësimit, formalizimin e afateve dhe ankimeve, si dhe shqyrtimin e mundësive për mekanizma më fleksibël, pa cenuar mbrojtjen e interesave fiskale dhe sigurinë doganore.

3.2.10.2. Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e auditimit ligjor dhe kontabilistit të miratuar

(Rregullator kryesor: Bordi i Mbikëqyrjes Publike; organizatat profesionale përkatëse)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon dy profesione të rregulluara në fushën e raportimit financiar: audituesin ligjor dhe kontabilistin e miratuar. Rregullimi i tyre justifikohet kryesisht nga objektiva të interesit publik që lidhen me integritetin e informacionit financiar, transparencën e tregut, besimin e investitorëve dhe mbrojtjen e palëve të treta, veçanërisht kreditorëve.

Modeli i rregullimit është i kombinuar, pasi përfshin njëkohësisht mbrojtjen e titullit profesional dhe rezervimin e veprimtarisë. Përdorimi i titullit “auditues ligjor” dhe kryerja e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, si edhe dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë kur kjo kërkohet nga legjislacioni, kushtëzohen nga regjistrimi dhe licencimi sipas kuadrit ligjor përkatës. Në mënyrë të ngjashme, ushtrimi i profesionit të kontabilistit të miratuar është i lidhur me regjistrimin profesional dhe përmbushjen e kërkesave ligjore.

Në terminologjinë angleze, “statutory audit” i referohet veprimtarisë, ndërsa për profesionistin është teknikisht më e saktë të përdoret “statutory auditor”, dallim që reflektohet edhe në strukturën rregullatore.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rezervuara lidhen kryesisht me kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare dhe me dhënien e sigurisë mbi raportimin financiar dhe të qëndrueshmërisë, kur kjo kërkohej nga legjislacioni. Këto funksione prodhojnë efekte të drejtpërdrejta në besueshmërinë e informacionit financiar dhe në sigurinë e transaksioneve, duke justifikuar një regjim të përforcuar kualifikimi dhe mbikëqyrjeje.

Nuk evidentohet kërkesë shtetësie për akses në profesion. Kuadri ligjor parashikon regjistrimin e audituesve të huaj, në përputhje me përafrimin me Direktivën 2006/43/KE, duke e lidhur aksesin jo me shtetësinë, por me përmbushjen e kriterëve profesionale dhe me verifikimin e njohurive mbi legjislacionin shqiptar.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale ndahet ndërmjet Bordit të Mbikëqyrjes Publike si autoritet i mbikëqyrjes publike dhe sigurimit të cilësisë, dhe organizatave profesionale — Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe Institutit të Kontabilistëve të Miratuar — të cilat kryejnë funksione vetërregulluese, përfshirë licencimin, regjistrimin, masat disiplinore dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm.

Në kuptim funksional, organizatat profesionale administrojnë regjistrimin profesional dhe mirëmbajnë regjistrin publik, ndërsa Bordi i Mbikëqyrjes Publike ushtron kontrollin e jashtëm dhe mbikëqyrjen publike të profesionit. Kjo ndarje kompetencash është në linjë me parimin evropian që profesioni të mos vetërregullohet pa mbikëqyrje publike efektive.

Megjithatë, procedurat për hyrje në profesion dhe për regjistrim nuk rezultojnë të publikuara në një format të unifikuar dhe të centralizuar nga një pikë e vetme zyrtare, çka ndikon në transparencën praktike dhe në parashikueshmërinë procedurale për aplikuesit.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat dominuese për hyrje dhe ushtrim përfshijnë arsim universitar përkatës në nivel të avancuar, praktikë profesionale të dokumentuar, përfundimin e programeve të trajnimit profesional, kalimin e provimeve kualifikuese të mbikëqyrura nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, si dhe regjistrimin në organizatën profesionale përkatëse.

Praktika profesionale ka kohëzgjatje të përcaktuar dhe shoqërohet me kërkesën që një pjesë dominuese e saj të kryhet në Shqipëri. Ekzistojnë gjithashtu kërkesa shtesë që lidhen me integritetin profesional, respektimin e kodit të etikës dhe standardeve ndërkombëtare të IFAC, si edhe rregulla mbi strukturën e pronësisë dhe të drejtave të votës në shoqëritë audituese, me qëllim ruajtjen e kontrollit profesional mbi veprimtarinë.

Këto masa aplikohen në mënyrë kumulative. Kur arsimimi, praktika, provimet, regjistrimi dhe kufizimet strukturore kombinohen pa shqyrtim alternativash më pak kufizuese, rritet rreziku i kufizimeve më të rënda seç është e nevojshme për arritjen e objektivave të interesit publik.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Njohja profesionale administrohet përmes procedurës së regjistrimit të audituesve të huaj, e cila përfshin verifikimin e përgatitjes dhe testim mbi legjislacionin shqiptar në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, me mundësi zhvillimi në shqip ose anglisht. Kjo përfaqëson përdorimin e masave kompensuese tipike për mbulimin e diferencave rregullatore.

Nuk evidentohet një dallim i strukturuar ndërmjet njohjes akademike dhe njohjes profesionale, as një skemë e unifikuar publike që të përmbledhë autoritetin kompetent, hapat proceduralë, afatet dhe mekanizmat e ankimit. Aplikimi elektronik nuk rezulton i institucionalizuar plotësisht. Për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36, kjo situatë kërkon standardizim të mëtejshëm të procedurave dhe rritje të transparencës, në mënyrë që aksesimi i profesionit të jetë jo vetëm ligjërish i mundur, por edhe praktikisht i parashikueshëm.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor nuk trajtohet si regjim i veçantë deklarativ. Qasja mbështetet kryesisht në regjistrim dhe në verifikimin e kualifikimeve, përfshirë testimin mbi legjislacionin shqiptar. Nuk rezultojnë procedura të posaçme deklarimi paraprak, afate të dedikuara apo mekanizma të qartë për ofrimin e shërbimeve të përkohshme.

Në një sektor me ndjeshmëri të lartë publike si auditimi ligjor, kjo qasje është e kuptueshme nga perspektiva e mbrojtjes së tregut, por kërkon qartësim nëse dhe në çfarë mase synohet lehtësimi i mobilitetit të kontrolluar, veçanërisht në kontekstin e rrjeteve ndërkombëtare të auditimit dhe standardeve të unifikuara profesionale.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti vlerësohet në përgjithësi i mbështetur në objektiva të qarta interesi publik, por me elemente që kërkojnë vlerësim të mëtejshëm. Veçanërisht, kërkesa që një pjesë dominuese e praktikës profesionale të kryhet në Shqipëri mund të prodhojë efekt tërthor kufizues për kandidatët me vendbanim jashtë vendit dhe për profesionistët e huaj, edhe kur disponojnë përgatitje të krahasueshme. Po kështu, rregullat mbi pronësinë dhe të drejtat e votës në shoqëritë audituese kërkojnë arsyetim të qartë se pse nuk mjaftojnë mekanizma më pak kufizuese, si kontrolli i cilësisë dhe sanksionet.

Këto gjetje përbëjnë bazën faktike për masat e Planit Kombëtar të Veprimit, me fokus në standardizimin e procedurave të njohjes profesionale, rritjen e transparencës (autoritet, hapa, afate, ankime, kanale elektronike), rishikimin e proporcionalitetit të kërkesave të praktikës dhe të kufizimeve strukturore, si dhe qartësimin e regjimit për mobilitetin profesional.

3.2.11. Profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e sigurimeve

(Rregullator kryesor: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare)

A) Shtrirja dhe natyra e rregullimit

Ky nën-seksion mbulon profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në sektorin e shërbimeve financiare të mbikëqyrura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të cilat operojnë në tregjet e kapitaleve, sigurimeve dhe fondeve të pensionit. Në këtë sektor përfshihen aktuarët e autorizuar, vlerësuesit e dëmeve në sigurime, agjentët e lidhur të shoqërive të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të shoqërive komisionere, agjentët në sigurime jete dhe jo-jete, si edhe brokerët në sigurime.

Rregullimi i këtyre profesioneve justifikohet nga objektiva të interesit publik që lidhen me stabilitetin financiar, mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit, integritetin e tregut dhe besueshmërinë e shërbimeve financiare. Modeli rregullator mbështetet kryesisht në licencim dhe regjistrim profesional, të kombinuara me kërkesa kualifikimi dhe integriteti, ndërsa në disa profesione parashikohet edhe testim formal. Inventari i profesioneve dhe bazat ligjore përkatëse pasqyrohen në Instrumentin 1.

Profili sektorial karakterizohet nga një ndërthurje e rregullimit të profesionistit individual me rregullimin e detajuar të vetë tregjeve financiare, çka e dallon këtë sektor nga profesionet juridike apo teknike dhe e zhvendos theksin nga rezervimi i veprimtarive drejt mbikëqyrjes prudenciale dhe të sjelljes në treg.

B) Veprimtaritë e rezervuara dhe kërkesat e shtetësisë/vendbanimit

Veprimtaritë e rregulluara lidhen kryesisht me ofrimin e shërbimeve financiare për konsumatorët dhe investitorët, këshillimin financiar, ndërmjetësimin në blerje dhe shitje të instrumenteve financiare, si edhe vlerësimin e risqeve dhe dëmeve në sigurime.

Nuk evidentohet kërkesë shtetësie apo vendbanimi për akses në këto profesione. Ato nuk bien në fushën e përjashtimeve të nenit 51 të TFBE-së dhe nuk lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e autoritetit publik. Për rrjedhojë, kuadri rregullator është i konceptuar të jetë i hapur për profesionistë të huaj, me kusht përmbushjen e kriterëve objektive të licencimit dhe integritetit. Në këtë kontekst, për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36, fokusi i analizës zhvendoset nga shtetësia drejt proporcionalitetit të kërkesave profesionale dhe transparencës së procedurave të aksesit.

C) Autoritetet kompetente dhe mbikëqyrja

Struktura institucionale është e centralizuar pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i cili ushtron funksione rregullatore, licencuese dhe mbikëqyrëse mbi profesionet dhe subjektet përkatëse. Ndryshe nga sektorë të tjerë, nuk operojnë dhoma profesionale me kompetenca të plota vetërregulluese; kontrolli realizohet kryesisht përmes mekanizmave administrative të AMF-së dhe përmes rregullimit të detajuar të tregjeve.

Kjo arkitekturë siguron një mbikëqyrje të integruar të profesionistëve dhe të subjekteve financiare, por njëkohësisht e bën transparencën procedurale veçanërisht të rëndësishme, pasi aplikuesit

varen pothuajse ekskluzivisht nga informacioni dhe praktikat administrative të një autoriteti të vetëm.

Kur procedurat nuk paraqiten në mënyrë të unifikuar me hapa, afate dhe ankime të qarta, krijohet pasiguri juridike dhe rritet kostoja e pajtueshmërisë me kriteret rregullatore.

D) Kërkesat rregullatore tipike

Kërkesat dominuese për hyrje dhe ushtrim përfshijnë arsim përkatës në fusha si financë, ekonomi ose drejtësi, përvojë profesionale, kriterë të integritetit moral dhe profesional, si dhe, për profesione të caktuara (si aktuarët e autorizuar dhe brokerët në sigurime), kalimin e testeve të kualifikimit të administruara nga AMF.

Një pjesë e profesioneve i nënshtrohen detyrimit për sigurim të përgjegjësisë profesionale dhe trajnimeve të vazhdueshme. Në praktikë, këto kërkesa kombinohen me licencim dhe regjistrim të detyrueshëm.

Profili sektorial tregon një paketë kumulative kriteresh ex ante, por me një veçori të rëndësishme: kontrolli i riskut profesional realizohet në masë të madhe përmes rregullimit të detajuar të tregut financiar dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme, çka redukton nevojën për barriera të tepërta në fazën e hyrjes në profesion.

Kur masat profesionale mbivendosen me kërkesat prudenciale të tregut, ekziston rreziku i kufizimeve më të rënda seç është e nevojshme, pa përfitim proporcional për mbrojtjen e konsumatorit apo stabilitetin financiar.

E) Njohja e kualifikimeve të huaja për vendosje

Procedurat për njohjen e kualifikimeve të fituara jashtë vendit administrohen në kuadër të regjimit të përgjithshëm të licencimit nga AMF. Nuk evidentohet një dallim i strukturuar ndërmjet njohjes akademike dhe asaj profesionale, as një skemë e centralizuar publike që të përmbledhë autoritetin kompetent, hapat proceduralë, afatet dhe mekanizmat e ankimit.

Aplikimi elektronik nuk rezulton i institucionalizuar plotësisht dhe në mënyrë të njëtrajtshme për të gjitha profesionet. Për qëllime të nenit 59 të Direktivës 2005/36, kjo situatë kërkon rritje të transparencës dhe harmonizim më të plotë të procedurave të njohjes, në mënyrë që profesionistët e huaj të kenë akses të parashikueshëm dhe proporcional në tregun shqiptar të shërbimeve financiare.

F) Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor

Ofrimi i përkohshëm dhe rastësor i shërbimeve financiare nuk trajtohet si regjim i veçantë deklarativ. Qasja mbështetet kryesisht në licencim dhe regjistrim, të kombinuara me mbikëqyrjen e vazhdueshme të subjekteve nga AMF.

Në një sektor të karakterizuar nga dinamika e lartë dhe inovacioni teknologjik, mungesa e një kornize të qartë për mobilitetin profesional të kontrolluar mund të prodhojë efekt frenues për hyrjen

e ekspertizës së huaj, pa qenë domosdoshmërisht e nevojshme për arritjen e objektivave të stabilitetit financiar.

G) Proporcionaliteti dhe drejtimi i reformës

Proporcionaliteti në sektor vlerësohet në përgjithësi i mbështetur në objektiva legjitime të interesit publik, por me nevojë për rishikim të vazhdueshëm në funksion të zhvillimeve të tregut financiar. Profesione nuk lidhen me ushtrimin e autoritetit publik dhe kontrollohen në masë të madhe përmes rregullimit të detajuar të tregjeve, çka sugjeron se barriera shtesë në licencim apo testim duhet të përdoren me kujdes dhe vetëm kur janë realisht të domosdoshme.

Pikat që kërkojnë vëmendje për Planin Kombëtar të Veprimit përfshijnë: standardizimin dhe publikimin e plotë të procedurave të licencimit dhe njohjes profesionale, qartësimin e afateve dhe mekanizmave të ankimit, zhvillimin e kanaleve elektronike, si edhe vlerësimin periodik të kërkesave të kualifikimit në raport me alternativa më pak kufizuese, duke ruajtur njëkohësisht mbrojtjen e konsumatorit dhe integritetin e tregut financiar.

4. Zbatimi dhe Monitorimi

4.1. Institucionet Përgjegjëse për Zbatimin

4.1.1. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e drejtësisë

Zbatimi i masave për profesionet e rregulluara në sektorin e drejtësisë koordinohet nga Ministria e Drejtësisë, si institucioni politik përgjegjës për hartimin, ndryshimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, si dhe për mbikëqyrjen e përgjithshme të reformës në këtë sektor. Ministria siguron lidhjen ndërmjet masave të parashikuara në Planin e Veprimit dhe autoriteteve zbatuese, si dhe koordinimin ndër-institucional për realizimin e tyre.

Zbatimi operacional i masave realizohet nga autoritetet profesionale dhe institucionet kompetente për secilin profesion, përkatësisht: Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Noterëve, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, si dhe strukturat përgjegjëse për përkthyesit zyrtarë dhe ekspertët gjyqësorë. Këto organe janë përgjegjëse për përshtatjen e rregulloreve të brendshme, procedurave të aksesit në profesion, trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, si dhe mekanizmave disiplinorë, në përputhje me masat e identifikuara në Tabelën e Masave.

Për profesionet e lidhura me procedurat e falimentimit dhe administrimin e masës së falimentimit, Agjencia Kombëtare e Falimentimit ushtron kompetencat e saj si autoritet përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe disiplinimin e administratorëve të falimentimit, si dhe për zbatimin e masave që synojnë rritjen e transparencës, proporcionalitetit dhe cilësisë së shërbimeve në këtë fushë.

Për secilin nga profesionet e sektorit të drejtësisë, përgjegjësitë institucionale janë të lidhura drejtpërdrejt me masat konkrete të përcaktuara në Planin e Veprimit dhe Tabelën e Masave, duke përfshirë: rritjen e transparencës së kërkesave për akses në profesion, rishikimin e kufizimeve

ekzistuese, përmirësimin e proporcionalitetit të kushteve të ushtrimit dhe forcimin e informimit publik.

Ministria e Drejtësisë siguron konsolidimin e informacionit nga të gjitha autoritetet përkatëse, harmonizimin e veprimeve ndërmjet tyre dhe integrimin e rezultateve të sektorit të drejtësisë në raportimin kombëtar mbi profesionet e rregulluara.

4.1.2. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e Punëve të Brendshme

Zbatimi i masave për profesionet dhe funksionet e rregulluara nën përgjegjësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme realizohet përmes një strukture institucionale të centralizuar dhe hierarkike, duke reflektuar natyrën e këtyre veprimtarive si shërbime që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë publike dhe rendin publik.

Për funksionin e zjarrfikësit, zbatimi i kuadrit rregullator realizohet nëpërmjet strukturave publike të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit. Duke qenë se ky funksion ushtrohet ekskluzivisht në kuadër të marrëdhënies së punës në administratën publike dhe përbën shërbim publik të sigurisë, përgjegjësitë për zbatimin e rregullave nuk ndahen me aktorë privatë apo mekanizma vetërregullues.

Në nivel qendror, Ministria e Punëve të Brendshme ushtron funksionin drejtues dhe koordinues, duke përcaktuar politikat, standardet, programet e trajnimit dhe aktet nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, si dhe duke mbikëqyrur përputhshmërinë e zbatimit me legjislacionin kombëtar dhe objektivat e reformës. Në nivel vendor, Drejtoritë Vendore të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi janë përgjegjëse për zbatimin konkret të rregullave që lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, gradimin, vlerësimin e performancës dhe disiplinën e personelit zjarrfikës, duke garantuar zbatimin e njëtrajtshëm të kriterëve ligjore dhe standardeve profesionale.

Strukturat përgjegjëse për trajnimin profesional, përfshirë Akademinë e Sigurisë dhe qendrat e akredituara të trajnimit, mbështesin zbatimin e masave përmes përgatitjes fillestare dhe formimit të vazhdueshëm të personelit, sipas programeve të miratuara nga autoritetet kompetente.

Për punonjësit në shërbimin privat të sigurisë fizike, zbatimi i masave realizohet përmes një sistemi të specializuar mbikëqyrjeje, në të cilin Policia e Shtetit ushtron rol kyç ekzekutiv dhe kontrollues. Policia e Shtetit është autoriteti përgjegjës për certifikimin e punonjësve dhe drejtuesve teknikë, verifikimin e përmbushjes së kriterëve ligjore, si dhe kontrollin e vazhdueshëm të ushtrimit të veprimtarisë.

Ministria e Punëve të Brendshme ushtron funksionin drejtues dhe rregullator në nivel politikash dhe aktesh nënligjore, duke përcaktuar standardet e përgjithshme të trajnimit, kriteret e licencimit dhe kornizën institucionale të funksionimit të sektorit, si dhe duke siguruar zbatim të njëtrajtshëm të masave në të gjithë territorin e vendit.

Institucionet përgjegjëse për regjistrimin dhe licencimin e subjekteve tregtare që ofrojnë shërbime private të sigurisë fizike kontribuojnë në zbatimin e kuadrit rregullator, duke garantuar që veprimtaria ekonomike të ushtrohet vetëm nga subjekte të pajisura me licencën përkatëse.

Qendrat e trajnimit të licencuara nga Ministria e Punëve të Brendshme mbështesin zbatimin e masave përmes përgatitjes profesionale fillestare dhe të vazhdueshme të personelit.

Për secilin nga funksionet dhe profesionet e këtij sektori, përgjegjësitë institucionale janë të lidhura drejtpërdrejt me masat konkrete të përcaktuara në Planin e Veprimit dhe Tabelën e Masave, duke përfshirë forcimin e kriterëve të aksesit, rritjen e transparencës, garantimin e proporcionalitetit dhe përmirësimin e standardeve profesionale.

4.1.3. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e shëndetësisë dhe kujdesit social

Zbatimi i masave për profesionet e rregulluara në sektorin e shëndetësisë dhe të kujdesit shoqëror realizohet përmes një strukture institucionale të ndarë qartë ndërmjet ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, organeve profesionale dhe strukturave të edukimit të vazhdueshëm, si dhe institucioneve përgjegjëse për shërbimet sociale.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale ushtron funksionin drejtues në hartimin e politikave, përafrimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor me acquis të Bashkimit Evropian dhe koordinimin e përgjithshëm të zbatimit të planit të veprimit. Ajo mbikëqyr funksionimin e institucioneve vartëse dhe siguron që procedurat administrative për hyrjen dhe ushtrimin e profesioneve shëndetësore të jenë të njëtrajtshme dhe në përputhje me kërkesat e Direktivës 2005/36/KE.

Zbatimi praktik i rregullimit profesional realizohet kryesisht nga organet e vetëqeverisjes profesionale, përkatësisht Urdhri i Mjekëve, Urdhri i Stomatologut, Urdhri i Farmacistëve, Urdhri i Infermierit, Urdhri i Psikologut dhe Urdhri i Punonjësve Socialë, të cilët janë përgjegjës për regjistrimin e profesionistëve, licencimin, mbikëqyrjen etike dhe disiplinore, si dhe administrimin e regjistrave profesionalë. Këto struktura garantojnë që vetëm individët që plotësojnë kushtet ligjore të formimit dhe kualifikimit të ushtrojnë profesionin.

Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm ushtron kompetenca qendrore në certifikimin dhe ricertifikimin profesional, duke administruar sistemin e edukimit të vazhdueshëm për mjekët, stomatologët, farmacistët, infermierët dhe profesionistët e tjerë të shëndetësisë. Ky mekanizëm lidh ruajtjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit me përditësimin periodik të njohurive dhe aftësive profesionale.

Për profesionet dhe veprimtaritë në fushën e kujdesit shoqëror, përfshirë kujdestarinë për fëmijë dhe kujdestarinë për persona me aftësi të kufizuara, zbatimi realizohet përmes ministrisë përgjegjëse dhe strukturave të saj vartëse, si dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat janë përgjegjëse për licencimin e shërbimeve, inspektimin periodik dhe monitorimin e respektimit të standardeve minimale të ofrimit të shërbimit.

Institucionet e arsimit të lartë dhe strukturat e sigurimit të cilësisë kontribuojnë në zbatimin e planit të veprimit përmes garantimit që programet e formimit profesional të jenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale, duke siguruar koherencë midis formimit universitar dhe praktikës profesionale.

4.1.3. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e veterinarisë

Zbatimi i masave për profesionet e rregulluara në fushën e veterinarisë realizohet përmes një sistemi të integruar institucional, i ndërtuar mbi ndarjen funksionale të kompetencave ndërmjet organeve profesionale, institucioneve rregullatore dhe autoriteteve inspektuese, me qëllim garantimin e shëndetit të kafshëve, sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së shëndetit publik.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ushtron rolin qendror politikëbërës dhe normativ, duke hartuar dhe miratuar kuadrin ligjor dhe nënligjor që rregullon ushtrimin e profesioneve veterinarë, përdorimin e barnave veterinarë, shërbimet mbështetëse dhe veprimtaritë e lidhura me riprodhimin e kafshëve. Përmes strategjive sektoriale dhe akteve rregullatore, Ministria përcakton standardet kombëtare për shëndetin e kafshëve, mirëqenien e tyre dhe sigurinë ushqimore, si dhe bashkërendon veprimtarinë e institucioneve zbatuese.

Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar ka rol qendror në rregullimin e ushtrimit të profesionit, duke administruar regjistrimin dhe licencimin e mjekëve veterinarë, farmacistëve veterinarë, teknikëve veterinarë dhe teknikëve të ndërzimit, duke mbikëqyrur respektimin e etikës profesionale dhe duke ushtruar kompetenca disiplinore ndaj anëtarëve të tij. Ky institucion garanton gjithashtu ndjekjen e formimit të vazhdueshëm profesional dhe respektimin e kufijve të kompetencave të përcaktuara me ligj për profesionet mbështetëse.

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve është institucioni përgjegjës për kontrollin teknik dhe inspektimin në fushën e shëndetit të kafshëve, sëmundjeve zoonotike, përdorimit të barnave veterinarë dhe veprimtarive riprodhuese. Ky autoritet mbikëqyr aktivitetin në terren të profesionistëve veterinarë dhe teknikëve, zbatimin e protokolleve sanitare dhe epidemiologjike, si dhe ndërhyr në rast emergjencash veterinarë, duke garantuar përputhshmërinë me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit plotëson sistemin e mbikëqyrjes përmes kontrollit të sigurisë ushqimore përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor, veçanërisht për produktet me origjinë shtazore. Në këtë kuadër, ai monitoron respektimin e periudhave të tërheqjes së barnave, praninë e mbetjeve farmaceutike dhe ndikimin e praktikave veterinarë në shëndetin e konsumatorit.

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore ushtron kompetenca në kontrollin e barnave dhe preparateve veterinarë, në bashkëpunim me strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, duke kontribuar në parandalimin e përdorimit të parregullt të produkteve mjekësore veterinarë dhe në adresimin e rezistencës antimikrobike.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale merr pjesë në koordinimin ndërsektorial në kuadër të qasjes One Health, veçanërisht për zoonozat, përdorimin e antibiotikëve dhe survejancën epidemiologjike, duke integruar profesionistët veterinarë në sistemin kombëtar të monitorimit të rreziqeve për shëndetin publik.

Koordinimi ndërmjet këtyre institucioneve siguron një zbatim të unifikuar të kuadrit rregullator për të gjitha profesionet veterinarë dhe mbështetëse, duke garantuar standarde të larta profesionale dhe mbrojtjen e interesit publik.

4.1.5. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e mjedisit

Zbatimi i masave për profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara në fushën e mjedisit kërkon koordinim të qartë institucional dhe një ndarje funksionale të kompetencave ndërmjet autoriteteve rregullatore, licencuese, mbikëqyrëse dhe inspektuese. Duke qenë se këto veprimtari lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e rreziqeve mjedisore, mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe respektimin e standardeve të Bashkimit Evropian, zbatimi i kuadrit rregullator duhet të jetë i qëndrueshëm, i kontrolluar dhe i mbështetur në të dhëna të verifikueshme, duke garantuar transparencë procedurale, siguri juridike dhe proporcionalitet të kufizimeve.

Për veprimtarinë e Operatorit të Mjedisit, institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit rregullator është Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila ushtron kompetencat në fushën e dhënies së lejeve mjedisore, kontrollit të përmbushjes së kushteve të lejes dhe monitorimit të ndikimeve në mjedis. Agjencia vepron në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe me strukturat inspektuese përkatëse, duke siguruar zbatim të unifikuar në të gjithë territorin. Autoritetet vendore dhe strukturat inspektuese luajnë rol plotësues, veçanërisht kur veprimtaritë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në territorin administrativ, duke kontribuar në verifikimin në terren, shkëmbimin e informacionit dhe reagimin e koordinuar ndaj shkeljeve të mundshme, me synim shmangien e mbivendosjeve kompetenciale dhe forcimin e efektivitetit të kontrollit.

Për profesionin e Ekspertit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e kuadrit rregullator është ministria përgjegjëse për mjedisin, e cila ushtron kompetencat për certifikimin e ekspertëve të VNM-së dhe përcaktimin e kriterëve profesionale të ushtrimit të profesionit, duke qenë se raportet e VNM-së prodhojnë efekte juridike të drejtpërdrejta dhe ndikojnë në vendimmarrjen administrative për autorizimin e projekteve. Agjencia Kombëtare e Mjedisit luan rol thelbësor në administrimin e procedurave, regjistrimin, licencimin e subjekteve juridike dhe përdorimin e raporteve të VNM-së në procedurat e autorizimit mjedisor. Bashkëpunimi institucional ndërmjet ministrisë dhe Agjencisë është i domosdoshëm për koherencë në zbatim dhe për të shmangur boshllëqet ose mbivendosjet.

Për aktivitetin e Transportuesit të Mbetjeve, zbatimi kërkon kuadër institucional të qartë dhe mekanizma monitorimi efektivë, duke qenë se ky aktivitet është hallkë kyçe e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Ministria përgjegjëse për mjedisin ushtron kompetencat për hartimin e politikave, miratimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të aktivitetit, ndërsa Agjencia Kombëtare e Mjedisit administron regjistrimin dhe kontrollin e transportuesve të licencuar, si dhe monitoron respektimin e kushteve të licencës dhe dokumentacionin shoqërues. Qendra Kombëtare e Licencimit vepron si autoriteti që lëshon dhe administron licencat për transportin e mbetjeve, në përputhje me legjislacionin për licencat dhe lejet. Strukturat inspektuese përkatëse dhe autoritetet

vendore bashkëpunojnë për identifikimin e shkëlqeve, parandalimin e depozitimit të paligjshëm dhe garantimin që transporti i mbetjeve të rrezikshme të kryhet sipas rregullave të sigurisë.

Për aktivitetin e Tregtarit të Mbetjeve, zbatimi realizohet përmes një sistemi të integruar institucional që përfshin autoritete licencuese, institucione mbikëqyrëse dhe struktura inspektuese në nivel qendror dhe vendor, me synim garantimin që aktiviteti të ushtrohet vetëm nga subjekte të autorizuar dhe sipas kushteve ligjore e teknike të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Licencimi administrohet nga Qendra Kombëtare e Licencimit, mbi bazën e dokumentacionit ligjor, teknik e administrativ dhe miratimit nga ministria përgjegjëse për mjedisin. Pas licencimit, subjekti regjistrohet në regjistrat përkatës të mbajtur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila ushtron funksionet kryesore të monitorimit dhe kontrollit, përfshirë gjurmueshmërinë e mbetjeve dhe respektimin e procedurave për importin, eksportin dhe tranzitimin. Strukturat inspektuese të ministrisë dhe autoritetet vendore kryejnë inspekte periodike dhe të papritura; në rast shkeljesh aplikohen masa administrative, përfshirë gjoba dhe pezullim ose heqje licence. Në tregtimin ndërkufitar, koordinimi me autoritetet doganore dhe autoritetet homologe është thelbësor për parandalimin e transferimeve të paligjshme.

Për profesionin e Agjentit të Mbetjeve, zbatimi mbështetet në një kuadër të konsoliduar ku kompetencat janë të shpërndara ndërmjet ministrisë përgjegjëse për mjedisin, Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Ministria përcakton politikat rregullatore, miraton aktet nënligjore dhe siguron përputhshmërinë e sistemit kombëtar me zhvillimet e legjislationit të BE-së në fushën e mbetjeve. Qendra Kombëtare e Licencimit administron procedurat e licencimit dhe garanton që vetëm subjektet që plotësojnë kriteret ligjore e teknike të pajisen me autorizim. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mbikëqyr zbatimin teknik e funksional, verifikon respektimin e kushteve të licencës, kontrollon dokumentacionin për qarkullimin e mbetjeve dhe bashkëpunon me strukturat inspektuese për parandalimin e shkëlqeve.

Për profesionin e Shpuesit Profesional për Ujë, zbatimi dhe mbikëqyrja realizohen nga organet e administrimit të burimeve ujore, konkretisht Këshillat e Baseneve Ujore, të cilat kanë kompetencën për dhënien e lejeve për shpim dhe për kontrollin e zbatimit të kushteve teknike dhe mjedisore të këtyre lejeve. Në nivel qendror, institucionet përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore dhe mjedisit ushtrojnë rol koordinues dhe rregullator për zbatim të njëtrajtshëm dhe nxjerrje udhëzimesh. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Arkivi Qendror Gjeologjik kontribuojnë në administrimin e informacionit teknik e hidrogeologjik, duke garantuar ruajtjen, përditësimin dhe aksesueshmërinë e të dhënave për qëllime kontrolli dhe planifikimi afatgjatë.

Për profesionin e Punonjësit të Shërbimit Pyjor, institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen është ministria përgjegjëse për pyjet, e cila ushtron kompetenca rregullatore, koordinuese dhe mbikëqyrëse në nivel qendror dhe nëpërmjet strukturave të saj vartëse, si dhe përmes bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore. Zbatimi përfshin aplikimin e njëtrajtshëm të kriterëve të kualifikimit, certifikimit dhe ushtrimit të profesionit, verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore për formimin profesional dhe kontrollin në terren të aktiviteteve të rezervuara që lidhen me administrimin, monitorimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave. Strukturat vendore

dhe institucionet inspektuese përkatëse garantojnë praninë e kontrollit në terren dhe reagimin ndaj shkeljeve.

4.1.6. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e infrastrukturës dhe transporteve

Zbatimi i masave për profesionet dhe veprimtaritë e rreguluara në sektorin e infrastrukturës dhe transporteve realizohet përmes një strukture institucionale të koordinuar, ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë mban rolin drejtues në politikëbërje, harmonizim ligjor dhe mbikëqyrje, ndërsa autoritetet sektoriale zbatojnë dhe kontrollojnë në praktikë regjimet e licencimit, certifikimit dhe ushtrimit të profesionit.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është institucioni qendror përgjegjës për drejtimin e zbatimit të planit të veprimit dhe për garantimin e përputhshmërisë së kuadrit kombëtar me parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit. Ministria vepron përmes strukturave të saj përgjegjëse për licencimin/certifikimin dhe përmes mekanizmave të koordinimit me institucionet vartëse dhe me autoritetet e tjera publike që ndërhyjnë në ciklin e aksesit, ushtrimit dhe kontrollit të veprimtarive të rreguluara.

Në fushën e infrastrukturës së ndërtimit dhe zhvillimit urban, autoritetet kompetente të licencimit pranë ministrisë administrojnë procedurat për arkitektët, urbanistët dhe profesionet e inxhinierisë në të gjitha profilet përkatëse. Këto struktura janë përgjegjëse për pranimin dhe verifikimin e aplikimeve, lëshimin dhe rinovimin e licencave, si dhe për masat administrative në rast mosplotësimi të kushteve ligjore.

Ministria e Arsimit dhe Sportit kontribuon në zbatimin e planit të veprimit përmes akreditimit dhe mbikëqyrjes së programeve të arsimit të lartë në arkitekturë dhe inxhinieri, si dhe përmes njohjes akademike të diplomave të huaja, duke siguruar koherencë ndërmjet formimit universitar dhe kërkesave për ushtrimin e profesionit.

Për profesionin e vlerësuesit të pasurive të paluajtshme, zbatimi realizohet nga institucioni përgjegjës për zhvillimin urban dhe komisioni përkatës i licencimit, i cili administron licencimin dhe ekuivalentimin e kualifikimeve, mban regjistrin e subjekteve të licencuara dhe ushtron funksione disiplinore dhe kontrolli administrativ.

Transporti rrugor përbën një komponent të veçantë të zbatimit, pasi lidhet me sigurinë publike, standardet teknike dhe funksionimin e tregut të shërbimeve të transportit. Në këtë nënfushë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ushtron rolin rregullator dhe mbikëqyrës, ndërsa zbatimi praktik mbështetet në një bashkëpunim funksional me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe strukturat përkatëse administrative, të cilat administrojnë procedurat dhe regjistrat për dëshmitë e aftësisë profesionale, testimet/vlerësimet dhe verifikimin e kriterëve të ushtrimit të veprimtarisë. Kjo përfshin, ndër të tjera, sistemin e dëshmimeve të aftësisë profesionale për shoqërues teknik të mjeteve jashtë norme në transporte në kushte jonormale, mësues teorie dhe instruktorë praktike për autoshkolla, përgjegjës teknik për autoriparime, veprimtarinë e shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe/ose rimorkiove, përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe ushtrimin e veprimtarisë së taksistit. Strukturat përgjegjëse sigurojnë që kriteret e aksesit, format e trajnimit, procedurat e vlerësimit

dhe kushtet e ushtrimit të jenë të qarta, të njëtrajtshme dhe të zbatueshme në praktikë, duke shmangur barrat joproporcionale dhe fragmentimin administrativ.

Roli i strukturave të inspektimit dhe kontrollit në transportin rrugor është plotësues dhe thelbësor për zbatimin, pasi garanton respektimin e kushteve të ushtrimit të veprimtarisë në terren, verifikimin e dokumentacionit, si dhe ndërhyrjen administrative në rast shkeljesh. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore është i domosdoshëm aty ku veprimtaritë kanë dimension lokal (p.sh. taksitë), për të siguruar zbatim të koordinuar dhe pa mbivendosje kompetencash.

Në sektorin detar, Drejtoria e Përgjithshme Detare vepron si autoritet kompetent për certifikimin, verifikimin dhe mbikëqyrjen e profesioneve detare, duke administruar procedurat për lëshimin, rinovimin, pezullimin dhe revokimin e certifikatave të kompetencës dhe duke garantuar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare, veçanërisht Konventën STCW.

Në sektorin e aviacionit civil, Autoriteti i Aviacionit Civil është institucioni qendror përgjegjës për licencimin, certifikimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e profesioneve të rregulluara, në përputhje me rregulloret e Bashkimit Evropian dhe standardet e ICAO dhe EASA, duke garantuar që hyrja dhe ushtrimi i profesionit të kushtëzohen nga kërkesa të qarta për trajnim, kompetencë, përshtatshmëri mjekësore dhe verifikim periodik.

4.1.8. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e turizmit, kulturës dhe sportit

Zbatimi i kuadrit rregullator për profesionet dhe veprimtaritë e rregulluara nën përgjegjësinë e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit mbështetet në një ndarje të qartë të kompetencave institucionale, në përdorimin e regjistrave administrativë sektorialë dhe në mekanizma inspektimi e mbikëqyrjeje, me synim garantimin e transparencës, proporcionalitetit dhe interesit publik në ushtrimin e veprimtarive përkatëse.

Në fushën e turizmit, për profesionet e udhërrëfimit turistik, përfshirë udhërrëfyesin turistik, udhërrëfyesin turistik kombëtar, udhërrëfyesin turistik lokal, udhërrëfyesin turistik të specializuar dhe statusin e udhërrëfyesit turistik të nderit, institucioni përgjegjës për zbatimin e legjislacionit dhe administrimin e sistemit të certifikimit është ministria përgjegjëse për turizmin. Kjo ministri ushtron funksione normative, administrative dhe mbikëqyrëse, duke miratuar programet e kualifikimit profesional, përcaktuar kriteret e certifikimit, administruar Regjistrin Qendror të Turizmit dhe mbikëqyrur respektimin e detyrimeve ligjore nga profesionistët e certifikuar. Komisionet e posaçme pranë ministrisë kanë rol vendimtar në vlerësimin e kualifikimeve, shqyrtimin e aplikimeve për certifikim dhe garantimin e standardeve profesionale të kërkuara, si dhe në ndërmarrjen e masave administrative në rast shkeljesh, përfshirë pezullimin ose heqjen e certifikatës, në përputhje me procedurat përkatëse.

Për veprimtaritë e operatorit turistik dhe të agjentit turistik/udhëtimit, zbatimi realizohet përmes kompetencave të ministrisë përgjegjëse për turizmin për licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të veprimtarisë, duke përfshirë regjistrimin në Regjistrin Qendror të Turizmit dhe kontrollin e vazhdueshëm të përmbushjes së kriterëve ligjore dhe administrative. Në këtë proces përfshihen gjithashtu institucione mbështetëse, në veçanti Qendra Kombëtare e Biznesit, për

aspektet e regjistrimit tregtar dhe publikimit të licencave, si dhe struktura inspektuese për kontrollin në terren të ushtrimit të aktivitetit.

Për operatorin e turizmit detar, ministria përgjegjëse për turizmin është autoriteti kryesor për administrimin e procedurave të licencimit dhe certifikimit, verifikimin e përmbushjes së kriterëve ligjore dhe teknike dhe regjistrimin në Regjistrin Qendror të Turizmit, në bashkëpunim me institucionet publike përgjegjëse për sigurinë detare, mjedisin, transportin detar dhe kontrollin teknik të mjeteve lundruese.

Për transportuesit turistikë, institucioni kryesor përgjegjës për licencimin dhe kontrollin teknik është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, ndërsa ministria përgjegjëse për turizmin ushtron rol koordinues dhe mbështetës, veçanërisht në lidhje me regjistrimin në Regjistrin Qendror të Turizmit dhe harmonizimin e politikave sektoriale.

Për profesionin e vrojtuesit të plazhit, zbatimi realizohet përmes një arkitekture të ndarë kompetencash ndërmjet autoritetit qendror përgjegjës për politikën publike dhe institucioneve sektoriale në nivel qendror dhe vendor, duke qenë se ky profesion lidhet drejtpërdrejt me sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e personave. Institucionet vendore luajnë rol kyç në zbatimin praktik të rregullave dhe verifikimin e kushteve të ushtrimit të profesionit, ndërsa strukturat përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional kontribuojnë në garantimin e cilësisë së trajnimeve dhe transparencës së kriterëve të certifikimit.

Në fushën e kulturës krijuese, për profesionet e agentit letrar, art-grafistit dhe botuesit, zbatimi i kuadrit ligjor realizohet përmes mekanizmave të përgjithshëm administrativë dhe ligjorë, pa struktura të posaçme rregullatore për aksesin ose ushtrimin e profesionit. Ministria ushtron funksione të përgjithshme politike dhe koordinuese, ndërsa autoritetet për regjistrimin tregtar, administrimin fiskal dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit sigurojnë zbatimin e rregullave të përgjithshme të veprimtarisë ekonomike dhe respektimin e të drejtave krijuese.

Në fushën e trashëgimisë kulturore, për profesionet e konservimit, restaurimit dhe arkeologjisë, përfshirë të gjitha nënkategoritë përkatëse, zbatimi i kuadrit rregullator realizohet përmes strukturave të specializuara shtetërore përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, të cilat ushtrojnë funksione licencuese, autorizuese dhe mbikëqyrëse. Këto institucione janë përgjegjëse për dhënien dhe rinovimin e licencave profesionale, miratimin e projekteve të ndërhyrjes, kontrollin e përputhshmërisë së punimeve me standardet e miratuara dhe ndjekjen e zbatimit të kushteve të autorizimit, duke garantuar që vetëm profesionistë të kualifikuar të kenë akses në veprimtari që ndikojnë drejtpërdrejt në integritetin e trashëgimisë kulturore materiale.

Në fund, për profesionet sportive të rregulluara, përfshirë trajnerët dhe instruktorët sipas disiplinave, gjyqtarët sportivë dhe veprimtaritë e tjera ku certifikimi dhe standardet profesionale kushtëzojnë ushtrimin e aktivitetit, zbatimi i kuadrit rregullator realizohet përmes ministrisë përgjegjëse për sportin dhe strukturave të saj administrative, në bashkëpunim me federatat sportive përkatëse dhe, kur është e aplikueshme, me Komitetin Olimpik Kombëtar. Ministria siguron kornizën rregullatore dhe kriteret minimale, ndërsa federatat kontribuojnë në standardizimin e kualifikimeve, organizimin e proceseve të certifikimit dhe administrimin e

regjistrave të profesionistëve sportivë, me synim garantimin e sigurisë së pjesëmarrësve, integritetit të veprimtarive sportive dhe cilësisë së shërbimeve.

4.1.9. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e ekonomisë

Zbatimi i masave për profesionet e rregulluara në fushën e ekonomisë, përfshirë profesionet zejtare, përfaqësuesit e autorizuar të pronësisë industriale dhe ekspertët e pronësisë industriale, realizohet përmes një sistemi institucional të koordinuar, që kombinon funksionet politike, rregullatore, teknike dhe mbikëqyrëse të disa institucioneve qendrore.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ushtron rolin drejtues në hartimin dhe zbatimin e politikave publike që lidhen me këto profesione, duke miratuar kuadrin ligjor dhe nënligjor për ushtrimin e veprimtarive përkatëse dhe duke siguruar koherencën e tij me politikat kombëtare të zhvillimit ekonomik dhe inovacionit. Ministria përcakton kushtet e formalizimit të veprimtarisë, standardet e kualifikimit profesional dhe parimet e përgjegjësisë administrative, si dhe koordinon veprimtarinë e institucioneve zbatuese.

Në fushën e zejtarisë, Dhoma Kombëtare e Zejtarisë ushtron funksione rregullatore dhe përfaqësuese, duke administruar regjistrimin e zejtarëve, duke mbrojtur interesat e tyre profesionale dhe duke kontribuar në përcaktimin e standardeve minimale të ushtrimit të veprimtarisë, përfshirë aspektet e etikës profesionale, cilësisë së produkteve dhe ruajtjes së traditës zejtare.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve është institucioni teknik përgjegjës për zhvillimin dhe administrimin e standardeve të formimit profesional për profesionet zejtare. Ajo harton dhe akrediton programet e arsimit dhe trajnimit profesional, administron proceset e certifikimit të kompetencave dhe garanton që kualifikimet profesionale të reflektojnë kërkesat e tregut dhe zhvillimet teknologjike, në bashkëpunim me Ministrinë dhe Dhomën Kombëtare të Zejtarisë.

Në fushën e pronësisë industriale, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ushtron rolin qendror rregullator dhe teknik, duke administruar regjistrimin dhe licencimin e përfaqësuesve të autorizuar, duke përcaktuar kriteret e njohjes dhe angazhimit të ekspertëve dhe duke mbajtur regjistrat përkatës. Ajo monitoron respektimin e standardeve profesionale në ushtrimin e veprimtarisë përpara autoritetit kompetent dhe në proceset e vlerësimit dhe ekzaminimit të objekteve të pronësisë industriale.

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut kontribuon në zbatimin e kuadrit rregullator përmes kontrollit të praktikave tregtare që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, veçanërisht në rastet e mallrave të falsifikuara, mallrave pirate ose produkteve që dyshohet se shkelin të drejta të pronësisë industriale.

Ky bashkërendim institucional ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së

Tregut siguron një sistem funksional dhe të unifikuar për zbatimin e masave rregullatore në sektorin ekonomik.

4.1.10. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin financiar

Zbatimi i masave për profesionet e rregulluara në fushën fiskale dhe financiare, përfshirë agjentin doganor, audituesin ligjor dhe kontabilistin e miratuar, realizohet përmes një arkitekture institucionale të strukturuar, e cila kombinon funksionet politike dhe normative të Ministrisë së Financave me kompetencat rregullatore, profesionale dhe mbikëqyrëse të institucioneve të specializuara dhe organizatave të vetëqeverisjes profesionale.

Në lidhje me profesionin e agjentit doganor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ushtron kompetencat kryesore për autorizimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të veprimtarisë. Ajo administron procedurat për pajisjen me licencë, verifikon respektimin e rregullave doganore dhe saktësinë e deklarimeve gjatë përfaqësimit të subjekteve ekonomike në proceset e importit, eksportit dhe tranzitit të mallrave, si dhe aplikon masa administrative dhe disiplinore në rast shkeljesh.

Ministria e Financave ushtron rolin politikëbërës dhe normativ për profesionin e agjentit doganor, duke hartuar dhe miratuar kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës dhe duke garantuar koherencën e tij me politikat fiskale dhe doganore të shtetit. Përmes këtij kuadri, Ministria siguron funksionimin e qëndrueshëm të sistemit të autorizimit dhe kontrollit, pa ndërhyrë në ushtrimin konkret të kompetencave mbikëqyrëse të administratës doganore.

Për profesionin e audituesit ligjor, mbikëqyrja publike realizohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, i cili ushtron kompetenca funksionalisht të pavarura në lidhje me kontrollin e cilësisë së auditimit, miratimin e standardeve profesionale dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të veprimtarisë. Anëtarët e Bordit emërohen nga Ministri i Financave, ndërsa Bordi ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë autonome nga organizatat profesionale dhe operatorët e tregut.

Në nivel profesional, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar është përgjegjës për regjistrimin e audituesve ligjorë, organizimin e formimit profesional fillestar dhe të vazhdueshëm, si dhe për zbatimin e kodeve etike dhe procedurave disiplinore ndaj anëtarëve të tij.

Ministria e Financave ushtron funksionin normativ edhe për profesionin e audituesit ligjor, duke përcaktuar kuadrin ligjor të auditimit, kriteret e aksesit në profesion dhe marrëdhëniet institucionale ndërmjet Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe organizatës profesionale, me synimin për të garantuar përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.

Për profesionin e kontabilistit të miratuar, organizata profesionale përkatëse ushtron kompetencat për regjistrimin, certifikimin dhe edukimin e vazhdueshëm profesional, si dhe për mbikëqyrjen etike dhe disiplinore të ushtrimit të profesionit. Ministria e Financave ruan rolin e saj politikëbërës dhe rregullator, duke përcaktuar kërkesat ligjore për ushtrimin e profesionit dhe duke siguruar koherencën e sistemit të kontabilitetit me politikat fiskale dhe standardet financiare kombëtare.

Në tërësi, ndarja e kompetencave ndërmjet Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe organizatave profesionale siguron një sistem të balancuar ndërmjet mbikëqyrjes publike dhe vetërregullimit profesional, duke garantuar transparencë, integritet dhe siguri juridike në ushtrimin e këtyre profesioneve.

4.1.11. Institucionet përgjegjëse për zbatimin në sektorin e sigurimeve

Zbatimi i masave për profesionet e rregulluara në sektorin e sigurimeve realizohet përmes një sistemi institucional plotësisht të pavarur, ku autoriteti i vetëm rregullator dhe mbikëqyrës është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. AMF ushtron në mënyrë ekskluzive kompetencat për licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e profesionistëve dhe subjekteve që veprojnë në fushën e sigurimeve, përfshirë agjentët dhe ndërmjetësit e sigurimeve, brokerët, si dhe profesionistët aktuarialë.

Në kuadër të këtij mandati ligjor, AMF administron procedurat e autorizimit, verifikon përmbushjen e kriterëve për aksesin në profesion, përcakton rregullat e ushtrimit të veprimtarisë dhe ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme mbi praktikën profesionale. Autoriteti siguron që profesionistët të plotësojnë kërkesat për kualifikim, përshtatshmëri dhe edukim të vazhdueshëm, si dhe që aktiviteti i tyre të zhvillohet në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, me synim stabilitetin e tregut të sigurimeve dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

AMF vepron si institucion i pavarur nga pushteti ekzekutiv, si në aspektin organizativ ashtu edhe funksional, dhe ushtron kompetencat e saj rregullatore, mbikëqyrëse dhe sanksionuese në mënyrë autonome. Kjo strukturë garanton ndarjen e plotë ndërmjet politikëbërjes së përgjithshme shtetërore dhe mbikëqyrjes konkrete të tregut, duke siguruar paanshmëri, profesionalizëm dhe siguri juridike për subjektet e licencuara.

Institucionet e trajnimit dhe strukturat e formimit profesional kontribuojnë në mënyrë mbështetëse përmes ofrimit të programeve të certifikimit dhe edukimit të vazhdueshëm, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AMF për ruajtjen dhe rinovimin e licencave. Organizatat profesionale, aty ku ekzistojnë, luajnë rol plotësues në promovimin e standardeve etike dhe profesionale, pa zëvendësuar kompetencat publike të autoritetit mbikëqyrës.

Në tërësi, konfigurimi institucional mbështetet në një model të centralizuar dhe të pavarur të rregullimit publik, ku AMF përbën pikën e vetme të përgjegjësisë për zbatimin e kuadrit ligjor në sektorin e sigurimeve.

4.2. Mekanizmat e Monitorimit dhe Raportimit

4.2.1. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e drejtësisë

Monitorimi i përparimit në sektorin e drejtësisë do të bazohet në Planin e Veprimit dhe në përditësimin periodik të Kartës së Sektorit, duke reflektuar statusin e zbatimit të çdo mase për secilin profesion. Autoritetet profesionale do të raportojnë periodikisht pranë Ministrisë së Drejtësisë mbi ecurinë e masave që lidhen me kompetencat e tyre, duke përfshirë ndryshimet rregullatore, përmirësimet procedurale dhe masat e ndërmarra për rritjen e transparencës.

Raportimi do të realizohet në cikle gjashtëmujore dhe do të konsolidohet në nivel qendror, në bashkëpunim me strukturën koordinuese të projektit, për të mundësuar një pasqyrë të plotë të progresit sektorial dhe për të identifikuar në kohë vonesat ose nevojat për ndërhyrje shtesë. Rezultatet e këtij procesi do të përdoren si bazë për raportimin ndaj Komisionit Evropian në kuadër të procesit të përafrimit me Direktivën 2005/36/EC dhe kërkesave të transparencës dhe proporcionalitetit.

Komunikimi me palët e interesit në sektorin e drejtësisë do të realizohet përmes publikimit të informacionit përkatës në faqet zyrtare të institucioneve përgjegjëse, organizimit të konsultimeve me dhomat profesionale dhe aktorët ekonomikë, si dhe aktiviteteve informuese për profesionistët dhe publikun. Ky proces synon të sigurojë përfshirjen aktive të aktorëve përkatës dhe rritjen e besimit në reformën e profesioneve të rregulluara.

4.2.2. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e Punëve të Brendshme

Monitorimi i progresit të zbatimit të masave në sektorin e Punëve të Brendshme realizohet përmes mekanizmave të kontrollit administrativ dhe funksional të strukturave përkatëse, përfshirë vlerësimin periodik të respektimit të kriterëve ligjorë për akses dhe ushtrim të funksioneve, nivelin e trajnimit profesional, si dhe efektivitetin e organizimit institucional dhe ndërhyrjeve operacionale.

Për funksionin e zjarrfikësit, monitorimi përfshin vlerësimin e rekrutimit, përgatitjes profesionale dhe performancës së personelit, si dhe të kapaciteteve operacionale të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit. Për shërbimet private të sigurisë fizike, monitorimi realizohet përmes kontrolleve administrative dhe inspektimeve funksionale të kryera nga Policia e Shtetit, duke përfshirë certifikimin e personelit, pajtueshmërinë e subjekteve të licencuara me detyrimet ligjore dhe respektimin e standardeve të sjelljes profesionale.

Raportimi periodik kryhet nga strukturat përgjegjëse drejt Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përputhje me procedurat administrative në fuqi. Të dhënat e mbledhura shërbejnë për vlerësimin e funksionimit të kuadrit rregullator, identifikimin e problematikave në zbatim dhe planifikimin e masave korrigjuese ose përmirësuese, veçanërisht në fushën e trajnimit, kontrollit dhe kapaciteteve njerëzore.

Në kuadër të procesit të integritetit evropian, informacioni i konsoliduar mbi zbatimin e masave dhe funksionimin e sektorit përdoret për raportimin periodik ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian, duke pasqyruar mënyrën se si kufizimet ekzistuese justifikohen nga arsye të interesit të përgjithshëm dhe zbatohen në mënyrë proporcionale.

Komunikimi me palët e interesit realizohet përmes publikimit të kuadrit ligjor dhe akteve nënligjore, raporteve institucionale dhe informacioneve të përgjithshme mbi kriteret dhe procedurat e zbatueshme, me qëllim rritjen e transparencës, parandalimin e shkeljeve dhe forcimin e besimit publik, duke ruajtur njëkohësisht kërkesat e sigurisë që lidhen me natyrën e këtyre veprimtarive.

4.2.3. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e shëndetësisë dhe kujdesit social

Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit në sektorin e shëndetësisë dhe të kujdesit shoqëror realizohet përmes një kombinimi mekanizmesh administrativë, profesionalë dhe inspektues.

Organet profesionale dhe institucionet përgjegjëse mbledhin dhe analizojnë në mënyrë periodike të dhëna mbi regjistrimin dhe licencimin profesional, certifikimin dhe ricertifikimin, edukimin e vazhdueshëm, procedurat disiplinore, trajtimin e ankesave dhe funksionimin e procedurave të njohjes së kualifikimeve profesionale.

Strukturat inspektuese dhe autoritetet kompetente verifikojnë respektimin e detyrimeve ligjore, etike dhe profesionale, si dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe sociale, duke ndërhyrë në rastet e shkeljeve përmes masave administrative dhe disiplinore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Për shërbimet e kujdesit shoqëror, monitorimi përfshin gjithashtu vlerësimin periodik të cilësisë së shërbimeve dhe respektimin e standardeve minimale të ofrimit.

Raportimi mbi progresin dhe efektet e zbatimit kryhet në intervale të rregullta përmes raporteve institucionale të ministrisë përgjegjëse dhe strukturave përkatëse profesionale. Këto raporte përfshijnë të dhëna mbi numrin e profesionistëve të regjistruar dhe të certifikuar, funksionimin e mekanizmave të edukimit të vazhdueshëm, problematikat e evidentuara në praktikë dhe masat korrigjuese të ndërmarra. Informacioni i konsoliduar përdoret për vlerësimin e efektivitetit të masave rregullatore dhe për komunikimin periodik me Komisionin Evropian, në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Komunikimi me palët e interesit, përfshirë profesionistët, institucionet arsimore, ofruesit e shërbimeve shëndetësore dhe sociale dhe publikun, realizohet përmes kanaleve zyrtare dhe mekanizmave të konsultimit, me qëllim rritjen e transparencës, identifikimin e hershëm të problematikave dhe forcimin e respektimit vullnetar të kërkesave rregullatore.

4.2.4. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e veterinarisë

Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit në sektorin e veterinarisë realizohet përmes një kombinimi mekanizmesh administrativë, profesionalë dhe inspektues, të cilët lejojnë ndjekjen sistematike të ushtrimit të profesioneve dhe vlerësimin e efektivitetit të masave rregullatore.

Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar mban regjistrat e profesionistëve të licencuar dhe ndjek respektimin e detyrimeve etike dhe profesionale, duke raportuar periodikisht mbi statusin e anëtarësimit, masat disiplinore dhe zhvillimet në formimin profesional. Këto të dhëna përbëjnë një burim bazë për monitorimin e aksesit në profesion dhe cilësisë së praktikës profesionale.

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit realizojnë kontrole të rregullta në terren dhe inspektime tematike, duke mbledhur të dhëna mbi përputhshmërinë me protokollet sanitare, përdorimin e barnave veterinare, zbatimin e masave profilaktike dhe ndikimin në sigurinë ushqimore. Rezultatet e këtyre kontrolleve përdoren për identifikimin e rreziqeve, ndërhyrjet korrigjuese dhe përmirësimin e praktikave administrative.

Monitorimi plotësohet me mbledhjen e informacionit mbi përdorimin e barnave veterinare, rezistencën antimikrobike, rastet e zoonozave dhe aktivitetet riprodhuese, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të sistemit kombëtar tëurvejancës epidemiologjike.

Raportimi periodik mbi zbatimin e masave kryhet nga institucionet përgjegjëse dhe integrohet në ciklet kombëtare të raportimit sektorial dhe ndërsektorial, si dhe në komunikimin me aktorët ndërkombëtarë. Raportet pasqyrojnë numrin e profesionistëve të licencuar, gjetjet inspektuese, shkeljet e konstatuara, masat administrative të marra dhe tendencat kryesore në shëndetin e kafshëve dhe sigurinë ushqimore.

Komunikimi me palët e interesit realizohet përmes publikimit të informacionit përkatës, udhëzimeve profesionale dhe shkëmbimit të rregullt të të dhënave ndërmjet institucioneve. Ky komunikim synon rritjen e transparencës, forcimin e zbatueshmërisë së rregullave dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet administratës publike dhe profesionistëve.

Në tërësi, mekanizmat e monitorimit dhe raportimit sigurojnë që rregullimi i profesioneve veterinarë të funksionojë në praktikë në mënyrë të qëndrueshme, duke mbështetur mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe njerëzve, sigurinë ushqimore dhe përafrimin gradual me standardet evropiane.

4.2.5. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e mjedisit

Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit në sektorin e mjedisit duhet të bazohet në tregues të matshëm, të krahasueshëm dhe të verifikueshëm, të lidhur drejtpërdrejt me regjimet e lejeve dhe licencave, me detyrimet e raportimit dhe me gjetjet e instrumenteve të transparencës dhe proporcionalitetit. Mekanizmat e monitorimit duhet të mundësojnë vlerësimin periodik të efektivitetit të masave, nivelit të përputhshmërisë së subjekteve me kushtet përkatëse, cilësisë së raportimit dhe funksionimit të mekanizmave të kontrollit dhe inspektimit. Raportimi periodik duhet të kryhet në intervale të rregullta dhe të përfshijë analizë të progresit, problematikave të hasura dhe nevojës për ndërhyrje korrigjuese, duke shërbyer si bazë për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe si instrument komunikimi me aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfshirë Komisionin Evropian, në kuadër të përafrimit me *acquis* mjedisor dhe forcimit institucional.

Për Operatorin e Mjedisit, monitorimi realizohet përmes mekanizmave të lidhur me kushtet e lejeve mjedisore, kontrollin e përmbushjes së tyre dhe ndjekjen e ndikimeve reale në mjedis, duke përfshirë verifikime administrative dhe kontrole në terren nga strukturat inspektuese, në bashkëpunim me autoritetet vendore kur veprimtaritë prekin drejtpërdrejt territorin e tyre. Raportimi periodik duhet të reflektojë nivelin e përputhshmërisë së subjekteve, cilësinë dhe rregullsinë e të dhënave mjedisore të raportuara, shkeljet e evidentuara dhe masat korrigjuese të marra, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të kontrollit dhe të transparencës administrative.

Për Ekspertin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, monitorimi realizohet përmes verifikimit të përputhshmërisë së raporteve të hartuara me kërkesat ligjore dhe teknike, kontrollit të respektimit të kushteve të certifikimit dhe, kur është e aplikueshme, vlerësimit të standardeve metodologjike dhe integritetit profesional. Strukturat inspektuese dhe autoritetet kompetente vlerësojnë cilësinë e dokumentacionit, saktësinë e analizave dhe përmbushjen e detyrimeve, duke ndërhyrë kur konstatohet shkelje. Raportimi periodik duhet të përfshijë të dhëna mbi numrin e ekspertëve të

certifikuar, subjektet e licencuara, rastet e refuzimit ose revokimit dhe problematikat e hasura, si bazë për vlerësimin e efektivitetit të masave dhe për përditësimin e kriterëve apo procedurave.

Për Transportuesin e Mbetjeve, monitorimi realizohet përmes kontrollit të respektimit të kushteve të licencimit, verifikimit të dokumenteve të dorëzimit dhe gjurmueshmërisë së lëvizjes së mbetjeve nga gjeneruesi të marrësi përfundimtar, duke përfshirë kontrole të synuara për mbetjet e rrezikshme. Strukturat inspektuese dhe autoritetet vendore bashkëpunojnë me institucionet qendrore për të identifikuar shkeljet dhe për të parandaluar depozitimin e paligjshëm. Raportimi periodik duhet të përfshijë të dhëna mbi licencat, rastet e pezullimit ose revokimit, shkeljet e konstatuara dhe masat administrative, për vlerësimin e sistemit dhe përmirësimet e mëtejshme procedurale ose teknike.

Për Tregtarin e Mbetjeve, monitorimi realizohet përmes verifikimit të respektimit të kushteve të licencës, gjurmueshmërisë së mbetjeve të tregtuara dhe respektimit të rregullave për importin, eksportin dhe tranzitimin, përfshirë kontrollin e dokumentacionit shoqërues, kontratave, dokumenteve të dorëzimit dhe regjistrave të brendshëm. Në rastet e tregtimit ndërkufitar, koordinimi me autoritetet doganore dhe autoritetet e shteteve të tjera mbetet element vendimtar për parandalimin e transferimeve të paligjshme. Raportimi institucional duhet të mundësojë identifikimin e rreziqeve, vlerësimin e efektivitetit të kontroleve dhe përshtatjen e praktikave të monitorimit në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe legjislative.

Për Agjentin e Mbetjeve, monitorimi i progresit realizohet përmes mekanizmave të raportimit dhe kontrollit administrativ mbi licencat e lëshuara, ndryshimet në statusin e subjekteve të licencuara, shkeljet e konstatuara dhe masat administrative të marra, duke mundësuar identifikimin në kohë të problematikave që lidhen me transparencën, proporcionalitetin ose zbatimin praktik të kërkesave. Raportimi periodik kryhet në kuadër të raporteve sektoriale që institucionet përgjegjëse përgatisin për qeverinë dhe për aktorët ndërkombëtarë, përfshirë komunikimin me Komisionin Evropian në kuadër të përafrimit dhe vlerësimeve të përputhshmërisë me standardet e BE-së.

Për Shpuesin Profesionist për Ujë, monitorimi realizohet përmes kontrollit dhe inspektimit të respektimit të kushteve të lejes për shpim dhe të detyrimeve për dorëzimin e raporteve teknike e hidrogeologjike pas përfundimit të punimeve. Inspektimet në terren dhe shqyrtimi i dokumentacionit shërbejnë për identifikimin e shkeljeve dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese ose sanksionuese. Raportimi periodik duhet të reflektojë të dhëna mbi lejet e dhëna, rastet e shkeljeve dhe masat e marra, duke mbështetur vlerësimin e efektivitetit të kuadrit rregullator dhe komunikimin e progresit në kuadër të përafrimit dhe transparencës.

Për Punonjësën e Shërbimit Pyjor, monitorimi realizohet përmes mekanizmave të brendshëm të raportimit administrativ dhe inspektimit periodik, duke mbledhur dhe analizuar të dhëna mbi numrin e profesionistëve të certifikuar, nivelin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe efektet konkrete të masave në mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave. Raportimi kryhet në cikle të rregullta, në përputhje me praktikën institucionale dhe detyrimet ndërkombëtare, duke kontribuar edhe në

komunikimin me partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet e Bashkimit Evropian, në kuadër të integritimit dhe përafrimit.

Komunikimi me palët e interesit në sektorin e mjedisit përbën element funksional të zbatimit dhe monitorimit dhe realizohet përmes publikimit të informacionit në kanalet zyrtare, përdorimit të mjeteve elektronike dhe shkëmbimit institucional të të dhënave. Përfshirja e operatorëve ekonomikë, subjekteve të licencuara, strukturave inspektuese, autoriteteve vendore dhe, kur është e nevojshme, publikut, synon të rrisë transparencën, të përmirësojë besueshmërinë e të dhënave, të identifikojë herët problematikat dhe të forcojë respektimin vullnetar të kërkesave ligjore. Në tërësi, zbatimi dhe monitorimi në këtë sektor synojnë krijimin e një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm që garanton mbrojtjen efektive të mjedisit dhe shëndetit të njeriut, ndërkohë që siguron siguri juridike dhe parashikueshmëri për subjektet dhe përmbushje të angazhimeve në kuadër të integritimit evropian.

4.2.6. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e infrastrukturës dhe transporteve

Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit në sektorin e infrastrukturës dhe transporteve realizohet përmes mekanizmave të rregullt të ndjekjes institucionale dhe analizës së të dhënave administrative. Institucionet përgjegjëse mbledhin periodikisht informacion mbi licencat dhe dëshmitë e aftësisë profesionale të lëshuara, kohëzgjatjen e procedurave, përdorimin e procedurave elektronike, rastet e pezullimit ose revokimit, si dhe funksionimin e mekanizmave të ankimit dhe njohjes së kualifikimeve profesionale.

Për profesionet rrugore, monitorimi fokusohet në funksionimin e sistemit të dëshmvive të aftësisë profesionale, respektimin e kushteve të trajnimit dhe ushtrimit të veprimtarisë, si dhe në kontrollin administrativ të subjekteve përkatëse. Për arkitektët, inxhinierët dhe vlerësuesit e pasurive të paluajtshme, monitorimi përfshin vlerësimin e aksesit në profesion, efektet e masave rregullatore në tregun e shërbimeve profesionale dhe identifikimin e pengesave praktike.

Në sektorin detar, monitorimi realizohet përmes kontrollit periodik të vlefshmërisë së certifikatave dhe mbikëqyrjes funksionale të ushtrimit të profesionit në bashkëpunim me autoritetet portuale, ndërsa në aviacionin civil përmes inspektimeve administrative dhe teknike, auditimeve periodike dhe mekanizmave të raportimit të incidenteve, me qëllim identifikimin e hershëm të rreziqeve dhe ndërhyrjen në kohë.

Raportimi periodik mbi progresin dhe efektet e zbatimit përgatitet nga institucionet përgjegjëse dhe integrohet në ciklet kombëtare të raportimit për procesin e integritetit evropian, përfshirë komunikimin me Komisionin Evropian. Raportet pasqyrojnë ecurinë e masave, sfidat e hasura dhe nevojën për ndërhyrje korrigjuese, duke shërbyer si bazë për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet e Bashkimit Evropian.

Komunikimi me palët e interesit realizohet përmes publikimit të informacionit mbi procedurat dhe ndryshimet rregullatore, si dhe përmes konsultimeve periodike me profesionistët, institucionet arsimore dhe operatorët ekonomikë. Ky komunikim synon rritjen e transparencës, forcimin e sigurisë juridike dhe krijimin e një mjedisi bashkëpunues për zbatimin e qëndrueshëm të planit të veprimit.

4.2.8. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e turizmit, kulturës dhe sportit

Monitorimi i zbatimit të masave në sektorin e turizmit, kulturës dhe sportit realizohet përmes mekanizmave të integruar administrativë, inspektimeve funksionale dhe përdorimit sistematik të regjistrave sektoriale, me qëllim verifikimin e respektimit të kushteve të ushtrimit të profesioneve dhe vlerësimin e efektivitetit të masave rregullatore në praktikë.

Në fushën e turizmit, monitorimi i profesioneve të udhërrëfimit dhe i operatorëve turistikë realizohet përmes përditësimit periodik të Regjistrat Qendror të Turizmit, kontrolleve administrative, ndjekjes së ankesave dhe inspektimeve në terren. Raportimi periodik përfshin të dhëna mbi certifikimet, shkeljet administrative, masat disiplinore dhe ndikimin e rregullimit në cilësinë e shërbimeve, duke shërbyer si bazë për komunikimin institucional me Komisionin Evropian në kuadër të procesit të integritetit.

Për operatorët e turizmit detar dhe transportuesit turistikë, monitorimi realizohet përmes kontrolleve teknike dhe administrative, verifikimit të licencave, dokumentacionit të mjeteve dhe kushteve të ushtrimit të aktivitetit, ndërsa raportimi institucional përdoret për identifikimin e problematikave në zbatim dhe përshtatjen e politikave sektoriale.

Për vrojtuesin e plazhit, monitorimi bazohet në tregues të matshëm dhe të verifikueshëm, duke mundësuar vlerësimin periodik të progresit në aksesin në informacion, thjeshtimin e procedurave dhe forcimin e sigurisë juridike. Raportimi realizohet në intervale të rregullta dhe shërben si instrument komunikimi me institucionet kombëtare dhe aktorët evropianë.

Në fushën e kulturës krijuese, për agjentët letrarë, art-grafistët dhe botuesit, monitorimi realizohet përmes mekanizmave pasues të zbatimit të ligjit, përfshirë mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të autorit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kontraktore, ndërsa informimi dhe ndërgjegjësimi i aktorëve të tregut mbeten elemente thelbësore të zbatimit.

Në fushën e trashëgimisë kulturore, monitorimi i profesioneve të konservimit, restaurimit dhe arkeologjisë realizohet përmes kombinimit të kontrollit administrativ dhe mbikëqyrjes teknike në terren, duke përfshirë inspektime të drejtpërdrejta të punimeve, vlerësime të metodologjisë së përdorur dhe ndjekjen e dokumentimit të ndërhyrjeve. Raportimi i rregullt shërben për vlerësimin e efektivitetit të masave, ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe komunikimin me aktorët ndërkombëtarë në fushën e trashëgimisë kulturore.

Në fund, për profesionet sportive të rregulluara, monitorimi realizohet përmes kombinimit të mekanizmave administrativë të ministrisë përgjegjëse për sportin dhe mekanizmave teknike të federatave sportive. Ky monitorim përfshin ndjekjen e certifikimeve dhe rinovimeve, respektimin e standardeve të sigurisë dhe rregullave teknike, trajtimin e ankesave dhe aplikimin e masave disiplinore ose administrative. Raportimi periodik konsolidohet në raportet sektoriale të ministrisë dhe shërben si bazë për vlerësimin e progresit dhe komunikimin me aktorët ndërkombëtarë në kuadër të proceseve të integritetit dhe harmonizimit me standardet përkatëse.

4.2.9. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e ekonomisë

Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit në fushën e ekonomisë realizohet përmes një kombinimi mekanizmash administrativë, profesionalë dhe inspektues, të cilët lejojnë ndjekjen periodike të ushtrimit të profesioneve dhe vlerësimin e efektivitetit të masave rregullatore.

Dhoma Kombëtare e Zejtarisë dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve mbajnë të dhëna mbi regjistrimin e zejtarëve, certifikimin e kompetencave dhe zhvillimet në formimin profesional, të cilat përdoren për të vlerësuar nivelin e formalizimit të veprimtarisë dhe përputhshmërinë e kualifikimeve me kërkesat e tregut.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale administron regjistrat e përfaqësuesve të autorizuar dhe ekspertëve, ndjek respektimin e kriterëve ligjore për ushtrimin e profesionit dhe mbledh informacion mbi veprimtarinë profesionale në procedurat e pronësisë industriale. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për identifikimin e problematikave strukturore dhe për përmirësimin e praktikave administrative.

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut realizon kontrole në treg dhe raporton mbi rastet e shkeljeve të të drejtave të pronësisë industriale dhe ndikimin e tyre në konkurrencën e ndershme, duke kontribuar në zbatimin efektiv të kuadrit rregullator.

Raportimi periodik mbi zbatimin e masave përgatitet nga institucionet përgjegjëse dhe integrohet në ciklet kombëtare të raportimit sektorial. Raportet pasqyrojnë zhvillimet kryesore në regjistrimin profesional, certifikimin, inspektimet e kryera dhe problematikat e identifikuara, duke shërbyer si bazë për dialogun institucional dhe për orientimin e ndërhyrjeve të mëtejshme rregullatore.

Komunikimi me palët e interesit realizohet përmes publikimit të informacionit përkatës, udhëzimeve administrative dhe konsultimeve periodike me profesionistët dhe organizatat përfaqësuese. Ky komunikim synon të rrisë transparencën, të forcojë sigurinë juridike dhe të mbështesë zbatimin e qëndrueshëm të reformave në sektorin ekonomik.

4.2.10. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e financave

Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit për këto profesione realizohet përmes një kombinimi mekanizmash administrativë, profesionalë dhe mbikëqyrës, të cilët mundësojnë ndjekjen e vazhdueshme të ushtrimit të veprimtarisë dhe vlerësimin e efektivitetit të masave rregullatore.

Për agjentët doganorë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbledh dhe analizon të dhëna mbi autorizimet e dhëna, respektimin e procedurave doganore, rastet e shkeljeve, masat administrative dhe funksionimin e mekanizmave të ankimit. Këto të dhëna përdoren për të vlerësuar nivelin e përputhshmërisë me legjislacionin doganor dhe për të identifikuar nevoja për përmirësime procedurale.

Në fushën e auditimit ligjor, Bordi i Mbikëqyrjes Publike realizon inspektime të cilësisë, shqyrton raportet e auditimit dhe ndjek respektimin e standardeve profesionale dhe kërkesave të pavarësisë. Bordi përgatit dhe publikon në mënyrë autonome raporte periodike mbi veprimtarinë e tij, përfshirë rezultatet e inspektimeve dhe masat mbikëqyrëse të ndërmarra, duke kontribuar

drejtpërdrejt në transparencën publike dhe dialogun institucional në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Organizata profesionale kontribuon përmes monitorimit të edukimit të vazhdueshëm dhe zbatimit të procedurave disiplinore ndaj audituesve ligjorë dhe kontabilistëve të miratuar, si dhe përmes mbajtjes së regjistrave profesionale të përditësuar.

Për kontabilistët e miratuar, mekanizmat e monitorimit përfshijnë verifikimin e përmbushjes së detyrimeve për edukimin e vazhdueshëm, procedurat disiplinore të organizatës profesionale dhe analizën e praktikave të raportimit financiar në bashkëpunim me institucionet fiskale.

Raportimi periodik mbi zbatimin e masave përgatitet nga institucionet përgjegjëse dhe integrohet në ciklet kombëtare të raportimit sektorial. Raportet pasqyrojnë zhvillimet kryesore në aksesin në profesion, cilësinë e shërbimeve profesionale, rastet e shkeljeve dhe masat korrigjuese, duke shërbyer si bazë për komunikimin e progresit me aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfshirë Komisionin Evropian.

Komunikimi me palët e interesit realizohet përmes publikimit të udhëzimeve administrative, informacionit mbi procedurat dhe rezultateve të mbikëqyrjes, si dhe përmes konsultimeve periodike me organizatat profesionale dhe operatorët ekonomikë. Ky komunikim synon rritjen e transparencës, forcimin e besimit në sistemin rregullator dhe sigurimin e një zbatimi të qëndrueshëm dhe koherent të reformave në fushën fiskale dhe financiare.

4.2.11. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në sektorin e sigurimeve

Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit për profesionet e sigurimeve realizohet përmes mekanizmave të brendshëm të mbikëqyrjes së AMF-së, të cilët përfshijnë mbledhjen dhe analizimin periodik të të dhënave mbi licencat e dhëna dhe të rinovuara, respektimin e kërkesave të përshtatshmërisë profesionale, përmbushjen e detyrimeve për edukimin e vazhdueshëm dhe pajtueshmërinë e praktikave të tregut me rregullat për mbrojtjen e konsumatorit.

Këta mekanizma plotësohen nga inspektive në vend, kontrole tematike dhe shqyrtimi i raportimeve periodike që subjektet e licencuara janë të detyruara të paraqesin. Një komponent i rëndësishëm i monitorimit lidhet me trajtimin e ankesave të klientëve dhe identifikimin e shkeljeve profesionale, ku AMF ushtron kompetencë të plotë për marrjen e masave administrative dhe korrigjuese, përfshirë paralajmërime, gjoka, pezullime ose revokime licence.

Raportimi mbi zbatimin e masave dhe zhvillimet në sektor realizohet në mënyrë periodike përmes raporteve institucionale të përgatitura dhe publikuara nga vetë AMF, të cilat pasqyrojnë gjendjen e tregut të sigurimeve, rezultatet e mbikëqyrjes dhe veprimet rregullatore të ndërmarra. Këto raporte shërbejnë si instrument transparence publike dhe si bazë për vlerësimin e efektivitetit të kuadrit rregullator.

Informacioni i përmbledhur përdoret gjithashtu për komunikimin e progresit në kuadër të procesit të integritetit evropian, duke demonstruar përputhshmërinë graduale të sistemit shqiptar me parimet e tregut të brendshëm, në veçanti transparencën, proporcionalitetin dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Komunikimi me palët e interesit realizohet përmes publikimit të akteve rregullatore, udhëzimeve administrative, statistikave të tregut dhe raporteve të mbikëqyrjes, si dhe përmes konsultimeve periodike me profesionistët dhe operatorët ekonomikë, me qëllim forcimin e sigurisë juridike dhe besimit në sistemin e mbikëqyrjes së sektorit të sigurimeve.

5. Përfundime dhe Rekomandime

5.1. Sektori i Drejtësisë

Përmbledhje e Masave Kryesore të Ndërmarra

Tabela e Masave, si instrumenti kryesor operacional i Planit Kombëtar të Veprimit, përmbledh rezultatet e Instrumenteve 1, 2 dhe 3 për profesionet e drejtësisë duke i përkthyer në ndërhyrje konkrete, me përgjegjësi institucionale dhe afate të qarta, në funksion të nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE dhe nenit 51 TFBE.

Për avokatinë, masa qendrore është transpozimi i Direktivave 98/5/EC dhe 77/249/EEC dhe harmonizimi i kuadrit të brendshëm (ligj, statut, kod etike, rregullore) për të garantuar standarde të unifikuara për avokatët e huaj, duke saktësuar kërkesën e gjuhës dhe duke zëvendësuar mekanizmat më kufizues (p.sh. bashkëpunimi i detyrueshëm) me masa të matshme dhe më pak kufizuese. Për noterinë, masa kryesore është heqja e kërkesës së shtetësisë shqiptare si kusht licencimi dhe ushtrimi, duke e zëvendësuar me kritere objektive dhe proporcionale, si dhe riformulimi i akteve nënligjore për të reflektuar mekanizma të qartë të njohjes së kualifikimeve të BE-së. Për ndërmjetësimin, masat e parashikuara synojnë rishikimin e kufizimeve që krijojnë trajtim të pabarabartë për shtetasit e BE-së, si dhe rritjen e qartësisë procedurale në njohjen e titujve dhe në përdorimin proporcional të masave kompensuese.

Rekomandime për Përmirësime të Mëtejshme

Për avokatinë, rekomandohet që transpozimi i Direktivave 98/5/EC dhe 77/249/EEC të shoqërohet me standardizim të plotë të procedurave për avokatët e huaj: përcaktim i qartë i nivelit të kompetencës gjuhësore, formave të verifikimit dhe alternativave të pranueshme, si dhe vendosje e mekanizmave më pak kufizues për integrimin profesional, të bazuar në kritere objektive dhe afate të përcaktuara.

Për noterinë, rekomandohet që heqja e shtetësisë të trajtohet si ndërhyrje horizontale, duke u reflektuar jo vetëm në ligj, por edhe në të gjitha aktet nënligjore dhe praktikatat e licencimit, me rregulla të qarta për njohjen e kualifikimeve të huaja dhe masat kompensuese kur justifikohen objektivist. Për profesionet e tjera të drejtësisë, rekomandohet të eliminohen ose të rishikohen kërkesat e shtetësisë aty ku ato ekzistojnë si barriera direkte, përfshirë administratorin e falimentit, duke i zëvendësuar me kritere profesionale të verifikueshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me interesin publik.

Për ndërmjetësimin, theksohet nevoja për qartësi të plotë në njohjen e kualifikimeve të huaja: procedura të aksesueshme dhe të standardizuara, afate të detajuara, mjete efektive ankimi dhe

përdorim i masave kompensuese vetëm kur vërtetohet diferencë reale kompetencash, në mënyrë që të shmangen barrat e panevojshme dhe trajtimi i pabarabartë për aplikantët nga BE.

5.2. Sektori i Punëve të brendshme

Përmbledhje e masave kryesore të ndërmarra

Analiza e kryer për funksionin e zjarrfikësit dhe për shërbimet private të sigurisë fizike konfirmon se kuadri rregullator ekzistues është ndërtuar mbi mbrojtjen e interesit publik dhe sigurinë, duke reflektuar natyrën e ndjeshme të këtyre funksioneve. Për zjarrfikësit, organizimi ekskluzivisht si shërbim publik e vendos funksionin jashtë fushës së lirisë së vendosjes dhe ofrimit të shërbimeve, duke përbërë një përjashtim të ligjshëm të justifikuar nga ushtrimi i autoritetit publik dhe funksionet thelbësore të sigurisë. Masat ekzistuese – përfshirë kriteret e pranimit, trajnimit, testimin profesional dhe sistemin e vlerësimit të performancës – rezultojnë të nevojshme dhe proporcionale ndaj nivelit të rrezikut dhe përgjegjësi të funksionit.

Për shërbimet private të sigurisë fizike, sistemi aktual i certifikimit të punonjësve dhe drejtuesve teknikë, licencimit të subjekteve, kriterëve të besueshmërisë dhe trajnimit profesional siguron një balancë funksionale ndërmjet mbrojtjes së rendit dhe sigurisë publike dhe hapjes së kontrolluar të sektorit. Procedurat dhe kompetencat institucionale janë të përcaktuara qartë, ndërsa kufizimet ekzistuese vlerësohen të targetuara dhe të diferencuara sipas rolit, duke reflektuar parimin e proporcionalitetit.

Në tërësi, masat e zbatuara pritet të ruajnë një nivel të lartë sigurie publike, të garantojnë profesionalizmin e personelit dhe të sigurojnë përputhshmëri të përgjithshme me kërkesat e Bashkimit Evropian për transparencë dhe proporcionalitet, në veçanti në kuadër të Direktivës 2005/36/KE.

Rekomandime për përmirësime të mëtejshme

Për funksionin e zjarrfikësit, rekomandohet ruajtja e modelit aktual të organizimit si shërbim publik, shoqëruar me përditësimin periodik të programeve të trajnimit në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe standardet bashkëkohore të sigurisë. Paralelisht, sugjerohet forcimi i mekanizmave të brendshëm të monitorimit dhe vlerësimit të performancës, me qëllim rritjen e eficiencës operative dhe profesionalizmit të shërbimit.

Për shërbimet private të sigurisë fizike, rekomandohet konsolidimi i kuadrit ekzistues përmes përmirësimit gradual të procedurave administrative, veçanërisht në drejtim të dixhitalizimit të aplikimeve për certifikim dhe licencim dhe rritjes së transparencës praktike. Po ashtu, rekomandohet forcimi i monitorimit të vazhdueshëm të subjekteve të licencuara dhe i mekanizmave disiplinorë, për të parandaluar abuzimet dhe për të garantuar respektimin e standardeve profesionale dhe etike.

Në perspektivë, sugjerohet rishikimi periodik i legjisllacionit dhe praktikave administrative për të dyja fushat, në funksion të evolucionit të riskut të sigurisë, zhvillimeve teknologjike dhe përvojës së fituar nga zbatimi. Këto rishikime duhet të synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së

shërbimit dhe eficiencës administrative, pa cenuar parimet themelore të sigurisë publike dhe proporcionalitetit që justifikojnë rregullimin e këtij sektori.

5.3. Sektori i Shëndetësisë

Përmbledhje e masave kryesore të ndërmarra

Vlerësimi i profesioneve në sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale (mjek i përgjithshëm dhe i specializuar, stomatolog dhe stomatolog i specializuar, farmacist, infermier, logoped, teknik laborator, teknik imazherie, fizioterapist, mami, psikolog, punonjës social, kujdestar për fëmijë dhe kujdestar për persona me aftësi të kufizuara) tregon se kuadri rregullator shqiptar është, në tërësi, i konsoliduar dhe funksional, duke garantuar një nivel të lartë mbrojtjeje të interesit publik, veçanërisht të shëndetit të pacientëve dhe të grupeve vulnerabël.

Sistemi mbështetet në kërkesa të qarta për formim profesional, praktikë të detyrueshme, provim shtetëror, regjistrim dhe licencim profesional, si dhe edukim të vazhdueshëm me mekanizma certifikimi dhe ricertifikimi periodik. Këto masa krijojnë një bazë të qëndrueshme për sigurimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe sociale, forcimin e etikës profesionale dhe rritjen e besimit të publikut, duke ruajtur një balancë të arsyeshme ndërmjet lirisë së ushtrimit të profesionit dhe mbrojtjes së interesit të përgjithshëm. Rezultati i pritshëm i këtij kuadri është standardizimi i kompetencave profesionale, rritja e sigurisë së pacientëve dhe përmirësimi gradual i cilësisë së shërbimeve në të gjithë sistemin.

Rekomandime për përmirësime të mëtejshme

Megjithatë, analiza tregon se ekzistojnë boshllëqe të rëndësishme në harmonizimin praktik të formimit profesional dhe të procedurave administrative, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në lëvizshmërinë profesionale dhe në funksionimin e njohjes së kualifikimeve. Rreziku kryesor lidhet me faktin se standardet minimale të trajnimit dhe struktura e kurrikulave, të cilat shërbejnë si bazë për njohjen automatike, nuk janë të harmonizuara në mënyrë të plotë. Kjo krijon pasiguri si për shtetasit shqiptarë që synojnë të ushtrojnë profesionin jashtë vendit, ashtu edhe për profesionistët e huaj që kërkojnë të ushtrojnë profesionin në Shqipëri, duke rrezikuar trajtim jo të njëtrajtshëm dhe barriera administrative në praktikë.

Në këtë kuadër, rekomandohet rishikimi dhe përafrimi i programeve të formimit dhe kurrikulave me standardet minimale përkatëse, në mënyrë që të garantohet njohje më e qartë dhe më e parashikueshme e kualifikimeve profesionale.

Po ashtu, rekomandohet modernizimi i procedurave administrative përmes digjitalizimit të regjistrimit, licencimit, certifikimit dhe raportimit të edukimit të vazhdueshëm, si dhe unifikimi i informacionit publik mbi procedurat, kriteret dhe afatet për të gjitha profesionet e sektorit.

Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet eliminimit të kërkesave joproporcionale në disa profesione, veçanërisht te farmacistët, ku procedurat aktuale për profesionistët nga shtetet anëtare të BE-së tejkalojnë atë që është e domosdoshme dhe krijojnë barriera të panevojshme për ushtrimin e profesionit. Paralelisht, rekomandohet forcimi i koordinimit ndërinstitucional

ndërmjet ministrisë përgjegjëse, urdhrave profesionale dhe strukturave të edukimit të vazhdueshëm, si dhe monitorimi periodik i proporcionalitetit të masave rregullatore.

Në përfundim, ruajtja e strukturës bazë të sistemit aktual vlerësohet e justifikuar, por kërkon ndërhyrje të synuara për harmonizimin e plotë të trajnimit dhe procedurave, rritjen e transparencës dhe modernizimin administrativ, me qëllim garantimin e një ekuilibri të qëndrueshëm ndërmjet mbrojtjes së shëndetit publik dhe funksionimit real të lirisë së ushtrimit të profesioneve në sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

5.4. Sektori i Veterinarisë

Përmbledhje e Masave Kryesore të Ndërmarra

Masat e parashikuara synojnë lehtësimin e aksesit në profesion për mjekët veterinarë, farmacistët veterinarë dhe teknikët veterinarë, veçanërisht për shtetasit e Bashkimit Evropian, përmes thjeshtimit dhe rritjes së transparencës së procedurave të njohjes së diplomave dhe kualifikimeve profesionale. Rezultati i pritshëm është reduktimi i barrierave administrative që aktualisht dekurajojnë lëvizshmërinë profesionale dhe krijimi i një mjedisi më të hapur dhe gjithëpërfshirës pune.

Krijimi i platformave të përbashkëta digjitale ndërmjet autoriteteve veterinarë dhe farmaceutike, si dhe zhvillimi i sistemeve të integruara për recetat veterinarë dhe raportimin në terren, pritet të përmirësojë monitorimin e përdorimit të barnave, të shmangë kontrollet e dyfishta dhe të rrisë efikasitetin operativ të institucioneve. Digjitalizimi i proceseve të certifikimit dhe regjistrave profesionale për teknikët veterinarë synon të garantojë transparencë, verifikim në kohë reale të kompetencave dhe një treg pune të bazuar në meritokraci.

Forcimi i pranisë së shërbimeve veterinarë në zonat rurale, i kombinuar me fushata ndërgjegjësimi për sigurinë ushqimore dhe mirëqenien e kafshëve, pritet të kontribuojë në zbatimin më të barabartë të standardeve kombëtare dhe në rritjen e mbrojtjes së shëndetit publik. Njëkohësisht, zhvillimi i edukimit të vazhdueshëm përmes trajnimeve të specializuara dhe platformave e-learning synon përditësimin e vazhdueshëm të profesionistëve me protokollet evropiane dhe garantimin e një niveli uniform kompetencash.

Rekomandime për Përmirësime të Mëtejshme

Rekomandohet përsheptimi i procedurave për njohjen e diplomave të lëshuara nga institucionet e akredituara të BE-së, minimizimi i dokumentacionit të tepërt dhe ofrimi i udhëzuesve të qartë në gjuhë të huaja, me qëllim shmangien e diskriminimit indirekt që buron nga burokracia.

Sugjerohet funksionalizimi i një platforme digjitale të përbashkët ndërmjet autoriteteve veterinarë dhe farmaceutike, si dhe zbatimi i një sistemi të integruar të recetës elektronike për të forcuar kontrollin e përdorimit të barnave dhe antibiotikëve, veçanërisht në zonat rurale, duke reduktuar mbivendosjet rregullatore.

Rekomandohet vijimi i digjitalizimit të proceseve të certifikimit dhe njohjes së kualifikimeve për teknikët veterinarë, përmes një platforme online dhe regjistri të unifikuar, si dhe zgjerimi i përdorimit të mjeteve digjitale për raportimin në terren dhe shkëmbimin e të dhënave me autoritetet veterinarë.

Në fund, rekomandohet forcimi i rolit të Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar në zhvillimin e një sistemi dinamik të edukimit të vazhdueshëm, si dhe zgjerimi i trajnimeve të aksesueshme për mjekët, farmacistët dhe teknikët veterinarë, me qëllim përditësimin e tyre me teknologjitë dhe protokollet më të fundit evropiane dhe garantimin e një standardi shërbimi të njëjtë në të gjithë territorin e vendit.

5.5. Sektori i Mjedisit

Përmbledhje e Masave Kryesore të Ndërmarra

Analiza e profesioneve dhe veprimtarive në sektorin e mjedisit, përfshirë Operatorin e Mjedisit, Ekspertin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Transportuesin, Tregtarin dhe Agjentin e Mbetjeve, Shpuesin Profesional për Ujë dhe Punonjës të Shërbimit Pyjor, tregon se kuadri rregullator shqiptar mbështetet në një bazë të konsoliduar ligjore dhe institucionale, e orientuar drejt mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut si interesa madhore të përgjithshme.

Rregullimi i këtyre veprimtarive fokusohet kryesisht në autorizimin administrativ të aktiviteteve me ndikim mjedisor dhe në kontrollin e ushtrimit të tyre, dhe jo në mbrojtjen e titujve profesionalë personalë në kuptimin klasik të Direktivës 2005/36/KE. Masat ekzistuese, përfshirë sistemin e lejeve mjedisore tip A dhe B, certifikimin e ekspertëve të VNM-së, licencimin e aktiviteteve të lidhura me mbetjet, autorizimin e shpimeve për ujë dhe kërkesat e kualifikimit për shërbimin pyjor, janë të ndërtuara mbi një qasje të bazuar në risk dhe vlerësohen përgjithësisht si të nevojshme dhe proporcionale.

Kuadri aktual garanton trajtim të barabartë dhe nuk parashikon kufizime mbi bazën e shtetësisë apo vendbanimit, duke respektuar parimet e lirisë së themelimit. Kufizimet e vendosura lidhen drejtpërdrejt me natyrën dhe rrezikshmërinë e aktiviteteve dhe synojnë parandalimin e ndotjes, shmangien e praktikave të paligjshme, garantimin e cilësisë së vlerësimeve mjedisore, kontrollin e lëvizjes së mbetjeve, mbrojtjen e burimeve ujore dhe administrimin e qëndrueshëm të pyjeve.

Rezultati i pritshëm i masave të zbatuara është forcimi i kontrollit mbi aktivitetet me ndikim mjedisor, rritja e gjurmueshmërisë dhe sigurisë së menaxhimit të mbetjeve, përmirësimi i cilësisë së raporteve të VNM-së, kontroll më i mirë i ndërhyrjeve në burimet ujore dhe rritja e mbrojtjes së ekosistemeve pyjore. Sistemi aktual kontribuon gjithashtu në krijimin e një baze më të besueshme të dhënash dhe në rritjen e transparencës institucionale.

Megjithatë, nga analiza rezulton nevoja për përmirësime të mëtejshme në drejtim të transparencës, qartësisë dhe standardizimit të procedurave administrative. Evidentohet mungesa e një prezantimi të unifikuar të informacionit rregullator, si dhe nevoja për forcimin e mekanizmave të raportimit, monitorimit dhe publikimit të të dhënave për subjektet e licencuara dhe aktivitetet e

kryera. Gjithashtu, konstatohet nevoja për përditësim të vazhdueshëm të procedurave dhe praktikave të inspektimit, si dhe për rritjen e kapaciteteve institucionale.

Rekomandime për përmirësime të mëtejshme

Rekomandohet strukturimi dhe sistematizimi i informacionit ligjor dhe proceduror për të gjitha profesionet dhe veprimtaritë e sektorit, me qëllim rritjen e sigurisë juridike dhe reduktimin e pasigurive praktike për operatorët ekonomikë. Po ashtu, rekomandohet forcimi i publikimit të kriterëve të certifikimit dhe licencimit, listave të profesionistëve të certifikuar dhe kushteve teknike të ushtrimit të veprimtarisë.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të mëtejshëm të procedurave elektronike dhe mekanizmave të raportimit, si dhe forcimit të koordinimit ndër-institucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për mjedisin, mbetjet, burimet ujore dhe shërbimin pyjor. Rekomandohet gjithashtu kryerja e rishikimeve periodike të masave ekzistuese për të vlerësuar ndikimin e tyre real dhe për të identifikuar mundësi për përmirësim, pa cenuar nivelin e mbrojtjes së mjedisit.

Në përfundim, ruajtja e sistemit aktual rregullator për sektorin e mjedisit vlerësohet si e justifikuar dhe proporcionale, me kusht që ai të shoqërohet me një proces të vazhdueshëm përmirësimi në drejtim të transparencës, efikasitetit administrativ dhe koordinimit institucional, në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe përafrimit gradual me standardet e Bashkimit Evropian.

5.6. Sektori i Infrastrukturës dhe transportit

Përmbledhje e masave kryesore të ndërmarra

Vlerësimi i profesioneve nën përgjegjësinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (arkitektë, urbanistë, profesionet e inxhinierisë, vlerësues të pasurive të paluajtshme, profesionet e transportit rrugor dhe shërbimeve teknike, profesionet detare dhe të aviacionit civil) tregon se kuadri rregullator shqiptar është, në tërësi, i konsoliduar dhe funksional, duke u mbështetur në objektiva të qarta të interesit publik si siguria publike, siguria rugore dhe detare, mbrojtja e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, cilësia e mjedisit të ndërtuar dhe garantimi i standardeve teknike profesionale.

Rregullimi i këtyre profesioneve realizohet përmes kombinimit të rezervës së titullit dhe aktivitetit (arkitektë, inxhinierë, vlerësues), sistemeve të licencimit profesional, si dhe mekanizmave të dëshmisë së aftësisë profesionale për veprimtari me rrezik të lartë, ndërsa në sektorët detar dhe të aviacionit civil mbështetet në regjime të strukturuar certifikimi të harmonizuar me standarde ndërkombëtare dhe evropiane. Masat ekzistuese konsiderohen përgjithësisht të përshtatshme dhe proporcionale në raport me kompleksitetin teknik dhe përgjegjësinë e drejtpërdrejtë që këto profesione mbartin për sigurinë publike dhe interesin e përgjithshëm. Rezultati i pritshëm i zbatimit të planit të veprimit është rritja e sigurisë juridike, përmirësimi i transparencës procedurale, standardizimi i aksesit në profesion dhe forcimi i funksionimit të tregut të shërbimeve profesionale, duke ruajtur njëkohësisht nivelin e lartë të mbrojtjes së interesit publik.

Rekomandime për përmirësime të mëtejshme

Megjithatë, analiza eidenton nevojën për përmirësime të mëtejshme horizontale në të gjithë sektorin, veçanërisht në drejtim të konsolidimit të transparencës procedurale, digjitalizimit të proceseve administrative dhe forcimit të testit të proporcionalitetit. Rekomandohet standardizimi dhe publikimi i plotë i hapave procedurale, dokumentacionit të kërkuar, afateve të shqyrtimit dhe mekanizmeve të ankimit për të gjitha profesionet, si dhe zgjerimi i përdorimit të mjeteve elektronike për aplikim, licencim, certifikim dhe rinovim autorizimesh. Në fushën e inxhinierisë dhe shërbimeve teknike, kërkohet një analizë më e strukturuar e masave rregullatore, duke shmangur mbivendosjet ndërmjet trajnimit, provimit dhe licencimit dhe duke garantuar një dallim të qartë ndërmjet njohjes akademike dhe asaj profesionale.

Po ashtu, nevojitet artikulum më i qartë i rregullave për ofrimin e përkohshëm të shërbimeve dhe për mobilitetin profesional, në mënyrë që të ruhet ekuilibri ndërmjet mbrojtjes së interesit publik dhe ushtrimit efektiv të lirive themelore. Për profesionet detare dhe të aviacionit civil, rekomandohet forcimi i mëtejshëm i sistemeve dixhitale të certifikimit, rritja e transparencës së kërkesave për trajnim dhe rinovim autorizimesh, si dhe intensifikimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me institucionet arsimore dhe qendrat e trajnimit. Në tërësi, ruajtja e strukturës aktuale rregullatore vlerësohet e justifikuar, por kërkon përmirësime graduale dhe të synuara për rritjen e efikasitetit administrativ, koherencës institucionale dhe harmonizimit praktik, me qëllim ndërtimin e një sistemi më transparent, proporcional dhe të parashikueshëm për profesionistët dhe operatorët ekonomikë.

5.7. Sektori i Arsimit

Përmbledhje e Masave Kryesore të Ndërmarra

Kuadri ligjor që rregullon profesionin e mësuesit është i gjerë dhe i detajuar, duke mbuluar formimin universitar, praktikën profesionale, provimin e shtetit, certifikimin periodik dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Këto masa synojnë garantimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mbrojtjen e interesit publik. Megjithatë, analiza eidenton fragmentarizim të procedurave të aksesit në profesion dhe mungesë transparence të unifikuar mbi kriteret, dokumentacionin, afatet dhe mekanizmat e ankimit, veçanërisht për kandidatët jashtë sistemit kombëtar dhe për profesionistët me kualifikime të huaja. Transparenca vlerësohet mesatare, ndërsa proporcionaliteti i masave paraqitet i pjesshëm, për shkak të kombinimit kumulativ të kërkesave (diplomë, praktikë, provim dhe certifikim periodik) pa një analizë të dokumentuar të ndërveprimit të tyre.

Rezultati i pritshëm i masave të propozuara është rritja e qartësisë procedurale, ulja e barrës administrative dhe lehtësimi i mobilitetit profesional, duke ruajtur objektivin legjitim të cilësisë së arsimit.

Rekomandime për Përmirësime të Mëtejshme

Rekomandohet standardizimi dhe konsolidimi i informacionit publik për aksesin dhe ushtrimin e profesionit të mësuesit në një pikë të vetme reference (single entry point), që përfshin kriteret e kualifikimit, procedurat, afatet dhe rrugët e ankimit, si dhe zgjerimi i aplikimit elektronik për

licencim dhe certifikim, me afat T4/2027. Paralelisht, rekomandohet kryerja e një analize të posaçme proporcionaliteti për profesionet e arsimit, me synim rishikimin e kombinimit të kërkesave ex ante dhe eksplorimin e mekanizmave alternativë më pak kufizues (si forcimi i kontrollit ex post, mentorimi profesional ose certifikimi i bazuar në kompetenca), si dhe qartësimi i trajtimit të kualifikimeve të huaja, në përputhje me nenin 59 të Direktivës 2005/36/KE, me afat T4/2026. Këto ndërhyrje pritet të rrisin transparencën, të përmirësojnë proporcionalitetin e sistemit dhe të mbështesin një mobilitet profesional më funksional, pa cenuar standardet e cilësisë në arsim.

5.8. Sektori i Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Përmbledhje e masave kryesore të ndërmarra.

Analiza e profesioneve dhe veprimtarive në këtë sektor tregon një qasje të diferencuar rregullatore, të përshtatur sipas rrezikut dhe interesit publik që preket. Për udhërrëfyesit turistikë (turistik, kombëtar, lokal, i specializuar), sistemi i certifikimit të detyrueshëm, akreditimit të programeve të kualifikimit dhe regjistrimit në Regjistrin Qendror të Turizmit ka ndërtuar një kornizë funksionale që rrit profesionalizmin, ul informalitetin dhe forcon sigurinë juridike dhe besimin e publikut. Për kategorinë e udhërrëfyesit turistik të nderit, regjimi rezulton i kufizuar dhe i orientuar drejt dhënies së një statusi të posaçëm, pa krijuar barriera strukturore në treg dhe pa prodhuar kufizime tipike të një profesioni të rregulluar.

Për operatorin turistik, agjentin turistik/udhëtimi dhe nënfushat e lidhura (përfshirë shërbimet e turizmit detar, transportin turistik dhe shërbime të tjera të zinxhirit turistik), kuadri i licencimit dhe mbikëqyrjes ka kontribuar në formalizim, rritje të standardeve dhe mbrojtje të konsumatorit, por kërkon vlerësim periodik të proporcionalitetit të kërkesave dhe përmirësim të transparencës praktike në zbatim. Për vrojtuesin e plazhit, masat synojnë kryesisht mbrojtjen e jetës dhe shëndetit, me nevojë të evidentuar për qartësim dhe unifikim të praktikës administrative, në mënyrë që rregullimi të jetë i parashikueshëm dhe i zbatueshëm në terren, veçanërisht në kushte sezonaliteti dhe mobiliteti.

Në fushën e profesioneve kulturore krijuese (agjentë letrarë, art-grafistë, botues), kuadri ekzistues reflekton ndërhyrje minimale rregullatore: objektivat e interesit publik realizohen kryesisht përmes të drejtës së autorit, të drejtës civile dhe rregullave kontraktore, pa licencim apo certifikim të detyrueshëm, çka është proporcional me rrezikun e ulët publik të këtyre veprimtarive. Ndërkohë, për sektorin e konservimit, restaurimit dhe arkeologjisë, rregullimi i lartë dhe kontrolli paraprak justifikohen nga rreziku i dëmtimeve të pakthyeshme të trashëgimisë kulturore materiale; ky model mbron interesin publik, por shfaq hapësira për përmirësim në transparencë procedurale, standardizim dhe shmangie të mbivendosjeve administrative.

Rekomandime për përmirësime të mëtejshme

Për udhërrëfyesit turistikë rekomandohet ruajtja e sistemit aktual të certifikimit dhe regjistrimit, e shoqëruar me rishikim periodik të kurrikulave dhe kriterëve të kualifikimit, bazuar në zhvillimet e sektorit dhe kërkesën për specializime. Për të rritur transparencën procedurale dhe për të ulur

barrën administrative, rekomandohet standardizimi i dokumentacionit, publikimi i plotë i kriterëve dhe afateve të trajtimit, si dhe zgjerimi i aplikimit dhe komunikimit elektronik. Në plan afatmesëm, vlerësimi i efektit real të kërkesave aktuale të certifikimit duhet të përdoret për të identifikuar mundësi thjeshtimi ose fleksibilizimi, për atë që nuk preken standardet e sigurisë dhe cilësisë; për kategori të caktuara mund të shqyrtohen edhe skema plotësuese vullnetare, nëse rezultojnë të dobishme.

Për operatorët turistikë, agjentët turistikë/udhëtimi, transportuesit turistikë dhe shërbimet e turizmit detar rekomandohet vendosja e një cikli të rregullt vlerësimi të proporcionalitetit të kërkesave të licencimit dhe kushteve teknike, i mbështetur në të dhëna mbi ankesat e konsumatorëve, rezultatet e inspektimeve dhe funksionimin e tregut. Digjitalizimi i aplikimeve, rinovimeve dhe komunikimit me autoritetin kompetent duhet të trajtohet si prioritet praktik për transparencë dhe efikasitet, duke ruajtur njëkohësisht kontrollin e nevojshëm për mbrojtjen e konsumatorit. Për shërbimet ndërkufitare, rekomandohet qartësim i kushteve administrative dhe i ndërveprimit me operatorë të huaj, në mënyrë që kuadri të jetë i parashikueshëm, jo-diskriminues dhe i justifikuar nga objektiva të interesit të përgjithshëm.

Për vrojtuesin e plazhit rekomandohet unifikimi i kriterëve, procedurave dhe përgjegjësiwe institucionale në praktikë, duke siguruar standarde të qarta të aftësisë dhe mekanizma të zbatueshëm monitorimi gjatë sezonit. Duhet të përmirësohet aksesueshmëria e informacionit për kushtet e ushtrimit të veprimtarisë dhe të harmonizohen kërkesat e trajnimit me praktikat më të mira evropiane, për atë që kjo është e aplikueshme në realitetin shqiptar dhe pa krijuar kufizime të panevojshme për hyrjen në veprimtari.

Për profesionet kulturore krijuese rekomandohet ruajtja e modelit të ndërhyrjes minimale rregullatore, duke shmangur vendosjen e kërkesave formale për akses në treg që do të krijojnë barriera artificiale pa përfitim të qartë publik. Përmirësimet më të dobishme në këtë nënsektor lidhen me masa mbështetëse jo-detyrimore: rritje e informimit mbi të drejtat dhe detyrimet kontraktore, promovim i praktikave të mira dhe forcim i mekanizmave të ndërgjegjësimit për të drejtën e autorit.

Për konservimin, restaurimin dhe arkeologjinë rekomandohet ruajtja e kërkesave thelbësore për licencim dhe kontroll teknik, por me rritje të transparencës procedurale (kriterë, afate, standarde vlerësimi) dhe standardizim të praktikave për të gjithë nënprofesionet. Duhet të shqyrtohet reduktimi i mbivendosjeve ndërmjet autorizimit profesional dhe autorizimeve për ndërhyrje konkrete, në mënyrë që të rritet efikasiteti administrativ pa ulur nivelin e mbrojtjes së trashëgimisë. Njohja e kualifikimeve të huaja duhet të jetë e qartë, e gjurmueshme dhe e mbështetur në kriterë të harmonizuara, për të lehtësuar bashkëpunimin ndërkombëtar pa komprometuar standardet kombëtare. Në vijim, forcimi i kapaciteteve institucionale dhe i trajnimit të vazhdueshëm, si dhe përdorimi i teknologjive bashkëkohore në dokumentim dhe monitorim, duhet të trajtohen si komponentë të domosdoshëm për qëndrueshmërinë e reformës.

5.9. Sektori i Ekonomisë dhe Pronësisë Industriale

Përmbledhje e Masave Kryesore të Ndërmarra.

Masat e parashikuara synojnë eliminimin e barrierave administrative për profesionet zejtare dhe profesionet e pronësisë industriale, veçanërisht për shtetasit e BE-së, përmes digjitalizimit të procedurave dhe krijimit të një sistemi të integruar “one-stop-shop”. Ky proces pritet të reduktojë barrën burokratike të regjistrimeve të shumëfishta, të përshpejtojë njohjen e kualifikimeve të huaja dhe të garantojë ndarje të qartë ndërmjet veprimtarive të rregulluara dhe atyre të lira, duke forcuar transparencën dhe meritokracinë.

Në fushën e pronësisë industriale, masat kryesore përfshijnë heqjen e kërkesës për vendbanim të përhershëm për përfaqësuesit dhe ekspertët, si dhe digjitalizimin e plotë të procedurave pranë DPPI-së. Këto ndërhyrje synojnë eliminimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë ndaj profesionistëve nga BE dhe ZEE, lehtësimin e lirisë së ofrimit të shërbimeve dhe pasurimin e tregut shqiptar me ekspertizë të specializuar, duke e zhvendosur fokusin nga prania fizike të cilësia e shërbimit profesional.

Rekomandime për Përmirësime të Mëtejshme.

Rekomandohet zhvillimi i mekanizmave të standardizuar për vlerësimin e aftësive joformale të zejtarëve, përmes portofolave digjitalë dhe testeve praktike të certifikuara, si dhe rritja e transparencës përmes udhëzuesve online dhe rishikimeve periodike të kuadrit ligjor, me qëllim garantimin e një proporcionaliteti real ndërmjet cilësisë së shërbimit dhe aksesit në treg.

Në sektorin e pronësisë industriale, prioritet mbetet konsolidimi i një platforme digjitale të avancuar për DPPI-në, që integron aplikimet elektronike, nënshkrimin elektronik dhe arkivat cloud, duke mundur funksionimin në distancë të përfaqësuesve dhe ekspertëve. Kalimi drejt një regjistri të digjitalizuar dhe të hapur për profesionistët e BE-së pritet të rrisë transparencën, të shkurtojë afatet e shqyrtimit dhe të krijojë një mjedis konkurrues të bazuar në meritë, duke forcuar integrimin e Shqipërisë në tregun unik evropian.

5.10. Sektori i Finacave

Përmbledhje e Masave Kryesore të Ndërmarra

Masat e parashikuara për profesionin e agjentit doganor synojnë heqjen e kërkesës për shtetësi shqiptare dhe hapjen e profesionit për shtetasit dhe subjektet nga BE dhe ZEE, duke eliminuar një barrierë thelbësore për lirinë e ofrimit të shërbimeve dhe integrimin e ekspertizës ndërkombëtare. Paralelisht, digjitalizimi i plotë i procesit të autorizimit dhe operimit pritet të zhvendosë fokusin nga kriteret formale të vendbanimit drejt verifikimit elektronik të kualifikimeve dhe kompetencave profesionale, duke mundur një proces më të shpejtë, transparent dhe konkurrues në sektorin doganor.

Në lidhje me profesionin e audituesit ligjor, masat synojnë forcimin e proporcionalitetit të kërkesave për akses në profesion, veçanërisht në raport me praktikën profesionale. Harmonizimi i mënyrës së organizimit dhe njohjes së praktikës, përfshirë mundësinë e realizimit të saj në

struktura të akredituara edhe jashtë vendit, pritet të lehtësojë mobilitetin profesional dhe të shmangë kufizimet e panevojshme për kandidatët nga BE, pa cenuar standardet e cilësisë dhe mbikëqyrjes publike.

Rekomandime për Përmirësime të Mëtejshme.

Rekomandohet konsolidimi i një platforme digjitale të unifikuar për licencimin dhe mbikëqyrjen e agjentëve doganorë, e ndërfaqur me sistemet elektronike ekzistuese, me qëllim verifikimin në kohë reale të kualifikimeve dhe përdorimin e nënshkrimit elektronik si element kyç i autorizimit. Ky zhvillim do të reduktojë barrën administrative dhe do të sigurojë zbatim efektiv të hapjes së tregut për profesionistët e BE-së.

Për audituesit ligjorë, rekomandohet qartësimi dhe standardizimi i rregullave mbi praktikën profesionale, duke garantuar njohjen e praktikës së kryer në juridiksione të tjera të BE-së dhe duke shmangur kërkesat territoriale joproporcionale. Këto masa do të kontribuojnë në rritjen e transparencës, forcimin e konkurrencës profesionale dhe përputhjen më të plotë me acquis të Bashkimit Evropian, duke ruajtur njëkohësisht integritetin dhe besueshmërinë e sistemit të auditimit.

5.11. Sektori i Sigurimeve

Përmbledhje e Masave Kryesore të Ndërmarra

Kuadri rregullator për profesionet e aktuarit, vlerësuesit të dëmeve, agjentit të sigurimeve (jetë dhe jo-jetë) dhe brokerit në sigurime, i ndërtuar mbi Ligjin nr. 52/2014 dhe aktet përkatëse nënligjore, siguron një regjim të qartë licencimi, kriteret përshatshmërie dhe mbikëqyrje të vazhdueshme nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Masat ekzistuese janë të justifikuara, jo diskriminuese dhe të lidhura drejtpërdrejt me mbrojtjen e konsumatorit dhe stabilitetin financiar, duke reflektuar një treg tashmë të mirë-rregulluar. Korniza ligjore është në përputhje me nenin 59, ndërsa pranimi i kualifikimeve nga BE dhe njohja e përvojës profesionale të fituar jashtë vendit nuk përjashtohen, por aktualisht nuk janë të shprehura në mënyrë eksplicite. Rezultati i pritshëm i masave të propozuara është rritja e sigurisë juridike dhe lehtësimi i aksesit në profesion për profesionistët e huaj, pa ulur nivelin ekzistues të mbrojtjes së konsumatorit.

Rekomandime për Përmirësime të Mëtejshme

Rekomandohet një ndërhyrje e kufizuar dhe teknike në kuadrin ligjor, përmes shtimit të një reference eksplicite për njohjen e kualifikimeve të BE-së dhe përvojës profesionale të fituar jashtë vendit, me qëllim rritjen e transparencës dhe parashikueshmërisë për aplikantët. Duke qenë se sektori i sigurimeve përbën një treg të mirë-rregulluar, krijimi i barrierave artificiale për hyrjen e profesionistëve të kualifikuar nuk rezulton i nevojshëm. Përkundrazi, një qartësim i tillë do të nxisë konkurrencë të shëndoshë dhe do të përmirësojë funksionimin e tregut, duke ruajtur njëkohësisht standardet e mbikëqyrjes financiare.



Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



PLANI KOMBETAR I VEPRIMIT

Tabela e Masave

Tabela e Masave përmbledh në mënyrë të strukturuar rezultatet e Instrumenteve 1, 2 dhe 3 të vlerësimit të transparencës dhe proporcionalitetit, duke i përkthyer gjetjet e shqyrtimit të transparencës, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit në veprime konkrete për çdo profesion të rregulluar dhe çdo rregullator. Ajo pasqyron kufizimet ekzistuese, vlerësimin e tyre kundrejt nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE dhe nenit 51 TFBE, ndërhyrjet e nevojshme (ruajtje, rishikim ose shfuqizim), si dhe afatet për miratim dhe hyrje në fuqi.

Tabela shërben si instrumenti kryesor operacional i Planit Kombëtar të Veprimit, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë institucionale dhe hapat e nevojshëm për arritjen e përputhshmërisë me acquis.

Plani i masave – Sektori i Drejtësisë

Rregullatori				MINISTRIA E DREJTËSISË DHOMA KOMBËTARE E AVOKATISË			
Sektori i shërbimeve profesionale				Avokatia			
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor) apo praktika administrative	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1.	Avokat	Ligji nr. 55/2018 "Për profesionin e avokatit" (FZ 123/18) Vendimi i DHKA nr. 31/2005 "Kodi Etik i Avokatit"	Kushti që avokati i huaj të dëshmojë zotërimin e gjuhës shqipe dhe kërkesa për bashkëpunim të detyrueshëm me një studio avokatie shqiptare përpara	Kërkesa për zotërimin e gjuhës shqipe mund të jetë e justifikuar për shkak të natyrës së profesionit dhe domosdoshmërisë për të garantuar cilësinë e përfaqësimit dhe mbrojtjen e të drejtave të klientëve dhe palëve gjyqësore. Megjithatë, mënyra aktuale e	– Përcaktimi i qartë i kërkesës për gjuhë, duke specifikuar nivelin minimal të nevojshëm për ushtrimin e profesionit (p.sh., niveli B2/C1 juridik ose standard i	T4/2027	Hyrja në fuqi e ndryshimit në ditën e anëtarësimit në BE. Kërkohe harmonizim ndërmjet Ligjit, Statutit, Kodit të Etikës dhe rregulloreve të provimit për të garantuar

		Vendimi i DHKA "Për Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë" Rregullorja "Për provimin e avokatisë"	ushtrimit të pavarur të profesionit. Parashikuar sipas: Ligjit nr. 55/2018 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", neni 13 pika 3 dhe neni 23.	zbatimit të kërkesës nuk përcakton nivelin e kompetencës gjuhësore, format e vlerësimit, përjashtimet ose alternativat, duke krijuar pasiguri juridike dhe rrezik disproportionaliteti. Po ashtu, kërkesa për bashkëpunim të detyrueshëm me një studio avokatie shqiptare para ushtrimit të pavarur mund të jetë më kufizuese sesa kërkohet për të arritur të njëjtin objektiv publik (p.sh. provim kompensues në të drejtën e brendshme ose periudhë mbikëqyrjeje të kufizuar dhe të përcaktuar qartë). Në formën aktuale, të dyja kërkesat kërkojnë saktësim për të përmbushur kriteret e domosdoshmërisë, transparencës dhe proporcionalitetit sipas nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE.	ngjashëm) dhe format e vlerësimit. – Zëvendësimi i kërkesës për bashkëpunim të detyrueshëm me studio vendase me mekanizma më pak kufizues dhe të matshëm, si provim kompensues, praktikë e drejtëpërdrejtë e mbikëqyrur me afat të përcaktuar ose vlerësim të njohurive në të drejtën shqiptare. Të unifikohet Kodi Etikës me ligjin përse i përket njohjes së ushtrimit të së drejtës së ushtrimit të profesionit avokatit të huaj.		standarde të unifikuara për avokatët e huaj dhe mënyrën e vlerësimit të kompetencës profesionale dhe gjuhësore, duke shmangur trajtimin e pabarabartë të aplikantëve vendas dhe atyre nga BE Duhet të transpozohen Direktivat 98/5/EC dhe 77/249/EEC
2.	Avokat	Ligji nr. 55/2018, neni 15 (2) (4)	Miratimi paraprak i detyrueshëm nga Dhoma e Avokatisë për krijimin e një studioje avokatie dhe mungesa e procedurave të qarta, transparente dhe të aksesueshme lidhur me kriteret, afatet dhe mjetet e ankimit.	Masat që synojnë mbrojtjen e pavarësisë profesionale dhe kontrollin etik mund të jenë të justifikueshme. Megjithatë, mungesa e rregullave të qarta dhe e kriterëve objektive krijojnë rrezik të disproportionalitetit dhe pasigurie juridike, duke cenuar parimet e transparencës, parashikueshmërisë dhe mosdiskriminimit.	Përmirësimi i dispozitës duke përcaktuar kriteret të qarta, afate procedurale, mekanizëm ankimi dhe vendim të heshtur pozitiv. Harmonizim me Statutin dhe Kodin Etik për të shmangur kufizime të	T4/2027	Hyrja në fuqi e ndryshimit në ditën e anëtarësimit në BE. Kërkohet harmonizim ndërmjet Dhomës së Avokatisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe rregulloreve ekzistuese për të garantuar standarde të unifikuara

					panevojshme ose kontradiktore.		dhe zbatim të njëtrajtshëm.
3.	Avokat	Ligji nr. 55/2018, neni 8, shkronja (f) dhe neni 15, pika 1, shkronja (ç).	Detyrimi për sigurimin profesional të avokatit është parashikuar në ligj, por kriteret, përmbajtja, mbulimi minimal, territori, përjashtimet dhe procedurat nuk janë të përcaktuara në akt nënligjor. Nuk parashikohet njohja e sigurimeve ekuivalente nga BE.	Detyrimi për sigurim profesional është i justifikuar për interes publik dhe i përputhshëm me parimin e domosdoshmërisë, duke mbrojtur klientët dhe palët e treta. Megjithatë, mungesa e standardeve të qarta, parametrave të mbulimit dhe njohjes së sigurimeve ekuivalente krijon mungesë transparence dhe rrezik të zbatimit të pabarabartë, duke mos përmbushur kriteret e nenit 59 (qartësi, proporcionalitet, akses publik dhe parashikueshmëri).	Hartimi dhe miratimi i një akti nënligjor (akt ose rregullore e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë) që përcakton qartë: – mbulimin minimal të sigurimit; – territorin e vlefshmërisë; – kategoritë e rrezeve të mbuluara; – përjashtimet e lejuara; – njohjen e sigurimeve të barasvlefshme nga BE/EEA sipas kriterëve objektive të përcaktuara në ligj ose statut.	T4/2027	Hyrja në fuqi e ndryshimit në ditën e anëtarësimit në BE. Kërkohej akt nga Dhoma e Avokatisë për definimin e modelit të sigurimit dhe publikimin e tij në mënyrë të aksesueshme për kandidatët vendas dhe të BE-së, duke siguruar zbatim të njëtrajtshëm të detyrimit. Statuti I DHKA duhet përshtatur me ligjin nr. 55/2028.

Rregullatori			MINISTRIA E DREJTËS DHOMA KOMBËTARE E NOTERËVE				
Sektori i shërbimeve profesionale			Noteria				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor) apo praktika administrative	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1.	Noter	Ligji nr. 110/2018 “Për noterinë” (FZ 16/18, 25/22)	Kërkesa për shtetësi shqiptare si kusht për licencim dhe	Kufizimi është diskriminues dhe nuk është i justifikueshëm me interes publik në kuptimin e së drejtës së BE-së. Jurisprudenca	Hegja e kërkesës për shtetësi dhe zëvendësimi me kriterë objektive dhe	T4/2027	Hyrja në fuqi e ndryshimit në ditën e anëtarësimit në BE.

		Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 444/2019 “Për miratimin e Kodit të Etikës Profesionale të Noterit” (FZ 142/19) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 445/2019 “Për miratimin e Statutit të Dhomës Kombëtare të Noterisë” (FZ 142/19) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 260/2020 “Për miratimin e rregullave në lidhje me kushtet e përgjithshme për statusin e zëvendësnoterit dhe kushtet kontraktuale të detyrueshme për kontratën e punës së zëvendësnoterit” (FZ 149/20) Rregullorja nr. 344/2020 “Për programin e detyrueshëm të formimit vazhdues për noterë” (FZ 187/20) Rregullorja nr. 345/2020 “Për funksionimin e Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve (QSHTN)” (FZ 187/20)	ushtrim të profesionit. Ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, neni 5, shkronja (a).	e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së ka konfirmuar që noteria nuk përbën përjashtim nga liria e themelimit dhe kërkesa e shtetësisë është e ndaluar. Masa nuk është proporcionale dhe bie ndesh me nenin 59 të Direktivës 2005/36..	proporcionale (provim, gjuhë, sigurim profesional, etikë).		Kërkohet riformulim i akteve nënligjore dhe procedurave të licencimit për të parashikuar mekanizëm të qartë të njohjes së kualifikimeve të BE-së sipas Direktivës 2005/36/KE dhe masave kompensuese.
2.	Noter	Nenet 10-15 të ligjit për Noterine 110/2018	Sistemi i numerus	Sistemi i numrit të mbyllur mund të jetë teorikisht i	Vendosja e rregullave të qarta	T4/2027	Kërkohet konsultim i strukturuar me

			clausus , ku hyrja në profesion varet nga ekzistenca e vendeve të lira dhe jo thjesht nga përmbushja e kriterëve profesionale	justifikueshëm, nëse shërben për interes publik (p.sh. siguri juridike, qasje territoriale e barabartë). Megjithatë, aktualisht mungojnë kriterë të qarta, të parashikueshme dhe transparente për përcaktimin e numrit dhe shpërndarjes territoriale, duke e bërë masën potencialisht joproporcionale sipas nenit 59 (domosdoshmëri, proporcionalitet, mosdiskriminim)	dhe të matshme për: metodologjinë e llogaritjes së numrit të noterëve; shpërndarjen territoriale; rishikimin periodik; shpalljen e konkurseve të hapura të bazuara vetëm në meritë.		Dhomën e Noterëve dhe analiza periodike e tregut dhe e ngarkesës së punës.
3.	Noter	Neni 65 I ligjit nr 110/2018. Urdhër I Ministrit të Drejtësisë Nr. 191, datë 29.3.2021 "Për përcaktimin e shumës minimale të mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar dhe shumës minimale të tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje" FZ 53/2021	Sigurim i detyrueshëm profesional (model i paqartë, vlera dhe kushtet jo plotësisht të specifikuar dhe jo të aksesueshme paraprakisht)	Kërkesa është e justifikueshme për interes publik, por mungesa e transparencës dhe parametrave teknikë të qartë e bën masën potencialisht joproporcionale dhe jo të parashikueshme. Ndërkohë që sigurimi i detyrueshëm profesional është masë e ligjshme dhe e justifikuar për shkak të natyrës publike të funksionit noterial, mungojnë rregulla të detajuara dhe të publikuara paraprakisht për mbulimin minimal, territorin, njohjen e sigurimeve të huaja dhe kushtet e aplikimit, çka krijon paqartësi procedurale dhe potencialisht cenon parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe parashikueshmërisë sipas nenit 59 të Direktivës 2005/36.	Miratimi i një akti nënligjor me standarde të qarta: vlera minimale, llojet e ngjarjeve, territor mbulimi, njohja e sigurimeve BE/EEA, afate dhe transparencë procedurale, në bazë edhe të nenit 65(6) të ligjit nr 110/2018.	T4/2027	Nevojitet koordinim MoJ – Dhoma e Noterëve dhe publikim i detajeve të sigurimit, përcaktimi i qartë i përgjegjësisë profesionale.

Rregullatori			MINISTRIA E DREJTËSISË DHOMA KOMBËTARE E NDËRMJETËSVE				
Sektori i shërbimeve profesionale			Ndërmjetësimi				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor) apo praktika administrative	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1.	Ndërmjetës	Ligji nr. 10 385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, I ndryshuar (FZ 25/11, 85/18) VKM nr. 414/2011 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve” (FZ 87/11) VKM nr. 418/11 “Për procedurën e heqjes së licencës së ndërmjetësit” (FZ 87/11) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 267/2020 “Për rregullat dhe procedurat për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në një shtet të huaj” (FZ 149/20)	Kriteri i shtetësisë shqiptare; Neni 5 (1) Neni 5(2) dhe germa (e) e pikës (2) të Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 90/2021 “Për miratimin e Rregullores së provimit të kualifikimit për profesionin e ndërmjetësit” (FZ 32/21)	Dispozita aktuale parashikon që vetëm shtetasi shqiptar mund të licencohet si ndërmjetës, ndërsa shtetasi e huaj parashikohen vetëm nëse janë tashmë të licencuar në vendin e origjinës. Kjo krijon një trajtim të pabarabartë, pasi një shtetas i BE-së që dëshiron të japë provimin dhe të licencohet në Shqipëri nuk ka të njëjtën mundësi si një shtetas shqiptar. Kufizimi nuk është i justifikuar dhe bie në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit dhe lirisë së ushtrimit të profesionit, siç kërkohet nga neni 59 i Direktivës 2005/36/KE. Gjithashtu, kërkesa shtesë për të provuar ndjekjen e një programi trajnimi, edhe kur ndërmjetësi i	Kërkohet rishikimi i dispozitës aktuale për të lejuar që edhe shtetasi e BE-së të kenë të njëjtën mundësi si shtetasi shqiptarë për të dhënë provimin dhe për t'u licencuar në Shqipëri, në përputhje me parimin e mosdiskriminimit. Gjithashtu, kërkohet heqja e kërkesës automatike për trajnim shtesë për ndërmjetësit e huaj të licencuar, duke e parashikuar atë vetëm si masë kompensuese kur vërtetohet mungesë reale e kompetencave, në përputhje me parimin e proporcionalitetit sipas nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE.	T4/2027	Rekomandohet forcimi i koordinimit ndërinstitucional midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve për harmonizimin e standardeve të licencimit, procedurave të njohjes së kualifikimeve të huaja dhe zbatimit të masave kompensuese. Kjo do të sigurojë zbatim të njëtrajtshëm të kërkesave ligjore, transparencë të procesit dhe shmangie të interpretimit të ndryshëm ose praktikave administrative të pabarabarta, veçanërisht në rastet e aplikimit nga shtetasi e BE-së.

	Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 268/2020 “Për formën, përmbajtjen dhe rregullat e administrimit të regjistrimit të ndërmjetësve dhe të dosjes personale të ndërmjetësit” (FZ 149/20) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 89/2021 “Për trajnimin fillestar dhe të vazhduar të ndërmjetësve” (FZ 32/21) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 90/2021 “Për miratimin e Rregullores së provimit të kualifikimit për profesionin e ndërmjetësit” (FZ 32/21) Statuti I Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve. Shtojca 1 Statuti DHKN-së: Rregullorja Bordi Disiplinor Vendimi i DHKN nr. 10/2013 “Kodi i Etikës iNdërmjetësit” Vendimi i DHKN 2018 “Manuali për tarifat e	huaj mban një licencë të vlefshme në vendin e origjinës, paraqet rrezik disproporcionaliteti. Licenca ekzistuese tashmë demonstroi kompetencë profesionale, ndaj kërkesa për trajnim shtesë nuk është domosdoshmërisht e nevojshme dhe mund të përbëjë barrë administrative të panevojshme. Përputhshmëria me kërkesat e transparencës dhe proporcionalitetit kërkon që: – kriteret e licencimit të jenë të qarta, të aksesueshme dhe të aplikohen njëtrajtshëm për shtetas vendas dhe të BE-së; – masat shtesë (trajnim, provim, kompensim aftësish) të kërkojnë vetëm nëse ekziston diferencë objektive dhe e dokumentuar në standardet e formimit. Për rrjedhojë, kërkesa aktuale rekomandohet të rishikohet për të shmangur diskriminimin e pajustificuar dhe për të	Në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 267/2020 “Për rregullat dhe procedurat për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në një shtet të huaj” (FZ 149/20) duhen përcaktuar qartë procedurat e ankimit dhe afatet si dhe procedurat elektronike.
--	---	--	--

		shpërblimit të ndërmjetësve"		siguruar proporcionalitet në përputhje me nenin 59 të Direktivës 2005/36/KE.			
2.	Ndërmjetës	Ligji për Ndërmjetësimin, neni 5 (1)(b)	Kërkesa për moshë minimale (28 vjeç) për licencim. kërkesa e nenit 5, pika 1, shkronja (b) i Ligjit për Ndërmjetësimin; VKM për Komisionin e Licencimit të Ndërmjetësve;(III. 1b)	Kriteri i moshës nuk lidhet drejtpërdrejt me kompetencën profesionale dhe nuk është i domosdoshëm për sigurimin e integritetit të profesionit. Kufizimi është potencialisht diskriminues dhe nuk justifikohet nga një arsye madhore interesi publik, duke rënë ndesh me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të kërkuara nga neni 59 i Direktivës 2005/36/KE.	Heqja e kërkesës për moshë minimale dhe orientimi i vlerësimit te kriteret profesionale (formim, provim, etikë), vetëm nëse ato janë të nevojshme dhe proporcionale, sipas kërkesave të nenit 59 të Direktivës 2005/36/KE.	T4/2027	Forcim koordinimi midis MD dhe DHNK.
3.	Ndërmjetës	Ligji për Ndërmjetësimin, neni 5, pika 3 dhe 4.	Kërkesa për diplomë të preferuar sipas fushës (psikolog, jurist ose punonjës social për çështjet e miturve; jurist, ekonomist ose inxhinier për çështjet tregtare).	Të përshtaten aktet nënligjore për të saktësuar se çdo diplomë e ciklit të dytë, e njohur nga legjislati i arsimit të lartë, është e vlefshme për licencimin si ndërmjetës. Formulimi aktual krijon paqartësi dhe potencial diskriminimi të pajustificuar, në kundërshtim me nenin 59 të Direktivës 2005/36/KE, i cili kërkon që kërkesat profesionale të jenë të	Përmirësimi i formulimit duke përcaktuar qartë se të gjitha diplomat e ciklit të dytë janë të vlefshme, ndërsa profili akademik i veçantë mund të kërkohej vetëm kur justifikohet nga dallime reale të kompetencës dhe vetëm si masë proporcionale. Formulimi "mundësisht" duhet zëvendësuar me kriter objektiv dhe të	T4/2027	Rekomandohet harmonizim praktik mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve për interpretimin dhe zbatimin uniform të kërkesave, për të shmangur trajtimin e pabarabartë të kandidatëve vendas dhe të BE-së.

				domosdoshme, proporcionale dhe jo-diskriminuese. Saktësimi siguron transparencë, qartësi dhe zbatim të njëtrajtshëm të procedurës së licencimit.	matshëm ose hiqet nëse rezulton i panevojshëm.		
4.	Ndërmjetës	Ligji për Ndërmjetësimin, neni 6, pika ç) dhe d).	Revokimi automatik i licencës kur ndërmjetësi nuk ushtron aktivitetin për 2 vite të njëpasnjëshme.	Masa nuk lidhet drejtpërdrejt me kompetencën profesionale dhe është më kufizuese nga sa kërkohet për qëllime të interesit publik. Mungesa e përjashtimeve për raste si shtatzënia, kujdestaria familjare, paaftësia e përkohshme apo sëmundjet afatgjata krijon rrezik diskriminimi të tërthortë dhe nuk është në përputhje me parimet e domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit të kërkuara nga neni 59 i Direktivës 2005/36/KE. Gjithashtu, mungon një procedurë e qartë riaktivizimi, çka krijon pasiguri juridike.	Zëvendësimi i revokimit automatik me status “jo aktiv”, me të drejtë riaktivizimi nëpërmjet verifikimit administrativ dhe, vetëm nëse nevojitet, trajnimit rifreskues. Parashikimi i përjashtimeve të qarta ligjore për raste të justifikuara (p.sh., shtatzënia, lejet familjare, sëmundjet afatgjata, paaftësia e përkohshme).	T4/2027	Rekomandohet harmonizim mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve për krijimin e një procedure të njëtrajtshme të statusit “jo aktiv” dhe riaktivizimit, në mënyrë të aksesueshme dhe transparente.

Rregullatori	MINISTRIA E DREJTËSISË
--------------	------------------------

Sektori i shërbimeve profesionale			NDËRMJETËS TË PASURIVE TË PALUAJTSHME				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor) apo praktika administrative	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1.	Ndërmjetës të pasurive të paluajtshme	Ligji nr. 9/2022 "Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme" (FZ 29/22) VKM nr. 712/2016 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme" (FZ 195/16) Rregullorja nr. 184/2022 "Për programin e detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme" (FZ 80/22)	Kërkesë gjuhës e paqartë dhe potencialisht diskriminuese (neni 8, pika 2 e ligjit nr. 9/2022).	Jo plotësisht transparente dhe jo e standardizuar	Standardizim i kërkesës për gjuhën + njohje e certifikatave BE	T4/2027	Nevojë udhëzim i ri MD.

		Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 185/2022 “Për miratimin e Kodit të Etikës Profesionale të Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme” (FZ 80/22) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 187/2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme mbi paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme” (FZ 80/22) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 188/2022 “Për përcaktimin e rregullave të					
--	--	--	--	--	--	--	--

		hollësishme për paraqitjen e kërkesës për regjistrimin në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore” (FZ 80/22)					
2.	Ndërmjetës të pasurive të paluajtshme		Kërkesa për kontratë bashkëpunimi me një zyrë vendase dhe periudhë e detyrueshme 6-mujore për ushtrim të mbikëqyrur para marrjes së licencës së pavarur (Neni 11 I ligjit nr 9/2022 dhe Udhëzim nr. 7/2022 I Minsitrit të Drejtësisë)	Masat janë potencialisht të justifikueshme për garantimin e njohjes së tregut lokal, kornizës ligjore dhe interesave të konsumatorëve. Megjithatë, periudha fikse kohore dhe detyrimi për bashkëpunim vetëm me operatorë vendas mund të jetë joproporcional dhe jo fleksibël, nëse nuk ka kriter objektiv për përmbajtjen, vlerësimin ose zëvendësueshmërinë e eksperiencës — duke rrezikuar shkeljen e nenit 59 (proporcionalitet, domosdoshmëri, mosdiskriminim).	Thjeshtimi i procedurës duke kërkuar si alternative të periudhës fikse 6-mujore, opsione të barazvlefshme (p.sh. provim, portofol profesional, ose praktikë më të shkurtër të certifikuar), dhe heqja e detyrimit të bashkëpunimit vetëm me operator vendas, duke e bërë fakultativ dhe jo kusht absolut	T4/2027	Kërkohet metodologji e qartë për vlerësimin e aftësive, jo vetëm kusht formal kohor.
3.	Ndërmjetës të pasurive të paluajtshme	Neni 22 I ligjit nr. 9/2022	Mekanizmi disiplinor ekziston, por disa formulime janë të përgjithshme dhe mbështeten në	Në përputhje me nenin 59, masa është e justifikuar, proporcionale dhe e lidhur me interes publik; mund të përmirësohet	Nuk kërkohet ndryshim ligjor; rekomandohet manual procedural ose akt nënligjor për detajim praktik	T4/2017	Hyrje në fuqi me anëtarësimin në BE. Nevojitet manual procedural dhe

			interpretim administrativ	transparenca përmes udhëzimeve teknike.			publikimi transparent i procesit disiplinor për të garantuar trajtim të barabartë dhe siguri juridike për profesionistët dhe konsumatorët
--	--	--	------------------------------	--	--	--	---

Rregullatori			MINISTRIA E DREJTËSISË				
Sektori i shërbimeve profesionale			PERKTHYES ZYRTAR DHE INTERPRET I GJUHËS SË SHENJAVE				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor) apo praktika administrative	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1.	Përkthyes Zyrtar dhe Interpret i gjuhës së shenjave	Ligji nr. 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” (FZ 120/2021) VKM nr. 208/2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për përfitimin e mbrojtjes së veçantë të garantuar nga shteti për përkthyesit zyrtarë dhe interpretët e gjuhës së shenjave” (FZ 54/22) •Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8/2022 “Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për	Afat i shkurtër për aplikim për marrjen e certifikates pas testimit dhe sanksion automatik 5-vjeçar për mosplotësim afati (neni 17/3)	Masa është disproporcionale sepse penalizon qasje në profesion pa lidhje me cilësinë ose sigurinë profesionale	Adaptim: shtyrje e afatit dhe heqje e ndalimit 5- vjeçar; mekanizëm njoftimi zyrtar para skadimit	T4/2027	Ndryshim vetëm i paragrafit 3 të nenit 17 të ligjit nr. 82/2021.

		përfshirjen nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike” (FZ 114/22) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 166/2022 “Për formën, përmbajtjen dhe karakteristikat e tjera të vulës dhe rregullat për pajisjen dhe administrimin e tyre, si dhe formën e kartës së identifikimit të përkthyesit zyrtar dhe interpretit të gjuhës së shenjave” (FZ 87/22) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 167/2022 “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave” (FZ 69/22) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 168/2022 “Për miratimin e Kodit të Etikës së Përkthyesit Zyrtar” (FZ 69/22) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 169/2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisioneve disiplinore, për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prej tyre dhe për zhvillimin e procedimit disiplinor” (FZ 70/22) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.					
--	--	--	--	--	--	--	--

		189/2022 “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së deklaratës tip të nënshkruar prej përkthyesit zyrtar” (FZ 74/22) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 190/2022 “Për miratimin e listës së gjuhëve të huaja, të cilat përfshihen në shërbimin e përkthimit zyrtar” (FZ 74/22) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 191/2022 “Për përcaktimin e rregullave për mbajtjen e adresës së postës elektronike për përkthyesin zyrtar dhe interpretin e gjuhës së shenjave” (FZ 74/22) •Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 192/2022 “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisioneve të posaçme, tarifat për pjesëmarrje, organizimin e zhvillimit të provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, si dhe për procedurën e mënyrën e vlerësimit të provimeve” (FZ 74/22) Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 200/2022 “Për miratimin e formularit të ankesave ndaj përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhës së shenjave”(FZ 74/22)					
--	--	---	--	--	--	--	--

		Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë nr. 4/2022 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e përkohshëm" (FZ 70/22)					
--	--	--	--	--	--	--	--

Rregullatori			MINISTRIA E DREJTËSISË				
Sektori i shërbimeve profesionale			AGJENCIA KOMBËTARE E FALIMENTIMIT				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor) apo praktika administrative	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1.	Administrator i Falimentimit	Ligj nr. 110/2016 "Për falimentimin" (FZ 226/2016). VKM nr. 294, datë 17.5.2023 "Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave, për paraqitjen e kërkesave, për të vepruar si administrator në procedurat e falimentimit, si dhe procedurën për dhënien e heqjen e licencës" (FZ 77/2023). VKM nr. 543, datë 19.09.2018, "Për miratimin e Kodit të Etikës për administratorët	Kërkesa që kandidati të jetë shtetas shqiptar (neni 3 (a) VKM 294/2023).	Kërkesa për shtetësi është një kriter i ndaluar dhe nuk konsiderohet i domosdoshëm, proporcional apo objektiv sipas nenit 59 të Direktivës 2005/36/EC. Funkcioni nuk përfshin ushtrim të autoritetit publik në kuptimin e jurisprudencës së GJED dhe objektivat e interesit publik (besueshmëria, integriteti, përgjegjësi profesionale) mund të arrihen me masa më pak kufizuese.	Zëvendësimi i kërkesës "vetëm shtetas shqiptar" me formulën: "shtetas i Shqipërisë ose i një shteti anëtar të BE që plotëson kriteret profesionale të përcaktuara në legjislacion" dhe shtimi i një kërkesë të qartë për demonstrimin e njohjes së gjuhës shqipe vetëm për qëllime profesionale.	Deri në vitin 2027; hyrje në fuqi me anëtarësimin në BE.	Gjithshtu kërkohet harmonizim me njohjen e kualifikimeve profesionale me qëllim që ky profesion të mund të kryhet edhe nga qytetarë të BE-së.

		e falimentimit” (FZ 26/2013) VKM nr. 733, datë 13.11.2019, “Për miratimin e standardeve kombëtare të administrimit të masës së falimentimit” (FZ 155/2019) VKM nr. 705, datë 09.09.2020, “Për kriteret e caktimit të shpërblimit të administratorit të përkohshëm të falimentimit, rregullat për shpërblimin e administratorit të falimentimit si dhe kriteret dhe përlogaritja e shpërblimit të kujdestarit” (FZ 164/2020) VKM nr. 65, datë 03.02.2021, “Për miratimin e rregullores ‘Për marrëveshjet jashtëgjyqësore të riorganizimit të përsheptuar’” (FZ 19/2021) VKM nr. 542, datë 19.09.2018, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit” (FZ					
--	--	--	--	--	--	--	--

		138/2018 dhe FZ 77/2023) Urdhër nr. 375/1, datë 05.09.2012, "Për krijimin e regjistrit të administratorëve të certifikuar të falimentit" (FZ 129/2012) Urdhër nr. 89, datë 05.03.2012, "Për formën, përmbajtjen dhe rregullat e pajisjes me vulat e administratorëve të falimentimit" Urdhër nr. 4217/1, datë 25.06.2012, "Për miratimin e rregullores 'Për përcaktimin e rregullave të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit'" (FZ 80/2012) Urdhër nr. 53, datë 04.02.2021, "Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së deklaratës së ekspertit për marrjen dijeni për përgjegjësinë penale në rast ekspertimi të rremë" (FZ 22/2021) Regullore për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin					
--	--	--	--	--	--	--	--

		e funksioneve publike në Agjencinë Kombëtare të Falimentimit Urdhër nr. 26, datë 14.01.2014, "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e mbikëqyrjes dhe kontrollit të administratorëve të falimentimit"					
--	--	--	--	--	--	--	--

Plani i masave – Sektori i Punëve të Brendshme

Rregullatori			MINISTRIA E BRENDSHME				
Sektori i shërbimeve profesionale			SIGURIA PUBLIKE DHE MBROJTJA CIVILE				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor) apo praktika administrative	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Zjarrfikës (Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi)	Ligji nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" (FZ 240/2015) dhe aktet nënligjore përkatëse	Kriteri i shtetësisë shqiptare; kufizimi i formës së ushtrimit vetëm si funksion publik; kufizimi i moshës ≤ 30 vjeç; detyrimi për trajnim dhe provim pranë Akademisë së Sigurisë	Kërkesa për shtetësi është e justifikuar vetëm për funksionet komanduese dhe vendimmarrëse (neni 51 TFBE). Për funksionet ndihmëse/teknike, kriteri është disproporcional. Kufizimi i formës juridike si funksion publik është proporcional. Kufizimi i moshës mund të konsiderohet problematik në dritën e acquis mbi mosdiskriminimin në punësim.	Ndryshim i ligjit për të diferencuar nivelet e funksioneve: shtetësia të kërkohej vetëm për rolet që përfshijnë ushtrim autoriteti publik; për rolet teknike të hapet qasja edhe për profesionistë të huaj të certifikuar. Rishikim i kufizimit të moshës	T4/2027	Kërkon koordinim me reformën e administratës publike dhe me politikat e barazisë në punësim. Nevojë për trajnim dhe certifikim shpesh për

					sipas standardeve të BE-së.		profesionistët e huaj.
2	Punonjës i shërbimit privat të sigurisë fizike	Ligji nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike" (FZ 124/2014) dhe aktet nënligjore përkatëse	Kriteri i shtetësisë dhe banimit të përhershëm në Shqipëri; detyrimi për formë juridike vetëm shoqëri tregtare; detyrimi për regjistrim në QKB dhe Regjistrin Kombëtar të Licencave; sigurim i detyrueshëm i përgjegjësisë civile nga subjektet	Kufizimi i shtetësisë dhe banimit është disproporcional, në kundërshtim me nenin 59 të Direktivës 2005/36/KE dhe jurisprudencën e GjED. Forma e detyrueshme juridike dhe sigurimi i përgjegjësisë civile janë proporcionalë. Barrat administrative janë të justifikuara pjesërisht, por kërkojnë thjeshtim.	Ndryshim i ligjit për të hequr kriterin e shtetësisë dhe banimit të përhershëm; forcim i kriterëve të integritetit moral, verifikimit penal dhe trajnimit. Thjeshtim dhe dixhitalizim i procedurave të regjistrimit dhe licencimit.	T4/2027	Nevojë për konsultim të gjerë me operatorët privatë dhe me Policinë e Shtetit. Proces i ndjeshëm politikisht për shkak të perceptimit të sigurisë kombëtare.

Plani i masave – Sektori i Shëndetësisë dhe Kujdesit Social

Rregullatori			MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE				
Sektori i shërbimeve profesionale			SHËNDETËSIA DHE SHËRBIMET SOCIALE				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor) apo praktika administrative	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Mjek i përgjithshëm	Ligji nr. 123/2014; Ligji nr. 10107/2009; aktet nënligjore për provimin dhe regjistrimin	Nostrifikimi i gjatë i diplomave të huaja; provim shtetëror shtesë	Diskriminim i tërthortë; barrë administrative	Thjeshtim i nostrifikimit; heqje e provimit për titujt e njohur automatikisht sipas Direktivës 2005/36	T4/2026	Harmonizim me praktikën e BE-së
2	Mjek specialist	Ligji nr. 123/2014; VKM nr. 824/2021; Statuti i Urdhrit	Provimi shtetëror dhe praktikë shtesë edhe për profesionistët e huaj	Diskriminim i tërthortë; barrë administrative	Njohje e drejtpërdrejtë e diplomave të BE-së; reduktim i praktikës. Heqje e provimit për titujt e njohur	T4/2026	Rishikim me Urdhrin e Mjekëve

					automatikiht sipas Direktivës 2005/36		
3	Stomatolog & stomatolog i specializuar	Ligji nr. 127/2014; Ligji nr. 9928/2008	Nostrifikim dhe praktikë e detyrueshme vendase	Në përputhje, por me pengesa praktike	Thjeshtim i procedurave për shtetas BE. Heqje e provimit për titujt e njohur automatikiht sipas Direktivës 2005/36	T4/2026	Monitorim i praktikës së zbatimit
4	Farmacist	Ligji nr. 9150/2003; Ligji nr. 105/2014	Praktikë e detyrueshme vendase; kufizime në regjistrim	Në përputhje, por ka barrë procedurale	Lehtësim i procedurave; harmonizim i praktikës. Heqje e provimit për titujt e njohur automatikiht sipas Direktivës 2005/36	T4/2026	Rishikim i rregullores së Urdhrit
5	Infermier i përgjithshëm	Ligji nr. 9718/2007	Regjistrim dhe provim i detyrueshëm	Përputhje me Direktiven, por kufizime për të huajt	Njohje reciproke me BE; thjeshtim i procedurave.	T4/2026	Duhet monitoruar implementimi
6	Mami (pa specialitet)	Ligji nr. 9718/2007; rregulloret përkatëse	Provim shtetëror i detyrueshëm; kufizim në ushtrimin individual	Përputhje me standardet, por ka pengesa praktike	Thjeshtim i regjistrimit dhe provimit për BE. Heqje e provimit për titujt e njohur automatikiht sipas Direktivës 2005/36	T4/2026	Harmonizim i trajnimit minimal
7	Logoped	Ligji nr. 10107/2009; Ligji nr. 15/2016	Nostrifikim dhe provim shtetëror	Barrë administrative e panevojshme	Përafrim i kushteve me BE; thjeshtim i nostrifikimit.	T4/2027	Kërkon zhvillim standardesh kombëtare
8	Teknik laborator	Ligji nr. 10107/2009; Ligji nr. 15/2016	Praktikë e detyrueshme vendase	Në përputhje pjesërisht; pengesë për lëvizshmërinë	Pranimi i praktikave të huaja; lehtësim licencimi.	T4/2027	Standardizim më i plotë i trajnimit
9	Teknik imazherie	Ligji nr. 10107/2009; Ligji nr. 15/2016	Praktikë e detyrueshme vendase; provim shtetëror	Në përputhje pjesërisht; kufizime për të huajt	Harmonizim i njohjes së diplomave; lehtësim	T4/2027	Përputhje më e qartë me acquis
10	Fizioterapist	Ligji nr. 10107/2009; Ligji nr. 15/2016	Praktikë dhe provim i detyrueshëm	Në përputhje pjesërisht; mbart barrë	Thjeshtim i njohjes; përputhje me BE	T4/2027	Nevojë për rishikim të standardeve

11	Psikolog	Ligji nr. 40/2016; rregulloret e Urdhrit	Praktikë 1-vjeçare; provim shtetëror; licencim i ngurtë	Diskriminim i tërthortë për të huajt	Thjeshtim i procedurës për profesionistët BE	T4/2027	Rishikim i procedurës së licencimit
12	Punonjës social	Ligji nr. 163/2014; Ligji nr. 121/2016	Praktikë dhe provim shtetëror	Në përputhje pjesërisht; kufizim për të huajt	Thjeshtim i licencimit; përputhje me BE.	T4/2027	Harmonizim i praktikave me BE
13	Kujdestar për fëmijë	Ligji nr. 121/2016; aktet nënligjore	Trajnim i gjatë dhe certifikim i detyrueshëm	Përputhje pjesërisht; procedura të rënda	Lehtësim i certifikimit; standarde unike.	T4/2027	Nevojë për standardizim minimal
14	Kujdestar i personave me aftësi të kufizuara	Ligji nr. 121/2016	Trajnim dhe certifikim i detyrueshëm	Përputhje pjesërisht; barrë procedurale	Lehtësim i procedurave; harmonizim gradual.	T4/2027	Fokus në mbrojtjen sociale

Plani i masave – Sektori i Veterinarisë

Rregullatori			MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL				
Sektori i shërbimeve profesionale			VETERIANARI				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor) apo praktika administrative	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Mjek veterinar	Ligji nr. 10171/2010 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (FZ 154/09, 174/10, 146/11, 126/14), shkronja "e", e pikës 1, të nenit 5.	Të drejtën e ushtrimit të profesionit të mjekut veterinar në Republikën e Shqipërisë e gëzojnë personat fizikë, shqiptarë ose të huaj, që janë diplomuar si mjekë veterinarë nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare i Universitetit Bujqësor të Tiranës, çdo fakultet tjetër i mjekësisë	Kërkesa për njohjen e diplomës së huaj nga autoritetet shqiptare mund të sjellë efekte indirekte diskriminuese për profesionistët e huaj.	Të rishikohet detyrimi i njohjes së diplomës së huaj, e parashikuar në nenin 5, të ligjit nr. 113/2015 "Për urdhrin profesional të mjekut veterinar", në mënyrë që të mos pengohet ushtrimi i profesionit. Të adoptohen procedura të	T4/2027	Rekomandohet digjitalizimi i mëtejshëm i procedurave dhe krijimi i një platforme të përbashkët digjitale që lidh autoritetet veterinarë me ato farmaceutike. Ky integrim do të mundësonte një monitorim më të mirë të recetave veterinarë dhe përdorimit të barnave, duke shmangur kontrollet e

		Ligji nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (FZ 143/11, 31/13, 119/20, 29/22, 192/24, 191/24, 122/25)	veterinare, i themeluar dhe njohur sipas ligjeve në fuqi, ose nga universitete të huaja, diploma e të cilave u është nënshtruar procedurave të njohjes nga ministria përgjegjëse për arsimin në Republikën e Shqipërisë, kanë përfunduar me sukses provimin e shtetit, si dhe janë të regjistruar në Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar.		përsheptuara për diplomat e lëshuara nga institucionet e akredituara të BE-së, duke minimizuar dokumentacionin e tepërt dhe duke ofruar udhëzues të qartë në gjuhë të huaja, me qëllim që të evitohet çdo formë diskriminimi që buron nga burokracia.		dyfishta që rëndojnë subjektet private.
2	Farmacist veterinar	Ligji nr. 113/2015 "Për urdhrin profesional të mjekut veterinar" (FZ 186/15) Ligji nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (FZ 143/11, 31/13, 119/20, 29/22, 192/24, 191/24, 122/25)	Për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit çdo kandidat duhet të jetë diplomuar në mjekësi veterinare, me një titull apo kualifikim zyrtar, të njësuar me diplomën apo kualifikimin zyrtar, në fushën përkatëse, në Shqipëri, të kalojë provimin shtetëror, sipas përcaktimeve të ligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë, të jetë shtetas shqiptar ose shtetas i huaj, i cili ka të drejtë ligjore, për të punuar në Shqipëri, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së	Kërkesa për njohjen e diplomës së huaj nga autoritetet shqiptare mund të sjellë efekte indirekte diskriminuese për profesionistët e huaj.	Të rishikohet detyrimi i njohjes së diplomës së huaj, e parashikuar në nenin 5, të ligjit nr. 113/2015 "Për urdhrin profesional të mjekut veterinar", në mënyrë që të mos pengohet ushtrimi i profesionit. Të adoptohen procedura të përsheptuara për diplomat e lëshuara nga institucionet e akredituara të BE-së, duke minimizuar dokumentacionin e tepërt dhe duke ofruar udhëzues të qartë në gjuhë të huaja, me	T4/2027	Rekomandohet forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional midis farmacistëve veterinarë dhe autoriteteve inspektuese. Një sistem i integruar i recetës elektronike do të shërbente si një urë lidhëse që redukton mbivendosjen rregullatore dhe rrit transparencën në terren. Edukimi i vazhdueshëm i farmacistëve duhet të synojë përditësimin me listat e fundit të barnave të lejuara në BE, duke garantuar që roli i tyre të

			prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, në momentin e kërkesës për anëtarësim, të njohë dhe të zotohet me shkrim se do të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi për shërbimin veterinar, statutin e Urdhrit dhe Kodin e Etikës së Mjekut Veterinar.		qëllim që të evitohet çdo formë diskriminimi që buron nga burokracia.		mos jetë thjesht tregtar, por një shtyllë e rëndësishme e shëndetit publik brenda konceptit "One Health", i cili lidh shëndetin e kafshëve me atë të njerëzve dhe mjedisit.
3	Teknik veterinar	Ligji nr. 113/2015 "Për urdhrin profesional të mjekut veterinar" (FZ 186/15)	Për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit teknikët veterinarë, duhet të jenë diplomuar në arsimin parauniversitar në shkollat e mesme profesionale veterinare të njohura nga ministra përgjegjëse për arsimin profesional, ose të ketë mbaruar ciklin 2-vjeçar për "Menaxhim veterinar". Tekniku veterinar e ushtron profesionin pasi regjistrohet në regjistrin e veçantë të Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar.	Kërkesa për njohjen e diplomës së huaj nga autoritetet shqiptare mund të sjellë efekte indirekte diskriminuese për profesionistët e huaj.	ë rishikohet detyrimi i njohjes së diplomës së huaj, e parashikuar në nenin 5, të ligjit nr. 113/2015 "Për urdhrin profesional të mjekut veterinar", në mënyrë që të mos pengohet ushtrimi i profesionit. Të adoptohen procedura të përsheptuara për diplomat e lëshuara nga institucionet e akredituara të BE-së, duke minimizuar dokumentacionin e tepërt dhe duke ofruar udhëzues të qartë në gjuhë të huaja, me qëllim që të evitohet çdo	T4/227	Rekomandohet kalimi i procedurave të njohjes së kualifikimeve profesionale në një platformë online do të reduktonte diskriminimin indirekt që buron nga vonesat burokratike, duke krijuar një mjedis transparent ku ekuivalentimi i titujve kryhet mbi kritere të qarta teknike. Përmes një regjistri digjital të unifikuar, kompetencat e teknikëve mund të verifikohen në kohë reale, duke siguruar që lëvizshmëria e tyre brenda tregut shqiptar të bazohet tërësisht në meritokraci dhe në përputhje me standardet e kualifikimit të Bashkimit Evropian.

					formë diskriminimi që buron nga burokracia.		Në rrafshin operacional, integrimi i mjeteve digjitale për raportimin në terren do të rriste ndjeshëm efikasitetin duke lehtësuar bashkëpunimin ndërinstytucional përmes shkëmbimit të të dhënave të menjëhershme me autoritetet veterinare. Paralelisht, edukimi i vazhdueshëm përmes platformave e-learning.
4	Teknik ndërzimi	Ligji nr. 113/2015 "Për urdhrin profesional të mjekut veterinar" (FZ 186/15) Ligji nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", nrfryshuar, (FZ 143/11, 31/13, 119/20, 29/22, 192/24, 191/24, 122/25) Ligji nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në	Për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit teknikët e ndërzimit, duhet të jenë diplomuar në arsimin parauniversitar në shkollat e mesme profesionale veterinare të njohura nga ministra përgjegjëse për arsimin profesional, ose të ketë mbaruar ciklin 2-vjeçar për "Menaxhim veterinar". Tekniku i ndërzimit e ushtron profesionin pasi regjistrohet në regjistrin e veçantë të Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar.	Kërkesa për njohjen e diplomës së huaj nga autoritetet shqiptare mund të sjellë efekte indirekte diskriminuese për profesionistët e huaj.	Të rishikohet detyrimi i njohjes së diplomës së huaj, e parashikuar në nenin 5, të ligjit nr. 113/2015 "Për urdhrin profesional të mjekut veterinar", në mënyrë që të mos pengohet ushtrimi i profesionit. Të adoptohen procedura të përsheptuara për diplomat e lëshuara nga institucionet e akredituara të BE-së, duke minimizuar dokumentacionin e tepërt dhe duke ofruar udhëzues të qartë në	T4/2027	Rekomandohet digjitalizimi i procedurave të ekuivalentimit që do të shmangte vonesat burokratike që shpesh shërbejnë si pengesë indirekte për specialistët e huaj, duke garantuar që aksesin në këtë profesion të bazohet vetëm në kualifikimin teknik dhe jo në pengesa procedurale. Krijimi i një regjistri të unifikuar digjital për teknikët e licencuar do të rriste transparencën dhe do të lehtësonte punësimin e tyre.

		Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (FZ 143/11, 31/13, 119/20, 29/22, 192/24, 191/24, 122/25)			gjuhë të huaja, me qëllim që të evitohet çdo formë diskriminimi që buron nga burokracia.		Rekomandohet përdorimi i aplikacioneve për regjistrimin e ndërhyrjeve gjenetike në kohë reale për të rritur efikasitetin dhe shmangjen e mbivendosjeve rregullatore me autoritetet veterinarë. Gjithashtu, edukimi i vazhdueshëm përmes platformave e-learning mbi metodat e reja të biologjisë së riprodhimit dhe menaxhimit të materialit gjenetik është i domosdoshëm për të sinkronizuar standardet vendase me ato evropiane.
--	--	--	--	--	--	--	---

Plani i masave – Sektori i Mjedisit

Rregullatori			MINISTRIA E MJEDISIT/AGJENCIA KOMBETARE E MJEDISIT				
Sektori i shërbimeve profesionale			Mbrojtja e Mjedisit dhe Burimeve Natyrore				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i transparencës dhe proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera
1	Operator mjedisi	Ligji nr. 10 431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar	Kërkesë për leje tip A ose B; kushte teknike dhe monitorim i detyrueshëm; drejtues teknik me arsim të lartë për tip B	Kufizimet janë proporcionale me rrezikun e aktivitetit; justifikohen me interesin publik për mbrojtjen e mjedisit	Ruajtje e sistemit aktual; forcim i monitorimit të vazhdueshëm	2025	Harmonizim me standardet e BE për autorizimet IPPC

2	Ekspert i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)	Ligji nr. 10 440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"	Kërkesë për diplomë universitare specifike; provim certifikimi; licencim pranë AKM/QKL	Kufizimet janë të forta, por të justifikuara për shkak të ndikimit të lartë të vendimarrjeve; sistemi është transparent	Mbajtje e kufizimeve, por shtim i mekanizmave të certifikimit të vazhdueshëm	2026	Duhet rishikuar lidhja me direktivat e BE për EIA
3	Transportues mbetjesh	Ligji nr. 10 463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"; VKM nr. 641/2014; VKM nr. 371/2014	Kërkesë për licencë; drejtues teknik me diplomë për mbetje të rrezikshme; sigurim i detyrueshëm	Kufizimet janë proporcionale; sigurojnë mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit; transparencë mesatare	Simplifikim i procedurave për mbetje jo të rrezikshme; ruajtje e kufizimeve për mbetje të rrezikshme	2026	Duhet sinkronizim me Rregulloren (EC) nr. 1013/2006
4	Tregtar mbetjesh	Ligji nr. 10 463/2011; VKM nr. 641/2014; VKM nr. 371/2014	Licencim i detyrueshëm; për mbetje të rrezikshme kërkohet drejtues teknik me diplomë	Transparencë e plotë; proporcionalitet i justifikuar – rreziku lidhet me shëndetin publik dhe mjedisin	Ruajtje e kufizimeve; forcim i inspektimeve në praktikë	T4/2026	Nevojitet koordinim me acquis për tregtinë ndërkufitare të mbetjeve
5	Shpues profesionist për ujë	Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"	Licencë (kategoria III.7); kërkesa për projekt teknik dhe hidrogeologjik; drejtues teknik me diplomë	Kufizimet janë të forta, por të justifikuara për mbrojtjen e burimeve ujore dhe mjedisit	Ruajtje e sistemit aktual; përmirësim i transparencës për publikun	T4/2026	Harmonizim me Direktivën Kuadër për Ujërat (2000/60/EC)
6	Punonjës shërbimi pyjor	Ligji nr. 57/2020 "Për pyjet"	Certifikim nga MTM; kërkesa për diplomë në inxhinieri pyjore ose arsimin profesional përkatës	Kufizimet janë proporcionale, lidhen me mbrojtjen e ekosistemeve pyjore; transparencë mesatare	Përmirësim i certifikimit dhe trajnimit të vazhdueshëm	2027	Duhet lidhur me acquis për biodiversitetin dhe menaxhimin e pyjeve
7	Ekspert pyjor (pjesë e shërbimit pyjor)	Ligji nr. 57/2020 "Për pyjet"; akte nënligjore për certifikimin e ekspertëve	Kërkesa për diplomë universitare; certifikim nga MTM; kufizim ushtrimi vetëm individual	Kufizime të forta, por të arsyetuara për përgjegjësi të larta; transparencë e përmirësueshme	Mbajtje e sistemit aktual; shtim i mekanizmave të certifikimit periodik	T4/2027	Nevojitet përafrim me praktikën e BE për ekspertizë të pyjeve

Plani i masave – Sektori i Infrastruktures dhe Transportit

Rregullatori			MINISTRIA E ENERGJISË DHE INFRASTRUKTURËS				
Sektori i shërbimeve profesionale			Inxhinieri, Ndërtim, Energji dhe Burime Natyrore				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor)	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Arkitekt	Ligji nr. 10 171/2009; Ligji nr. 107/2014; Udhëzimi nr. 1, datë 10.02.2016	Mungon njohja automatike sipas nenit 46 të Dir. 2005/36/KE; procedura të fragmentuara licencimi	Transparencë mesatare; proporcionalitet i pjesshëm për shkak të kërkesave shtesë	Harmonizim me nenet 46–49 të Direktivës 2005/36/KE; futja e njohjes automatike të diplomave	T4/2026	Arkitektët duhet të përfshihen në Aneksin V të Direktivës për njohje automatike
2	Urbanist	Ligji nr. 107/2014; VKM nr. 408/2015	Mungesë standardizimi të trajnimit dhe mungesë ekuivalence me BE	Transparencë e kufizuar për kandidatët e huaj	Harmonizim me EQF dhe përgatitje për njohje reciproke	T4/2026	Duhet ndarë qartë profili i urbanistit nga ai i arkitektit në licencim
3	Inxhinier ndërtimi	Ligji nr. 10 171/2009; Ligji nr. 107/2014; VKM nr. 408/2015	Procedura të fragmentuara; mungesë ndarjeje për nënprofile	Transparencë mesatare; proporcionalitet i pjesshëm	Unifikim i nënprofileve dhe përafrim me EQF/Dir. 2005/36/KE	T4/2026	Nivele kompetencash të përcaktuara sipas riskut teknik
4	Inxhinier strukturist	Si më sipër	Kërkesa disproporcionale për përvojë 5-vjeçare	Proporcionalitet i ulët ndaj rrezikut teknik	Reduktim i kërkesës për përvojë; përafrim me modelet e BE	T4/2026	Duhet harmonizuar me kornizën EQF niveli 7
5	Inxhinier transporti	Ligji nr. 107/2014; aktet nënligjore për infrastrukturën rrugore	Procedura të ndryshme për licencim sipas sektorëve	Transparencë mesatare	Harmonizim me EU Transport Engineer Frameëork	T4/2027	Bashkërendim institucional me DPSHTRR
6	Inxhinier gjeoteknik	Ligji nr. 107/2014; VKM nr. 409/2015	Mungesë standardizimi për kualifikime; mungesë certifikimi risku	Transparencë e kufizuar	Përafrim me sistemet e BE-së për licencim teknik	T4/2026	Duhet hartuar akt specifik për licencimin gjeoteknik
7	Inxhinier mjedisi	Ligji nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”	Mungesë kategorizimi sipas profileve (ujë, energji, mbetje)	Transparencë e pjesshme; proporcionalitet mesatar	Përafrim me sistemin e BE-së për “Green Skills”	T4/2026	Duhet integrim me strategjitë kombëtare

							për tranzicion të gjelbër
8	Inxhinier energjie	Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”	Licencim i ndarë midis ERE dhe AKBN	Transparencë e kufizuar; procedura të dyfishta	Centralizim i procedurës së licencimit dhe publikim online	T4/2026	Duhet platformë unike për licencimin e profesionistëve të energjisë
9	Inxhinier hidroteknik	Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të ujërave”	Kërkesa për autorizime të shumëfishta (MIE, AMBU, AKBN)	Transparencë e kufizuar; procedura komplekse	Thjeshtim procedurash dhe bashkërendim institucional	T4/2027	Harmonizim me Direktivën 2000/60/EC (Kudri i Ujërave)
10	Inxhinier gjeolog	Ligji nr. 10 171/2009; Ligji nr. 125/2015 “Për burimet natyrore”	Mungesë dallimi ndërmjet gjeologut dhe hidrogeologut	Proporcionalitet i pjesshëm	Vendosje nënkategorish profesionale dhe standard raportimi	T4/2026	Përafrim me standardet ndërkombëtare CRIRSCO
11	Inxhinier hidrogeolog	Si më sipër	Nuk ekzistojnë standarde për validim të të dhënave hidrogeologjike	Transparencë e kufizuar	Krijim i certifikimit profesional ISO për ujëra nëntokësore	T4/2027	Kërkon bashkërendim MIE–Mjedis
12	Inxhinier gjeofizik	Ligji nr. 125/2015; Udhëzimet për kërkime minerare	Procedura të ngadalta dhe jo të digjitalizuara	Transparencë e pjesshme	Digjitalizim i sistemit të licencave profesionale	T4/2026	Harmonizim me direktivën INSPIRE për të dhënat gjeohapësinore
13	Inxhinier nafte	Ligji nr. 7746/1993 “Për hidrokarburet”	Procedura të ndara mes AKBN dhe MIE	Transparencë e kufizuar	Centralizim i regjistrat profesional në AKBN	T4/2026	Standardizim i raportimeve sipas JORC/PRMS
14	Inxhinier minierash	Ligji nr. 10 304/2010 “Për minierat”	Mungesë standardi të harmonizuar për ekspertizën teknike	Proporcionalitet mesatar	Harmonizim me standardet e BE për shfrytëzim të qëndrueshëm	T4/2026	Përafrim me standardet ESG dhe raportimin EITI
15	Inxhinier kimie	Ligji nr. 89/2019 “Për sigurinë kimike”	Nuk ekziston regjistër profesional i detyrueshëm	Transparencë e kufizuar	Krijim regjistri kombëtar për inxhinierët kimikë	T4/2027	Integrim me AKSEM për menaxhimin e riskut kimik
16	Inxhinier i proceseve kimike	Si më sipër	Procedura të paunifikuara për licencim	Transparencë e ulët	Hartim rregulloreje specifike për	T4/2027	Harmonizim me REACH dhe CLP

					proceset kimike industriale		
17	Inxhinier elektrik	Ligji nr. 43/2015; VKM nr. 538/2016 "Për sigurinë elektrike"	Kërkesa për leje të shumëfishta (AKBN, ERE)	Proporcionalitet i ulët	Unifikim i autorizimeve në një certifikatë unike profesionale	T4/2026	Standardizim sipas EN 50110-1
18	Inxhinier elektroenergjetik	Si më sipër	Mungesë kategorizimi sipas nivelit të tensionit	Proporcionalitet mesatar	Kategorizim i certifikatave sipas riskut të operimit	T4/2026	Harmonizim me direktivat për rrjetet inteligjente (Smart Grids)
19	Inxhinier automatizimi industrial	Ligji nr. 43/2015 dhe aktet për automatizim	Mungesë rregulloreje të dedikuara për automatizim industrial	Transparencë e kufizuar	Hartim akti nënligjor specifik për automatizim industrial	T4/2027	Përafrim me Direktivat e Makinerive (2006/42/EC)
20	Inxhinier mekanik	Ligji nr. 10 171/2009; VKM për projektimin mekanik	Kërkesë disproporcionale për përvojë 5-vjeçare	Proporcionalitet i pjesshëm	Reduktim i përvojës minimale dhe njohje e trajnimeve alternative	T4/2026	Përafrim me EQF niveli 7 dhe CEN TC 122
21	Inxhinier konstruksione dhe mjete lëvizëse	Si më sipër	Mungesë kategorizimi dhe njohje e profilit	Transparencë e kufizuar	Futje e profilit si nënkategori ligjore e inxhinierisë mekanike	T4/2027	Përafrim me direktivat për automotivet dhe hekurudhat
22	Inxhinier detar/naval	Ligji nr. 9251/2004 "Kodi Detar"; VKM nr. 551/2014	Nuk ka sistem të unifikuar për licencim profesional	Transparencë mesatare	Krijim regjistri kombëtar të inxhinierëve detarë	T4/2027	Harmonizim me standardet STCW për projektimin detar
23	Inxhinier gjeodet	Ligji nr. 107/2014; Udhëzimi për matje topografike	Kërkesa për leje të shumëfishta paraprake	Proporcionalitet i ulët	Reduktim i barrierave administrative dhe digjitalizim i procedurës	T4/2026	Integrim me platformën kombëtare GIS
24	Inxhinier gjeomatikë	Si më sipër	Nuk ka profil të njohur ligjor	Transparencë e ulët	Përfshirje si nënkategori ligjore e gjeodetëve	T4/2027	Harmonizim me Direktivat INSPIRE dhe EQF 6–7
25	Inxhinier hidrogeologjie	Ligji nr. 111/2012	Mungesë kategorizimi profesional	Transparencë e kufizuar	Koordinim me rregullimet e Ministrisë së Mjedisit	T4/2027	Harmonizim me EQF 7

26	Vlerësues i pasurive të paluajtshme	Ligji nr. 10 091/2009; VKM nr. 538/2016	Procedura të gjata njohjeje për vlerësuesit e huaj	Transparencë mesatare	Përafrim me standardet EVS (European Valuation Standards)	T4/2026	Duhet bashkërendim me Kadastrën dhe Bankën e Shqipërisë
----	-------------------------------------	---	--	-----------------------	---	---------	---

Rregullatori			MINISTRIA E ENERGJISË DHE INFRASTRUKTURËS DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE				
Sektori i shërbimeve profesionale			Transport Detar				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor)	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Kapiten detar	Ligji nr. 9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar", i ndryshuar; Urdhri nr. 134, datë 27.6.2022 (rregullorja për nivelin minimal të trajnimit të detarëve); STCW 1978, A-II/2	Licencim vetëm nga DPD; mungesë procedure të automatizuar për njohjen e kualifikimeve të huaja	Transparencë mesatare; proporcionalitet i plotë ndaj riskut	Digjitalizim i procesit të licencimit dhe procedurë e përbashkët me BE për njohje automatike	T4/2026	Duhet harmonizim me modelin e njohjes automatike STCW/Dir. 2008/106/EC
2	Oficer detar	Si më sipër; STCW A-II/1	Procedurat e trajnimit të përbashkëta nuk janë të standardizuara midis akademive shqiptare	Transparencë mesatare; proporcionalitet i pranueshëm	Krijim mekanizmi të akreditimit të qendrave të trajnimit sipas ETO Model Course 7.03	T4/2026	Kërkohe certifikim i unifikuar nga DPD për të gjitha qendrat
3	Oficer detar i kuvertës	Si më sipër; STCW A-II/1	Mungesë verifikimi automatik për eksperiencën detare (sea service)	Proporcionalitet i mirë, por transparencë e pjesshme	Përdorim i regjistrat elektronik të shërbimit detar	T4/2026	Duhet platformë kombëtare për evidencën e detarëve
4	Oficer detar i parë	Si më sipër; STCW A-II/2	Përvoja detare 12 muaj e paprovuar elektronikisht	Transparencë e kufizuar për shkak të evidencave manuale	Digjitalizim i procesit të verifikimit të shërbimit në det	T4/2026	Duhet ndërlidhje me bazat e të dhënave të flamurit shqiptar

5	Inxhinier detar mekanik	Kodi Detar; STCW A-III/1	Procedurat e certifikimit të qendrave të trajnimit janë të pjesshme	Transparencë mesatare; proporcionalitet i pranueshëm	Hartim standardi të ri kombëtar për trajnimin e inxhinierëve detarë	T4/2027	Duhet përfshirje e UPT në procesin e akreditimit teknik
6	Kryeinxhinier detar mekanik	Kodi Detar; STCW A-III/2	Përvojë e gjatë e kërkuar (24 muaj) pa ekuivalencë me BE	Proporcionalitet i ulët ndaj standardeve BE	Reduktim i përvojës në 12 muaj, sipas kërkesave të Dir. 2012/35/EU	T4/2027	Harmonizim me skemat e validimit ETO Model Course 7.02
7	Inxhinier detar mekanik i dytë	STCW A-III/2	Pa kornizë të qartë për validimin e përvojës dhe trajnimit	Transparencë mesatare	Futje e sistemit të krediteve ECVET për trajnimin detar	T4/2027	Duhet manual kombëtar për validimin e kompetencave
8	Ndihmësinxhinier detar mekanik	STCW A-III/5	Nuk ekziston ndarje e plotë ligjore për kualifikimin fillestar	Proporcionalitet i ulët; transparencë e kufizuar	Hartim akti nënligjor specifik për detarët ndihmës (Entry Level)	T4/2026	Harmonizim me rekomandimin MSC.418(97) të IMO
9	Oficer detar elektroteknik	STCW A-III/6	Licencim i kufizuar; mungon trajnim i specializuar për ETO	Transparencë e kufizuar; proporcionalitet mesatar	Futje e trajnimit ETO në akademitë shqiptare sipas Model Course 7.08	T4/2026	Duhet njohje e titullit "Electro-Technical Officer" sipas BE
10	Operator detar i radiokomunikimit	STCW A-IV/1; Konventa ITU	Kërkesa për certifikim manual të GOC/ROC	Transparencë e pjesshme; proporcionalitet i mirë	Digjitalizim i regjistrat të certifikatave GOC/ROC	T4/2026	Integrim me sistemet ITU për validim ndërkombëtar
11	Operator detar i radiokomunikimit GMDSS	STCW A-IV/2	Procedura e njohjes ndërkombëtare e kufizuar	Transparencë mesatare	Harmonizim me skemat e GMDSS Operator (UK/IMO)	T4/2026	Përafrim me ETO course për komunikime emergjente
12	Marinar	Kodi Detar; STCW A-II/4 dhe A-III/4	Mungon standardizimi i dokumentacionit të trajnimit bazë	Transparencë e kufizuar; proporcionalitet mesatar	Harmonizim me Model Course 1.19 dhe validim ECVET	T4/2026	Përdorim i standardeve të përbashkëta për trajnim bazë

13	Marinar kuverte i kualifikuar	STCW A-II/5	Procedurat për trajnimin bazë janë të fragmentuara	Transparencë e pjesshme	Integrim i trajnimit bazë dhe atij të avancuar në një kurrikul unike	T4/2026	Duhet përditësim i moduleve të sigurisë (survival & firefighting)
14	Oficer detar mashine i kualifikuar	STCW A-III/5	Nuk ekziston strukturë e plotë për trajnimin paraprak në Shqipëri	Proporcionalitet i pjesshëm	Akreditim i qendrave trajnimi për Engine Room Procedures	T4/2026	Harmonizim me ETO për "Watchkeeping Duties"

Rregullatori:			MINISTRIA E ENERGJISË DHE INFRASTRUKTURËS AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL				
Sektori i shërbimeve profesionale			Transport Ajror				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor)	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Operator i aerodromit	Ligji nr. 96/2020 "Kodi Ajror"; VKM nr. 1095/2020; Reg. (EU) 139/2014	Licencim vetëm nga AAC; proces administrativ jo tërësisht i digjitalizuar	Transparencë mesatare; proporcionalitet i plotë ndaj rrezikut	Digjitalizim i plotë i procesit të certifikimit; harmonizim me EASA CS-ADR-DSN	T4/2026	Kërkohej ndërlidhje me sistemet e EASA për raportim të përbashkët
2	Operator avioni (Air Operator Certificate – AOC)	Kodi Ajror; Reg. (EU) 965/2012 (Air OPS); Urdhri nr. 59/2020	Kërkesa e lartë financiare dhe dokumentacion teknik, e pasaktësuar për operatorë të vegjël	Proporcionalitet mesatar; transparencë e pjesshme	Rishikim i kriterëve të AOC për operatorë charter dhe taksi ajror	T4/2026	Duhet përafrim me Reg. (EU) 2018/1139 për "Light AOC Operators"
3	Koordinator i aeroportit (slot coordinator)	Kodi Ajror (nenet 68–70); Udhëzim nr. 17, datë 02.09.2010; Reg. (EC) 793/2004 dhe 545/2009	Një pozicion unik, emërim vetëm nga ministri; mungesë transparence në përzgjedhje	Transparencë e ulët; proporcionalitet i pjesshëm	Futje e konkursit publik dhe kriterëve të EASA Slot Regulation	T4/2027	Duhet ndarje funksionale nga operatori aeroportual për të shmangur konflikt interesi
4	Kontrollor i trafikut ajror (ATCO)	Kodi Ajror; Urdhri nr. 91/2019; Reg. (EU) 2015/340; Annex 1 ICAO	Kufizim për ushtrim ndërkufitar (vetëm brenda hapësirës shqiptare)	Transparencë shumë e mirë; proporcionalitet i plotë	Ngritje e sistemit të njohjes automatike të licencave sipas Dir. 2005/36/EC	T4/2026	Duhet marrëveshje dypalëshe me EASA për njohje të ndërsjellë

5	Kontrollor i ekuipazhit ajror (Cabin CreëwInspector)	Kodi Ajror; Urdhri nr. 59/2020; Reg. (EU) 1178/2011 Part CC; Reg. (EU) 965/2012	Kufizim numerik (pozicione vetëm pranë AAC); proces licencimi jo publik	Transparencë e ulët; proporcionalitet i plotë (funksion inspektimor)	Formalizim i kriterëve të përzgjedhjes për inspektorët dhe përfshirje në EASA Data Pool	T4/2027	Duhet vendosje e standardeve për “continuing training of inspectors”
6	Pilot (PPL, CPL, ATPL)	Kodi Ajror; Urdhri nr. 262/2019; Reg. (EU) 1178/2011 Part FCL; Reg. (EU) 965/2012	Kosto e lartë e trajnimit; mungesë e njohjes automatike të licencave nga BE	Transparencë e mirë; proporcionalitet i plotë	Harmonizim i plotë me Part FCL dhe krijim marrëveshjes për konvertim licencash	T4/2026	Shqipëria duhet të nënshkruajë marrëveshje EASA për mutual recognition
7	Ekuipazh kabine (Cabin Crew)	Kodi Ajror; Urdhri nr. 262/2019; Reg. (EU) 1178/2011 Part CC; Reg. (EU) 965/2012	Mungesë transparence në trajnimin fillestar; standarde jo të njëtrajtshme ndër operatorë	Transparencë e pjesshme; proporcionalitet i mirë	Akreditim i qendrave të trajnimit sipas EASA CC.TRA.220	T4/2026	Kërkohet ndërtimi i databazës kombëtare të certifikatave të ekuipazhit
8	Instruktor fluturimi (Flight Instructor)	Kodi Ajror; Reg. (EU) 1178/2011 Part FCL (Subpart J); Urdhri nr. 250/2014	Proces i gjatë rinovimi licence; mungesë fleksibiliteti për instruktoret freelance	Transparencë mesatare; proporcionalitet i pranueshëm	Rregullim i statusit të instruktoreve të pavarur sipas FCL.900	T4/2026	Duhet përafrim me amendamentin EASA 2020/2193 për modular courses
9	Ekzaminues fluturimi (Flight Examiner)	Kodi Ajror; Urdhri nr. 250/2014; Reg. (EU) 1178/2011 Part FCL (Subpart K)	Licencim vetëm nga AAC; nuk ekziston proces publik për përzgjedhje	Transparencë e kufizuar; proporcionalitet i justifikuar	Formalizim i procesit të akreditimit dhe publikimi i listës kombëtare të FE	T4/2026	Harmonizim me EASA FCL.1015 dhe standardet e FE(A)/FE(H)

Rregullatori			MINISTRIA E ENERGJISË DHE INFRASTRUKTURËS DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR				
Sektori i shërbimeve profesionale			Transport Rrugor				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor)	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Mësues teorie për autoshkola	Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për	Kërkesë për diplomë të inxhinierisë	Transparencë e pjesshme;	Zgjerim i listës së diplomave të	T4/2026	Duhet rishikim i kushteve për

		transportet rrugore”; Udhëzimi nr. 9, datë 14.04.2022 “Për aktivitetin e autoshkollave”; VKM nr. 153, datë 07.04.2000	mekanike; mungesë fleksibiliteti për diploma ekuivalente teknike	proporcionalitet i justifikuar me sigurinë rrugore	pranueshme për trajnim teorik (p.sh. edhe inxhinieri transporti, automotiv)		provimin e licencimit për të shmangur subjektivitetin
2	Instruktor praktik për autoshkolla	Ligji nr. 8308/1998; Udhëzimi nr. 9/2022; VKM nr. 153/2000	Kërkesa për 10 vjet përvojë në drejtim; kufizim moshe 30–70 vjeç	Transparencë mesatare; proporcionalitet i kufizuar (kufizim i panevojshëm mbi moshën)	Rishikim i kërkesës për përvojë dhe moshë; futje e sistemit të kontrollit të vazhdueshëm të aftësive	T4/2026	Duhet përputhje me praktikatat e BE-së (trajnim bazuar në kompetencë, jo në vite përvojë)
3	Dëshmi aftësie profesionale për autoriparime – përgjegjës teknik	Ligji nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin...”; Udhëzimi nr. 1546, datë 29.03.2016; Rregullorja nr. 4, datë 21.04.2018 e DPSHTRR-së	Kërkesa për diplomë inxhinierike ose teknike mekanike dhe 5 vite përvojë pune; mungesë fleksibiliteti për arsim profesional të avancuar	Transparencë e mirë; proporcionalitet i plotë për sigurinë rrugore	Rishikim i kriterëve të përvojës për kandidatët me kualifikim profesional të lartë; digjitalizim i procedurës së provimit	T4/2026	Duhet futje e sistemit elektronik të regjistrimit të DAP për gjurmueshmëri kombëtare
4	Dëshmi aftësie profesionale për shitblerje të mjeteve rrugore me motor dhe/ose rimorkio	Ligji nr. 9573/2006; Udhëzimi nr. 1546/2016; Rregulloret e DPSHTRR	Kërkesa për diplomë teknike dhe eksperiencë 5 vjeçare; proces manual aplikimi	Transparencë mesatare; proporcionalitet i mirë	Automatizim i sistemit të aplikimit dhe përfshirje e moduleve të detyrueshme për integritet profesional	T4/2026	Nevojitet publikimi online i listës së subjekteve të certifikuara
5	Dëshmi aftësie profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke	Ligji nr. 8308/1998; VKM nr. 808, datë 04.12.2003; DPSHTRR Training Manual 2023	Kërkesë për leje drejtimi të kategorisë përkatëse; program trajnimi 24 orësh; mungesë standardizimi ndër rajone	Transparencë e mirë; proporcionalitet i plotë ndaj rrezikut teknik	Harmonizim i kurrikulave të trajnimit me direktivat e BE për sigurinë në punë dhe makineri (Dir. 2006/42/EC)	T4/2026	Duhet certifikim i qendrave private të trajnimit dhe sistem elektronik për monitorim
6	Dëshmi aftësie profesionale për shoqërues teknik të	Ligji nr. 8308/1998; Udhëzimi i përbashkët nr. 4447, datë 23.09.2003;	Kërkesë për arsim të mesëm, kurs teorik dhe provim;	Transparencë e mirë; proporcionalitet i	Futje e detyrueshme e trajnimit periodik çdo 5 vjet për	T4/2026	Duhet përafrim me praktikatat e EN 12195-1 dhe

mjeteve jashtë norme në kryerjen e transporteve në kushte jonormale	DPSHTRR Training Guidelines 2022	mungesë mekanizmi për rifreskimin periodik të aftësive	justifikuar me natyrën e profesionit	rifreskim kompetencash		standardet e sigurisë rrugore të BE-së
--	-------------------------------------	--	---	---------------------------	--	--

Plani i masave – Sektori i Arsimit

Rregullatori			MINISTRIA E ARSIMIT				
Sektori i shërbimeve profesionale			MESUESI				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i transparencës dhe proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera
1	Mësues (të gjitha profiel)	Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (FZ 101) Ligji nr. 10 171/2010 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (FZ 154/09, 174/10, 126/14) VKM nr. 649, datë 14.9.2011 “Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nën- specialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara”, e ndryshuar (FZ 141, 177, 77)	Fragmentarizim i procedurave të aksesit në profesion dhe mungesë transparence të unifikuar mbi kriteret, dokumentacionin, afatet dhe rrugët e ankimit për licencim dhe ushtrim të profesionit, veçanërisht për kandidatët nga jashtë sistemit kombëtar	Transparencë mesatare; proporcionalitet i pjesëshëm. Objektivi i cilësisë së mësimdhënies është legjitim, por informacioni procedural është i shpërndarë dhe jo i standardizuar, duke krijuar barrë administrative dhe pasiguri juridike	Standardizim dhe konsolidim i informacionit publik për aksesin dhe ushtrimin e profesionit të mësuesit në një pikë të vetme reference (single entry point), përfshirë kriteret e kualifikimit, procedurat, afatet dhe mekanizmat e ankimit, si dhe zgjerim i aplikimit elektronik për licencim dhe certifikim	T4/2027	Masa kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e transparencës dhe në lehtësimin e mobilitetit profesional

		VKM nr. 436, datë 3.6.2020 "Për përcaktimin e notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve, në institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar (FZ 107, 81) VKM nr. 952, datë 12.12.2012 "Për përjashtimin e profesionistit nga detyrimi për dhënien e provimit të shtetit për profesionet e rregulluara" (FZ 189) Urdhër Ministri nr. 100/2022 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", i ndryshuar Urdhër Ministri nr. 365/2020 "Për miratimin e rregullores 'Për funksionimin e komisionit të provimit të shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit'"					
--	--	--	--	--	--	--	--

		Udhëzime Ministri Udhëzim Ministri nr. 16, datë 22.7.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” Udhëzim Ministri nr. 17, datë 22.7.2024 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë”, i ndryshuar (Udhëzimi nr. 6/2025) Udhëzim Ministri nr. 3, datë 15.2.2023 “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlefishme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko- pedagogjike”, i ndryshuar (nr. 7, datë 6.3.2023)					
2	Mësues (të gjitha profilet)	Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e	Kombinim kumulativ i kërkesave (diplomë + praktikë + provim + certifikim periodik) pa	Proporcionalitet miks. Ekziston justifikim për sigurimin e cilësisë së arsimit, por mungon	Kryerje e një analize të posaçme proporcionaliteti për profesionet e arsimit, me synim rishikimin e	T4/2026	Duhet harmonizim me nenin 59 të

		Shqipërisë”, i ndryshuar (FZ 101) Ligji nr. 10 171/2010 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (FZ 154/09, 174/10, 126/14)	analizë të dokumentuar të proporcionalitetit dhe pa konsiderim sistematik të alternativave më pak kufizuese, veçanërisht për kandidatët me përvojë profesionale ose kualifikime të huaja	arsyetim i strukturuar mbi domosdoshmërinë e çdo elementi dhe mbi ndërveprimin e tyre	kombinimit të kërkesave ex ante dhe eksplorimin e mekanizmave alternativë (p.sh. forcim i kontrollit ex post, mentorim profesional, certifikim i bazuar në kompetenca), si dhe qartësim i trajtimit të kualifikimeve të huaja		Direktivës 2005/36/KE
--	--	--	--	---	---	--	-----------------------

Plani i masave – Sektori i Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Rregullatori			MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT				
Sektori i shërbimeve profesionale			Turizëm dhe Shërbime të Lidhura				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i transparencës dhe proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera
1	Udhërrëfyes turistik	Ligji nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar; VKM nr. 692/2016; Udhëzim i përbashkët nr. 517/2017	Kërkesa për certifikatë të lëshuar nga MTM; kërkesa për qëndrim të ligjshëm ≥1 vit për të huajt; njohuri të gjuhës shqipe	Transparencë e lartë; proporcionalitet i pjesshëm – kërkesa e qëndrimit 1 vit dhe gjuha shqipe mund të jenë kufizuese për ofruesit e huaj	Rishikim i kriterëve për të huajt: qëndrimi dhe gjuha të vlerësohen me testim profesional, jo si barrë e përgjithshme	T4/2026	Duhet harmonizim me nenin 59 të Direktivës 2005/36/KE
2	Udhërrëfyes turistik kombëtar	Ligji nr. 93/2015, VKM nr. 692/2016, Udhëzimi 517/2017	Të njëjtat kufizime si për udhërrëfyesin bazë, me certifikim për gjithë territorin	Kufizimet për shtetas të huaj me qëndrim ≥1 vit janë të debatueshme; kërkesa për njohje të gjuhës shqipe është e justifikueshme për shkak të natyrës së shërbimit	Hegje e kushtit për qëndrim minimal 1 vit; forcim i testimit profesional	T4/2026	Mund të integrohet me skema të certifikimit vullnetar për gjuhë të tjera
3	Udhërrëfyes turistik lokal	Ligji nr. 93/2015, VKM nr. 692/2016	Kufizim i fushës territoriale (vetëm zonë e caktuar); kërkesat e njëjta për të huajt	Kufizimi territorial justifikohet pjesërisht (natyra e shërbimit lokal), por duhet të ketë mekanizëm për njohje reciproke	Rishikim për të mundësuar ushtrim edhe jashtë zonës për raste të veçanta;	T4/2027	Potencial diskriminues për të huajt në lidhje me qëndrimin minimal

					njohje reciproke për zonat		
4	Udhërrëfyes turistik i specializuar	Ligji nr. 93/2015, VKM nr. 692/2016, Udhëzimi 517/2017	Kërkesa për programe të akredituara të specializuara; kufizime për të huajt (1 vit qëndrim, gjuhë shqipe)	Kufizimet mbi gjuhën shqipe të mbeten për të garantuar cilësinë; kriteri i qëndrimit 1 vit është disproporcional	Heqje e kushtit të qëndrimit; përfundim i trajnimeve modulare	T4/2026	Nevojitet krahasim me praktikën e BE për guidat të specializuara
5	Udhërrëfyes turistik i nderit	Ligji nr. 93/2015, VKM nr. 692/2016, Udhëzimi 517/2017; Urdhri nr. 745/2017	Status special, jo i hapur; kusht ≥20 vjet eksperiencë ose tituj shkencorë	Kufizim i justifikuar, pasi është certifikim nderi, jo licencë e përgjithshme	Ruajtje e status quo	Pa afat	Status më tepër ceremonial, nuk lidhet me tregun e lirë
6	Operator turistik	Ligji nr. 93/2015, VKM nr. 710/2016, Udhëzimi nr. 179/2017	Kërkesa për licencë, mjedis pune ≥16 m ² , diplomë dhe eksperiencë për drejtuesin teknik; mosdënim për vepra penale	Disa kufizime (sipërfaqja e mjedisit, diplomë e detyrueshme) janë të forta krahasuar me BE	Ulje e kërkesës për sipërfaqe fikse; fleksibilizim i diplomës – njohje përvojash të barasvlershme	T4/2027	Harmonizim me standardet e BE për lëvizjen e shërbimeve
7	Agjent turistik/udhëtimi	Ligji nr. 93/2015, VKM nr. 709/2016, Udhëzimi 179/2017	Kërkesa për licencë; mjedis pune ≥10 m ² ; diplomë min. shkollë e mesme profesionale; mosdënim për vepra penale	Kriteret janë transparente, por mund të konsiderohen barrë administrative për subjektet e vogla	Reduktim i kërkesës për hapësirë fikse; përvojë pune të njohur si alternativë ndaj diplomës	T4/2026	Duhet përafrim me acquis për shërbimet e lëvizshme
8	Operator turizmi detar	Ligji nr. 43/2020, Udhëzimi nr. 4/2020	Kërkesa për kontratë vendbazimi, flotë të certifikuar, plan emergjencash, sigurim ndaj palëve të treta	Kufizimet janë të justifikuara për sigurinë detare; por kontratat e detyrueshme me marina rrisin koston	Mbajtje e kërkesës për siguri; rishikim për lehtësim procedurash administrative	T4/2026	Mund të shihet lidhja me acquis për transportin detar
9	Transportues turistik	Ligji nr. 93/2015; Ligji nr. 8308/1998; Udhëzimi nr. 8885/2016; VKM nr. 1101/2015	Licencim i detyrueshëm; kërkesa për kontrata me operatorë/agjenci; sigurim për pasagjerët; CAP për shoferët	Kufizimet janë proporcionale për sigurinë rrugore; por burokracitë e licencimit mund të jenë barrë	Simplifikim i procedurave për transport të rastit; njohje më e shpejtë e lejeve	T4/2026	Marrëveshja INTERBUS kërkon përafrim shtesë

10	Vrojtues plazhi	Ligji nr. 93/2015; VKM nr. 171/2019	Kërkesë për certifikatë formimi profesional; rinovim periodik; punësim vetëm në stacione të licencuara	Kufizimet janë proporcionale për sigurinë publike; nuk ka diskriminim mbi shtetësinë	Ruajtje e status quo; forcim i trajnimeve dhe kontrollit periodik	T4/2026	Mund të lidhet me standardet ndërkombëtare të shpëtimit në ujë
----	-----------------	-------------------------------------	--	--	---	---------	--

Rregullatori Sektori i shërbimeve profesionale			MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT				
			Kulturë				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor) apo praktika administrative	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Agjent letrar	Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”; Udhëzimi i MKRS nr. 2, datë 21.02.2017	Kërkesa për regjistrim dhe licencë nga MKRS	Transparencë mesatare; mungesë standardizimi mbi tarifave e ndërmjetësimit	Rishikim i kriterëve të licencimit dhe tarifave	T4/2026	Nevojë për harmonizim me nenet 10–14 të Direktivës 2014/26/BE
2	Art-grafist	Ligji nr. 27/2018; praktika administrative nëpërmjet IKT	Mungesë kategorizimi profesional; mungesë standardeve minimale	Kufizim jo diskriminues por pa strukturë të qartë vlerësimi	Hartim akti nënligjor që përcakton kriteret profesionale	T4/2027	Duhet unifikim me sistemin e arsimit profesional artistik
3	Botues	Ligji nr. 35/2016; VKM nr. 752/2020 “Për regjistrin e botuesve”	Kërkesë për NUIS dhe qarkullim minimal; procedurë administrative	Transparent, por mungon proporcionalitet ekonomik	Thjeshtim procedurash për mikro-ndërmarrjet	T4/2026	Kërkohet përafrim me standardet e BE për lirinë e botimit
4	Konservues–Restaurator i rrënojave/siteve arkeologjike	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020; VKM nr. 364/2019	Kërkesë për licencë të posaçme dhe përvojë min. 7 vite	Transparencë e mirë; proporcionalitet i lartë	Ruajtje e sistemit ekzistues	—	Nevojë për përditësim të kriterëve të praktikës
5	Konservues–Restaurator i	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020	Licencim i detyrueshëm; kufizim në	E drejtë e kufizuar, por proporcional për mbrojtje publike	Ruajtje e sistemit ekzistues	—	Kërkohet formim i vazhduar profesional

	ndërtimeve me karakter mbrojtës		profesionistë të diplomuar				
6	Konservues–Restaurator i arkitekturës së kultit	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020; VKM nr. 464/2023	Kërkesë për licencë dhe diplomë “Master profesional”	Masë e justifikuar nga interesi publik (trashëgimi fetare)	Ruajtje e sistemit ekzistues	—	Duhet saktësim në nivelin e specializimit fetar
7	Konservues–Restaurator i ndërtimeve inxhinierike	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020	7 vite eksperiencë; master profesional; licencë nga KKTKM	Justifikuar për shkak të rrezikut strukturor	Rishikim i kufirit të eksperiencës në 5 vite	T4/2026	Përfshirje e inxhinierëve strukturorë në grup
8	Konservues–Restaurator i arkitekturës së traditës (vernakulare)	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020	Kërkesa për eksperiencë të gjatë dhe formim të dyfishtë	Mbrojtje e interesit kulturor; proporcionalitet i mirë	Asnjë ndryshim thelbësor	—	Duhet manual metodologjik për arkitekturë tradicionale
9	Konservues–Restaurator i arkitekturës së projektuar	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020	Kërkesë për dy diploma Master + 7 vite eksperiencë	Proporcional, por mungon unifikim terminologjik	Saktësim në klasifikimin e ndërtimeve moderne	T4/2026	Nevojë për harmonizim me arkitektët projektues
10	Konservues–Restaurator – Rikualifikues i hapësirave publike	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020	Licencim për ndërhyrje në zona historike urbane	Masë e drejtë për siguri dhe autenticitet urban	Pa ndryshim; mbetet e nevojshme për mbrojtje publike	—	Mundësi për bashkëpunim me arkitektë urbanë
11	Konservues–Restaurator i mozaikëve	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020	Master + 7 vite përvojë; praktikë e detyrueshme	Kufizim i drejtë për shkak të kompleksitetit të artit	Ruajtje e sistemit; përditësim kreditesh periodike	T4/2027	Kërkohej përfshirje e laboratorëve të analizës së materialeve
12	Konservues–Restaurator i pikturave murale dhe shkëmbore	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020	Licencë nga KKTKM; përvojë 7–15 vite	Proporcional për ruajtjen e autenticitetit të trashëgimisë	Përmirësim i sistemit të trajnimit të detyrueshëm	T4/2026	Nevojë për standarde për restaurim të pikturës shkëmbore
13	Konservues–Restaurator i veprave të artit në dru	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020	Kërkohej diplomë Master dhe praktikë 240 orë	Justifikuar për shkak të rrezikut të dëmtimit të objekteve	Pa ndërhyrje të nevojshme	—	Duhet qartësim për restaurimin e ikonave dhe mobilie

14	Konservues– Restaurator i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020	Eksperiencë 7 vite; praktikë 240 orë	Kufizim teknik i drejtë dhe proporcional	Rishikim i formimit pasuniversitar	T4/2026	Përfshirje e teknikave bashkëkohore laboratorike
15	Konservues– Restaurator i veprave të artit në metal dhe gelq	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020	Master + praktikë 240 orë; njohuri në kimikë	Proporcional për sigurinë kimike e materiale	Pa ndërhyrje thelbësore	—	Duhet mbështetje laboratorike në IKTK
16	Konservues– Restaurator i objekteve tekstile, lëkure, pergamene, telajo, letër	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 279/2020	Licencim dhe eksperiencë 7 vite + 2–4 projekte	Proporcional për ruajtjen e objekteve muzeale	Formalizim i trajtimeve të detyrueshme	T4/2027	Harmonizim me normat e ICOM dhe ICCROM
17	Arkeolog	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 793/2020	Diplomë master + 6 projekte të certifikuara	Masë e drejtë për cilësinë shkencore	Ruajtje e sistemit aktual	—	Nevojë për strukturim të bazës kombëtare të të dhënave
18	Gërmues arkeologjik	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 793/2020	Kërkesë për doktoraturë ose drejtim projekti	Proporcional për objektivat e kërkimit shkencor	Thjeshtim dokumentacioni për projektet e huaja	T4/2026	Standardizim i dokumentacionit për licenca shumëvjeçare
19	Vëzhgues arkeologjik (survey)	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 793/2020	Diplomë Master + 5 projekte survey	Masë e drejtë dhe proporcionale	Ruajtje e sistemit ekzistues	—	Duhet përcaktim për rolin e vëzhguesit në fazat paraprake
20	Sondues arkeologjik	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 793/2020	Diplomë Master + 5 sondazhe të certifikuara	Proporcional për sigurinë e gërmimeve paraprake	Rishikim i kriterëve për përvojën 5- vjeçare	T4/2026	Harmonizim me legjislacionin francez dhe italian
21	Vëzhgues arkeologjik nënujor	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 793/2020	Diplomë Master + gradë zhytjeje + 3 projekte	Masë e justifikuar për shkak të rrezikut profesional	Pa ndërhyrje thelbësore	—	Kërkohet certifikim ndërkombëtar DAN/SSI
22	Sondues arkeologjik nënujor	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 793/2020	Gradë zhytësi; dokument sigurimi jete; 3–5 projekte	Proporcional; masë mbrojtëse ndaj rrezikut fizik	Përmirësim i procedurës së njohjes së certifikatave	T4/2026	Harmonizim me standardet e zhytjes nënujore të BE

23	Arkeolog nënujor	Ligji nr. 27/2018; VKM nr. 793/2020	Diplomë Master ose “PhD”; gradë zhytjeje; 4–6 projekte	Proporcional për ruajtjen e trashëgimisë nënujore	Pa ndryshim thelbësor; rekomandohet verifikim periodik	T4/2027	Përafrim me “European Convention on Underëater Cultural Heritage”
----	------------------	-------------------------------------	--	---	--	---------	---

Rregullatori			MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT				
Sektori i shërbimeve profesionale			Sport				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor) apo praktika administrative	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Sportist i nivelit të lartë / Trajner / Specialist i sportit / Instruktor skish	Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar (FZ nr. 154/2017; nr. 114/2020) Ligji nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (FZ nr. 154/2009; nr. 174/2010; nr. 146/2011; nr. 126/2014) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 15.12.2021 “Për kriteret, mënyrën e	Fragmentarizim i bazës ligjore dhe informacionit procedural; mungesë e një pike të vetme reference për aplikantët; kritere jo gjithmonë të standardizuara për certifikim/ricertifikim; dallim i paqartë ndërmjet njohjes akademike dhe asaj profesionale; procedura kryesisht fizike dhe afate jo gjithmonë të shprehura qartë.	Transparencë mesatare. Autoritetet kompetente janë përgjithësisht të identifikueshme, por përshkrimi i procedurave, dokumentacioni i kërkuar, afatet dhe mekanizmat e ankimit nuk janë të konsoliduara në një burim unik. Intensitet i konsiderueshëm i kontrollit ex ante (certifikim, licencim, praktikë), pa arsyetim të strukturuar të proporcionalitetit dhe pa konsiderim sistematik të alternativave më pak kufizuese.	Standardizim i transparencës dhe procedurave: Unifikimi dhe publikimi në një pikë të vetme elektronike (p.sh. përmes e-Albania ose faqes zyrtare të MAS) i gjithë informacionit për profesionet e sportit: baza ligjore, autoritetet kompetente, hapat proceduralë, dokumentacioni, afatet dhe të drejtat e ankimit. Paralelisht, harmonizim terminologjik i akteve nënligjore dhe vendosje e afateve të detyrueshme administrative për certifikim/ricertifikim.	T4/2026	Masat synojnë rritjen e parashikueshmërisë procedurale, uljen e barrës administrative dhe përmirësimin e lëvizshmërisë profesionale, pa cenuar objektivat e interesit publik që lidhen me sigurinë e sportistëve, cilësinë e shërbimeve dhe integritetin e veprimtarive sportive.

		shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre”, i ndryshuar (FZ nr. 114/2017; nr. 154/2020) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 135, datë 6.3.2024 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të kërkesës, rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontroleve për fitimin e shtetësisë shqiptare kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar ose interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës dhe sportit”, i ndryshuar (FZ nr. 49/2024; nr. 64/2025)			Forcim i proporcionalitetit dhe lehtësim i mobilitetit profesional: Vendosje e një testi standard proporcionaliteti për kërkesat ekzistuese (certifikim, praktikë, ricertifikim periodik), me synim shmangien e mbivendosjeve dhe kalimin, aty ku është e mundur, nga kontrolli ex ante drejt mekanizmave ex post dhe edukimit të vazhdueshëm profesional. Sqarim i dallimit ndërmjet njohjes akademike dhe njohjes profesionale, si dhe krijim i një procedure të thjeshtuar për ofrimin e përkohshëm të shërbimeve sportive nga profesionistë të huaj, me deklaram paraprak dhe kontrole të kufizuara vetëm kur justifikohet nga siguria.		
--	--	---	--	--	---	--	--

Plani i masave – Sektori i Ekonomisë dhe Pronësisë Industriale

Rregullatori			MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT DHOMA E ZEJEVE AKAFPK				
Sektori i shërbimeve profesionale			Zejtari				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor apo praktikë administrative)	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Profesionet zejtare	Ligji nr. 70/2016 “Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë” VKM nr. 578/2020 “Për përcaktimin e listës së profesioneve zejtare” VKM nr. 3, datë 06.01.2020 “Për kohën e nevojshme, që i duhet ndihmësit për kualifikimin me njohuritë praktike pranë një mjeshtri dhe me njohuritë teorike në një institucion arsimor”	Kufizimi i identifikuar lidhet me faktin se, ndonëse kuadri ligjor aktual nuk përmban dispozita që parashikojnë diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj shtetasve të huaj, procedurat për hyrjen në treg mbeten të ngurta dhe potencialisht përjashtuese. Për të ushtruar aktivitet ekonomik në Republikën e Shqipërisë, individët, përfshirë shtetasit e huaj, duhet të kryejnë regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit,	Kufizimet e parashikuara në kuadrin ligjor janë, në thelb, proporcionalisht të justifikuara, pasi synojnë objektiva legjitimë si garantimi i standardeve profesionale, mbrojtja e konsumatorit dhe funksionimi i rregullt i tregut. Megjithatë, zbatimi aktual i këtyre kërkesave nuk rezulton plotësisht proporcional, pasi disa elementë procedurale krijojnë barrë më të madhe sesa nevojitet për arritjen e këtyre qëllimeve.	Kufizimet e identikuara në kuadrin ligjor, ndonëse në parim të justifikuara dhe proporcionalisht të arsyeshme për garantimin e standardeve profesionale dhe mbrojtjen e tregut, paraqesin elementë që në praktikë mund të krijojnë barrë të panevojshme për shtetasit e huaj zejtarë. Regjistrimi në QKB, pajisja me NIPT, regjistrimi në Dhomen Kombëtare të Zejtarisë dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve janë masa të zakonshme, por mungesa e qartësisë	Afat i vazhdueshëm	Digjitalizimi i procedurave do të ofronte një ndarje të qartë dhe automatike midis veprimtarive të rregulluara dhe atyre të lira, duke ofruar një rrugë të përshpejtuar për njohjen e kualifikimeve të huaja. Nevojitet krijimi i mekanizmave të standardizuar, siç janë portofolat digjitalë të punës apo testimet praktike të certifikuara, që lejojnë zejtarët të

		Urdhri nr. 99/2021, i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale”, i ndryshuar (FZ 87/21, 13/23, 163/23, 155/24, 151/25)	të pajisen me NIPT dhe të sigurojnë njohjen e kualifikimeve të tyre nga institucionet shqiptare kompetente. Këto kërkesa, të cilat janë të domosdoshme sipas legjislacionit në fuqi, mund të funksionojnë si barrierë hyrëse për shtetasit e huaj që nuk i plotësojnë paraprakisht ose nuk arrijnë t'i përmbushin në kohë kriteret përkatëse. Në mënyrë të veçantë, shtetasit e huaj që synojnë të ushtrojnë veprimtari në fushën e zejtarisë në territorin shqiptar duhet të regjistrohen pranë Dhomës Kombëtare të Zejtarisë dhe të kalojnë provimin e kualifikimit ose të ndjekin procedurat për njohjen e kualifikimeve të fituara në vendin e tyre të origjinës. Këto detyrime formale synojnë sigurimin e standardeve profesionale në tregun		së plotë ligjore, sidomos në lidhje me dallimin ndërmjet veprimtarive të rregulluara dhe të lira, si dhe mungesa e procedurave të standardizuara dhe të përshpejtuara për njohjen e kualifikimeve të huaja dhe të aftësive të fituara në mënyrë joformale, krijojnë potencialisht barrierë të panevojshme. Për të garantuar proporcionalitetin real në zbatim, nevojitet qartësim i procedurave të njohjes së kualifikimeve, krijimi i mekanizmave për verifikimin e aftësive joformale, rishikimi i kërkesave të dyfishta administrative, rritja e transparencës përmes udhëzuesve të qartë dhe të aksesueshëm, si dhe kryerja e rishikimeve periodike të kuadrit ligjor. Këto ndërhyrje do të siguronin balancimin e nevojshëm midis mbrojtjes së interesit publik dhe aksesit të drejtë e jo-diskriminues në treg për profesionistët e huaj.	dëshmojnë mjeshtërinë e tyre pa pasur nevojë për dokumentacion akademik shpesh të paarrtshëm për përvojën praktike. Duke rritur transparencën përmes udhëzuesve të detajuar të aksesueshëm online dhe duke kryer rishikime periodike të ligjit, mund të garantohet një proporcionalitet real midis mbrojtjes së cilësisë së shërbimit dhe aksesit të lirë në treg.
--	--	--	--	--	--	--

			vendas, por ndërkohë mund të përbëjnë kufizim shtesë për aksesin e zejtarëve të huaj në ushtrimin e profesionit.				
--	--	--	--	--	--	--	--

Rregullatori			MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONËSISE INDUSTRIALE				
Sektori i shërbimeve profesionale			Pronësia industriale				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor apo praktikë administrative)	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Përfaqësues i Autorizuar për Patentat e Shpikjeve dhe Modeleve të Përdorimit	Ligj nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar (FZ 121/08, 29/13, 96/14, 43/17, 125/21, 192/24, 138/25) Neni 195-198/a Vendim nr. 317, datë 31.05.2018, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “për përfaqësuesit e autorizuar në drejtorinë e përgjithshme të	Përfaqësues i autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit mund të jetë: 1- Çdo person me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë me kusht që të ketë përfunduar së paku studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave”, në fushën e inxhinierisë ose të shkencave natyrore ose farmaceutike, si dhe të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale, ose në një fushë tjetër dhe të ketë	Legjislacioni shqiptar vendos diskriminim të drejtpërdrejtë bazuar në vendqëndrimin në Shqipëri të përfaqësuesit të autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit, pasi përcaktohet se shtetasit e huaj duhet të kenë vendbanimin e tyre të zakonshëm në Shqipëri për tu pajisur me certifikatën përkatëse dhe ushtrimin e profesionit.	Të riformulohet pika 1.1 dhe 2.1, e nenit 197, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, për të shmangur kërkesën për qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë si kusht për t'u bërë përfaqësues i autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit. Kërkesa aktuale për qëndrim të përhershëm në Shqipëri diskriminon shtetasit e shteteve anëtare të BE-së dhe ZEE-së. Heqja e kësaj kërkesë	Afat i vazhdueshëm	Rekomandohet digjitalizimi i plotë i procedurave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI). Përmes një platforme të integruar online, ku aplikimet për patentat, diseno industriale dhe tregues gjeografikë kryhen tërësisht në rrugë elektronike, përfaqësuesit e huaj mund të operojnë me efikasitet të plotë nga distanca.

		pronësisë industriale”, i ndryshuar (FZ 82/18, 98/22)	jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune në këtë fushë, si dhe të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale. Gjithashtu të ketë kaluar testimin për kualifikimin e përfaqësuesve të autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit. 2- Çdo ish-punonjës i DPPI-së i diplomuar, që ka jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale në DPPI.		përputhet me nenin 14 (1) (b) të Direktivës së Shërbimeve duke siguruar akses jodiskriminues në profesionin e përfaqësuesve të autorizuar për të drejtat e pronësisë industriale.		
2	Përfaqësues i Autorizuar për Disenjot Industriale, Markat Tregtare dhe Treguesit Gjeografikë	Ligj nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar (FZ 121/08, 29/13, 96/14, 43/17, 125/21, 192/24, 138/25) Neni 195-198/a Vendim nr. 317, datë 31.05.2018, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e	Përfaqësues i autorizuar për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë mund të jetë: 1- Çdo person me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, me kusht që të ketë kryer së paku studimet e ciklit të dytë “Master profesional”, si dhe të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në	Legjislacioni shqiptar vendos diskriminim të drejtpërdrejtë bazuar në vendqëndrimin në Shqipëri të përfaqësuesit të autorizuar për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë, pasi përcaktohet se shtetasit e huaj duhet të kenë vendbanimin e tyre të zakonshëm në Shqipëri për tu pajisur me certifikatën përkatëse dhe ushtrimin e profesionit.	Të riformulohet pika 1.1 dhe 2.1, e nenit 197, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, për të shmangur kërkesën për qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë si kusht për t'u bërë përfaqësues i autorizuar për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë. Kërkesa aktuale për qëndrim të përhershëm	Afat i vazhdueshëm	Rekomandohet digjitalizimi i plotë i procedurave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI). Përmes një platforme të integruar online, ku aplikimet për patenta, disenjo industriale dhe tregues gjeografikë kryhen tërësisht në rrugë elektronike,

		rregullores “për përfaqësuesit e autorizuar në drejtorinë e përgjithshme të pronësisë industriale”, i ndryshuar (FZ 82/18, 98/22)	fushën e pronësisë industriale dhe të ketë kaluar testimin për kualifikimin e ekspertëve në fushën e markave, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë. 2- Çdo ish-punonjës i DPPI-së i diplomuar, që ka jo më pak se 3 vjet përvojë pune në çështjet e pronësisë industriale pranë DPPI-së.		në Shqipëri diskriminon shtetasit e shteteve anëtare të BE-së dhe ZEE-së. Heqja e kësaj kërkesë përputhet me nenin 14 (1) (b) të Direktivës së Shërbimeve duke siguruar akses jodiskriminues në profesionin e përfaqësuesve të autorizuar për të drejtat e pronësisë industriale.		përfaqësuesit e huaj mund të operojnë me efikasitet të plotë nga distanca.
3	Ekspert për Patentat e Shpikjeve dhe Modeleve të Përdorimit	Ligj nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar (FZ 121/08, 29/13, 96/14, 43/17, 125/21, 192/24, 138/25) Neni 198/b-198/ç Vendim nr. 501, datë 29.08.2018 , i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për ekspertët e objekteve të pronësisë industriale”, te	Ekspert për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit mund të jetë: 1- Çdo individ me kusht që të ketë qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, të ketë përfunduar një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” në fushën ku kërkohet ekspertizë, të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune si përfaqësues i autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit apo të jetë kualifikuar	Legjislacioni shqiptar vendos diskriminim të drejtpërdrejtë bazuar në vendqëndrimin në Shqipëri të ekspertit për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit. Shtetasit e huaj duhet të kenë vendbanimin e tyre të zakonshëm në Shqipëri për tu pajisur me certifikatën përkatëse dhe ushtrimin e profesionit.	Të hiqet kërkesa për qëndrim të përhershëm në Shqipëri për ekspertët e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit, siç përcaktohet në nenin 198/b, të ligjit nr. 9947/2008. Kjo kërkesë bie ndesh me nenin 14(1)(b) të Direktivës së Shërbimeve duke diskriminuar në bazë të shtetësisë ose vendbanimit. Heqja e këtij kushti u lejon shtetasve të shteteve anëtare të BE-së/ZEE-së me qëndrim të përhershëm në vendet	Afat i vazhdueshëm	Rekomandohet zhvillimi i një platforme të avancuar digjitale për DPPI-në, e cila integron nënshkrimin elektronik dhe arkivat cloud, do të lejonte që i gjithë procesi i ekspertizës, nga shqyrtimi i risisë së një shpikjeje deri te vlerësimi i treguesve gjeografikë, të kryhet në rrugë tërësisht elektronike. Ky modernizim do të mundësonte një bashkëpunim në kohë reale midis

		ndryshuar (FZ 128/18, 105/22)	në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale dhe të ketë kaluar testimin për kualifikimin e ekspertëve të fushës për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit. 2- Çdo ish-punonjës i DPPI-së i diplomuar në fushën ku kërkohet ekspertizë, që ka jo më pak se 4 vjet eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale dhe çdo ish-anëtar i Bordit të Apelit pranë DPPI-së, që ka jo më pak se 2 vjet pune në këtë bord.		e tyre të regjistronen si ekspertë në Shqipëri.		ekspertëve vendas dhe të huaj, duke rritur transparencën dhe duke shkurtuar afatet e shqyrtimit të aplikimeve.
4	Ekspert për Disenjt Industrial, Markat Tregtare dhe Treguesit Gjeografikë	Ligj nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar (FZ 121/08, 29/13, 96/14, 43/17, 125/21, 192/24, 138/25) Neni 198/b-198/ç Vendim nr. 501, datë 29.08.2018, i Këshillit të	Ekspert për disenjt industrial, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë mund të jetë: 1- Çdo individ me kusht që të ketë qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune si përfaqësues i autorizuar për markat,	Legjislacioni shqiptar vendos diskriminim të drejtpërdrejtë bazuar në vendqëndrimin në Shqipëri të ekspertit për disenjt industrial, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë, pasi përcaktohet se shtetasit e huaj duhet të kenë vendbanimin e tyre të zakonshëm në Shqipëri për tu pajisur me certifikatën përkatëse.	Të hiqet kërkesa për qëndrim të përhershëm në Shqipëri për ekspertët për disenjt industrial, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë, siç përcaktohet në nenin 198/b, të ligjit nr. 9947/2008. Kjo kërkesë bie ndesh me nenin 14(1)(b) të Direktivës së Shërbimeve duke	Afat i vazhdueshëm	Rekomandohet zhvillimi i një platforme të avancuar digjitale për DPPI-në, e cila integron nënshkrimin elektronik dhe arkivat cloud, do të lejonte që i gjithë procesi i ekspertizës, nga shqyrtimi i risisë së një shpikjeje deri te vlerësimi i treguesve gjeografikë, të kryhet

		Ministrave "Për miratimin e rregullores për ekspertët e objekteve të pronësisë industriale", te ndryshuar (FZ 128/18, 105/22)	disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë pranë DPPI-së apo të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse të specializuara në fushën e pronësisë industriale, të ketë kaluar testimin për kualifikimin e ekspertëve në fushën e markave, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë dhe të ketë përfunduar një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave". 2- Çdo ish-punonjës i DPPI-së që ka jo më pak se 4 vjet eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale, si dhe çdo ish-anëtar i Bordit të Apelit pranë DPPI-së, që ka jo më pak se 2 vjet pune në këtë bord.		diskriminuar në bazë të shtetësisë ose vendbanimit. Heqja e këtij kushti u lejon shtetasve të shteteve anëtare të BE-së/ZEE-së me qëndrim të përhershëm në vendet e tyre të regjistrohen si ekspertë në Shqipëri.		në rrugë tërësisht elektronike. Ky modernizim do të mundësonte një bashkëpunim në kohë reale midis ekspertëve vendas dhe të huaj, duke rritur transparencën dhe duke shkurtuar afatet e shqyrtimit të aplikimeve.
--	--	--	---	--	--	--	---

Plani i masave – Sektori i Financave

Rregullatori	MINISTRIA E FINANCAVE DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE
Sektori i shërbimeve profesionale	Dogana

Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor apo praktikë administrative)	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Agjent Doganor	Ligj nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (FZ 134/14, 63/15), Pika 6, e nenit 6, dhe nenet 24, 25 dhe 26. VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat në zbatim të Kodit Doganor”, i ndryshuar (FZ 199/17, 114/19, 137/19, 22/20, 227/24) s Udhëzimi nr. 5, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të procedurave të miratimit dhe funksionimit të përfaqësimit në doganë”, i ndryshuar Udhëzimi nr. 11, datë 20.07.2018 “Për zbatimin	Agjentë doganorë konsiderohen personat të licencuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të kryer formalitetet doganore. Personi në këto raste, duhet të ketë shtetësi shqiptare, të ketë diplomë universitare, të gjykohet i besueshëm nga administrata doganore, të kalojë provimin të organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të ketë eksperiencë pune si punonjës pranë një agjencie doganore jo më pak se 1 vit, dhe nuk duhet të jetë i punësuar në administratë publike apo shtetërore.	Kuadri ligjor aktual diskriminon në mënyrë të qartë në bazë të shtetësisë. Vetëm qytetarët ose subjektet shqiptare të regjistruara në Shqipëri mund të autorizohen si agjentë doganorë, gjë që kufizon drejtpërdrejt aksesin në profesion për shtetasit e huaj.	Të hiqet kërkesa për shtetësi shqiptare si kusht për këtë profesion, në mënyrë që të lejohet regjistrimi edhe për shtetasit e shteteve anëtare të BE-së/ZEE-së, me vendbanim në ato shtete anëtare.	Afat i vazhdueshëm	Rekomandohet digjitalizimi i plotë i procesit të autorizimit dhe operimit për të garantuar që vendndodhja gjeografike apo shtetësia të mos jenë më faktorë kufizues. Implementimi i sistemeve të avancuara dhe ndërfaqja e plotë me platformat e regjistrimit elektronik do të bënin që kontrolli mbi agjentët doganorë të bazohej te vlefshmëria e nënshkrimit elektronik dhe certifikimi i njohurive teknike, sesa te dokumentacioni fizik i vendbanimit. Një platformë digjitale e unifikuar do të mundësonte verifikimin e menjëhershëm të kualifikimeve evropiane, duke shndërruar burokracinë e sotme në një proces të shpejtë dhe transparent.

		praktik të garancisë së dorëzimit për agjencitë doganore					
--	--	--	--	--	--	--	--

Rregullatori			MINISTRIA E FINANCAVE/ BORDI I MBIQEQRJES PUBLIKE				
Sektori i shërbimeve profesionale			Auditim				
Nr.	Profesioni i rregulluar	Baza ligjore (ligj/akt nënligjor apo praktikë administrative)	Kufizimi i identifikuar	Vlerësimi i Transparencës dhe Proporcionalitetit	Ndërhyrja e kërkuar	Afati për përafrim	Vërejtje të tjera me rëndësi
1	Auditues ligjor	Ligj nr.10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", ndryshuar nga ligji nr. 10 091, datë 5.3.2009, Fletore Zyrtare (FZ) nr. 36/2009; Ligji nr.10 137, datë 11.5.2009, Fletore Zyrtare (FZ) nr. 86/2009; Ligji nr.10 297, datë 8.7.2010, Fletore Zyrtare (FZ) nr. 92/2010; Ligji nr. 47/2016, datë 28.4.2016, Fletore Zyrtare (FZ) nr. 84/2016; Ligji 126/2024, Fletore Zyrtare 7/2025.	Kërkesa që praktika profesionale të kryhet për tre vjet dhe që dy të tretat e saj të zhvillohen në Republikën e Shqipërisë; rregullat e pronësisë dhe të të drejtave të votës në shoqëritë audituese; mungesë e standardizimit publik të informacionit procedural (afate, ankime, aplikim elektronik) për regjistrimin dhe njohjen e audituesve të huaj.	Transparenca është në thelb e siguruar për bazën ligjore dhe identifikimin e autoriteteve, por mbetet e paplotë sa i përket publikimit të unifikuar të procedurave, afateve, mjeteve të ankimit dhe kanaleve elektronike. Proporcionaliteti është përgjithësisht i mbështetur nga interesat madhore të përgjithshme të profesionit, por kërkesa për kryerjen e 2/3 të praktikës në territorin e Shqipërisë paraqet risk të diskriminimit të tërthortë ndaj kandidatëve të vendosur jashtë vendit dhe kërkon rishqyrtim të argumentuar dhe, sipas rastit, zëvendësim me masa më pak kufizuese.	Rishqyrtim dhe riformulim i kërkesës territoriale të praktikës profesionale (2/3 në Shqipëri), duke vendosur një zgjidhje më pak kufizuese që ruan objektivin e cilësisë, si p.sh. njohja e praktikës së kryer në juridiksione me standarde të krahasueshme, e kombinuar me testim të detyrueshëm mbi legjislacionin shqiptar dhe, kur është e nevojshme, me masa kompensuese të synuara. Paralelisht, standardizim i publikimit të procedurave administrative për regjistrim dhe njohje të audituesve të huaj, me afate të shprehura, informim të qartë mbi	T4/2027	Vërejtje të tjera me rëndësi: Ndërhyrja duhet të koordinohet me organizatën profesionale dhe me strukturat e provimeve dhe regjistrimit, në mënyrë që ndryshimi i praktikës territoriale të mos ulë standardet e cilësisë, por të kalojë nga një kufizim territorial në një mekanizëm të verifikueshëm kompetencash. Duhet të sigurohet që regjimi i njohjes së audituesve të huaj të mbetet i parashikueshëm dhe i matshëm, përmes dokumentimit publik të kritereve, hapave dhe afateve.

ankimin dhe
funktionalizim të
aplikimit elektronik.

Plani i masave – Sektori i Sigurimeve

Rregullatori			AUTORITETI I MBIQEYRJES FINANCIARE				
Sektori i shërbimeve profesionale			Sigurime				
